

Natasha Kalemi
Luljeta Noka

Libër mësuesi
për tekstin shkollor

GJUHA SHQIPE 7



Shtëpia botuese Albas

Botues:
Latif AJRULLAI
Rita PETRO

Redaktore
Natasha PEPIVANI

Redaktore letrare
Imelda PRENÇE

Arti grafik:
Ela LUMANI

© Albas, 2016

ISBN 978-9928-02-787-0

Shtëpia botuese Albas

Në Tiranë: Rr. "Donika Kastrioti", pallati 14, ap. 4D.

Tel: 00355 45800160; e-mail: info@albas.al

Në Tetovë: Rr. "Ilinden", nr. 105

Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas_te@yahoo.com

Në Prishtinë: Rr. "Muharrem Fejza", p.n.

Tel: 00377 45 999 770

e-mail: albas_pr@yahoo.com

Shtypur në shtypshkronjën:
DEAPRINT

HYRJE

Të nderuar mësuese e mësues,

Shtëpia Botuese ALBAS po sjell për ju librin e mësuesit *Gjuha shqipe 8*, hartuar mbi programin e ri të MAS-it që mbështetet te kompetencat.

Libri i mësuesit është ndërtuar me katër ndarje:

I. Planifikimi lëndor, që përbëhet nga:

- a. plani mësimor *sintetik*, sipas kërkesave të programit;
- b. plani mësimor *analitik*, ndarë në tremujorë; sipas rubrikave që janë përcaktuar në Udhëzimet e MAS-it,
- c. rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç;
- d. rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës (në program).

II. Planifikimi ditor për çdo orë të trajtuar në tekstin mësimor.

III. Testimet për çdo tremujor.

IV. Projektet e sugjeruara.

Materiali që ju vihet në dispozicion është sugjerues. Në planifikim është mbajtur parasysh që të realizohen përgjithësisht kërkesat e orëve programit, por, brenda mundësive që të jep programi, u është dhënë një orë më shumë njohurive për gjuhën.

Orët e testeve, projekteve, bisedave janë parashikuar të merren nga të gjitha kompetencat. Në plan janë parashikuar orët e testeve dhe të diktiveve, kurse orët e projekteve apo të bisedave letrare nuk janë parashikuar të gjitha. Kjo i lihet në dorë mësuesit/es, të cilët mund të shfrytëzojnë temat mësimore të të lexuarit, të të shkruarit për të planifikuar bisedat letrare, projektet, por edhe orët e të folurit dhe të të dëgjuarit. Kështu, mund të planifikohet një projekt me orët e të shkruarit për të përgatitur një udhëzues turistik, nga orët e të lexuarit mund të planifikohet një projekt për dramatizimin e dramës “Epoka para gjyqit”, është parashikuar një projekt për mjedisin, por mund të zhvillohet edhe për marrëdhëniet në grup etj.

Në planin ditor janë bërë përpjekje që të ofrohen modele mësimi dhe metodologji të tilla, ku nxënësit të jetë në qendër të orës së mësimi, të nxitet fantazia dhe puna e tyre krijuese dhe të shfrytëzohen në mënyrë sa më racionale njohuritë që ata kanë, jo vetëm nga kjo lëndë, por edhe nga lëndët e tjera.

Për çdo pjesë leximi janë parashikuar dy orë, ku orën e parë kërkohet që të lexohet pjesa dhe të punohet rubrika *Kuptimi dhe mesazhi*, kurse në orën e dytë duhet të punohen dy rubrikat e tjera të tekstit *Interpretimi dhe vlerësimi* dhe *Gjuha dhe stili*.

Ushtrimet dhe kërkesat që ofron libri janë të studiuara që çdo çështje të zërthehet duke e vënë nxënësin të punojë me laps në dorë, të thellohen në njohuritë e marra dhe çdo orë të fitojnë njohuri të reja.

Teksti është i digjitalizuar. Në librin elektronik, që ju mund ta shkarkoni në kompjuter, me kodin që ka çdo libër, ju do të keni tekstet e të dëgjuarit dhe materiale të tjera, që do t’ju ndihmojnë në punën tuaj.

Shpresojmë që me këtë botim të kemi ndihmuar sadopak për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së lëndës së gjuhës shqipe.

Mirëpresim çdo mendim dhe sugjerim nga ju.

PËRMBAJTJA

Planifikimi vjetor i lëndës Gjuha shqipe VIII	8
1. Të folurit Komunikimi dhe gjuha	39
2. Të lexuarit Endur në tisin e kohës (V. Kokona)	40
3. Të lexuarit Endur në tisin e kohës (V. Kokona)	42
4. Fonetikë Theksi i fjalës dhe i fjalisë	43
5. Fonetikë Grupet e zanoreve dhe diftongjet në gjuhën shqipe	44
6. Të dëgjuarit Ay mal (L. Skëndo)	45
7. Të shkruarit Eseja	47
8. Të shkruarit Eseja për Atdheun	50
9. Drejtshkrim Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupe zanoresh dhe diftongje	51
10. Fjalëformim Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe	53
11. Të lexuarit Moxarti (Stefan Cvajg)	54
12. Të folurit Më shumë për Moxartin dhe muzikën klasike	57
13. Fjalëformim Fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura	59
14. Drejtshkrim Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura	61
15. Të lexuarit Intervista me Ivna Mulën	62
16. Të shkruarit Intervista	63
17. Të shkruarit Intervista	65
18. Drejtshkrim Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra	66
19. Drejtshkrim Drejtshkrimi i fjalëve të përngjitura	67
20. Të lexuarit Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit (J. Hahn)	68
21. Të lexuarit Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit (J. Hahn)	69
22. Të shkruarit Udhëzuesi turistik	71
23. Të shkruarit Udhëzuesi turistik	72
24. Leksikologji Fusha leksikore	74
25. Leksikologji Fjalët me kuptim të parë dhe të figurshëm	76
26. Të lexuarit Për te shpella e Pëllumbasit	78
27. Të lexuarit Për te shpella e Pëllumbasit	79
28. Leksikologji Llojet e sinonimeve, antonimeve dhe homonimeve	80
29. Të dëgjuarit Zbulimet arkeologjike	81
30. Leksikologji Gjuha shqipe dhe standardi	82
31. Të lexuarit Ndotja e ujërave (reportazh)	84
32. Të shkruarit Reportazhi	85
33. Të shkruarit Reportazhi	87
34. Morfologji Klasat e fjalëve. Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme	88
35. Të lexuarit Zërat nga Çernobili (S. Alekseviç)	89
36. Të lexuarit Zërat nga Çernobili (S. Alekseviç)	90
37. Morfologji Lakimi i emrave	92
38. Morfologji Emrat e dygjinishëm	93
39. Të lexuarit Heroi që nuk deshëm ta identifikojmë (F. Baxhaku)	94
40. Të lexuarit Heroi që nuk deshëm ta identifikojmë (F. Baxhaku)	96
41. Drejtshkrim Drejtshkrimi i emrave me dy trajta shumësi	97
42. Drejtshkrim Drejtshkrimi i Zanores <u>ë</u> në trup të fjalës	98

43.	Të shkruarit	Diktim 1	99
44.	Të lexuarit	Ma hiq atë celular (U. Eko)	100
45.	Të lexuarit	Ma hiq atë celular (U. Eko)	102
46.	Të folurit	Teksti enciklopedik	103
47.	Të lexuarit	Bisedë letrare	104
48.	Të lexuarit	Bisedë letrare	105
49.	Morfologji	Mbiemri. Përshtatja e mbiemrit me emrin	107
50.	Morfologji	Shkallët e mbiemrit	108
51.	Të shkruarit	Shkruajmë njoftime e rregullore	109
52.	Të shkruarit	Shkruajmë njoftime e rregullore	110
53.	Morfologji	Ushtrime për mbiemrin	112
54.	Morfologji	Përemri vetor. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor	113
55.	Drejtshkrim	Përdorimi i apostrofit te trajtat e shkurtra e të bashkuara	114
56.	Morfologji	Përemri dëftor, vetvetor	115
57.	Të dëgjuarit	Dëgjojmë lajme e njoftime	116
58.	Të lexuarit	Kundërajtori i vjetër (I.Kadare)	117
59.	Të lexuarit	Kundërajtori i vjetër (I.Kadare)	118
60.	Morfologji	Përemrat pyetës	120
61.	Morfologji	Ushtrime për përemrat	121
62.	Të lexuarit	Test 1	222
63.	Të shkruajmë	Kujtime nga vendlindja	132
64.	Të shkruajmë	Kujtime nga vendlindja	133
65.	Të lexuarit	Unë një e Çuli dy... (M. Kuteli)	134
66.	Të lexuarit	Unë një e Çuli dy... (M. Kuteli)	135
67.	Të folurit	Rëndësia e lojërave	136
68.	Morfologji	Foljet gjysmëndihmëse	137
69.	Morfologji	Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëftore dhe lidhore, forma joveprore	138
70.	Të lexuarit	Njeriu që ndiqte kuajt (N. Prifti)	139
71.	Të lexuarit	Njeriu që ndiqte kuajt (N. Prifti)	141
72.	Të shkruarit	Vazhdimi i tregimit	142
73.	Të shkruarit	Vazhdimi i tregimit	143
74.	Morfologji	Ushtrime për zgjedhimin jovepror të foljes	144
75.	Të lexuarit	Vdekja e lisnajës (A. Papeleka)	145
76.	Të lexuarit	Vdekja e lisnajës (A. Papeleka)	146
77.	Të shkruarit	Mbrojtja e mjedisit Projekt Ora I “Mjedis i gjelbër, jetë më e shëndetshme”	148
78.	Të lexuarit	Hajdutja e librave (M. Zusak)	149
79.	Të lexuarit	Hajdutja e librave (M. Zusak)	150
80.	Të folurit	Libri dhe lufta	152
81.	Morfologji	Folja. Zgjedhimi i foljeve në mënyrën kushtore dhe habitore	153
82.	Morfologji	Folja. Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëshirore dhe urdhërore	154
83.	Të lexuarit	Jakobi ndien si ne (R. Velsh)	155
84.	Të lexuarit	Jakobi ndien si ne (R. Velsh)	156
85.	Morfologji	Ushtrime për zgjedhimin e foljeve veprare në habitore...	158
86.	Morfologji	Pjesorja dhe Format e pashtjelluara të foljes	159

87.	Të dëgjuarit	Gjuha e ndjesive	160
88.	Të shkruarit	Përshkruajmë “Katër stinët” e Vivaldit	161
89.	Të lexuarit	Bisedë letrare	
90.	Të dëgjuarit	Bisedë letrare	
91.	Të lexuarit	Letër babait (Lë Klezio)	162
92.	Të lexuarit	Letër babait (Lë Klezio)	163
93.	Morfologji	Ushtrime për format e pashtjelluara të foljeve	165
94.	Morfologji	Lidhëzat dhe llojet e tyre	166
95.	Të shkruarit	Letra personale dhe formale	168
96.	Të lexuarit	Koni, miqtë dhe ethet e festës (D. Hoshtfeld)	169
97.	Të lexuarit	Koni, miqtë dhe ethet e festës (D. Hoshtfeld)	170
98.	Morfologji	Lidhëzat nënrenditëse	174
99.	Morfologji	Ushtrime për lidhëzat	175
100.	Të lexuarit	Projekt Ora II “Mjedis i gjelbër, jetë më e shëndetshme”	
101.	Të folurit	Marrëveshja në grup	177
102.	Të shkruarit	Ritregojmë një tregim (Përmbledhja)	178
103.	Të shkruarit	Ritregojmë një tregim (Përmbledhja)	179
104.	Të lexuarit	Figurat kryesore letrare	180
105.	Morfologji	Pasthirrmat	182
106.	Të lexuarit	Një ditë e ka dhe korbi (M. Camaj)	183
107.	Të lexuarit	Ekstazë pranverore (Migjeni)	185
108.	Të lexuarit	Poradeci (L. Poradeci)	188
109.	Morfologji	Pjesëzat	190
110.	Të lexuarit	Kinema e vjetër (I. Kadare)	191
111.	Sintaksë	Funksionet e fjalëve dhe grupit të fjalëve në fjali. Kryefjala	193
112.	Sintaksë	Kallëzuesi dhe llojet e tij	194
113.	Të folurit	Piktura dhe fotografia	197
114.	Të lexuarit	Edukimi i Herakliut (Staikos)	198
115.	Të lexuarit	Edukimi i Herakliut (Staikos)	199
116.	Të folurit	Sporti në Greqinë e lashtë	201
117.	Të lexuarit	Prometeu i lidhur (Eskili)	204
118.	Të lexuarit	Prometeu i lidhur (Eskili)	206
119.	Sintaksë	Ushtrime për kryefjalën dhe kallëzuesin	208
120.	Sintaksë	Kundrinori i drejtë dhe mënyrat e shprehjes	209
121.	Të dëgjuarit	Lloje të ndryshme tekstesh	210
122.	Të dëgjuarit	Projekt ora III “Mjedis i gjelbër, jetë më e shëndetshme”	211
123.	Të lexuarit	Ymer Aga (Popullore)	212
124.	Të lexuarit	Ymer Aga (Popullore)	213
125.	Sintaksë	Kundrinori i zhdrejtë dhe mënyrat e shprehjes	214
126.	Të shkruarit	Përshtatim vargjet në prozë	216
127.	Të shkruarit	Përshtatim vargjet në prozë	219
128.	Të lexuarit	Test 2	220
129.	Të lexuarit	Shporta magjike (Përrallë rome)	231
130.	Të lexuarit	Shporta magjike (Përrallë rome)	232
131.	Të dëgjuarit	Përralla dhe fabula	233

132.	Sintaksë	Rrethanori i vendit dhe i kohës	234
133.	Sintaksë	Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit	235
134.	Të lexuarit	Marko Boçari (F. Ballanca)	236
135.	Të lexuarit	Marko Boçari (F. Ballanca)	237
136.	Të folurit	Krenar si një shqiptar	239
137.	Sintaksë	Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre	240
138.	Sintaksë	Ushtrime për rrethanorët	243
139.	Sintaksë	Ushtrime përmbledhëse për gjymtyrët e dyta	245
140.	Të lexuarit	PROJEKT Ora I Dramatizojmë “Epoka para gjyqit”(E. Kryeziu)	
141.	Të lexuarit	Epoka para gjyqit (E. Kryeziu)	247
142.	Të lexuarit	Epoka para gjyqit (E. Kryeziu)	248
143.	Sintaksë	Fjalìa e përbërë	250
144.	Sintaksë	Ushtrime për fjalitë e përbëra	251
145.	Drejtshkrim	Përdorimi i pikës dhe pikëçuditjes në llojet e ndryshme të fjalive	252
146.	Të shkruarit	Kthejeni dramën në tregim	253
147.	Të shkruarit	Kthejeni dramën në tregim	254
148.	Të lexuarit	Zana e vizitorit (Gj. Fishta)	255
149.	Të lexuarit	Zana e vizitorit (Gj. Fishta)	256
150.	Të dëgjuarit	Gojëdhëna e mitologji shqiptare	258
151.	Sintaksë	Fjalitë me bashkërenditje dhe nënrenditje	259
152.	Sintaksë	Ushtrime për fjalitë me bashkërenditje dhe nënrenditje	260
153.	Të lexuarit	Kërcimtarja e Dukagjinit (E. Koliqi)	261
154.	Të lexuarit	Kërcimtarja e Dukagjinit (E. Koliqi)	263
155.	Të shkruarit	Përshkruajmë veshje popullore	265
156.	Të shkruarit	Përshkruajmë veshje popullore	266
157.	Sintaksë	Llojet e fjalitë me bashkërenditje	267
158.	Sintaksë	Ushtrime për fjalitë me bashkërenditje	268
159.	Drejtshkrim	Përdorimi i presjes	269
160.	Të lexuarit	Historia pa mbarim (M. Ende)	270
161.	Të lexuarit	Historia pa mbarim(M. Ende)	272
162.	Sintaksë	Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë	273
163.	Sintaksë	Rendi i pjesëve në ligjëratën e drejtë dhe shenjat e pikësimit	274
164.	Sintaksë	Ushtrime për ligjëratën e drejtë e të zhdrejtë	275
165.	Drejtshkrim	Përdorimi i shumëpikëshit në fjali	276
166.	Të lexuarit	Princi i vogël (A. Ekzyperi)	277
167.	Të lexuarit	Princi i vogël (A. Ekzyperi)	279
168.	Të lexuarit	Diktim 2	280
169.	Të dëgjuarit	Dëgjojmë dhe shijojmë poezi	282
170.	Sintaksë	Ushtrime përmbledhëse për sintaksën	283
171.	Të lexuarit	Test 3	
172.	Të folurit	Vepra dhe autori	284
173.	Të lexojmë	Ishuj në qiell	285
174.	Të lexuarit	Nata e dymbëdhjetë	287
175.	Të lexuarit	Nata e dymbëdhjetë	289

Panifikimi vjetor i lëndës *Gjuha shqipe VIII*

Kompetencat/ klasat	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi drejtë i gjuhës	Totali
Klasa VII	10	10	70	25	60	175

Brenda këtyre orëve janë parashikuar 3 projekte (1 për çdo tremujor)

3 Biseda letrare (1 për çdo tremujor)

3 Teste (1 për çdo tremujor)

2 Diktime

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS PËR TREMUJORIN I

	SHTATOR – DHJETOR	JANAR–MARS	PRILL–QERSHOR
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	3 orë	5 orë	2 orë
Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	4 orë	3 orë	2 orë
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	22 orë	22 orë	28 orë
Të shkruarit për qëllime formale dhe funksionale	14 orë	7 orë	4 orë
Përdorimi i drejtë i gjuhës	27 orë	1 orë	16 orë

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT

1. Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
2. Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
3. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruues, shkencor, publicistik etj.
4. Komenton pjesën sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
5. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
6. Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim.
7. Shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore.
8. Shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare ose të huaj, për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.
9. Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

KOMPETENCA E TË MENDUARIT

1. Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media.
2. Shpreh mendimin për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit.
4. Zgjidh një problem (gjuhësor) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
5. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (gjuhësor) duke paraqitur rezultat të njëjtë.
6. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive o s e krijimeve artistike.

KOMPETENCA E TË NXËNIT

1. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
2. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
3. Shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.
4. Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela,grafike) sipas një radhitjeje logjike.
5. Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijës.
6. Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. menaxhon

emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo diku tjetër).

KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN MJEDISIN.

1. Përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.
2. Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
3. Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrim (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve).
4. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) Për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
5. Merr pjesë si anëtar i një jurie, (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi artistik, duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.

KOMPETENCA PERSONALE

1. Merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike, etj., dhe raporton (me gojë, me shkrim) për përvojat personale të fituara.

KOMPETENCA QYTETARE

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. Dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.
2. Shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të ndryshme interesi.
3. Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

KOMPETENCA DIGJITALE

1. Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
2. Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
3. Zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe burimi është primar ose sekondar).
- 4.

TREMUJORI I PARË

Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës (në program)

TË DËGJUARIT

- Kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to.
- Jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.
- Dëgjon me vëmendje dhe përqendrim: duke mbajtur trupin në një pozicion korrekt.
- Shfaq interes, respekt dhe empati ndaj folësit me shprehje të tilla.
- Nxit dhe inkurajon folësin me shprehje të tilla si: kjo që po rrëfeni është shumë interesante etj.

- Përcakton qëllimin e të dëgjuarit (për kënaqësi, për informacion, për kuriozitet etj.).
- Kujton njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit.
- Parashikon rreth tekstit që do të dëgjojë.
- Mban shënime gjatë të dëgjuarit.
- Pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i kupton mirë.
- Kërkon informacion shtesë.
- Ritregon me detaje dhe ilustrime përmbajtjen e tekstit.
- Interpretë tekstin duke dhënë gjykimet e tij.
- Identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (në biseda, në television ose në ndonjë media tjetër).
- Dallon rendin e ngjarjeve dhe ideve.
- Klasifikon detajet në një tekst.
- Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst.
- Dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst.
- Përcakton me ndihmën e mësuesit qëllimin ose synimin e folësit (këshillon, bind, sqaron etj.).
- Dallon ndjenjat e folësit.

TË FOLURIT

- Zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij.
- Merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.
- Identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në media.
- Flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (e fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje të tjerët.
- Jep informacione, ide, ndjesi, emocione duke përdorur fjalorin e duhur.
- Përshtat të folurin në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës.
- Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup nxënësish.
- Bën pyetje për t'u sqaruar dhe për të marrë më shumë informacion gjatë diskutimeve në grup.
- Ofron të dhëna ose informacion, si dhe shpreh mendimin ose këndvështrimin e tij personal.
- Jep argumentet e tij gjatë diskutimeve në grup, si dhe pranon idetë e të tjerëve.
- Reciton me ndjenjë pjesë të ndryshme para bashkëmoshatarëve dhe mësuesve në aktivitete të ndryshme në shkollë.
- Planifikon dhe organizon lojëra me role.

TË LEXUARIT

- Interpretë tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara.
- Dallon informacionin e rëndësishëm në tekst. – lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.
- Analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme.
- Dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik.
- Dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre.
- Shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.
- Dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme.
- Përcakton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme
- Përdor fjalorë, për të sqaruar e për të gjetur kuptimin e një fjale dhe enciklopedi, për të marrë informacion.

- Përdor disa strategji (para, gjatë dhe pas leximit) për të kuptuar tekstin.
- Analizon elementet figurative që shoqërojnë tekstet (piktura, ilustrime, lista, tabela, harta etj.) për të kuptuar më mirë tekstin.
- Përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti.
- U përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit.
- Lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme.
- Krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj..
- Gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit
- Dallon tekstet letrare dhe joletrare.
- Dallon elemente të formës dhe strukturës së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre.
- Lexon tekste të llojeve të ndryshme letrare: në poezi, në prozë dhe tekste dramatike, të përshtatshme për moshën e tij.
- Flet shkurt (3-4 fjali) për autorin e tekstit letrar (krijimtarinë, jetën).
- Diskuton rreth përmbajtjes, personazheve, përshtypjeve dhe ndjesive për tekstet që lexon.
- Ritregon histori duke u bazuar në fjalë kyç, skica ose foto e figura.
- Ritregon me hollësi subjektin, duke e ilustruar me detaje nga teksti.
- Bën pyetje të ndryshme rreth tekstit.
- U përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij ose me shembuj nga teksti.
- Rendit ngjarjet e një teksti.
- Përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet.
- Përshkruar pamjen, tiparet, sjelljen e personazheve (duke u bazuar në tekst).
- Analizon marrëdhëniet mes personazheve, vlerëson sjelljet e tyre, si dhe i krahason me veten ose njerëzit që njeh.
- Gjen idetë kryesore në një tekst dhe formulon temën dhe idenë kryesore.
- Jep dhe argumenton këndvështrimet e tij rreth temës, ideve, personazheve etj.
- Kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato.
- Dallon epitetin, krahasimin, personifikimin metaforën, hiperbolën, aliteracionin personifikimin dhe tregon efektin që krijojnë ata.
- Shpjegon kuptimin e një teksti poetik, duke u bazuar në ndjenjat dhe përvojën e tij.
- Dallojnë rimën dhe strofën (llojet kryesore) në një tekst poetik.
- Dallon disa karakteristika të disa teksteve në prozë,
- Dallon dhe analizon disa elemente të strukturës së një teksti dramatik, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë.
- Përdor bibliotekën dhe internetin për të lexuar tekste të ndryshme.
- Reciton me ndjenjë poezi, copëza proze ose luajnë një rol nga një tekst dramatik.
- Lexon tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura, si: autobiografi, biografi (të një shkrimtari, sportisti, shkencëtari), intervista, enciklopedi të shtypura dhe elektronike, udhëzime, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, njoftime.
- Dallon e përdor njohuritë për karakteristikat e përbashkëta të teksteve, si: tema, paragrafi, fjalitë përmbyllëse, fjali etj.
- Dallon dhe përdor njohuritë për mënyrën e organizimit të tekstit (rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.).
- Pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga tekste e fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore dhe i përdor ato.
- Ndan përvojat dhe kënaqësitë e leximit me shokët e shoqet e klasës.
- Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst.
- Dallon problemin dhe zgjidhjen.
- Dallon faktet dhe opinionet në një tekst.
- Dallon disa veçori të teksteve si: citimet dhe referencat dhe të shpjegojnë funksionin e tyre.

- Dallon në një tekst përdorimin e argumenteve pro dhe kundër për një çështje të caktuar.
- Shpjegon funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave,
- Ilustrimeve, me të cilat shoqërohen tekstet.
- Dallon në tekste disa elemente të stilit dhe të gjuhës si p.sh.: zgjedhja e fjalëve. përdorimi i mbiemrave. përdorimi i fjalive të ndryshme (të thjeshta, të përbëra, të plota dhe mungesore.

TË SHKRUARIT

- Përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara.
- Mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.
- Identifikon qëllimin dhe lexuesin e tij, kur shkruan njohur për bashkëmoshatarët e tyre etj.
- Mbledh informacionin e duhur për të trajtuar subjektin e një teme të dhënë.
- Përdor burime të ndryshme për të mbledhur informacion.
- Studion dhe analizon modele të mira shkrimi që kanë trajtuar të njëjtën temë ose subjekt.
- Mban shënime për çështje të ndryshme të punës me shkrim.
- Përzgjedh dhe klasifikon informacionet e mbledhura.
- Përdor bibliotekën e shkollës ose internetin për të mbledhur informacion për punën dhe detyrat me shkrim.
- Zgjedh format e duhura të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit dhe lexuesit që ka.
- Mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.
- Respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme në shkrimet e tij, si p.sh., një larmi ndajfoljesh, mbiemrash etj., me qëllim që të ndikojë te lexuesi.
- Përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.
- Shkruan tekste me dorë ose duke përdorur teknologjinë e informacionit.
- Bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen, qartësinë dhe formën.
- Shpreh me vargje të thjeshta (strofa, rima) ndjenjat dhe mendimet e tij.
- Shkruan tregime të shkurtra duke pasur parasysh disa elemente, si: personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë.
- Kthen një tekst poetik në prozë.
- Rrëfen brendinë e një libri të preferuar për të.
- Përshkruan personazhe duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet e tyre, paraqitjen e jashtme dhe veprimet.
- Shkruan për ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një tekst letrar, si: tregim, poezi, përrallë etj.
- Krahason dy ose më shumë personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, dramë etj.
- Krahason dy ose më shumë tekste që trajtojnë të njëjtën tematikë.
- Përdor një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur gjatë të shkruarit.
- Shkruan shpjegime, udhëzime, njoftime të shkurtra.
- Shkruan letra formale p.sh., drejtuar stafit drejtues të shkollës ose përfaqësuesve të pushtetit vendor për probleme të ndryshme të shkollës, drejtuar një gazetari etj.
- Shkruan një intervistë drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për të nga fusha e artit, sportit, kinematografisë.
- Respekton formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit.
- Shkruan ese.

PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS, FONETIKË DHE FONOLOGJI

- Dallon grupet e zanoreve dhe diftongjet në gjuhën shqipe.
- Përcakton theksin e fjalës dhe fjalisë.

FJALËFORMIM

- Përcakton mënyrat e fjalëformimit të fjalëve në gjuhën shqipe.
- Dallon, përdor dhe krijon fjalë të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

DREJTSHKRIM

- Shkruan drejt zanoren ë në trup të fjalës.
- Shkruan drejt fjalët që kanë grupe zanoresh dhe diftongje **-ie** dhe **-je**.
- Shkruan drejt emrat që kanë dy trajta shumësi sipas kuptimit të ndryshëm të tyre.
- Shkruan drejt fjalët e prejardhura me prapashtesat **-si, -ri, -ar, -tar, -tor, -shëm** etj..
- Shkruan drejt fjalët e përbëra, kur fjala e dytë fillon me zanore. – shkruan drejt fjalët e përngjitura.

MORFOLOGJI

- Përcakton klasat e fjalëve.
- Klasifikon fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.
- Analizon emrin në kategoritë e tij gramatikore: gjini, numër, rasë dhe shquarsi-pashquarsi.
- Përcakton lakimin e emrave.
- Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore.
- Përcakton shkallët e mbiemrit.
- Dallon dhe analizon përemrat.

PANIANALITIK I TREMUJORIT TË PARË

NR	KOMPETENCA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE	VLERËSIMI	BURIMI
1	Të folurit 1	Komunikimi dhe gjuha	Situata të ndryshme komunikimi	Diskutim, Pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri, përvoja dhe materiale të nxënësve
2	Të lexuarit 1	Endur në tisin e kohës (V. Kokona)	Punë me tekstin	Lexim i pjesës, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri, përvoja të nxënësve
3	Të lexuarit 2	Endur në tisin e kohës (V. Kokona)	Punë me tekstin	Analizë e pjesës, Punë e pavarur, shkrim i lirë	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri,
4	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Fonetikë 1	Theksi i fjalës dhe i fjalisë	Poezia “Lejleku”	stuhi mendimi, analizë rastesh, punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri,
5	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Fonetikë 2	Grupet e zanoreve dhe diftongjet në gjuhën shqipe	Në dhomën time	Shkrim i lirë, stuhi mendimi, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri,
6	Të dëgjuarit 1	Ay mal (L. Skëndo)	Punë me tekstin	Diskutim, pyetje përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri, materiale të nevojshme
7	Të shkruarit 1	Eseja	Punë me modele	Punë e drejtuar me modele diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, modele esesh nga mësuesi
8	Të shkruarit 2	Eseja për Atdheun	Punët me shkrim të nxënësve	Punë e pavarur me shkrim diskutim, Turi I galerisë	Vlerësim i vazhduar Vetëvlerësim	Punët me shkrim të nxënësve
9	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Drejtshkrim 3	Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupe zanoresh dhe diftongje	Punë me tekstin	stuhi mendimi, diktim, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri, drejtshkrimi i gjuhës shqipe
10	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Fjalëformim 4	Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe	Vendlindja ime	stuhi mendimi, analizë rastesh, punë e drejtuar, punë e pavarur, INSERT.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve

11	Të lexuarit 3	Moxarti (Stefan Cvajg)	Pjesë nga Moxart	Dëgjim materialesh, lexim zinxhir, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti, e-libri, materiale të nxënësve
12	Të folurit 2	Më shumë për Moxartin dhe muzikën klasike	Punë me tekstin	Punë e pavarur, analizë rasti, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësit, e-libri
13	Përdorimi i drejtë i gjuhës Fjalëformim 5	Fjalët e preardhura, të përbëra dhe të përngjitura	Fragment nga romani “Këshjella”	stuhi mendimi, tabela e tipareve semantike, punë e drejtuar, punë e pavarur.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
14	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Drejtshkrim 6	Drejtshkrimi i fjalëve të preardhura	Punë me tekstin	diktim, punë e drejtuar, punë e pavarur.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe
15	Të lexuarit 4	Intervista me Ivna Mulën	Inva Mula	Lexim në role, diskutim, punë e drejtuar, pyetje-përgjigje, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri, përvoja të nxënësve, Intervista të Inva Mulës
16	Të shkruarit 4	Intervista	Intervistë me Inva Mulën	Analizë rasti, punë e drejtuar me modele.	Vlerësim dhe rivlerësim	Teksti i nxënësve,
17	Të shkruarit 5	intervista	Punë me shkrim	Punë e pavarur me shkrim	Vlerësim i vazhduar	
18	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Drejtshkrim 7	Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra	Punë me tekstin	stuhi mendimi, punë e drejtuar në çift, punë e pavarur.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
19	Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrim 8	Drejtshkrimi i fjalëve të përngjitura	Punë me tekstin	stuhi mendimi, konkurs, punë e drejtuar, punë e pavarur.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
20	Të lexuarit 5	Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit (J. Hahn)	Udhëtim nëpër Drin	Vëzhgim i materialeve të mbledhura, diskutim, lexim materiali	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
21	Të lexuarit 6	Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit (Punë me tekstin	Punë e pavarur, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
22	Të shkruajmë 6	Udhëzuesi turistik	Modele udhëzuesish turistike	Punë me modele	Vlerësim me gojë	Teksti materiale të ndryshme, model udhëzuesish turistike
23	Të shkruajmë 7	Udhëzuesi turistik	Punët me shkrim	Punë me shkrim diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti, materiale të ndryshme, model udhëzuesish turistike

24	Përdorimi i drejtë i gjuhës - Leksikologji 9	Fusha leksikore	Konkurs	stuhi mendimi, punë e drejtuar me modele, diskutim INSERT, punë e pavarur, Diagram Veni	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
25	Përdorimi i drejtë i gjuhës - Leksikologji 10	Fjalët me kuptim të parë dhe të figurshëm	Fragment ”Gjenerali i ushtrisë së vdekur” I.Kadare	stuhi mendimi, analizë rasti, INSERT, punë e drejtuar, punë e pavarur.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri përvoja të nxënësve
26	Të lexuarit 7	Për të shpella e Pëllumbasit	Pika turistike në vendin tim	Vëzhgim materialesh të ndryshme, lexim drejtuar, punë e drejtuar	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
27	Të lexuarit 8	Për të shpella e Pëllumbasit	Punë me tekstin	Punë e pavarur, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
28	Përdorimi i drejtë i gjuhës-Leksikologji 11	Llojet e sinonimeve, antonimeve dhe homonimeve	Punë me tekstin	Stuhi mendimi, shënime mbi shënime, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri, përvoja të nxënësve, fjalori i gjuhës shqipe
29	Të dëgjuarit 2	Zbulimet arkeologjike	Materiali në disk	Punë e drejtuar, diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim i vazhduar	CD, teksti, material të tjera shtesë
30	Përdorimi i drejtë i gjuhës Leksikologji 12	Gjuha shqipe dhe standardi	Punë me tekstin	Stuhi mendimi, Tabela e koncepteve, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, fjalorë të gjuhës shqipe
31	Të lexuarit 9	Ndotja e ujërave (reportazh)	Pasuri ujore të vendit tonë	Lexim i pjesës, punë e drejtuar , punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri, përvoja e materiale të nxënësve
32	Të shkruarit 8	Reportazhi	Reportazh “Valbona”	Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur, vëzhgim i materialeve në power point	Vlerësim me gojë	Teksti, e-libri, materiale të nxënësve, reportazh për Valbonën, You tube.
33	Të shkruarit 9	Reportazhi	Punë me shkrim.	Punë me shkrim	Vetëvlerësim Vlerësimi i vazhduar	Teksti i nxënësve

34	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 13	Klasat e fjalëve. Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.	Fantazma dhe plani tre+katër	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh	Vlerësim diagnostikues vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
35	Të lexuarit 10	Zërat nga Çernobili (S. Alekseviç)	Ndodja radioaktive	Punë e drejtuar, lexim zinxhir, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, materiale të nxënësve
36	Të lexuarit 11	Zërat nga Çernobili (S. Alekseviç)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
37	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 14	Lakimi i emrave	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
38	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 15	Emrat e dygjinishëm	Përshkrim i natyrës	Punë e drejtuar, analizë rastesh, punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
39	Të lexuarit 12	Heroi që nuk deshëm ta identifikojmë (F. Baxhaku)	Kronikë televizive	Punë e drejtuar, diskutim, lexim teksti	Vlerësim me gojë	Teksti, e-libri, përvoja e materiale të nxënësve
40	Të lexuarit 13	Heroi që nuk deshëm ta identifikojmë (F. Baxhaku)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diskutim.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
41	Përdorimi i drejtë i gjuhës - Drejtshkrimi 16	Drejtshkrimi i emrave me dy trajta shumësi	Shpend Bengu “Gjirokastra”	Punë e drejtuar, analizë rasti, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
42	Përdorimi i drejtë i gjuhës-Drejtshkrim 17	Drejtshkrimi i Zanores <u>ë</u> në trup të fjalës	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
43	Të shkruarit 10	Diktim 1	Diktim	Punë e drejtuar, diskutim	Vlerësim i vazhduar	Diktim i përgatitur nga mësuesi
44	Të lexuarit 14	Ma hiq atë celular (U. Eko)	Unë kam/nuk kam një celular, sepse....	Lexim zinxhir, pyetje-përgjigje, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
45	Të lexuarit 15	Ma hiq atë celular (U. Eko)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, shkrim i lirë, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve

46	Të folurit 3	Teksti enciklopedik	Enciklopedi për fëmijë	Diskutim, pyetje-përgjigje, harta e tregimit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Libri i përzgjedhur nga mësuesi dhe nxënësit
47	Të lexuarit 16	Bisedë letrare	Libri....	Tabela e koncepteve, shkrim i lirë, analizë gjuhësore,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Libri i përzgjedhur nga mësuesi dhe nxënësit
48	Të lexuarit 17	Bisedë letrare				
49	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 18	Mbiemri. Përshtatja e mbiemrit me emrin	Gjenerali i ushtrisë së vdekur	Punë e drejtuar, analizë rasti, punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve, e-libri
50	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 19	Shkallët e mbiemrit	Krahasojmë përdorime të mbiemrit	Punë e pavarur, diskutim,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve
51	Të shkruajmë 11	Shkruajmë njoftime e rregullore	Punë me modele	Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur, diskutim	Vetëvlerësim, vlerësim me gojë	Modele
52	Të shkruajmë 12	Shkruajmë njoftime e rregullore	Rregullorja e Shkolës	Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur, diskutim	Vetëvlerësim, vlerësim me notë	Modele
53	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 20	Ushtrime për mbiemrin	Përshtatim shokun e bankës	Shkrim i lirë, punë e drejtuar, diskutim, punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve
54	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 21	Përmiri vector. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përmirit vector	Aventurat e Tom Sojerit (M. Tuen)	Punë e drejtuar, analizë rasti, punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve
55	Përdorimi i drejtë i gjuhës-Drejtshkrim 25	Përdorimi i apostrofit te trajtat e shkurtra e të bashkuara	Përralla shqiptare	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve
56	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 22	Përmiri dëftor, vetvector,	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, analizë rasti, punë a pavarur	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve
57	Dëgjimë 3	Dëgjimë lajme e njoftime	Materiali në CD	Dëgjim materiali, diskutim, pyetje përgjigje	Vlerësim i vazhduar	Teksti, e-libri, CD.
58	Të lexuarit 18	Kundërajtori i vjetër (I.Kadare)	Gjyrokastra	Diskutim, lexim zinxhir, punë e drejtuar	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësheve, e-libri

59	Të lexuarit 19	Kundërajtori i vjetër (I.Kadare)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, analizë teksti, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
60	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 23	Përemrat pyetës	Dialog	Punë e drejtuar, analizë rasti, bashkëbisedim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
61	Përdorimi i drejtë i gjuhës - Morfologji 24	Ushtrime për përemrat	Shkruajmë një tregim	Shkrim i lirë, analizë rasti, punë e drejtuar	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
62	Të lexuarit 20	Test 1	Test	Testim	Vlerësim përmbledhës	Testi
63	Të shkruajmë 13	Kujtime nga vendlindja	Vendlindja ime	Punë e drejtuar, Punë me modele, punë e pavarur	Vlerësim me gojë	Teksti, përvojë të nxënësve
64	Të shkruajmë 14	Kujtime nga vendlindja	Punët me shkrim të nxënësve	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar, vetëvlerësim	Punimet e nxënësve
65	Të lexuarit 21	Unë një e Çuli dy (M. Kuteli)	Kujtime nga fëmijëria	DRTA, punë e drejtuar, punë e pavarur	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
66	Të lexuarit 22	Unë një e Çuli dy (M. Kuteli)	Punë me tekstin	Përshkrim personazhesh, punë e pavarur, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
67	Të folurit 4	Rëndësia e lojërave				
68	Përdorimi i drejtë i gjuhës-Morfologji 26	Foljet gjysmëndihmëse	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
69	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 27	Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëftore dhe lidhore, forma joveprore	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

TREMUJORI I DYTË

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës (në program)

TË DËGJUARIT

- Kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to.
- Jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.
- Dëgjon me vëmendje dhe përqendrim: duke mbajtur trupin në një pozicion korrekt.
- shfaq interes, respekt dhe empati ndaj folësit me shprehje të tilla.
- nxit dhe inkurajon folësin me shprehje të tilla si: kjo që po rrëfeni është shumë interesante etj.
- Përcakton qëllimin e të dëgjuarit (për kënaqësi, për informacion, për kuriozitet etj.).
- Kujton njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit.
- Parashikon rreth tekstit që do të dëgjojë.
- Mban shënime gjatë të dëgjuarit.
- Pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i kupton mirë.
- Kërkon informacion shtesë.
- Ritregon me detaje dhe ilustrime përmbajtjen e tekstit.
- Interpretin tekstin duke dhënë gjykimet e tij
- Identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (në biseda, në televizion ose në ndonjë media tjetër).
- Dallon rendin e ngjarjeve dhe ideve.
- Klasifikon detajet në një tekst.
- Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst.
- Dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst.
- Përcakton me ndihmën e mësuesit qëllimin ose synimin e folësit (këshillon, bind, sqaron etj.).
- Dallon ndjenjat e folësit.

TË FOLURIT

- Zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij.
- Merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.
- Identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në media.
- Flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (e fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje të tjerët.
- Jep informacione, ide, ndjesi, emocione duke përdorur fjalorin e duhur.
- Përshtat të folurin në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës.
- Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup nxënësi:
- Bën pyetje për t'u sqaruar dhe për të marrë më shumë informacion gjatë diskutimeve në grup.
- Ofron të dhëna ose informacion, si dhe shpreh mendimin ose këndvështrimin e tij personal.
- Jep argumentet e tij gjatë diskutimeve në grup, si dhe pranon idetë e të tjerëve.
- Reciton me ndjenjë pjesë të ndryshme para bashkëmoshatarëve dhe mësuesve në aktivitete të ndryshme në shkollë.
- Planifikon dhe organizon lojëra me role

TË LEXUARIT

- Interpreton tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara.
- Dallon informacionin e rëndësishëm në tekst. – lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.
- Analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme.
- Dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik.
- Dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre.
- Shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.
- Dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme.
- Kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme, një fjalor për të sqaruar e gjetur kuptimin e një fjale, një enciklopedi për fëmijë që të marrë informacion, përdor disa strategji (para, gjatë dhe pas leximit) për të kuptuar tekstin.
- Analizon elementet që shoqërojnë tekstet (piktura, ilustrime, lista, tabela, harta etj.) Për të kuptuar më mirë tekstin. i
- Përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti.
- U përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit.
- Lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme.
- Krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj..
- Gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit
- Dallon tekstet letrare dhe joletrare.
- Dallon elemente të formës dhe strukturës së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre.
- Lexon tekste të ndryshme letrare poetike, në prozë dhe dramatike, të përshtatshme për moshën e tij.
- Flet shkurt (3-4 fjali) për autorin e tekstit letrar (krijimtarinë, jetën).
- Diskuton rreth përmbajtjes, personazheve, përshtypjeve dhe ndjesive për tekstet që lexon.
- Ritregon histori duke u bazuar në fjalë kyçe, skica ose foto e figura.
- Ritregon me hollësi subjektin, duke e ilustruar me detaje nga teksti.
- Bën pyetje të ndryshme rreth tekstit.
- U përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij ose me shembuj nga teksti.
- Rendit ngjarjet e një teksti.
- Përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet.
- Përshkruan pamjen, tiparet, sjelljen e personazheve (duke u bazuar në tekst).
- Analizon marrëdhëniet mes personazheve, vlerëson sjelljet e tyre, si dhe i krahason me veten ose njerëzit që njeh.
- Gjen një tekst idetë kryesore dhe formulon temën dhe idenë kryesore.
- Jep dhe argumenton këndvështrimet e tij rreth temës, ideve, personazheve etj..
- Kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato.
- Dallon epitelin, krahasimin, personifikimin metaforën, hiperbolën, aliteracionin personifikimin dhe tregon efektin që krijojnë ata.
- Shpjegon kuptimin e një teksti poetik, duke u bazuar në ndjenjat dhe përvojën e tij.
- Dallojnë rimën dhe strofën (llojet kryesore) në një tekst poetik.
- Dallon disa karakteristika të disa teksteve në prozë,
- Dallon dhe analizon disa elemente të strukturës së një teksti dramatik si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë.
- Përdor bibliotekën dhe internetin për të lexuar tekste të ndryshme.

- Recitojnë me ndjenjë poezi, copëza proze ose luajnë një rol nga një tekst dramatik.
- Lexon tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura si: autobiografi, biografi (të një shkrimtari, sportisti etj.).
- Dallon dhe përdor njohuritë e përbashkëta të teksteve, si: tema, paragrafi, fjalitë përmblylëse, fjalori etj.
- Dallon dhe përdor njohuritë rreth mënyrës së organizimit të tekstit (rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.).
- Pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, nga tekstet që lexon, dhe i përdor ato.
- Ndan përvojat dhe kënaqësitë e leximit me shokët e shoqet e klasës.
- Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst.
- Dallon problemin dhe zgjidhjen.
- Dallon faktet dhe opinionet në një tekst.
- Dallon disa veçori të teksteve si: citimet dhe referencat dhe të shpjegojnë funksionin e tyre.
- Dallon në një tekst përdorimin e argumenteve pro dhe kundër për një çështje të caktuar.
- Shpjegon funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve, me të cilat shoqërohen tekstet.
- Dallon në tekste disa elemente të stilit dhe të gjuhës, si p.sh.: përdorimin e figurshëm të fjalëve, përdorimi i mbiemrave, përdorimi i tipave dhe llojeve të fjalive të ndryshme (dëftore, nxitëse, thirrmore; të thjeshta, të përbëra, të plota dhe mungesore.

TË SHKRUARIT

- Përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara.
- Mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.
- Identifikon qëllimin dhe lexuesin e tij, kur shkruan njohur për bashkëmoshatarët e tyre etj..
- Mbledh informacionin e duhur për të sqaruar rreth temës, çështjes, subjektit. kujton njohuritë që ka rreth temës që do të shkruajë.
- Përdor burime të ndryshme për të mbledhur informacion.
- Studion modele të mira shkrimi që kanë trajtuar të njëjtën temë ose subjekt. Mban shënime për çështje të ndryshme të punëve me shkrim.
- Përzgjedh dhe klasifikon informacionet e mbledhura.
- Përdor edhe bibliotekën e shkollës ose internetin për të mbledhur informacion për punën dhe detyrat me shkrim.
- Zgjedh format e duhura të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit dhe lexuesit që ka.
- Mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.
- Respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme në shkrimet e tij si p.sh., një larmi ndajfoljesh, mbiemrash etj., me qëllim që të ndikojë te lexuesi.
- Përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.
- Shkruan tekste me dorë ose duke përdorur teknologjinë e informacionit.
- Bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen, qartësinë dhe formën

- Shpreh me vargje të thjeshta (strofa, rima) ndjenjat dhe mendimet e tij.
- Shkruan tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve si: personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë.
- Kthen një tekst poetik në prozë.
- Rrëfen brendinë e një libri të preferuar për të.
- Përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tij.
- Shkruan për ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një tekst letrar si: tregim, poezi, përrallë etj..
- Krahason dy ose më shumë personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, dramë etj.,
- Krahason dy ose më shumë tekste që trajtojnë të njëjtën tematikë.
- Përdor një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur gjatë të shkruarit.
- Shkruan shpjegime, udhëzime, njoftime të shkurtra.
- Shkruan letra formale p.sh., drejtuar stafit drejtues të shkollës ose përfaqësuesve të pushtetit vendor për probleme të ndryshme të shkollës, drejtuar një gazetari etj..
- Shkruan një intervistë drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për ta nga fusha e artit, sportit, kinematografisë.
- Respekton formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit.
- Shkruan ese.

PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS MORFOLOGJI

- Përcakton shkallët e mbiemrit.
- Përcakton zgjedhimin e foljes.
- Dallon dhe përdor në fjali pjesoren dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes.
- Zgjedhon foljen në mënyrën kushtore dhe kohët e saj, mënyrën habitore dhe kohët e saj, mënyrën dëshirore dhe kohët e saj, mënyrën urdhërore dhe kohët e saj.
- Dallon dhe përdor lidhëzat, si dhe llojet e tyre.
- Dallon dhe përdor pjesëzat.
- Dallon dhe përdor pasthirrat.

SINTAKSË

- Dallon fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë.
- Përcakton funksionet gramatikore të fjalëve në një fjali.
- Përcakton në fjali kryefjalën e shprehur me emër, përemër etj.
- Dallon në fjali kallëzuesin.
- Gjen dhe përdor në fjali kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Argumenton pse një gjymtyrë është kundrinor i drejtë ose kundrinor i zhdrejtë.

TREMËJORI I DYTË

KOMPETENCA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE	VLERËSIMI	BURIMI
70	Të lexuarit 23 Njeriu që ndiqte kuajt (N. Prifti)	Filmi “Pylli i lirisë”	DRTA, punë e drejtuar	Vlerësim me gojë	Teksti, e-libri, pjesë nga filmi “Pylli i lirisë”
71	Të lexuarit 24 Njeriu që ndiqte kuajt (N. Prifti)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diskutim, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
72	Të shkruarit 15 Vazhdimi i tregimit	Hyrja e një tregimi	Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur	Vlerësim me gojë	Materiale për punën me shkrim të nxënësve
73	Të shkruarit 16 Vazhdimi i tregimit	Punë me shkrim	Punë me shkrim	Vlerësim i vazhduar, vetëvlerësim	Punët me shkrim të nxënësve
74	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 28 Ushtrime për zgjedhimin jovepror të foljes	Ushtrime	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
75	Të lexuarit 25 Vdekja e lisanjës (A. Papeka)	Të mbrëmje pyjet	Diskutim i materialeve të ndryshme, punë e drejtuar,	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
76	Të lexuarit 26 Vdekja e lisanjës (A. Papeka)	Punë me tekstin	Analizë teksti, analizë personazhesh	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve e-libri
77	Të lexuarit 27 Projekt Ora I “Mjedis i gjelbër, jetë më e shëndetshme”	Punë me projekt	Diskutim, punë në grup, vëzhgim i materialeve në power point	Vlerësim me gojë	Material për punën me projekt
78	Të lexuarit 28 Hajdutja e librave (M. Zusak)	Libri që më ka pëlqyer më shumë...	Punë e drejtuar, punë e pavarur, lexim i pjesës	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
79	Të lexuarit 29 Hajdutja e librave (M. Zusak)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diskutim, analizë teksti, përshkrim personazhesh	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti, e-libri
80	Të folurit 4 Libri dhe lufta	Ditari i Ana Frank	Diskutim , pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	E-libri, materiale nga interneti, enciklopedi
81	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 29 Folja. Zgjedhimi i foljeve në mënyrën kushtore dhe habitore	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

82	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 30	Folja. Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëshirore dhe urdhërore	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
83	Të lexuarit 30	Jakobi ndien si ne (R. Velsh)	Njerëz me aftësi të kufizuara	Punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
84	Të lexuarit 31	Jakobi ndien si ne (R. Velsh)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diskutim, analizë teksti, përshkrim personazhesh	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri,
85	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 31	Ushtrime për zgjedhimin e foljeve veprone në habitore...	Përshkrim	Punë e pavarur, shkrim i lirë, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
86	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 32	Pjesorja dhe Format e pashtjelluara të foljes	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti		Teksti i nxënësve, e-libri
87	Të dëgjuarit 4	Gjuha e ndjesive				
88	Të shkruarit	Përshkruajmë “Katër stinët” e Vivaldit				
89	Të lexuarit 32	Bisedë letrare	Libri....	Diskutim, pyetje-përgjigje, harta e tregimit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Libri i përzgjedhur nga nxënësit dhe mësuesi
90	Të dëgjuarit 5	Bisedë letrare	Libri...	Tabela e konceptit, punë e pavarur, shkrim i lirë, analizë gjuhësore, ditarët e të nxënësit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë, vetëvlerësim	Libri i përzgjedhur nga nxënësit dhe mësuesi
91	Të lexuarit 33	Letër babait (Lë Klezio)	Një letër	lexim , punë e pavarur zinxhir, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
92	Të lexuarit 34	Letër babait (Lë Klezio)	Punë me tekstin	Tabela e konceptit, punë e pavarur, shkrim i lirë, analizë gjuhësore, ditarët e të nxënësit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
93	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 33	Ushtrime për format e pashtjelluara të foljeve	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

94	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 34	Lidhëzat dhe llojet e tyre	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
95	Të shkruarit	Letra personale dhe formale				
96	Të lexuarit 35	Koni, miqtë dhe ethet e festës (D. Hoshfeld)	Punë me tekstin	Karrige e nxehtë, lexim, punë e pavarur zinxhir, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
97	Të lexuarit 36	Koni, miqtë dhe ethet e festës (D. Hoshfeld)	Punë me tekstin	Diskutim, punë në grupe, punë e pavarur, ditaret e të nxënësve.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
98	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 35	Lidhëzat nënrenditëse	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
99	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 36	Ushtrime për lidhëzat	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
100	Të lexuarit 37	Projekt Ora II "Mjedis i gjelbër, jetë më e shëndetshme"	Punë me projekt	punë në grupe, diskutim, vëzhgim materialesh me power point.	Vlerësim me gojë	Materiallet e nxënësve për projektin
101	Të folurit 5	Marrëveshja në grup	Festë në shkollën tonë.	Diskutim, pyetje përgjigje	Vlerësim me gojë	Material e përvoja të nxënësve
102	Të shkruarit 18	Ritregojmë një tregim (Përmbledhja)	Meri Ylli	Punë drejtuar me modele, punë e pavarur	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
103	Të shkruarit 19	Ritregojmë një tregim (Përmbledhja)	Punë me shkrim	Punë e pavarur me shkrim	Vlerësim i vazhduar	Punët me shkrim të nxënësve
104	Të lexuarit 38	Figurat kryesore letrare				
105	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 37	Pasthirrat	Legjenda e Gjergj Elez Alisë	Punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
106	Të lexuarit 39	Një ditë e ka dhe korbi (M. Camaj)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje përgjigje, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

107	Të lexuarit 40	Ekstazë pranverore (Migjeni)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje përgjigje, analizë teksti, ditarrët e të nxënimit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
108	Të lexuarit 41	Poradeci (L. Poradeci)	Vargje dhe pamje nga Pogradeci	Lexim, diskutim, pyetje përgjigje, analizë teksti	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
109	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Morfologji 38	Pjesëzat	Ditari i Ana Frankut	punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh, INSERT	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
110	Të lexuarit 42	Kinema e vjetër (I. Kadare)	Kujtime nga fëmijëria	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditarrët e të nxënimit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
111	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 39	Funksionet e fjalëve dhe grupit të fjalëve në fjali. Kryefjala	Gjenerali i ushtrisë së vdekur (në tekst)	stuhi mendimi, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh, INSERT	Vlerësim diagnostikues Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
112	Përdorimi i drejtë i gjuhës Sintaksë 40	Kallëzuesi dhe llojet e tij	Punë me tekstin	stuhi mendimi, analizë rasti, punë e pavarur, punë e drejtuar, tabela e koncepteve,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
113	Të folurit 6	Piktura dhe fotografia	Piktura të famshme	Diskutim, pyetje-përgjigje, vëzhgim i materialeve me power point	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
114	Të lexuarit 43	Edukimi i Herakliut (Staikos)	12 bëmat e Herakliut	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditarrët e të nxënimit	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
115	Të lexuarit 44	Edukimi i Herakliut (Staikos)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditarrët e të nxënimit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
116	Të folurit 7	Sporti në Greqinë e lashtë	Lojërat Olimpike	Diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti dhe materiale të ndryshme
117	Të lexuarit 45	Prometeu i lidhur (Eskili)	Punë me tekstin	Lexim në role, diskutim, punë e drejtuar	Vlerësim me gojë	Teksti dhe materiale të ndryshme të nxënësve, e-libri
118	Të lexuarit 46	Prometeu i lidhur (Eskili)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditarrët e të nxënimit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

119	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 41	Ushtrime për kryefjalën dhe kallëzuesin	Punë me tekstin	pema e mendimit, punë e pavarur, punë e drejtuar, shkrim i lirë.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
120	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 42	Kundrinori i drejtë dhe mënyrat e shprehjes	Shkrim i lirë	stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, INSERT	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
121	Të dëgjuarit 5	Lloje të ndryshme tekstesh				
122	Të dëgjuarit 6	Projekt ora III “Mjedis i gjelbër, jetë më e shëndetshme”	Punë me projekt	Diskutim, punë në grup, vëzhgim i materialeve me power point	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë, vetëvlerësim	Projektet e nxënësve
123	Të lexuarit 47	Ymer Aga (Popullore)	Kënga e Ymer Agës	Lexim i pjesës, punë e drejtuar, diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
124	Të lexuarit 48	Ymer Aga (Popullore)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditarët e të nxënësve	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
125	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 43	Kundrinori i zhdrejtë dhe mënyrat e shprehjes	Punë me tekstin	stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
126	Të shkruarit 20	Përshtatim vargjet në prozë	Kostandini dhe Dhoqina	Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, materiale të ndryshme nga mësuesi
127	Të shkruarit 21	Përshtatim vargjet në prozë	Punë me shkrim	Punë me shkrim, diskutim	Vlerësim i vazhduar, vetëvlerësim	Punët me shkrim
128	Të lexuarit 49	Test 2	Test	Testim	Vlerësim përmbledhës	Testi
129	Të lexuarit 50	Shporta magjike (Përrallë rome)	Përralla	Lexim i pjesës, punë e drejtuar, diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
130	Të lexuarit 51	Shporta magjike (Përrallë rome)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditarët e të nxënësve	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
131	Të dëgjuarit	Përralla dhe fabula				

132	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 44	Rrethanori i vendit dhe i kohës dhe mënyrat e shprehjes së tyre	Udhëtim në Lurë	vëzhgim i materialit me video-projektor, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, pema e mendimit.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
133	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 45	Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit dhe mënyrat e shprehjes së tyre	Punë me tekstin	Stuhi mendimi, pemë mendimi, analizë rastesh, punë e drejtuar, punë e pavarur, Diagram Veni, shkrim i lirë, diskutim, INSERT.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS (në program)

TË DËGJUARIT

- Kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to.
- Jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.
- Dëgjon me vëmendje dhe përqendrim: duke mbajtur trupin në një pozicion korrekt.
- Shfaq interes, respekt dhe empati ndaj folësit me shprehje të tilla
- nxit dhe inkurajon folësin me shprehje të tilla si: kjo që po rrëfeni është shumë interesante etj.
- Përcakton qëllimin e të dëgjuarit (për kënaqësi, për informacion, për kuriozitet etj.).
- Kujton njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit.
- Parashikon rreth tekstit që do të dëgjojë.
- Mban shënime gjatë të dëgjuarit.
- Pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i kupton mirë.
- Kërkon informacion shtesë.
- Ritregon me detaje dhe ilustrime përmbajtjen e tekstit.
- Interpretin tekstin duke dhënë gjykimet e tij
- Identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (në biseda, në televizion ose në ndonjë media tjetër).
- Dallon rendin e ngjarjeve dhe ideve.
- Klasifikon detajet në një tekst.
- Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst.
- Dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst.
- Përcakton me ndihmën e mësuesit qëllimin ose synimin e folësit (këshillon, bind, sqaron etj.).
- Dallon ndjenjat e folësit.

TË FOLURIT

- Zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij.
- Merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.
- Identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në media.
- Flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (e fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje te të tjerët.
- Jep informacione, ide, ndjesi, emocione duke përdorur fjalorin e duhur.
- përshtat të folurin në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës.
- Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup nxënësi:
- bën pyetje për t'u sqaruar dhe për të marrë më shumë informacion gjatë diskutimeve në grup.
- Ofron të dhëna ose informacion, si dhe shpreh mendimin ose këndvështrimin e tij personal.
- Jep argumentet e tij gjatë diskutimeve në grup, si dhe pranon idetë e të tjerëve.
- Reciton me ndjenjë pjesë të ndryshme para bashkëmoshatarëve dhe mësuesve në aktivitete të
- Ndryshme në shkollë.
- Planifikon dhe organizon lojëra me role

TË LEXUARIT

- Interpretin tekste duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara.
- Dallon informacionin e rëndësishëm në tekst. – lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

- Analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme.
- Dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik.
- Dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre.
- Shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.
- Dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme.
- Kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme një fjalor për të sqaruar e gjetur kuptimin e një fjale, një enciklopedi për fëmijë që të marrë informacion, përdor disa strategji (para, gjatë dhe pas leximit) për të kuptuar tekstin
- Analizon elementet që shoqërojnë tekstet (piktura, ilustrime, lista, tabela, harta etj.) Për të kuptuar më mirë tekstin.
- Përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti.
- U përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit.
- Lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme.
- Krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj..
- Gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit
- Dallon tekstet letrare dhe joletrare.
- Dallon elemente të formës dhe strukturës së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre.
- Lexon tekste të ndryshme letrare poetike, në prozë dhe dramatike, të përshtatshme për moshën e tij. –
- Flet shkurt (3-4 fjali) për autorin e tekstit letrar (krijimtarinë, jetën).
- Diskuton rreth përmbajtjes, personazheve, përshtypjeve dhe ndjesive për tekstet që lexon.
- Ritregon histori duke u bazuar në fjalë kyçe, skica ose foto e figura.
- Ritregon me hollësi subjektin, duke e ilustruar me detaje nga teksti
- Bën pyetje të ndryshme rreth tekstit.
- U përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij ose me shembuj nga teksti.
- Rendit ngjarjet e një teksti.
- Përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet.
- Përshkruar pamjen, tiparet, sjelljen e personazheve (duke u bazuar në tekst).
- Analizon marrëdhëniet mes personazheve, vlerëson sjelljet e tyre, si dhe i krahason me veten ose njerëzit që njeh.
- Gjen një tekst idetë kryesore dhe formulon temën dhe idenë kryesore.
- Jep dhe argumenton këndvështrimet e tij rreth temës, ideve, personazheve etj..
- Kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato.
- Dallon epitetin, krahasimin, personifikimin metaforën, hiperbolën, aliteracionin personifikimin dhe tregon efektin që krijojnë ata.
- Shpjegon kuptimin e një teksti poetik, duke u bazuar në ndjenjat dhe përvojën e tij.
- Dallon rimën dhe strofën (llojet kryesore) në një tekst poetik.
- Dallon disa karakteristika të disa teksteve në prozë,
- Dallon dhe analizon disa elemente të strukturës së një teksti dramatik si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë.
- Përdor bibliotekën dhe internetin për të lexuar tekste të ndryshme.
- Recitojnë me ndjenjë poezi, copëza proze ose luajnë një rol nga një tekst dramatik.
- Lexon tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura si: autobiografi, biografi (të një shkrimtari, sportisti, shkencëtari), intervista, enciklopedi të shtypura dhe elektronike, udhëzime, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, njoftime.
- dallon dhe përdor njohuritë rreth karakteristikave të përbashkëta të teksteve si: tema, paragrafi, fjalitë përmblylëse, fjalori etj.
- Dallon dhe përdor njohuritë rreth mënyrës së organizimit të tekstit (rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.).
- Pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, nga tekstet që lexon dhe i përdor ato.

- Ndan përvojat dhe kënaqësitë e leximit me shokët e shoqet e klasës.
- Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst.
- Dallon problemin dhe zgjidhjen.
- Dallon faktet dhe opinionet në një tekst.
- Dallon disa veçori të teksteve si: citimet dhe referencat dhe të shpjegojnë funksionin e tyre.
- Dallon në një tekst përdorimin e argumenteve pro dhe kundër për një çështje të caktuar.
- Shpjegon funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve, me të cilat shoqërohen tekstet.
- Dallon në tekste disa elemente të stilit dhe të gjuhës, si p.sh.: zgjedhja e fjalëve të figurshme, përdorimi i mbiemrave, përdorimi i fjalive të ndryshme (të thjeshta, të përbëra, të plota dhe mungesore).

TË SHKRUARIT

- Përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara.
- Mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.
- Identifikon qëllimin dhe lexuesin e tij, kur shkruan njohur për bashkëmoshatarët e tyre etj..
- Mbledh informacionin e duhur për të sqaruar rreth temës, çështjes, subjektit. kujton njohuritë që ka rreth temës që do të shkruajë.
- Përdor burime të ndryshme për të mbledhur informacion. studion modele të mira shkrimi që kanë trajtuar të njëjtën temë ose subjekt. mban shënime për çështje të ndryshme rreth punës me shkrim.
- Përzgjedh dhe klasifikon informacionet e mbledhura.
- Përdor edhe bibliotekën e shkollës ose internetin për të mbledhur informacion për punën dhe detyrat me shkrim.
- Zgjedh format e duhura të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit dhe lexuesit që ka.
- Mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.
- Respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme në shkrimet e tij si p.sh., një larmi ndajfoljesh, mbiemrash etj., me qëllim që të ndikojë te lexuesi.
- Përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.
- shkruan tekste me dorë ose duke përdorur teknologjinë e informacionit.
- Bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen, qartësinë dhe formën
- Shpreh me vargje të thjeshta (strofa, rima) ndjenjat dhe mendimet e tij.
- Shkruan tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve si: personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë.
- Kthen një tekst poetik në prozë.
- Rrëfen brendinë e një libri të preferuar për të.
- Përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tij.
- Shkruan për ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një tekst letrar si: tregim, poezi, përrallë etj.
- Krahason dy ose më shumë personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, dramë etj.
- Krahason dy ose më shumë tekste që trajtojnë të njëjtën tematikë.
- Përdor një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur gjatë të shkruarit.
- Shkruan shpjegime, udhëzime, njoftime të shkurtra.
- Shkruan letra formale p.sh., drejtuar stafit drejtues të shkollës ose përfaqësuesve të pushtetit vendor për probleme të ndryshme të shkollës, drejtuar një gazetari etj..
- Shkruan një intervistë drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për ta nga fusha e artit, sportit, kinematografisë.

- Respekton formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit.
- Shkruan ese

PËRDORIMI I DREJTË I GJUHËS

SINTAKSË

- Gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e vendit dhe të kohës dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e shkakut e të qëllimit dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e mënyrës e të sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Argumenton pse një gjymtyrë është rrethanor vendi, kohe, shkak, qëllimi, mënyre, sasi.
- Krahason fjalitë e thjeshta me fjalitë e përbëra.
- Dallon dhe ndërton fjali me bashkërenditje.
- Dallon dhe përdor ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë.

DREJTSHKRIM

- Përdor drejt pikën, presjen dhe pikëçuditjen në llojet e ndryshme të fjalive.
- Përdor trepikëshin, kur intonacioni i fjalisë është i pa mbaruar.
- Përdor saktë shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë

TREMUIORI I TRETË

NR	KOMPETENCA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE	VLERËSIMI	BURIMI
134	Të lexuarit 52	Marko Boçari (F. Ballanca)	Punë me tekstin	Lexim i pjesës, punë e drejtuar, diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
135	Të lexuarit 53	Marko Boçari(F. Ballanca)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditaret e të nxënësve, tabelë koncepti për personazhe	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
136	Të folurit 8	Krenar si një shqiptar	Jam krenar që jam shqiptar.	Diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti, Përvoja e materiale të nxënësve, e-libri,
137	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 46	Rrethorimi i mënyrës dhe i sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre	Shkrim i lirë	Stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim, INSERT.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
138	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 47	Ushtrime për rrethorët	Punë me tekstin	tabela e koncepteve, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
139	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 48	Ushtrime përmbledhëse për gjymtyrët e dyta	Punë me tekstin. Ushtrime	punë e pavarur, punë e drejtuar. Ushtrime.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
140	Të lexuarit 54	PROJEKT Ora I Dramatizojmë “Epoka para gjyqit” (E. Kryeziu)	Pjesë nga drama “Epoka para gjyqit” ,	Diskutim, punë në grupe, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
141	Të lexuarit 55	Epoka para gjyqit (E. Kryeziu)	Lidhja e Prizrenit	Lexim në role, punë e drejtuar, diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
142	Të lexuarit 56	Epoka para gjyqit (E. Kryeziu)	Punë me tekstin	Lexim, diskutim, pyetje-përgjigje, analizë teksti, ditaret e të nxënësve	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

143	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 49	Fjalja e përbërë	Punë me tekstin	stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, INSERT.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
144	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 50	Ushtrime për fjalitë e përbëra	Punë me tekstin	punë e pavarur, punë e drejtuar, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
145	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Drejtshkrim 51	Përdorimi i pikës dhe pikëçuditjes	Punë me tekstin	punë e drejtuar punë e pavarur, diskutim,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
146	Të shkruarit 22	Kthejeni dramën në tregim	Punë me tekstin	Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
147	Të shkruarit 23	Kthejeni dramën në tregim	Punë me shkrim	Punë e pavarur me shkrim, diskutim	Vlerësim i vazhduar, vetëvlerësim	Punë me shkrim
148	Të lexuarit 57	Zana e vizitorit (Gj. Fishta)	Punë me tekstin	Lexim i pjesës, diskutim, punë e drejtuar	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
149	Të lexuarit 58	Zana e vizitorit (Gj. Fishta)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, shkrim i lirë, ditarët e të nxënët	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
150	Të dëgjuarit 8	Gojëdhëna e mitologji shqiptare	Legjenda e Tomorit dhe Shpiragut	Diskutim, pyetje përgjigje	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri, materiale nga interneti etj.
151	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 52	Fjalitë me bashkërenditje dhe nënrenditje	Punë me tekstin	Stuhi mendimi, shkrim i lirë, punë e drejtuar, analizë rastesh, punë e pavarur, INSERT	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
152	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 53	Ushtrime për bashkërenditje dhe nënrenditje	Punë me tekstin. Ushtrime	punë e pavarur, diskutim, stuhi mendimi.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
153	Të lexuarit 59	Kërcimtarja e Dukagjinit (E. Koliqi)	Punë me tekstin	Lexim zinxhir, punë e drejtuar, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
154	Të lexuarit 60	Kërcimtarja e Dukagjinit (E. Koliqi)	Punë me tekstin	Punë e pavarur, diagram veni, ditarët e të nxënët	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri

155	Të shkruarit 24	Përshkruajmë veshje popullore	Veshjet e krahinës sime	Punë e pavarur, me modele, punë e pavarur,	Vlerësim me gojë	Foto nga veshjet e krahinës, e-libri
156	Të shkruarit 25	Përshkruajmë veshje popullore	Punë me shkrim	Punë e pavarur me shkrim	Vlerësim i vazhduar, vetëvlerësim	Punë me shkrim
157	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 54	Llojet e fjalitë me bashkërenditje	Shkolla ime	punë e pavarur, punë e drejtuar, shkrim i lirë, tabela e koncepteve, stuhi mendimi.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
158	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 55	Ushtrime për fjalitë me bashkërenditje	Punë me tekstin. Ushtrime	punë e pavarur, stuhi mendimi, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
159	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Drejtshkrim 56	Përdorimi i presjes	Punë me tekstin	Di, dua të di, mësova, punë e pavarur, diskutim.	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
160	Të lexuarit 61	Historia pa mbarim (M. Ende)	Punë me tekstin	Lexim zinxhir, punë e drejtuar, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve,
161	Të lexuarit 62	Historia pa mbarim(M. Ende)	Punë me tekstin	Tabela e konceptit të personazhit, ditarët e të nxënësve, diskutim	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
162	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 57	Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë	Punë me tekstin	stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar punë e pavarur,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
163	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 58	Rendi i pjesëve në ligjëratën e drejtë dhe shenjat e pikësimit	Punë me tekstin	stuhi mendimi, diktim, punë e drejtuar, analizë rastesh, Di, Dua të Di, Mësova,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, e-libri
164	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 59	Ushtrime për ligjëratën e drejtë e të zhdrejtë	Punë me tekstin. Ushtrime	punë e pavarur, diktim, Diagram Veni	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
165	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Drejtshkrim 60	Përdorimi i shumëpikështit në fjali	Punë me tekstin	stuhi mendimi, analizë rasti, punë e pavarur, lojë në çift, punë e drejtuar,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
166	Të lexuarit 63	Princi i vogël	Punë me tekstin	Lexim zinxhir, punë e drejtuar, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve

167	Të lexuarit 64	Princi i vogël	Punë me tekstin	Përshkrim personazhesh, diskutim, ditarët e të nxënësve,	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
168	Të lexuarit 65	Diktimit	Diktimit	diktimit, diktimit me plotësim.	Vlerësim i vazhduar	Diktimit i përgatitur nga mësuesi
169	Të dëgjuarit	Dëgjim dhe shijim poezinë				
170	Përdorimi i drejtë i gjuhës -Sintaksë 61	Ushtrime për sintaksën	Punë me tekstin Ushtrime	Punë e drejtuar, punë e pavarur, ushtrime	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
171	Të lexuarit 66	Test 3	Test	Testim	Vlerësim përmbledhës	Testet e nxënësve
172	Të folurit 10	Vepra dhe autori	Autorë dhe vepra të famshme shqiptare	Diskutim, pyetje, përgjigje, shkrim i lirë	Vlerësim me gojë	Teksti, e-libri, Materiale nga letërsia shqipe për fëmijë, enciklopedi
173	Të lexojmë 67	Ishuj në qiell	Punë me tekstin	Lexim zinxhir, punë e drejtuar, diskutim, pyetje-përgjigje	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve, përvoja të nxënësve
174	Të lexuarit 68	Nata e dymbëdhjetë	Fragment nga komedia "Nata e dymbëdhjetë" Teatri Kombëtar	Lexim në role, punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim	Vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve
175	Të lexuarit 69	Nata e dymbëdhjetë	Punë me tekstin	Lojë në role, analizë teksti, tabela e koncepteve të personazhit	Vlerësim i vazhduar ose vlerësim me gojë	Teksti i nxënësve

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Komunikimi dhe gjuha Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënit: Komunikimi dhe gjuha	
<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. • Nxënësi/ja: • Shpreh mendimin e tij rreth komunikimit dhe rëndësisë së tij. • Dallon llojet e komunikimit. • Dallon dhe ilustron elementet e komunikimit. • Ndan tekstet e komunikimit sipas llojit të tyre. 		Fjalët kyç: komunikim, elemente të komunikimit, tekste të komunikimit	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacione nga psikologjia për komunikimin në grup ose të individit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Sociologji, psikologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë, diskutim, organizues grafik, punë e drejtuar, punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit:

1. Lidhja e mësimit me temat e mëparshme: Bisedë

Me anë të një bisede nxënësit japin mendimet e tyre rreth komunikimit dhe rëndësisë që ai ka në shoqëri.

- Pse komunikojmë?
- Ç’rëndësi ka ai për qeniet njerëzore?
- Si realizohet ai?


Mësuesi plotëson njohuritë e nxënësve rreth komunikimit me informacione nga psikologjia, duke e parë atë si element bazë që na bën qenie njerëzore.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar, organizues grafik

Pasi nxënësit lexojnë informacionin e dhënë në tekst, përgjithësojmë bashkë me ta se komunikimi është:

Komunikimi: **gjuhësor** (me anë të gjuhës)
jogjuhësor (gjeste, zë, dritë, figura, simbole)

Diskutohen së bashku elementet e komunikimit duke i paraqitur ato grafikisht:



Dhënësi

Mesazhi


Marrësi

Kanali (fjalët)

(Do të shkoj me pushime në Itali.)

Gjuha dhe teksti

Diskutojmë me nxënësit rreth llojeve të teksteve, në varësi të informacionit që paraqesin dhe mënyrës se si e paraqesin informacionin.



3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

Nxënësit punojnë ushtrimet 1, 2, 3, 4 të tekstit.

Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit duke vënë në pah arritjet e tyre.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e Mithat Frashërit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Vedat Kokona “Endur në tisin e kohës” (ora e parë) - tekst joletrar</p> <p>Kompetenca: Të lexuarit</p>		<p>Situata e të nxënit: Bisedë rreth jetës dhe veprimtarisë së Mithat Frashërit</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Paraqet për shokët informacion rreth Lumo Skëndos. • Kupton përmbajtjen e fragmentit përmes leximit të tij. • Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja. • Ndan fragmentin në pjesë sipas asaj që përshkruhet duke dhënë detaje. • Përmbledh veçoritë e tekstit autobiografik me kllaster. 		<p>Fjalët kyç: Mithat Frashëri, librari, fytyrë që godet, cigarishte, parathënie, mrekulli</p>	
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacione për jetën dhe veprën e Mithat Frashërit</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim, lexim zinxhir, diskutim, organizues grafik, punë e pavarur</p>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e mësimit me temat e mëparshme: *Prezantim*

Nxënësit flasin për jetën dhe veprimtarinë e Mithat Frashërin, mbi bazën e informacioneve të gjetura, duke u përqendruar në momentet më të rëndësishme të jetës dhe veprës së tij. Mësuesi përgëzon nxënësit për punën e bërë.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim zinxhir, diskutim*


Mësuesi/ja u kërkon nxënësve, që gjatë leximit të fragmentit të mbajnë parasysh këto çaste nga autobiografia:

- a. Të dhënat për qytetin dhe më pas bëjnë dallimin e qytetit të Tiranës së viteve `30 me atë të sotmen, duke paraqitur ç’ka ndryshuar më së shumti.
 - popullsia
 - libraritë
 - gazetat, revistat etj.
- b. Ndikimi i Mithat Frashërin mbi V. Kokonën.
- c. Nxënësit bëjnë dallimin e elementeve të jetës së shkrimtarit.

Shpjegohen fjalët dhe shprehjet e reja bashkë me nxënësit.

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: *organizues grafik*

Nxënësit realizojnë organizuesin grafik për veçoritë e tekstit autobiografik:



Vlerësimi: Përgëzoi nxënësit për punën e bërë gjatë orës. Vlerësohen nxënësit që kanë lexuar rrjedhshëm, saktë dhe bukur; kanë zbuluar detajet që lidhen me shkrimin autobiografik, kanë fjalor të pasur dhe e përdorin në situata të reja.

Detyrë shtëpie: Gjeni elementet letrare në tekstin autobiografik. Kërkoni në internet ose në burime të tjera të dhëna për jetën dhe veprën e Vedat Kokonës

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Vedat Kokona “Endur në tisin e kohës” (ora e dytë) - tekst joletrar Kompetenca: të lexuarit		Situata e të nxënit: E shkuara jonë dhe ne.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për rëndësinë e së kaluarës në jetën e tij. • Shpjegon rëndësinë që kishte për Vedat Kokonën takimi me Mithat Frashërin. • Përshkruan dhe ilustron nga teksti emocionet dhe ndjesitë që përjeton V. Kokona. • Gjykon mbi gjuhën e përdorur në shkrim. 		Fjalët kyç: takim, përjetim, ndjesi, adhurim	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacion mbi Vedat Kokonën dhe Mithat Frashërin		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, diskutim, empati, punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja me temat e mëparshme: <i>Bisedë</i> Nxënësit shprehin mendimin e tyre rreth së kaluarës, si një fazë e rëndësishme në jetën e tyre. - Pse e kaluara është e rëndësishme? - Ç’ përfaqëson e kaluara për këdo?			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Empatia</i> Për të treguar rëndësinë e këtij takimi për autorin, përjetimeve, emocioneve, nxënësit vendosin veten në vendin e Kokonës, duke realizuar teknikën e empatisë. Dëgjohen me vëmendje nxënës të ndryshëm dhe vlerësohen për origjinalitetin dhe përjetimin e rolit. Nxënësit ilustrjnë nga teksti përjetimet dhe ndjesitë e autorit për takimin me Mithat Frashërin.			
3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>diskutim, punë e pavarur</i> Punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4, ku nxënësit gjykojnë mbi gjuhën e tekstit, shprehjet frazeologjike të përdorura, figurat letrare.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit në bazë të përgjigjeve të tyre, aktivizimit dhe mënyrës së të shprehurit.			
Detyrë shtëpie: Punë në grup, f. 17.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fonetikë. Theksi i fjalës dhe theksi i fjalisë Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Fonetikë		Situata e të nxënimit: Poezia ime	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dallon fjalët shërbyese nga të mëvetësishme në një fjali a tekst. Përkufizon theksin e fjalës e të fjalisë. Përcakton llojet e theksit të fjalës e fjalisë. Gjen theksin e fjalës e të fjalisë. Tregon kuptimet e fjalëve përmes theksit. Pasqyron nëpërmjet intonacionit variante të ndryshme të theksit. 		Fjalët kyç: theksi i fjalës theksi i fjalisë theks emocionor theks logjik	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>analizë rastesh, stuhi mendimi, punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*

Nxënësit nga klasa e gjashtë kanë njohuri për theksin, ndaj ua rikujtojmë ato përmes këtyre pyetjeve:

- Nga çfarë përbëhet alfabeti i gjuhës shqipes?
- Ç’është theksi i fjalës?
- Sa llojesh theksash ka?
- Ç’është theksi i fjalisë?

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e drejtuar, analizë rastesh, tabela e koncepteve*

U kërkojmë nxënësve të punojnë me poezinë “Lejleku” duke gjetur theksat e fjalëve në të. Për secilën fjalë të thonë rrokjen në të cilën ka rënë theksi i fjalës. Më pas punojnë me materialin e tekstit për të plotësuar tabelën e koncepteve rreth theksit.

Theksi	Theksi i fjalës			Theksi i fjalisë	Theksi logjik	Theksi emocionor
	Fundor	Parafundor	tejfundor			

Pas plotësimit dhe diskutimit të koncepteve kalohet në rubrikën e ushtrimeve.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, Ushtrime.*

Punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6 sipas kërkesës.

Ushtrimi 2, u kujtojmë nxënësve që fjalët shërbyese nuk kanë theks.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësueses/it, duke pasur parasysh rezultatet e të nxënimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 7

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Grupet e zanoreve. Diftongu dhe togu zanor. Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Fonetikë		Situata e të nxënit: Në dhomën time	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon diftongun dhe togun zanor. • Dallon togjet zanore dhe diftongun në fjalët e fjalive të dhëna. • Krahason togun zanor me diftongun. • Ndan si duhet fjalët në rrokje me diftongje e togje zanorë. 		Fjalët kyç: Grupe zanore, diftong, tog zanor, theks, rrokje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, shkrim i lirë, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. U kërkojmë nxënësve të kujtojnë shkurtimisht alfabetin e shqipes, zanoret, bashkëtingëlloret, theksin e fjalës.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>shkrim i lirë, punë e drejtuar,</i> U kërkojmë nxënësve të bëjnë një shkrim të shkurtër me temë “Në dhomën time”, ku të përdorin dhe fjalët: <i>i kthyer, ëndërrues, reale, flaut.</i> Fjalët diktohen dhe gjatë leximit një nxënës i shkruan në tabelë për të parë se si i shkruan ato. Nxënësit vendosin theksin në këto fjalë. Ndahen në dy grupe grupet e zanoreve ato që kanë në përbërje u, y, i, të patheksuar pranë një zanoreje dhe grupe të tjera ku theksi bie në secilën zanore. U kërkojmë gjithashtu nxënësve të ndajnë në rrokje fjalët e mësipërme dhe nuk bajmë asnjë korrigjim rreth tyre. U kërkojmë nxënësve të kthehen në tekst për të lexuar materialin teorik dhe u kërkojmë të emërtojnë klasifikimin e bërë për grupet e zanoreve në diftong dhe tog zanor. Më pas kontrollojmë ndarjen e fjalëve në rrokje duke bërë korrigjimet e duhura sipas rregullit që te diftongu nuk ndahen zanoret ndërsa te togu mundet.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur, Ushtrime.</i></p> <p>Ushtrimi 1. <u>Shuë</u>t, zgjue, mënia. Grupet e nënvizuara janë togje sepse theksi bien ë zanoret, u dhe i .</p> <p>Ushtrimi 2, 5 Sipas kërkesës.</p> <p>Ushtrimi 3 togje- zmadhuan, iu, zbërthyeshme, pathyeshme, kthyer, qëlloi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diftongje- kau, rrëmbeu, qëlloi. • Aureli është me theks dyfish. 			


<p>Ushtrimi 4 am-bient, stu-dioj,lu-aj,shtë-pi-a, kër-ku-am.Ndarja bëhet në bazë të llojit të grupit zanor pra diftongose tog zanore. Ambient, studioj-diftongje, të tjerat togje zanore.</p> <p>Ushtrimi 6, Diftongje kanë fjalët ; amoniak, devocion, amiant, aktual, akuarium, ku theksi bie në zanoret a,o,a,a, u. Togjet e zanoreve ; diell, qiell, liniolum, theksi i, i, u.</p>
<p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur; Ushtrimi 7 sipas kërkesës.</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Lumo Skëndo “Ay mal” Kompetenca: Të dëgjuarit</p>		<p>Situata e të nxëniet: Malet e Shqipërisë</p>	
<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Dallon me të dëgjuar të dhëna gjeografike, historike dhe heroike që përmban fragmenti. Gjykon mbi veçoritë e tekstit dhe mënyrën e të shkruarit. 		<p>Fjalët kyç: mal, Shqipëri, respekt, i bukur, plagë, këmbë të huaja</p>	
<p>Burimet: Libri <i>Gjuha shqipe 7</i>, libri digjital; harta e Shqipërisë, informacion mbi historinë e popullit tonë</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi, Histori</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, dëgjim i drejtuar, diskutim, kllaster, punë e pavarur</i></p>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e mësimit me temat e mëparshme: *Stuhi mendimi*

Kujtojmë së bashku njohuritë e marra në lëndën e gjeografisë rreth maleve të Shqipërisë dhe shtrirjes së tyre gjeografike, si dhe në lëndën e historisë rreth historisë së popullit tonë. Për të realizuar më mirë këtë përdoret harta e Shqipërisë, e cila vendoset para nxënësve.



Nxënësit lihen të lire të thonë çfarë dine për malin dhe ndjesitë që iu shkaktojnë ato. Nëse nxënësit nuk kanë informacionin e duhur, atëherë e plotëson mësuesja dhe bën lidhjen me temën e re.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: Dëgjim i drejtuar

Fragmenti është i incizuar në tekstin digjital. Nëse mësuesi/ja s’ka mundësi ta përdorë aty, e lexon tekstin vetë ose një nxënës që lexon bukur.

Para së të fillojë të lexojë pjesën, mësuesi/ja ndahet klasën në tri grupe dhe iu kërkohet që gjatë leximit të nxënësit të mbajnë shënim:

Grupi I: të dhënat gjeografike (det, malet, lumenjtë, krahinat e Shqipërisë)

Grupi II: të dhënat historike (cilat vende kanë mbetur jashtë Shqipërisë)

Grupi III: të dhënat heroike (Skënderbeu)

Nxënësit përpiqen të dallojnë gjatë dëgjimit momentet kyçe, të cilat autori ka dashur të nxjerrë në pah.

Vlerësohen nxënësit që kanë arritur të mbajnë mend sa më shumë të dhëna dhe i ilustrjnë ato

Po në grupe mund të punohet edhe **ushtrimi 2**.

Fjalët kyç

Dashurinë ndaj atdheut: Shqipërinë tonë, deti kaltër, pushton, vëllezër, plak i bekuar etj.

Krenarinë: mali i Skënderbeut, rrodhi për mbrojtjen e mëmëdheut etj.

Dhimbjen: ujitur me gjak, mos lëndo plagë etj.


Ushtrimi 3. Përse autori ka zgjedhur formën e dialogut për të dhënë informacionin që ai ka dashur të nxjerrë në pah?

- Kush dialogon në këtë fragment?

Theksohet në fund të komenteve se gjyshërit (paraardhësit tanë), i lënë trashëgimi pasardhësve historinë, vlerat e tyre.

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: organizues grafik

Realizojmë organizuesin grafik me veçoritë e tekstit në tabelë dhe në fletoret e tyre.



Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e tyre, saktësinë e mendimit dhe të shprehurit bukur.

Detyre shtëpie: Ese “Unë, pasardhës i denjë i paraardhësve të mi.”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë ese për atdheun (ora I) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Model eseje nga Faik Konica.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. kompetenca e të menduarit; 3. kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: • Dallon elementet e strukturës në një ese. • Veçon tezë, antitezën dhe argumentet në një ese. • Përcakton rrugën që ndiqet në shkrimin e një eseje argumentuese.		Fjalët kyç: ese, atdhe, strukturë, hyrje, zhvillim, mbyllje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve; modele esesh.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë e drejtuar, analizë modelesh, punë e pavarur.</i>			

Organizimi i orës së mësimit:

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Punë e drejtuar*

Nxënësit kanë njohuri rreth shkrimeve përshkruese, por edhe argumentuese dhe pse nuk i kanë emërtuar ato si ese. Nxënësit fillimisht përcaktojnë se çfarë kuptojnë me një shkrim përshkrues, krahasues dhe argumentues dhe çfarë kanë parasysh gjatë shkrimeve të tilla.

Nga nxënësit duhet të dalë se eseja është një shkrim joletrar, ku shkruesi sjell informacion, fakte, të dhëna, argumente dhe opinionin e tij për një temë të caktuar. Ajo ka këtë strukturë: hyrje, zhvillim, mbyllje. Ajo dallohet nga gjuha që përdoret.

Nëse nxënësit nuk arrijnë të dalin në përfundimet e synuara nga mësuesi/ja, atëherë jepet informacion i detajuar në lidhje me sa më sipër nga mësuesi/ja.


2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar, analizë rasti.*

U kërkohet nxënësve të shohin shembullin e librit duke ndarë gradualisht elementet e strukturës: *hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen* dhe për çfarë shkruhet në secilën hallkë të esesë.

Orientohen nxënësit që në **hyrje** të jepen shkurtimisht disa të dhëna rreth temës a faktit që do të trajtohet. Në **zhvillim** jepen mendimet dhe opinionet rreth faktit a çështjes së parashtruar në hyrje; sillen argumente rreth këtyre opinionëve. Kjo në njërin nga paragrafët e zhvillimit, ndërsa në vazhdim argumente për të mbështetur opinionin e tyre për këtë tezë.

Në **mbyllje** nxënësit duhet të rimarrin përmbledhtas temën e trajtuar, të arrijnë në disa përfundime rreth çështjes dhe të japin mendimin e tyre si mund t’i jepet zgjidhje. Shembulli i tekstit ka orientime të mjaftueshme rreth strukturës.

(Mësuesi/ja bën një grafik në dërrasën e zezë për esenë)



3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur me modele*

Meqë eseja merret për herë të parë si lloj i shkrimit, nxënësve mund t’u ofrohen edhe modele të tjera esesh, si: ese nga Faik Konica, nga teksti didaktik “Si të shkruajmë ese”, ese nxënësish etj. Mund të shfrytëzohet nga teksti dhe eseja “Ma hiq qafe atë celular!”

U kërkohet nxënësve të punojnë me modelet sipas kësaj rruge dhe të nxjerrin përfundime rreth strukturës dhe shkrimit të eseve.

1. Përcaktojnë elementet e strukturës së esesë.
2. Për secilin element: *hyrje, zhvillim, mbyllje* përcaktojnë nga sa paragrafë përbëhet.
3. Dallojnë çfarë përmban hyrja: çfarë parashtrohet, cilat elemente të temës sillen për lexuesin.
4. Sa paragrafë ka zhvillimi, çfarë thuhet në secilin, si renditen opinionet, argumentet, kundërgargumentet, mendimi i autorit për temën.
5. Në mbyllje, si realizohet përfundimi dhe si ofrohet zgjidhje në lidhje me atë që kërkon tema.
6. Nga ana gjuhësore, ç’lloj fjalish përdoren dhe çfarë leksiku përdoret, ç’lloj gjuhe ka në secilën halkë të strukturës, ç’vend zënë figurat letrare.

Për çdo bankë mund të jenë dy modele esesh, ku secili nxënës punon i pavarur dhe këmben punën e tij për vetëvlerësim me shokun. Nxënësit mund të ofrojnë vetë shembuj esesh me tema për atdheun.

Tema që mund t’u ofrohen nxënësve:

- Gjuha është kyçi i mbijetesës së një kombi.”
- “Liria e mendimit është liria e vërtetë e një kombi.”
- “Shkrimtarët, (artistët), janë ambasadorët e një vendi larg tij.” etj

Nëse mjafton koha mund të realizohet paragrafi i hyrës për temën që nxënësit do të zgjedhin dhe lexohen për të bërë vlerësimin dhe vetëvlerësimin e tyre.

Vlerësimi: Vlerësim me gojë dhe vetëvlerësim.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit mund të mendojnë të risjellin të tjera tema, të shkruajnë hyrje apo dhe ese të plota në shtëpi për të bërë rishikimin e tyre në klasë.

Shembuj esesh për model

Përse duhet të studioj jashtë shtetit

Sot pothuajse të gjithë pranojnë me bindje se shkollës i takon ende një nga rolet kryesore në formimin e individit. Ajo zgjon tek ata interesat dhe ndjenjat e tyre intelektuale e shoqërore, stimulon pavarësinë e vetëveprimin, si dhe ndikon në forcimin e personalitetit.

Edhe pse Shqipëria ka një numër të konsiderueshëm universitetesh shumë të mira, ka disa arsye që më bëjnë mua të studioj jashtë. Përballja me përgjegjësitë, njohja me miq të rinj dhe pavarësia janë disa nga arsyet më tunduese që çdo i ri, i cili aspiro për një të ardhme më të mirë dhe për të qenë i gatshëm të përballojë sfidat, nuk u shmanget dot.

Një nga gjërat që do të fitoja nga largimi, do të jetë përballja me përgjegjësi më të mëdha, gjë që para së gjithash prindërve u pëlqen. Sot gjithmonë e më shumë prindërit ankohen se fëmijët e tyre janë kthyer në turistë të përhershëm dhe që shtëpinë e tyre e kanë kthyer në hotel, ku shërbimi është 100% i garantuar. Nëse unë largohem për të vazhduar shkollën, prindërit nuk do të jenë aty për t’i bërë të gjitha dhe kështu unë do të jem e detyruar të bëj gjithçka vetë: të gatuj, të laj, të fle dhe të ha sa duhet e, ç’është më e rëndësishmja, do të kem përgjegjësi të administroj paratë. Për më tepër, në këtë mënyrë unë do të mund të përgatitem të përballem me të ardhmen.

Përveç marrjes së përgjegjësi më të mëdha, unë do të njihem me miq të rinj. Kjo ka qenë gjithmonë e rëndësishme për mua. Nëse unë largohem, do të kem mundësi të takoj njerëz interesantë e me kultura të ndryshme. Ajo çfarë më pëlqen është se largësia e qëndrimi në një vend të huaj të detyron në njëfarë mënyre të njohësh njerëz të rinj, pasi eksperiencia ka treguar se studentët takohen vetëm me shokët e shkollës së mesme dhe shumë pak me të rinj. Një anë tjetër është se unë do të bëj një jetë më të pasur sociale, sepse, si i thonë, njohja me kultura dhe mendime të ndryshme të intrigon më shumë sesa ajo që ti e njuh po aq mirë. Ç’është më e rëndësishmja dikush ka thënë se universiteti është vendi ku do të gjesh miqtë e vërtetë. Unë do të ndihesha shumë keq në qoftë se nuk do ta provoja.

Megjithatë, një tjetër përparësi e largimit jashtë është pavarësia nga prindërit. Sot më shumë se kurrë kam

nevojë të kuptoj se Ç’është e drejtë për mua. Deri tani ishin prindërit ata që kanë ndikuar në çdo vendim timin. Është mirë që të kesh dikë që të të ndihmojë në gjithçka, por në të ardhmen prindërit nuk do të jenë gjithnjë me mua dhe duhet të mësohem të mbështetem vetëm te vetja. Së fundmi të qenit i pavarur më jep mua mundësinë të kuptoj atë çfarë ndien kur largohesh nga shtëpia dhe do të më përgatitur për ditën kur do të largohem përgjithmonë.

Shkuarja në universitet do të më bëjë më të përgjegjshëm e më të pavarur dhe përvojat e reja do të më përgatisin për të ardhmen. Unë tashmë jam e gatshme të marr më shumë përgjegjësi, të provoj të jetoj vetëm dhe të përfitoj nga kjo përvojë.

Tema: Mbrojtja e ambientit

Ambienti është ai në të cilin njeriu zhvillon veprimtarinë e tij jetësore dhe pa të, ai nuk do të mund të ekzistonte. Duke u fokusuar te mënyra se si të fitojë më shumë para, njeriu po e anashkalon kujdesin ndaj ekuilibrave natyrorë. Me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitatet natyrore të kafshëve dhe bimëve. Dëmtimi i florës dhe faunës, njëkohësisht sjell përkeqësimin e gjendjes së mjedisit dhe cilësisë së jetës. Duke parë rëndësinë e mjedisit, lind nevoja e madhe për mbrojtjen e tij. Në Shqipëri rastet e ndotjes së mjedisit janë të pafundme.

Njeriu e shfrytëzon tokën në favor të interesave të tij, ku gjatë përdorimit ka dhe disa kosto mjedisore, të cilat duhen minimizuar në maksimum.

Ndotja e tokës paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore. Mënyra më e mirë për të parandaluar ndotjen e tokës është përmes menaxhimit të mbeturinave në mënyrë te organizuar, shfrytëzimit të tokës në mënyrë te organizuar dhe praktikave të dobishme bujqësore.

Në vendin tonë rastet e ndotjes së tokës janë të shumta. Në zonën e Porto-Romanos, në qytetin e Durrësit, çdo ditë digjen me qindra tonë mbeturinash, ku mbetjeve urbane u bashkohen dhe ato spitalore. I gjithë procesi bëhet mbi një sipërfaqe toke të sheshtë dhe ku ndotja shkon 7-8 herë mbi nivelin e lejuar. E gjithë kjo situatë sjell pasoja të rënda mjedisore dhe dëmton shëndetin e njerëzve.

Shumë procese në natyrë kryhen falë ekzistencës së ujit, të cilin njeriu po e ndot dita-ditës.

Burimet ujore, po preken si nga faktorët shoqërorë (derdhja në ujëra e kimikateve, naftës etj.), ashtu dhe nga faktorët natyrorë (përzierja e ujërave sipërfaqësore me ujërat e ndotura nëntokësore). Ndotja e ujit sjell pasoja të rënda për jetën, si: zhdukja e gjallesave të ndryshme të ujit, mospërdorimi për nevojat jetike i ujit, përhapjen e sëmundjeve infektive etj³.

Në Shqipëri ndotjen e ujit gjendet në të gjitha format. Përdorimi pa kriter i burimeve naftëmbajtëse nga një kompani e huaj për nxjerrjen e naftës, shkaktoi shpërthimin e dy puseve në zonën e Patos-Marinzës. Kjo situatë solli ndotjen e ujit, ku Instituti i Shëndetit Publik konfirmoi praninë e lëndëve toksike në ujin e ujësjellësit dhe burimeve ujore nëntokësore të zonës.

Ajri është një ndër elementet bazë të ekzistencës së gjallesave. Dekadat e fundit, megjithëse vendet më të zhvilluara kanë përcaktuar limite të ndotjes, ai po ndotet vazhdimisht. Zhvillimi i industrisë dhe përdorimi i makinave ka shkaktuar ndotjen e ajrit, sidomos në zonat e banuara. Pasojat e këtyre zhvillimeve kanë sjellë sëmundje të rënda tek njerëzit dhe dëmtimin e ekosistemeve natyrore.

Në vendin tonë, vitin e kaluar gjatë matjeve të kryera nga Ministria e Mjedisit, u konstatua se në Tiranë niveli i ndotjes së ajrit ishte 20 % më shumë se norma e përcaktuar nga Bashkimi Evropian.

Duke parë rëndësinë e mjedisit dhe atë ç’ka po ndodh me të këto dekadat e fundit, lind nevoja që çdo individ të ndërjegjësohet dhe të punojmë për ruajtjen e mjedisit. Pasojat që sjell ndotja mjedisore dhe situata aktuale që paraqitet një vendin tonë, janë vërtet shqetësuese. Për një cilësi jete më të mirë, duhet kontribuar në ruajtjen e mjedisit.

Punoi: Geri Emiri **adresa** <https://geriemiri.wordpress.com/2015/05/03/ese-argumentuese-tema-mbrojtja-e-ambientit/>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë ese për atdheun (ora e dytë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Punë me shkrim	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton elementet e strukturës së një eseje. • Përcakton përmbajtjen e secilit element të strukturës. • Shkruan një ese për atdheun sipas rregullave të shkrimit të një eseje. • Respekton rregullat e drejtshkrimit. 		Fjalët kyç: Ese atdheu, strukturë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e pavarur me shkrim.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit kujtojnë elementet e strukturës së një eseje dhe asaj që përmban secili element i saj. Lexohen detyrat e shtëpisë dhe ndalemi në realizimin e elementeve të kërkuar.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur me shkrim.</i> Nxënësve u kujtohen hapat që duhet të ndjekin për të shkruar esenë në bazë të strategjive të të shkruarit që jepen në hyrjen e temës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pararashikimi, i cili përfshin planifikimin e ideve rreth asaj që do të shkruajmë, studimin e tyre, shtjellimin dhe mbajtjen e shënimeve për atë që do të realizojmë duke i përmbledhur shkurtimisht idetë e tyre. - Dorëshkrimi i parë. Kompozimi fillestar në letër, e cila nuk është e thënë të jetë perfekt, por është e rëndësishme të hedhin atë që kanë planifikuar. Në këtë fazë nuk ka rëndësi drejtshkrimi dhe saktësia e plotë të shkrimit. - Korigjimi i cili lidhet me ndryshimet që bëhen në material duke e përmbledhur e duke e redaktuar në formën përfundimtare të tij. Duhet pasur parasysh se në këtë pikë u bëhet e qartë nxënësve, që të shohin, nëse e kanë arritur atë që ka si synim shkrimi, apo duhet redaktuar ose shtuar gjëra të reja në të, a e ka organizimin e duhur sipas strukturës që vetë kanë planifikuar në etapën a parë, pra në një farë mënyre a i kanë realizuar pikat e etapës së parë që nisi me planifikimin. - Redaktimi ka të bëjë me rregullimin e çdo lloj gabimi që mund të perceptojmë, p.sh., qartësia e saktësia e ndërtimit të fjalive, paragrafëve; ndreqje e gabimeve drejtshkrimore dhe të shenjave të pikësimit. - Publikimi ka të bëjë me paraqitjen e shkrimit të audienca, e cila, në të shumtën e rasteve është mësuesi, por mund të jenë dhe shokët, blogje të ndryshme, revista apo gazeta të shkollës, turi i galerisë në klasë etj. <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënësit përfundojnë brenda orës kopjen e parë të esesë së tyre. Në mungesë të kohës kopja e parë mund të përfundohet dhe në shtëpi.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësime me gojë dhe vetëvlerësime në çdo etapë të orës mësimore. Detyrat dhe puna e pavarur. Vazhdohet me kopjen e parë të esesë nëse nuk është përfunduar.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë ese për atdheun (ora e tretë)		Situata e të nxënit: Punët me shkrim të nxënësve	
Kompetenca: Të shkruarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton rreth kopjes së parë të esesë. • Korrigjon kopjen e parë pas diskutimeve rreth saj. • Redakton punën e tij në bazë të drejtshkrimit dhe rregullave të esesë. • Prezanton punën e tij përfundimtare. 			
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punët me shkrim të nxënësve, diskutim,</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: diskutim Nxënësit lexojnë kopjet e tyre të para dhe diskutojnë rreth punëve të shokëve duke bërë vërejtjet e duhura.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur me shkrim</i> Nxënësit korrigjojnë dhe redaktojnë punën e tyre sipas rregullave dhe vërejtjeve që bëhen.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Rilexohen disa nga punimet përfundimtare nëse del koha dhe diskutohet rreth tyre.</p> <p>Vlerësimi: Vetëvlerësim dhe vlerësim me notë pas korrigjimit për të gjithë klasën.</p> <p>Shënim. Kjo teme mund të zhvillohet në dy orë</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupe zanoresh dhe diftongje.		Situata e të nxënit: Diktim	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 			

<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon diftongun nga togu zanor; përcaktojnë rregullat për drejtshkrimin e diftongut e togut zanor; shkruan saktë fjalët me diftong e tog zanor. 	<p>Fjalët kyç: drejtshkrim, tog zanor, diftong</p>
<p>Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, diktim, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rasti.</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit rikujtojnë dhe një herë klasifikimin e grupeve të zanoreve (diftong e tog zanor), duke dhënë veçoritë e secilit.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diktim, punë e drejtuar, analizë rasti</i> U diktohet nxënësve me libra mbyllur teksti në hyrje të mësimit. Pasi përfundohet diktimi, u kërkohet të qarkojnë grupet e zanoreve duke specifikuar llojin e tyre nëse janë diftong apo tog zanor. Nxënësit rihapin tekstet dhe vlerësojnë diktimin e shokut, duke lexuar rregullat e tekstit. U kërkohet nxënësve të shpjegojnë (nëse munden) pse janë shkruar diku me i dhe diku me j. Pra aty ku zanorja i, është e theksuar, ajo nuk ndryshon, në tog zanor, ndërsa në diftong, ku ajo është e patheksuar, bëhet j dhe me raste të veçanta ka dhe përjashtime. U kërkohet nxënësve të listojnë të tjera rregulla për drejtshkrimin e fjalëve me togje zanore ose diftong dhe t'i ilustrojnë ato me shembuj.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur, Ushtrime.</i> Ushtrimi 1 shkruhen me i të gjitha fjalët, përjashtoj fjalën <i>objekt</i> që lidhet me përjashtimin në rregullin e fundit. Ushtrimi 2, 3, sipas kërkesës. Ushtrimi 4, <i>pyet, mësuesin, reaksion, fërshëllyeka, aksion, portier, ndjeva, trajektoren.</i> Ushtrimi 5 ndalemi në rregullin e parë dhe të e fjalëve me grupet ia, ie, iu, io, në trup të fjalës për fjalët e huaja (rregulli 1 e diel, qiell, qiellor, diell, fierishtë, ndiej, diellor, shtie, miellzim). Rregulli i grupeve në trup të fjalës (thoi, ftoi, përroi), (këmbyes, shpërthyes), (dialekt, special), (volejbol, lajtmotiv), sipas nënpikave përkatëse.</p>	
<p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 6 sipas kërkesës.</p>	


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mënyrat e formimit të fjalëve. Kompetenca: Njohuri për gjuhën- Fjalëformim		Situata e të nxënësve: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • liston mënyrat e formimit të fjalëve; • përcakton përbërësit e fjalës; • gjen përbërësit e fjalëve jo të parme; • dallon fjalët e parme nga jo të parme. 		Fjalët kyç: fjalë, përbërës, fjalëformim, kompozim, morfemë, fjalëformuese, trajtë formuese	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rastesh, punë e drejtuar, punë e pavarur, INSERT.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*

Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

Nxënësit kanë njohuri rreth fjalëformimit ndaj plotësojnë një kllaster duke dhënë njohuritë e tyre për të.



Vazhdohet me përkufizimin dhe njohuritë që kanë rreth fjalëve të prejardhura e të tjera dhe mënyrës së formimit me prejardhje.

1. Ndërtimi i njohurive të reja: *analizë rastesh, INSERT, punë e drejtuar*

Nxënësit punojnë disa minuta me tekstin në hyrje shkëputur nga proza “Ay mal”, e Lumo Skëndos, duke dalluar fjalët e parme e jo të parme. Për fjalët jo të parme bëjnë klasifikimin e tyre në të prejardhura, të përbëra e të përngjitura. Për secilin rast nxënësit tregojnë mënyrën e formimit të fjalëve.

Për fjalët e prejardhura dallojmë elementet që formojnë fjalë të reja nga ato që shërbejnë vetëm për të dhënë trajta të reja të fjalës.

Rikthehen në tekst për të punuar me teorinë me shenjat e tabelës INSERT duke specifikuar kuptimin e termave: *morfemë, trajtëformuese, fjalëformuese, kompozim.*

Pasi sqarohen këto koncepte, i dallojmë në shembujt që u nxorën në paragrafin hyrës.

Dallojmë konceptin e temës në të dyja format që vjen *tema* (pjesë e fjalës që mbetet, kur heqim mbaresën), *tema fjalëformuese* (pjesa e fjalës që mbetet kur heqim parashtesën dhe prapashtesën).

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur, Ushtrime.

Ushtrimi 1, 3, 4, 5 sipas kërkesës.

Ushtrimi 2 Kujtojmë rregullin që emrat me prapashtesën **-im** dhe **-je** formohen nga tema foljore të zgjedhimit I dhe II.

Ato me prapashtesën **-im** formohen nga folje të zgjedhimit I, dhe ato me prapashtesën **-je** formohen nga folje të zgjedhimit II.

Udhëheq dhe *duarartë* (fjalë të përbëra)

Mënyra (fjalë e parme)

Fjala *drejtshkrim* është e formuar nga **drejt** + emrin **shkrim**, ku pjesa drejt u përgjigjet nga kuptimi i fjalëve *i drejtë*, *mbiemër*, *drejt*, *ndajfolje*.

- Nuk duhet të ngatërrohen fjalët e prejardhura me parashtesë e prapashtesë njëkohësisht me fjalët që këto morfema i marrin gradualisht.(përçmim) **-im** dhe **për** janë marrë gradualisht në fillim **për** pastaj **im**.

Ushtrimi 6

Fjalët **prehjes** dhe **mprehje** nuk kanë lidhje përsa i përket rrënjës.

Prehje vjen nga folja **preh**/em/, çlodhem ndërsa **mprehje** lidhet me foljen (mpreh, holloj diçka, e bëj me majë, mpreh lapsin. Të dyja këto fjalë janë formuar me prapashtesat **-je** së bashku me fjalët çlodhje dhe *vrasje*.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit

Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 7 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjeniu i vogël (ora I) Kompetenca: Të lexuarit tekst joletrar		Situata e të nxënit: Muzikë simfonike e Moxartit dhe diskutim rreth saj	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 5. Kompetenca qytetare 7. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon për të kuptuar përmbajtjen; • shpreh mendimin e tij rreth muzikës klasike; • Rendit sipas radhës provat që Moxarti u detyrua të kalojë; • ritregon bukur përmbajtjen e pjesës. 		Fjalët kyç: gjeni, muzikë, piano, famë, Moxarti	
Burimet: teksti i nxënësit, informacione nga interneti, CD me muzikë të Moxartit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Muzikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, lexim i drejtuar DRTA, Diagrami Venit, Punë e pavarur</i>			


Organizimi i orës së mësimit:

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *bashkëbisedim*

Nxënësit dëgjojnë pjesë muzikore të Moxartit dhe më pas diskutojnë rreth preferencave të tyre muzikore duke u ndalur te muzika klasike. U drejtohen

- A ju pëlqen muzika? Ç’ lloj muzike dëgjoni më shpesh?
- Po kjo lloj muzike ju pëlqen? Pse?
- Ç’ndjesi ju zgjon ajo?

(Mësuesi/ja bën një grafik në dërrasën e zezë për muzikën)



- Ç’ dini për Moxartin?
- Jetën e tij?

Dëgjojnë mendimet e nxënësve dhe vlerësohen ato.

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi i pjesës së re

Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse në të cilën prezanton titullin e pjesës dhe autorin e saj. Më pas u kërkon nxënësve të bëjnë parashikimet e tyre duke u bazuar te titulli i pjesës “Gjeniu i vogël”.

- *Lexim i drejtuar*

Mësuesi/ja (ose nxënësi), lexon pjesë-pjesë tekstin dhe nxënësit flasin për atë që kuptojnë gjatë leximit duke u ndalur në elementet kyçe të përmbajtjes si; fjalët kyçe apo figurat letrare.

Pjesa 1: Paragrafi i parë deri te e *bënin flakë e tym* etj.

Pjesa 2: deri te *sipas mësimëve të babait*.

Pjesa 3: deri në fund të tregimit.

- Pyetje rreth të kuptuarit

Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e tregimit.

- Ç’ lloj shkrimi është kjo pjesë? (Biografi)
- Ç’ tipare ka ky lloj shkrimi?
- Pse autori e fillon pjesën me fjalinë: *Lavdia e Moxartit arriti edhe në Vjenë*.
- Ç’ përfaqësonte Vjena në atë periudhë? Po sot?
- Pse autori e titullon pjesën “Gjeniu i vogël”?
- Kur e quajmë dikë gjeni?
- Ç’ tregon kjo pjesë për gjenialitetin e Moxartit?
- Nga ishte Moxarti?
- Ku i kishte arritur lavdia?
- Si po e priste Vjena gjeniun e vogël?

Ushtrimi 3: Mund të realizohet dhe me ndihmën e diagramit të Venit. Mësuesja e vizaton në tabelë dhe nxënësit e plotësojnë, duke gjetur ngjashmëritë dhe të veçantat midis gjeniut dhe njeriut të talentuar.

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të shkruar përmbajtjen e tregimit me tri fjali përmbledhëse.

Vlerësimi: Mësuesi vlerëson mendimet e sakta dhe të formuluarat bukur.

Detyrë shtëpie: Nxënësit gjejnë figuracionin e përdorur dhe e komentojnë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjeniu i vogël (ora e dytë) Kompetencë: Të lexuarit		Situata e të nxënësve: Moxarti dhe unë (lojë)	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 5. Kompetenca personale 6. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • paraqet një informacion të plotë mbi jetën dhe veprën e Moxartit; • krahason cilësitë e Moxartit duke vendosur përballë vetveten; • realizon hartën e personazhit për Moxartin; • dallon dhe ilustron veçoritë e tekstit biografik. 		Fjalët kyç: Moxart, muzikant, i famshëm, cilësi të karakterit, tekst biografik	
Burimet: teksti i nxënësit, informacione nga internet, muzikë e Moxartit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Muzikë, histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>lojë, kllaster, harta e personazhit, punë e pavarur</i>			


Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Lojë*

Mësimi fillohet me një lojë “Moxarti dhe unë”, ku nxënësit flasin së pari rreth jetës së Moxartit, veprës së tij dhe me pas flasin hobit që ata kanë dhe si i ushqejnë ato për t’i zhvilluar më tej.


2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Harta e personazhit*

Nxënësit bazuar në punën e mësipërme dhe në fragmentin e dhënë në tekst ndërtojnë hartën e personazhit për Moxartin, duke e argumentuar atë me veprimet e tij.



3. Demonstrim i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Nxënësit punojnë në grupe kërkesat e ushtrimit 4 dhe mbi këtë bazë ata plotësojnë kllasterin për tekstin biografik.



Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit që aktivizohen dhe inkurajon ata për arritje të mëtejshme.

Detyrë shtëpie: Nxënësit plotësojnë kllasterin e mësipërm në shtëpi, nëse nuk arrihet gjatë orës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: “Më shumë për Moxartin dhe muzikën klasike” Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënit: Jeta e klasikëve të mëdhenj	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca digjitale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: • Sjell informacione për Moxartin dhe klasikët e tjerë të muzikës. • të flasë për muzikën e Moxartit dhe ndikimin e saj; • të tregojë për karakteristikat e muzikës së Moxartit, klasikëve të tjerë dhe të çdo periudhe të muzikës klasike; • të dëgjojë simfoninë “Jupiteri” të Moxartit dhe të diskutojë rreth saj; • jep informacione dhe veçori të koncertit të Vitit të Ri në Vjenë ndër vite.		Fjalët kyç: Moxart, Kompozitor, muzikë klasike, koncert.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale që lidhen me jetën dhe muzikën e Moxartit e të klasikëve të tjerë https://www.youtube.com/watch?v=zK5295yEQMQ ose (libri digjital)		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Muzikën Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim i materialeve të sjella nga nxënësit dhe çështjeve të shtruara, dëgjim i materialeve të ndryshme muzikore, shkrim i lirë.			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Lexohen detyrat e shtëpisë dhe diskutohen ato duke bërë vlerësimet e duhura. Nxënësve u kërkohet të flasin për Moxartin, pa përsëritur ato të dhëna që kanë sjellë gjatë temës “Gjeniu i vogël”, për muzikën klasike dhe kompozitorë që njohin. Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim Nxënësve u kemi kërkuar që më parë të nxjerrin informacionin e mëposhtëm që flet për “Efektin Moxart” dhe të diskutojnë rreth tij duke dhënë dhe eksperiencën personale në lidhje me dëgjimin e muzikës klasike. Disa të dhëna për <i>Efektin Moxart</i> • Sipas shkencëtarëve, nëse dëgjojmë muzikë të këndshme për veshin, efektiviteti i trurit mund të pësojë rritje. Shkencëtarët flasin për të ashtuquajturin “Efekti Moxart”. Ai haset jo vetëm në muzikën klasike, por edhe te heavy metal. Rëndësi ka që dëgjuesit t’i pëlqejë tingulli. Por a ka ndonjë lidhje organike mes muzikës e shkallës sonë të inteligjencës? • Nën një ritëm të këndshëm e tone jo fort të larta, një muzikë e lehtë mbrëmjeje, mund të të sjellë – ndërsa përpiqesh të flesh – në shinat e duhura. “Edhe kur je duke dëgjuar pjesë të shkurtra nga Moxarti i madh gjatë pirjes së një çaji qetësues në ndonjë pasdite, kur mbase jo të gjithë do të ishin dakord me zgjedhjen tënde”, shkruajnë shkencëtarët në një studim të fundit mbi efektet e muzikës në trurin njerëzor. • Prej shkencëtarëve besohet se tingujt rrisin aftësinë e njerëzve për të medituar e për të gjykuar. E këtu bëhet fjalë për “Efektin Moxart”. Dhjetë minuta melodi të këndshme nga pjesët e famshme të gjenit nga Salcburgu, i shndërrojnë njerëzit në një gjendje gatishmërie e aftësie më të madhe për të medituar. Studimet kanë treguar se ndikimet e muzikës në “shpirtin” njerëzor, janë të shumta. • Ata kanë provuar se edukimi i hershëm muzikor, mund të stimulojë aftësinë apo rritjen e nivelit të mëvonshëm të inteligjencës të njerëzit dhe se struktura e trurit mund të ndryshojë, pasi është mësuar të dëgjojë për një kohë të gjatë pjesë në piano. Ndërkohë, është studiuar e marrë në shqyrtim dhe ndikimi kur			

dëgjoen rryma moderne të muzikës, që në dukje janë shumë larg asaj klasikes, si pop apo heavy metal, të cilat gjithashtu ushtrojnë efekte të ndryshme te njeriu.

- Është hetuar në detaje edhe në ç’moshë është koha më e mirë për t’ia nisur nga mësimet në muzikë, dhe nëse të dëgjosh thjesht muzikë, pra të jesh një marrës pasiv, do të ishte e mjaftueshme, ashtu sikurse të këndosh apo të luash vetë në një vegël, pra të bësh muzikë në mënyrë aktive.

- Në vitin 1993, në një revistë të specializuar shkencore, “Nature”, u publikuan rezultatet e një testimi të bërë asokohe, ku theksonin se pasi dëgjuan për dhjetë minuta një pjesë nga Moxart, disa nga studentët e tyre, që kishin prirje për muzikë, mundën të zgjidhnin më saktë disa detyra që u ishin dhënë në klasë pak minuta më parë. Aftësia e tyre në përgjithësi për t’i kuptuar gjërat, tashmë dukej se ishte shtuar dhe se ata paraqiteshin shumë më mirë sesa shokët e tyre që nuk kishin prirje dhe dëshirë të dëgjonin muzikë para se të bënin detyrat.

- Qysh prej asaj kohe, u pa madje dhe një lulëzim i tregut muzikor amerikan me produkte muzikore, për t’i përdorur si materiale ndihmëse didaktike të rekomanduara gjerësisht për fëmijët. Në Florida, fëmijëve u rekomandohet muzikë klasike, në shtetin e Georgia-s, ndërkohë, prindërve të çdonjërit prej të sapolindurve të këtij shteti, u bëhet dhuratë madje edhe nga një CD me muzikë klasike.

- Në vitet e mëpasshme, adhuruesit e Moxartit, ashtu sikurse dhe skeptikët, kanë raportuar disa herë për efektet e muzikës mbi “njohjen njerëzore”. Pjesërisht janë raportuar edhe disa fakte të çuditshme: kështu, shkencëtarët duan të dëshmojnë se nëse foshnjave u luhet muzikë qysh në bark të nënës, do të gjendeshin më pas në një situatë më normale, kur të dëgjonin të luhej po e njëjta muzikë. Por siç dihet, foshnjat lindin duke mos dëgjuar asgjë, pasi në trupin e nënës ato, sigurisht, nuk mund të dëgjojnë dot muzikë. Të tjerë shkencëtarë ndërkohë pohojnë se – sipas preferencës së marrësit – leximi me zë të lartë i një historie nga Stephen King për shembull, sjell të njëjtat efekte aktive si dëgjimi i një disku të Moxartit, Shubertit, Bahut apo i ndonjë pjese “Heavy Metal”.

- Me një projekt të financuar nga Ministria gjermane e Arsimit, shkencëtarët kanë arritur më në fund të bëjnë të ditura rezultatet e një studimi të gjatë, ku kanë konstatuar përfundimisht se edukimi i hershëm i fëmijëve me muzikë, i bën ata të mësojnë më kollaj pastaj gjatë procesit të tyre edukativ apo dhe madje, të rrisë nivelin e përgjithshëm të inteligjencës së tyre.

- Nga shkencëtarët është marrë në shqyrtim edhe pyetja e drejtpërdrejtë “A të bën Moxarti më të zgjuar?”. Por ende nuk është dhënë një përgjigje e mirëfilltë prej tyre. Profesionit i muzikantit, normalisht nuk futet tek ata me kuota më të larta inteligjence sesa të tjerët (jo muzikantët), e kjo flet më së miri për pretendimin e mëparshëm, sa për të mos gjykuar apriori.

- Megjithatë, shkencëtarët po përipiqen edhe me anë studimesh të tjera, ku në teste janë marrë fëmijë të moshave të ndryshme, të cilët janë vënë në kontakt në mënyra të ndryshme me muzikën (duke marrë mësim pianoje, orë kori, duke dëgjuar muzikë etj.), për të nxjerrë në pah një lidhje mes muzikës e zgjuarsisë. Ndërkohë, është bërë më se e qartë se pas dëgjimit të një muzike të mirë, aftësia “konjitive” të paktën për një afat të shkurtër, rritet.

- Sidoqoftë, nuk është se në çdo rast, muzika duhet të vijë nga tingujt e notave të Moxartit. Kështu, kërkuesit në Universitetin e “Glasgout Caledonian” në Skoci, kanë mundur të tregojnë në një elektroencefalogram, se veshi apo prirja muzikore, luan gjithsesi, një rol të rëndësishëm. Të tjerë shkencëtarë dëshmojnë se ka një ndryshim mes muzikantëve profesionistë që merren në teste me njerëzit e thjeshtë, të cilët nuk luajnë dot asnjë instrument dhe që nuk kanë ndonjë prirje të admirueshme ndaj muzikës.

- Ekziston dhe një ndryshim gjithashtu, kur muzika bëhet vetë apo vetëm dëgjohet. Megjithatë: truri organizohet më mirë nën ndikimin intensiv të muzikës.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Në vazhdim vendosim një fragment nga simfonia « Jupiteri » nga Moxart dhe të diskutojnë rreth saj.
<https://www.youtube.com/watch?v=zK5295yEQMQ>

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur; Detyra. Të merren informacione dhe të dëgjoen fragmente nga koncerti i Vitit të Ri në Vjenë dhe bëjnë një shkrim të shkurtër duke dhënë dhe përshtypjet e tyre rreth saj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: Fjalët e prejardhura, të përbëra e të përngjitura Kompetencë: Njohuri për gjuhën - Fjalëformim		Situata e të nxënit: “Kështjella “ Kadare			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;					
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët jo të parme në një tekst; • i klasifikon ato në të prejardhura, të përbëra e të përngjitura; • përcakton mënyrën e formimit të fjalëve të prejardhura, të përbëra e të përngjitura; • përcakton klasën së cilës i përkasin fjalët e prejardhura, të përbëra e të përngjitura. 		Fjalët kyç: fjalë, fjalëformim, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura.			
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, tabela e tipareve semantike, punë e drejtuar, punë e pavarur.</i>					
Organizimi i orës së mësimt					
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi,</i> Bëhet kontrolli, diskutimi i detyrave të shtëpisë dhe një vlerësim për to. Nisur nga detyrat nxënësit paraqesin përmes një skeme njohuritë e tyre rreth ndarjes së fjalëve sipas formimit dhe fjalëformimit.					
<pre> graph TD A[Fjalë] --> B[të parme] A --> C[jo të parme] C --> D[të prejardhura] C --> E[të përbëra] C --> F[të përngjitura] </pre>					
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>analizë rasti, tabela e tipareve semantike</i> <ul style="list-style-type: none"> • U kërkojmë nxënësve të punojnë me tekstin e shkëputur nga romani “Kështjella” e Kadaresë, duke ndarë fjalët sipas formimit në të parme e jo të parme. • Fjalët jo të parme: në të prejardhura, të përbëra e të përngjitura. • Për secilën prej tyre nxënësit thonë mënyrën e formimit dhe klasën së cilës i përkasin. 					
Fjala	e prejardhur	e përngjitur	e përbërë	Mënyra e formimit	Klasa e fjalës
megjithatë		+		Me+gjithë+atë (paraf+përemër i pacaktuar+përemër)	lidhës
qimebardhë			+	qime+bardhë (emër + mbiemër)	mbiemër
Mallkim	+			Mallko+im (folje+prapashtesë)	emër

ogurzi			+	Ogur+zi (emër + mbiemër)	mbiemër
sepse		+		Se+pse (lidhëz+lidhëz)	lidhëz
diku		+		Di+ku (folje+ndajfolje)	ndajfolje
nëntoka	+			Nën+tokë (parafjalë+emër)	Emër
ujësjellës			+	Ujë+sjellës (emër + emër prejfoljor)	emër
atëherë		+		Atë+herë (përemër+emër)	ndajf
Të pamundurën	+			Pa+e mundura (me parashtesë+emër prejfoljor)	Emër
shpresonim	+			Shpresë+o (emër +prapashtesën-o)	folje
Kërkimi	+			Kërko+im (folje+prapashtesë -im)	emër
Përdridhej	+			Për+dredh (parashtesë+folje)	folje
Të ngrirë	+			Pjesorja ngrirë me paranyjëzim	mbiemri
mërzitje	+			Mërzit+je (folje+prapashtesën -je)	emër
lëvizje	+			Lëviz+je (folje+prapashtesën -je)	emër

Kjo tabelë edhe me një shembull mund t’u jepet nxënësve për të lehtësuar punën e tyre me fjalët. Nxënësit duhet të përpiqen vetë të tregojnë mënyrat e fjalëformimit në secilin rast duke arritur dhe në konkluzione.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur, Ushtrime.

Ushtrimi 1, 2, 4, 7 sipas kërkesës.

Ushtrimi 3: vetëm fjalët *asnjëherë* dhe *kurdoherë* janë të përngjitura,

- flokëverdhë-e përbërë, përflak-prejardhur.

Ushtrimi 5

- janë mbiemra të formuar me prapashtesa të ndryshme, si: *-acak, -taq, -acuk, -almaq, -ash, -alec*
- folje, formuar nga emra me prapashtesa *-o*;
- emra të formuar me prapashtesat: *-ës, -es, -ar, -tar*, formuar nga klasa të ndryshme fjalësh;
- emra që tregojnë origjinë të formuar me prapashtesën: *-ar, -or, -ak, -an, -it* etj. nga emrat e vendeve.
- folje të formuara nga klasa të ndryshme fjalësh, si ndajfolje e emra me prapashtesën *-o*.
- ndajfolje të formuara nga emra, mbiemra, folje me prapashtesat: *-as, -thi, -çe* etj.

Përmes këtij ushtrimi nxënësit mund të arrijnë në konkluzione se cilat janë ato prapashtesa që formojnë një klasë të caktuar fjalësh, si dhe u tha edhe më sipër.

Ushtrimi 6 - kujtohen rregullat e drejtshkrimit për parashtesat *ç-, sh-, zh-*.

Fjalët marrin kuptim të kundërt:

me *sh-*, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët (*f, k, p, q, t, th* etj.): *shfajësoj, shkëput, shpalos, shqep, shtrydh*;

me *zh-*, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme (*b, d, g, gj, v*): *zhbart, zhdëmtoj, zhgënjej, zhgënjim, zhvat*, me *ç-*, kur kjo ndiqet nga një zanore ose nga një bashkëtingëlloree tingullit (*l, ll, r, rr, m, n, nj, j*): *çarmtatos, çlodhje; çregjistroj, çregjistrim; çrrënjosje; çmalle, çmend, çjerr* etj.

Shënim. Përemri *ç* dhe te të gjitha fjalët e formuara me pjesëmarrjen e tij, shkruhet kështu, pavarësisht nga bashkëtingëllorja që e pason: *çdo, çdokush, çdonjëri, çfarë, çfarëdo, i çfarëdoshëm, çka, diçka, gjithçka*.

Shënim. Shkruhen me *sh-* fjalët: *shmang, shlyej, shndërroj, shndrit* dhe ato që formohen prej tyre.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit

Detyrat dhe puna e pavarur; Ushtrimi 7. Fjalët e formuara përdorini në një tekst ose në fjali.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Situata e të nxënimit: Diktim	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> shkruan saktë fjalët me parashtesat: ç-, sh-, zh-, s-, z-; shkruan saktë fjalët me prapashtesat: -si, -ri, -shëm, -të, -tar, -tor; gjen gabimet drejtshkrimore në një tekst dhe i korrigjon ato. 		Fjalët kyç: drejtshkrim, fjalë, të prejardhura, parashtesa, prapashtesa.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diktim, punë e drejtuar, punë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. U kërkohet nxënësve të kujtojnë drejtshkrimin e fjalëve me parashtesat ç-, sh-; zh-.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: diktim, punë e drejtuar. U jepet nxënësve një fletë në të cilën është shkruar një tekst me disa fjalë që janë shkruar gabim dhe u kërkohet atyre t'i gjejnë dhe, në bazë të rregullave që ndodhen në libër, t'i qortojnë. Fjalët mund dhe të shkruhen edhe në tabelë dhe bëhet nga nxënësit evidentimi i gabimeve dhe qortimi i tyre duke pasur parasysh rregullat rreth tyre në tekst.			
Fjalët që mund të shkruhen: çpalos, shnerëzor, sbus, mirsi, vajzri, shpejtsi, mjeksi, devotshmëri, i njëmijët, i natyrshëm, antar, puntor, kombtar, zdrukthar, Shqipri, shqiptar, shkakëtar.			
Me këto fjalë mund të formulohen edhe tekste të shkurtra, me të cilat mund të punojnë nxënësit. Në qiell u çpalos flamuri shqipëtar që prej kohësh në Shqipri nuk çpalosej. Ishte e njëmijëta herë që përpiqeshin me devotshmëri sa e sa lufëtarë, msues e atdhetar, të ngrinin të lirë flamurin tonë kombtar. Por kjo u arrit falë vajzrisë e djalrisë shqipëtare. Pak prej tyre u bënë të famëshëm e shumë mbetën anonimë dhe u përjetësuan vetëm në këngë. Qenë poetët e vjershtarët që përjetsuan kujtimin e tyre.			
Nxënësit pasi grupojnë fjalët sipas llojit të gabimit bëjnë korrigjimet në bazë të rregullave duke thënë secilën prej tyre. Mund të punohet dhe në çift.			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur, Ushtrime. Ushtrimi 1, 2, 5 sipas kërkesës. Ushtrimi 3 çformohej-shformohej, shlodhen-çlodhen, çfaqje-shfaqje, shmallej-çmallej, svogëluar-zvogëluar, çfleton-shfleton. Ushtrimi 4 ndërkombëtar (sipas rregullit), fajtor, shtegtar, kujdestar, gjyqtar, shtegtoj (sipas përjashtimit të rregullit).			
Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit. Sugjerohet të bëhet vlerësim dhe mbi bazën ushtrimeve në fazën e ndërtimit të njohurive; të diktimit dhe argumentimin e zgjidhjeve të ushtrimeve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Intervistë me Inva Mulën – tekst joletrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Intervistë me Inva Mulën	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca digjitale;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dëgjon për të marrë informacion për këngëtarin Inva Mula nëpërmjet intervistës; dallon veçori të intervistës; lexon intervistën për ta krahasuar me atë që dëgjon dhe për ta zbërthyer atë nga ana kuptimore; analizon gjuhën dhe strukturën e intervistës për të nxjerrë karakteristikat dhe rregullat e shkrimit të një interviste. 		Fjalët kyç: Intervistë, Inva Mula këngëtare, famë, botërore, strukturë ,	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale për Inva Mulën, https://www.youtube.com/watch?v=TG-wlRGdnl0		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave të tjera	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>dëgjim, diskutim, lexim në role, Diagram Veni, punë e drejtuar, punë e pavarur.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Dëgjim i intervistës së Inva Mulës, diskutim për figurën e artistes.</p> <p>Nxënësit kanë marrë informacione për jetën dhe veprimtarinë e Inva Mulës duke renditur shkurtimisht disa prej tyre.</p> <p>U drejtohen pyetje të tilla, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> A e keni dëgjuar emrin e Inva Mulës? Ç’ dini për të? Ç’ përfaqëson ajo? <p>Nëse nuk kanë informacionin e nevojshëm, jepet nga mësuesi/ja.</p> <p>Inva Mula ka lindur në <u>Tiranë</u> në vitin 1963, është një këngëtare soprano shqiptare me famë botërore. Ajo ka marrë shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 1987 fitoi konkursin “Këngëtarja Shqiptare”, më 1988 konkursin “George Enescu” në <u>Bukuresht</u>. Pas katër vjetësh më 1992 fiton konkursin “Butterfly” në <u>Barcelona</u>. Më 1993 merr një çmim në Operalia-n e parë të <u>Placido Domingos</u> në Paris. Ka bashkëpunuar me tenorë të famshëm në operën e Bastille-s në Paris, në Bruksel, në Mynih dhe në Oslo. Në vitin 1996 mori pjesë në operën <i>Medea</i> të Luigi Cherubini-t në Francë. Në vitin 1998 rikthehet në operën e George Bizet-it “La Jolie fill de Perth”. Në filmin “Elementi i pestë” më 1997 luan rolin e Luçia di Lammermoor në skenën «The Diva Dance». Më vonë ajo luajti në operën “Ivan IV” të Bizet-it në Paris. Në vitin 2001 luajti në teatrin “La Scala” të Milanos, pjesën e Verdit “Falstaff” dhe Riggoletto-n në Arenën e Veronës. Ka marrë pjesë rregullisht në “La Scara” ku luajti Lucia di Lammermoor, La bohème, Manon (2006). Luajti gjithashtu disa herë dhe La traviata-n në qytete të rëndësishme si Tokio, Bilbao, Orange, Trieste dhe Toronto. Mënyra e saj e të kënduarit e beri atë të famshme.</p>			


Ndërtimi i njohurive të reja: Dëgjim dhe lexim në role i Intervistës, diskutim,

Nxënësve u vëmë të dëgjojnë fillimisht intervistën e Inva Mulës nga Zëri i Amerikës dhe u kërkojmë të evidentojnë personin që intervistohet, tematikën e intervistës dhe qëllimin e saj.


Lexohet në role intervista e Inva Mulës dhe nxënësit japin shkurtimisht përgjigje rreth të kuptuarit.

Vazhdohet me rubrikën “Diskutoni” ku për pikën e parë, është folur në pjesën e parë të mësimit.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur, Diagram i Venit

 Në lidhje me mesazhin e thënies “ *Lidershipi në mendim, që çon në veprim*”, mund të pranohen përgjigje të ndryshme. Një nga këto mund të jetë: *Njeriu duhet të ndihet gjithmonë dikush që mund të arrijë majat, të jetë i pari dhe udhëheqës i shumë eksperiencave dhe nëse ka besim në vetvete, siguri dhe punë për të arritur, mund të realizojë në praktikë çdo ëndërr.*

 Në cilën prej përgjigjeve, e intervistuar i kundërshton fjalët e gazetares? Pse?

 Sopranoja kundërshton gazetaren në pyetjen lidhur se sa është bërë për të investuar që talentet e reja të arrijnë majat dhe të njohin mirënjohje, sepse e ndien se shumë artistë nuk janë afirmuar brenda kufijve, por jashtë saj, kjo falë punës dhe talentit të tyre, ndërsa brenda kufijve të Shqipërisë është bërë shumë pak për të investuar në fusha të caktuara, që ngritja profesionale të kapë majat së pari në atdhe e pastaj për t’i afirmuar në botë.

Analizoni gjuhën e tekstit

Fjalët kyçe të gazetares: *lajm i orës së fundit, anëtare e Akademisë Botërore të Artit, Dyzim mes atdheut dhe pjesës tjetër të botës, fond i vyer njerëzor, imazhi i Shqipërisë në Botë, realiteti artistik shqiptar.*

Shënim: Analiza e gjuhës së tekstit bëhet në vazhdim dhe të orës së parë të të shkruarit të një interviste nëse nuk mjafton koha.

Pikat e tjera plotësohen nga nxënësi thjesht për informacion.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Materiale në lidhje me një personalitet arti ose sporti, një event artistik a sportiv në jetën e tyre, rreth të cilit do të ndërtojnë një intervistë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë intervistë (ora e parë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të shkruarit		Intervistë me Inva Mulën	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton karakteristikat e një interviste. • Përcakton karakteristikat e ndërtimit të pyetjeve për një intervistë. • Ndërton vetë pyetje për një intervistë. 		Intervistë, strukturë e intervistës, pyetje, përgjigje	

Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; intervista nga burime të ndryshme me personalitete të ndryshme https://www.youtube.com/watch?v=DP-AVgocG0M ,	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte dhe sport, identiteti kulturor dhe njohja e kulturave
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë e drejtuar me modele, diskutim, punë e pavarur.</i>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi.</i></p> <ul style="list-style-type: none">☞ Ç’ lloj shkrimi është intervista?☞ Ç’ tipare ka ky lloj shkrimi?☞ A keni bërë ndonjëherë një intervistë?☞ Ç’ duhet të kemi parasysh kur zhvillojmë një intervistë?☞ Ç’ modele pyetjesh mund të përdorim gjatë një interviste? <p>Bëhet prezantimi i temës dhe rezultateve të saj, ndërkohë që nxënësit janë njohur një orë më parë me intervistën e organizuar me Inva Mulën.</p> <p>Gjatë orës së parë nxënësit kanë zbërthyer kuptimisht intervistën, por dhe janë njohur me të, si lloj i shkrimit gazetaresk duke evidentuar karakteristikat e një interviste, të cilat përsëriten dhe duhet të dalë në pah nisur dhe nga intervistat që nxënësit kanë marrë si modele.</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Personi që duam të intervistojmë.☞ Qëllimi që lidhet me tematikën e intervistës.☞ Titulli dhe nëntitulli i intervistës.☞ Llojet e pyetjeve që i drejtohen të intervistuarit.☞ Renditja e pyetjeve.☞ Struktura e saj etj. <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e drejtuar me modele</i></p> <p>Nxënësit janë porositur një orë më parë të kenë nga burime të ndryshme, të tjera intervista me personalitete të artit dhe sportit shqiptar.</p> <p>Nxënësit ose mësuesi/ja, në varësi të mundësisë me videoprojektor mundësojmë shfaqjen e intervistës marrë nga Zëri Amerikës, me sopranon Ermonela Jaho ose përdorim intervistën që ka disku shoqërues i librit me Amik Kasoruhon duke nxjerrë shënime për përgjigjet e kërkuara në tekst.</p> <p>Këto modele intervistash ndihmojnë për të ngulitur te nxënësit konceptin e intervistës.</p> <p>Bazuar në këto intervista dhe modelet që kanë përzgjedhur vetë nxënësit punohet për të evidentuar karakteristikat e modeleve të dhëna të intervistave.</p> <p>Nxënësit përcaktojnë tematikën, personazhin, qëllimin e intervistës, llojet e pyetjeve që janë drejtuar, si janë renditur ato etj.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur me shkrim</i></p> <p>Nxënësit përcaktojnë vetë personazhin që duan të intervistojnë, tematikën e intervistës duke e lidhur me qëllimin se përse duan ta realizojnë atë.</p> <p>Bazuar në strategjitë e të shkruarit punojnë me ndërtimin e pyetjeve të një interviste hap pas hapi.</p> <p>Nxënësve u kërkohet që të njohin mirë personazhin që duan të intervistojnë duke parashikuar dhe ndonjë përgjigje për të mundësuar një rrjedhë logjike dhe pyetje sa më të arrira nga ana strukturore dhe e përmbajtjes.</p> <p>Nxënësit dhe nëse nuk i përfundojnë intervistat e tyre brenda orës, mund të lexojnë hyrjen e intervistës dhe pyetjet e para që kanë realizuar.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësim me gojë dhe vetëvlerësim</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. U kërkohet nxënësve që të realizojnë një intervistë me pyetjet që përgatitën në klasë, të mbajnë shënime ose edhe ta incizojnë, në varësi me mundësit.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë intervista (ora e dytë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Punët me shkrim të nxënësve	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Liston karakteristikat e një interviste. Përcakton hapat që ndiqen për të realizuar një intervistë. Realizon pyetjet dhe përgjigjet e një interviste. Diskuton për pyetjet e realizuara nga shokët. 		Fjalët kyç: intervistë, pyetje, personalitet	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale ndihmëse, të dhëna për personazhe të ndryshme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte dhe sport, Identiteti kombëtare dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë e drejtuar, punë me shkrim, diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Lexohen detyrat e shtëpisë dhe diskutohet për to.</p> <p>Nxënësit rikujtojnë njohuritë që morën për intervistën, karakteristikat, hapat që ndiqen për të realizuar një intervistë, si realizohen pyetjet etj.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë individuale</i> Nxënësit shkruajnë intervistën e plotë duke sjellë të dhënat që i kanë marrë personazhit që kanë përcaktuar për ta intervistuar. Pastaj rishikojnë edhe një herë intervistën, bëjnë korrigjimet drejtshkrimore dhe të pikësimit.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Lexohen dhe diskutohen disa nga punët e bëhen diskutimet dhe bëhen vlerësimet e nevojshme. Vërejtjet e bëra, nxënësit i reflektojnë në punimet e tyre.</p> <p>Vlerësimi: Vetëvlerësim dhe vlerësim me notë sipas gjykimit të mësuesit</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Situata e të nxënit: Krijojmë fjalë të reja.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon fjalët e përbëra • Ndërton vetë fjalë të përbëra nga fjalë të thjeshta. • Shkruan saktë fjalë të përbëra dhe të përbëra me vizë në mes 		Fjalët kyç: fjalë të përbëra, drejtshkrim	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e drejtuar në çift, punë e pavarur.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit kujtojnë përkufizimin dhe njohuritë rreth fjalëve të përbëra, mënyrës së formimit dhe klasës që i përkasin.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lojë në çift, punë e drejtuar.</i> Parapregatitje. Në tryezë vendosen dy kuti me fjalë që mund të kombinohen me njëra-tjetrën për të formuar fjalë të përbëra. Dy nxënës përzgjedhin fjalët, i kombinojnë kur munden dhe i shkruajnë në tabelë fjalët e krijuara. Pjesa tjetër e klasës vëzhgon drejtshkrimin e tyre dhe pas përfundimit të shkrimit të të gjitha fjalëve diskuton për to. Fjalët që mund të përzgjidhen për kombinim janë: Grupi I; libër, flokë, fletë, bashkë, sy, drejt, keq, zemër, kokë, krye, jashtë, brenda, letër, qytet Grupi II; i madh, bisedë, shkruar, muze, gështenjë, redaktor, shkollor, shkruaj, lidhës, palosje, përdor, prodhues, këndor, hekur. Fjalët e përbëra, që formuan: libërlidhës, fletëpalosje, flokë gështenjë, kryeredaktor, jashtëshkollor, brendashkruar etj. Nxënësit diskutojnë për rregullat mbi bazën e të cilave janë shkruar këto fjalë të përbëra dhe shtojnë të tjera rregulla duke i ilustruar me shembuj.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur, Ushtrime.</i> Ushtrimi 1 anëshkrim, armëpushim, bashkëfjalim, bashkëshorte, bukëpjekës, buzëqesh, dorëheqje, dhjetëvjetor, frymëmarrje, gjashtëdhjetë, vetëvendosje, kafe-restorant, shtëpi-muze. Ushtrimi 2. Zëvendëskryeredaktor, zëvendësministër, ish-drejtor, bar blete. Ushtrimi 3. Zëëmbël, fotoekspozitë, i porsaardhur, paraardhës, (sipas përjashtimit <u>b</u>, rregulli i parë) besëlidhje, flokëgështenjë, fletëankesë (sipas rregullit të parë). Fletankesë, gjysmanalfabet (sipas përjashtimit <u>a</u> në rregullin e parë). Ushtrimi 4, 5, sipas kërkesës.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 6</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII	
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve të përngjitura Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Fjalëformim		Situata e të nxënësve: konkurs		
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.				
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon fjalët e prejardhura; ndërton fjalë të prejardhura nga tema të dhëna; drejtshkruan fjalët e prejardhura sipas rregullave. 		Fjalët kyç: fjalë, të përngjitura, drejtshkrim,		
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, konkurs, punë e drejtuar, punë e pavarur.</i>				
Organizimi i orës së mësimit				
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit rikujtojnë përkufizimin e fjalëve të përngjitura dhe mënyrën e formimit të tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>konkurs, punë e drejtuar.</i> U jepen nxënësve fjalët: gjithë, kurrë, gur, me të cilat tre nxënës nga tri skuadrat shkruajnë fjalë që i kanë ato në përbërje. Nxënësit e tjerë vëzhgojnë procesin duke mbajtur shënim problemet që hasen me drejtshkrimin e tyre duke iu referuar tekstit. Fiton skuadra që ka gjetur më shumë fjalë dhe ka punuar më saktë. Nxënësit rikthehen në tekst duke nxjerrë të tjera rregulla që lidhen me drejtshkrimin e fjalëve të përngjitura dhe ilustruar me shembuj.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur, Ushtrime.</i> Ushtrimi 1, 4 sipas kërkesës. Ushtrimi 2, frymëmarrje, gjithmonë, gjithkush, vetvetiu, mikpritëse, mirë se vini, gjithkund, thashethemet. Ushtrimi 3, farefis, ecejake, gjëegjëzë, mirëseardhje, thashethem, taketuke.</p>				
Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit				
Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 5 Kjo detyrë mund të punohet me tabelën e tipareve semantike				
Fjala	Të prejardhura	Të përbëra	Të përngjitura	Mënyra e formimit
shkrimtari	+			shkrim+tar (em+prap)
flokëthinjur		+		flokë+i thinjur (am+mb)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Johan Georg fon Han “Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit” (ora e parë) - tekst joletrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Udhëtimet	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç: Udhëtim Viset Drini Vardari	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Lexim në heshtje, Hartë koncepti, Diskutim, Punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim mësues-nxënës</i>			
- A ju pëlqejnë udhëtimet? - Cili është udhëtimi që ju ka lënë më tepër mbresa dhe pse? - Keni udhëtuar më shumë brenda apo jashtë Shqipërisë? - Çfarë ju lë më shumë mbresa gjatë një udhëtimi dhe a i shkruani mbresat tuaja në ditar apo diku? - Po libra që flasin për udhëtimet a keni lexuar? Përmendni disa tituj?			
Nëse nxënësit thonë ndonjë titull që i përket llojit të udhëpërshkrimit, atëherë mësuesja e merr si bazë dhe bën lidhjen me temën e re, në të kundërt kujton ndonjë titull vetë ose u rikujton nxënësve mësimin e vitit të kaluar që ka të bëjë me udhëpërshkrimin.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: -Përkufizimi i udhëpërshkrimit Mësuesi/ja përmbledh përgjigjet e nxënësve në lidhje me përkufizimin e udhëpërshkrimit, sepse nxënësit kanë njohuri dhe nga viti i kaluar për këtë te			
Këto i shkruan në dërrasë në formën e hartës së konceptit.			
<pre> graph TD A(()) --> B([]) A --> C([]) A --> D([]) A --> E([]) </pre>			
Prezantimi i pjesës së re Nxënësit njihen me autorin e veprës nga është shkëputur fragmenti, jetën dhe veprën e tij. Johan Georg fon Han (Johann Georg von Hahn, 1811-1869) shkencëtar gjerman, konsiderohet si babai i albanologjisë. Ai ka lindur në Frankfurt mbi Main dhe studioi drejtësi. Për disa vjet punoi për Ministrinë e Drejtësisë së Mbretërisë së Re Greke dhe më pas ishte konsull prusian në Athinë e në Janinë, ku ra në kontakt me shqiptarët dhe filloi të mësonte shqip. Gjatë viteve të qëndrimit në Janinë, Hani bëri tri udhëtime në Shqipëri dhe mblodhi të dhëna për historinë,			

filologjinë dhe folklorin shqiptar, të cilat i botoi në tri vëllime me titull “Studime shqiptare”, Jena 1854, me të cilat hodhi themelet e albanologjisë. Shquhet gjithashtu për vëllimin “Përralla greke dhe shqiptare”, Lajpcig 1864 dhe për rrëfimet e ekspeditave të tij në Ballkan: “Udhëtim nga Beogradi në Selanik”, Vjenë 1861, dhe “Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit”, Vjenë 1867, 1869, nga është marrë edhe kjo pjesë.

Në ekspeditën e fundit nga gushti në nëntor 1863 Hani dhe bashkudhëtarët e tij udhëtuan nga Durrësi dhe Shkodra nëpër lumin Drin për në Prizren në Kosovë, në Maqedoninë perëndimore. Pastaj duke kaluar luginën e Vardarit erdhën në Selanik në detin Egje. Interesat e Hanit në Shqipëri dhe në Ballkanin jugperëndimor ishin të shumëllojshme dhe, gjatë këtij udhëtimi, përveç albanologjisë, ai hodhi, mbase paditur, edhe themelet e historisë së fotografisë në Ballkanin jugperëndimor. Ekspedita e vitit 1863 rezultoi me një koleksion prej pesëdhjetë fotografish – nga më të hershmet në rajon.

Lexim në heshtje i tekstit

Nxënësit lexojnë në heshtje tekstin. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që gjatë leximit të nënvizojnë në tekst emrat e njerëzve, vendeve, maleve, lumenjve dhe figurat letrare që ka përdorur autori.

- Pyetje rreth të kuptuarit:

Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e përmbajtjes së tregimit.

- Ç’ lloj shkrimi është kjo pjesë? (Udhëpërshkrim)
- Ç’ përshkruan autori në secilin paragraf?
- Çfarë i bën më shumë përshtypje atij?

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura:

- Rubrika *Diskutoni*, në tekstin e nxënësit; f. 29

Pyetja 1: Udhëpërshkrimi është shkruar në vetën e parë shumës, sepse ishte një ekspeditë.

Punohen **ushtrimet 2, 3** dhe **5**, sipas kërkesave.

Nxënësit dallojnë fjalinë kyç të çdo paragrafi, si dhe informacionin e ri që silllet në çdo paragraf.

Ushtrimi 4: Një nga fjalitë “*Ky ishte një përrua i egër në plot kuptimin e fjalës, por, megjithatë, malësorët e kishin detyruar që të bluante drithin e tyre.*”

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen në bazë të aktivizimit të tyre, përgjigjeve të sakta dhe shprehjes së mendimeve.

Detyrë: Jepni opinionin tuaj me shkrim për këtë mesazh të autorit: *Historia është bijë e diturisë, pa shkrim nuk ka histori.*

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Johan Georg fon Han “Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit” (ora e dytë) - tekst joletrar		Situata e të nxënit: Përshkrimi i natyrës dhe i karakterit të shqiptarëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
2. Kompetenca e të menduarit			
5. Kompetenca qytetare			
6. Kompetenca personale			

<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon përshkrimet e natyrës në fragmentin dhënë; krahason përshkrimet e natyrës me atë të karakterit të shqiptarëve; liston veçoritë e udhëpërshkrimit si tekst joletrar; gjykon mbi gjuhën e përdorur dhe figuracionin. 	<p>Fjalët kyç: udhëpërshkrim, tekst joletrar, natyra, karakteri i shqiptarëve</p>
---	--

<p>Burimet: teksti i nxënësit, harta e Shqipërisë, përvoja të nxënësit, e-libri</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi, Histori</p>
---	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *punë dyshe, kllaster, punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja me temat e mëparshme: *punë dyshe*

Nxënësit pasi lexojnë pjesën që u ka pëlqyer më shumë nga përshkrimet e dhëna në tekst, ndalen tek përshkrimet e natyrës dhe të karakterit të shqiptarëve duke bërë dallimet apo ngjashmëritë përkatëse.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *kllaster,*

Përmes kllasterit nxënësit plotësojnë në fletore dhe tabelë veçoritë e tekstit që studiovan.



3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Nxënësit punojnë ushtrimet e tekstit si dhe gjejnë dhe emërtojnë figurat letrare të përdorura. Nxënësit përcaktojnë elemente reale të tekstit (vendi, natyra e njerëzve, fakte historike).

Këtu mësuesi/ja bën lidhjen me punimin e ushtrimeve;

Ushtrimi 6 në tekstin e nxënësit: Gjeni dhe shpjegoni elementet letrare

Figura letrare	Cilat janë	Komenti im
Epitetet	E larta, i egër, e vogël, e madhnueshme, etj	
Krahasimet	Si më i egri,	
Metaforat	Përroi “shqiptar i vërtetë”, ai e kishte hedhur zgjedhën tej,	

Ushtrimi 7: Gjeni elementet reale

Vendet	Toplana, Shoshi, Dushmani, Berishës, Merturit
Natyra e njerëzve	Malësorë trima, luftëtarë, punëtorë
Faktet historike	Shën Theodhori, Aleksandri

Ushtrimi 8:

Në rrëfim përdoren folje në kohën e tashme: lundruam, arritëm, rrjedh etj.

Në përshkrim përdoren folje në kohën e shkuar: kaluam, pamë, ishte, zbriste etj.

Detyrë: Gjeni një udhëpërshkrim dhe analizoni gjuhën e tij sipas modelit të mësipërm.

Shënim. Tema e të shkruarit Udhëzuesi turistik është mjaft interesante për t’u organizuar si projekt, ku orën e parë mësuesi/ja punojnë së bashku me nxënësit rregullat e hartimit të një udhëzuesi turistik dhe orën e dytë nxënësit paraqitin punimin e tyre që e kanë bërë në grupe.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Udhëzuesi turistik (ora e parë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Një udhëzues turistik	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca qytetare; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Jep karakteristikat e një udhëzuesi turistik. • Liston informacionet e një udhëzuesi turistik. • Nxjerr rregullat për të bërë një udhëzues turistik. 		udhëzues turistik, (guidë turistike), traditë, kulturë, kuzhinë,	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, udhëzues turistikë të ndryshëm në shqip ose gjuhë të huaj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Punë e pavarur, Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e drejtuar, DRTA, Ditari dypjesësh</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Punë e drejtuar</i>			
Kontrolli i detyrave të shtëpisë Mësuesi aktivizon dy nxënës për të lexuar detyrat e shtëpisë. Më pas pyet dhe disa nxënës të tjerë për të plotësuar përshkrimet dhe për të dhënë opinionet e tyre në lidhje me temën. Mësuesi/ja me nxënësit përmes metodës stuhi mendimi ose bashkëbisedimit flasin për udhëzuesit turistikë ose guidat turistike. U drejtohen pyetje të tilla, si: - A ju pëlqejnë udhëtimet? - Çfarë vini re kur udhëtoni në vende të panjohura? - Po udhëzues turistikë apo guida turistike a keni parë ose përdorur gjatë udhëtimeve tuaja?			

– Ç’të veçanta shkruhen në to?

Nxënësit lexojnë modelet e udhëzuesve, që janë në tekst. Mund të gjejnë nga vende të ndryshme dhe listojnë materialet që ndodhen në to, mënyrën e vendosjes dhe llojin e stilit për shkrimet që janë në të.

2. Ndërtimi i njohurive të reja; Diskutim, DRTA, Punë e drejtuar

Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse në të cilën prezanton temën e mësimit të ditës dhe jep sqarimet e nevojshme në lidhje me temën dhe mënyrën e trajtimit të kësaj teme përmes tre hapave. Jepet sqarimi për udhëzuesin turistik ose guidat turistike, rolin dhe funksionin e tyre.

UDHËZUESI TURISTIK është një tekst joletrar. Qëllimi i tij është të bindë lexuesin për vlerat e një vendi dhe ta nxitë atë për ta vizituar këtë vend.

- *Lexim i drejtuar*

Mësuesi/ja (ose nxënësit), lexojnë pjesë-pjesë tekstet e dhëna për qytetin e Pogradecit dhe nxënësit flasin për atë që kuptojnë gjatë leximit duke u ndalur në elementet e përmbajtjes, si: fjalët kyç, faktet e ndryshme dhe informacionet që përcillen tek lexuesi.

- Pyetje rreth të kuptuarit

Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e tregimit.

- Ç’ lloj shkrimi është secila pjesë?

- Ç’ jepet në secilën prej pjesëve?

- Pse autori e fillon pjesën e parë me nëntitullin: *Zbuloni magjinë tonë*

- Ç’do të tregojë me këtë?

- Pse autori e titullon pjesën e parë “ Pogradeci, një nga perlat shqiptare, ende i pazbuluar”?

- Ç’ tregon kjo pjesë për magjinë e Pogradecit?

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dypjesësh

Analizoni gjuhën e tekstit

Punohet me anë të ditarit dypjesësh ushtrimet e f. 31.


Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur; Materiale që u shërbejnë për shkrimin e udhëzuesit turistik. Nxënësit punojnë sipas grupeve duke ndarë detyrat për finalizimin e udhëzuesit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Udhëzuesi turistik (Ora e dytë) – Teksti joletrar		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të shkruarit		Materialet e nxënësve	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca qytetare; 6. Kompetenca digjitale; 			

<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkruajnë informacione që u shërbejnë për udhëzuesin turistik. • Redaktojnë materialet që do paraqesin në udhëzues. • Renditin si duhet materialet e udhëzuesit turistik. • Prezantojnë udhëzuesit e tyre turistikë. 	<p>Fjalët kyç: Udhëzues turistik, informacione, harta, guida, foto,</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materialet për të bërë udhëzuesin turistik</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkenca dhe shoqëria, Teknologji, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë e pavarur në grupe, leximi materialeve për udhëzuesin, diskutim</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>diskutim</i> Nxënësit prezantojnë materialet që kanë për të bërë udhëzuesit e tyre turistik. Diskutohen dhe bëhen vërejtjet e duhura për të bërë redaktimin dhe renditjen e materialeve.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur në grupe</i> Pasi kanë studiuar disa modele udhëzuesish turistikë që janë në tekst, dhe kanë nxjerrë karakteristikat e udhëzuesve dhe rregullat që ndiqen për të bërë një udhëzues, nxënësit ndahen në çift ose në grupe me tre nxënës. Nxënësve mund t’u sugjerohen qytete, si: Tirana, Shkodra, berati, Lezha, Kruja, Tropoja, Durrësi, Fieri, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Vlora etj., por edhe vende turistike që janë në krahinën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> ☞ Nxënësit lexojnë karakteristikat dhe grupet përzgjedhin një nga vendet e sugjeruara. <p>Rregullat e shkrimit të një udhëzuesi listohen në tabelë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ☞ Udhëzuesi duhet të jetë i shkurtër, i qartë, me informacione të sakta dhe funksionale. ☞ Në të të zënë vend: <ul style="list-style-type: none"> - historia dhe trashëgimia kulturore; - natyra dhe klima; - vendet për t’u vizituar dhe për t’u argëtuar; - restorantet dhe ushqimet. ☞ Çdo informacion të ketë një ose dy foto. <p>U kujtohet nxënësve që udhëzuesi turistik bëhet interesant, kur shoqërohet me harta e foto për vendin.</p> <p>Nxënësit punojnë të pavarur në grup për të renditur. Pasi e kanë shkruar udhëzuesin, ata redaktojnë materialet, si nga përmbajtja dhe nga ana gjuhësore.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Prezantohen se si janë shkruare janë redaktuar. Udhëzuesi përfundohet në shtëpi. Nxënësit duhet të punojnë për faqosjen e paraqitjen digjitale të udhëzuesit. Ata mund ta paraqitin edhe si një fletëpalosje.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë. Për vlerësimin mund të ngrihet edhe një juri nga nxënësit që të diskutojë dhe të bëjë vlerësimet e saj. Materialet më interesante mund të afishohen në klasë, në shkollë ose të botohen në gazetën e shkollës (nëse ka një të tillë).</p> <p>Detyrë shtëpie: Përshkruani një legjendë të vendit që zgjodhët për të shkruar udhëzuesin turistik, sipas hapit të dytë të mësimit në faqen 32.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fusha leksikore Kompetenca: njohuri për gjuhën – leksikologji		Situata e të nxënit: Konkurs për ndarjen e fjalëve të tekstit në krye të mësimit në fusha leksikore	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon fushën leksikore; • plotëson me fjalë një fushë leksikore; • grupon fjalët sipas fushës leksikore; • bën dallimin mes fushës leksikore dhe familjes së fjalëve. 		Fjalët kyç: fushë leksikore, fjalë, kuptim.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, shoqëria dhe mjedisi, matematika.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e drejtuar me modele, diskutim stuhi mendimi, iINSERT, punë e pavarur, Diagram Veni.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: konkurs <ul style="list-style-type: none"> • Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. • Nxënësit rikujtojnë përkufizimin e fushës leksikore. • Organizimi i konkursit. Ndahet klasa në tri grupe dhe formojnë këto fusha leksikore: I. Bimë; II. Ujë; III. Shtëpi; me fjalë të tekstit. Fiton grupi që arrin të nxjerrë sa më shumë fjalë për fushën përkatëse leksikore. Bimë: pemë, fletë, pyll, degë Ujë: liqen, rrëke, det, lundra, peshq, bretkosa, Shtëpi: tjegulla, dërrasa, kopsht. 			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: punë e drejtuar me modele Nxënësit punojnë në tekst fushën leksikore <i>Hapësira ujore</i> . Ata duhet të arrijnë vetë te e përbashkëta që kanë fjalët <i>det, oqean, liqen, lumenj</i> etj., që tregojnë hapësira ujore. Me anë ta diagramit të Venit dhe fjalorit (për të nxjerrë kuptimin e secilës fjalë) ata arrijnë në dallimin e të përbashkëtave dhe dallimet. Nxënësit dallojnë fjalën e përgjithshme, e cila përcakton fushën leksikore dhe fjalët e veçanta që bëjnë pjesë në një fushë leksikore. Për këtë ata plotësojnë grafikun organizues që është në tekst.. Sipas këtij modeli, klasa ndahet në grupe dhe u kërkohet grupeve të përcaktojnë një fushë leksikore dhe ta plotësojnë me fjalët e veçanta. P.sh.:			



Pas klasifikimit u kërkohet nxënësve të shpjegojnë se në cilat tipare u bazuan për të klasifikuar fjalët në fushat leksikore që zgjodhën.

U kërkohet nxënësve të formojnë një familje fjalësh. Pastaj pyeten ata:

A është një familje fjalësh një fushë leksikore? Pse?

Familja e fjalëve është fushë leksikore. Fjalët që përmban ajo kanë rrënjën e përbashkët që s’është gjë tjetër veç fjala e përgjithshme që përcakton fushën leksikore.

Edhe klasat e fjalëve formojnë fusha të caktuara leksikore.


Me anë të një grafiku organi

fjalët grupohen sipas kuptimit

grupohen sipas familjes së fjalës
(fjalët grupohen sipas formimit)

fjalët grupohen sipas klasave

grupohen sipas ndërtimit



3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur, Ushtrime.

Ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 sipas kërkesës.

Ushtrimi 8. Fjalët e prejardhura, të përbëra e të parme përbëjnë një fushë leksikore, më vete sikurse dhe parafjalët, ndajfoljet apo parashtesat e mbaresat.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit

Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 9 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalë me kuptim të parë e të figurshëm		Situata e të nxënit: Punë me fragmentin e tekstit.	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> jep kuptimin e drejtpërdrejtë të një fjale; dallon përdorimin në kuptim të figurshëm të një fjale; ndërton fjali duke përdorur kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalës. 		Fjalët kyç: fjalë, kuptim, i drejtpërdrejtë, i figurshëm.	
Burimet: teksti i nxënësit, fjalori i gjuhës shqipe, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, INSERT, punë e drejtuar, punë e pavarur.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*

Kontrolloni, diskutoni dhe vlerësoni detyrat e shtëpisë.

Nxënësit plotësojnë një kllaster në të cilin hedhin njohuritë e tyre për fjalën si kombinim i formës dhe kuptimit. U kërkojmë nxënësve të japin një përkufizim tyrin për kuptimin e fjalëve.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *analizë rastesh, INSERT, punë e drejtuar.*

Nxënësve u kërkohet të lexojnë tekstin në hyrje dhe për fjalët me të zeza diskutojnë për kuptimin e tyre.

Pyeten nxënësit se çfarë kuptimi kanë fjalët.

Nxënësit duhet të dalin në konkluzionin se kuptimet e fjalëve me të zeza janë të figurshme, Kuptimi i tyre nuk është i drejtpërdrejtë, por jepet në ngjashmëri me një send tjetër, duke marrë kështu kuptim të figurshëm.

Pas kësaj nxënësit rikthehen në tekst për të punuar me teknikën e INSERT-it, duke plotësuar tabelën sipas kërkesave të saj dhe duke diskutuar rreth njohurive të reja.

√	+	-	?
Nxënësit e dinë informacionin që po lexojnë	Informacioni i ri për nxënësit	Nxënësit e dinin ndryshe informacionin e ri	Informacioni shtesë

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Punë e pavarur, Ushtrime.*

Ushtrimi 1, sipas kërkesës.

Ushtrimi 2, gjashtë fjalitë e fundit e kanë fjalën “**këmbë**” në kuptim të figurshëm.

Ushtrimi 3, përveç kuptimit i parë apo i figurshëm të shpjegohet dhe kuptimi i figurshëm i mbiemrit.

i/e fortë (me përjashtim të fjalëve *dru* dhe *këpucë*, fjalët e tjera janë me kuptim të figurshëm; (*erë e rëndë*, *kthesë* e theksuar, *ndeshje e rëndësishme*, *njeri me karakter e pushtet*, *miqësi* e *gjatë* dhe *e ngushtë*, raki me gradacion të lartë, zë që dëgjohet shumë. Në emrat abstraktë pothuajse të gjithë mbiemrat kanë kuptim të figurshëm).

i/e qetë (kuptimi më i drejtpërdrejtë është te fjala det te të tjerat i figurshëm. Të shpjegohen si më lart.)

i zjarrtë - me të gjithë emrat ka kuptim të figurshëm.

Ushtrimi 4

Buzëmbremje - fillimi i mbrëmjes (1. Koha që kur perëndon dielli e deri sa erret e bëhet natë, pjesa e kohës midis fundit të ditës dhe fillimit të natës; muzg.

Ylberi - hark i ndritshëm në qiell, që ka shtatë ngjyrat e spektrit të dritës dhe që krijohet zakonisht pas shiut nga thyerja e rrezeve të diellit e nga pasqyrimi i tyre në pikat e ujit të reve. Ngjyrat e ylberit. i bukur si ylber. Doli ylberi. Shikon ylberin.

Ndizej; NDEZ *kal;* . i jap zjarr, e bëj që të digjet diçka; kund. shuaj, fik. Ndez zjarrin. Ndez fitilin. Ndez furrën (sobën).

2. bised. i vë zjarrin cigares a duhanit dhe nis ta thith; kund. shuaj, fik. Ndez një cigare (një duhan). E ndezim nga një! Nuk e ndez (fare) nuk e pi (fare) duhanin.

Përflakëj; 1. E djeg me flakë, i jap flakë, e mbuloj me flakë (një vend etj.). Rrufetë e përflakën korijen. Zjarri përflaku dheun.

3. fig. i jap një ngjyrë të kuqe të ndezur si të flakës, e përskuq, e ndez. Agimi përflaku diellin. Rrezet e diellit përflakën retë e bardha. Perëndimi përflaku liqenin.

Lisat 1. bot. Dru pylli i lartë, me gjethe me dhëmbëza anash, që lidh lëndë dhe që përdoret si lëndë ndërtimi e për zjarr; dushk. Lis i bardhë qarri. Lis i butë bungëbuta. Lis bujk bulgri. Lis i egër ashe. Dru (trung, lende) lisi. 2. Dru i lartë.

Shkëmb; 1. Gur shumë i madh e i fortë, zakonisht me faqe të rrëpirëta e me thepa, që gjendet sidomos nëpër male, shkrep; gur i madh e i rëndë që mezi lëvizet nga vendi. Shkëmb i madh (i lartë, vigan). Shkëmb i nënujshëm. Çanë shkëmbin.

Hije; 1. Hapësirë e errët a me fare pak dritë pas një trupi, i cili nuk lë të kalojnë nëpër të rrezet e diellit ose të një burimi tjetër drite; mungesë drite ose errësirë jo e plotë pas dikujt a diçkaje që e zë dritën;. Hije e madhe (e dendur, e lehtë). Hija e drurëve (e lisit, e fikut, e arrës). Hija e reve.

Ushtrimi 5 do të japim vetëm kuptimet e figurshme

Breshëri; 2. edhe fig. Shumicë, sasi e madhe dhe e pandërprerë, rrëke e vullshme dhe e pandërprerë e diçkaje, breshër. Breshëri plumbash (gjylesh). Breshëri duartrokitjesh. Breshëri pyetjesh.

Prushi; Nxehtësi e lartë që ka dikush kur është i sëmurë; zjarrmi, ethe. Ka prush. 4. fig. Ndjenjë e fuqishme që të rrëmben; dëshirë e zjarrtë. Prushi i dashurisë. Me prush në gji. ...6. përd. mb. fig. Që duket sikur lëshon shkëndija; i gjallë e i papërmbajtur në punë, në luftë etj.; i zjarrtë, zjarr. Është prush. i ka sytë prush.

Pallto; kuptimi figurshëm i fjalës veshje, mburojë.

Acari; 3. fig. Ashpërsi, vrazhdësi; zemërim. i flet me acar. E merr me acar. 4. fig. Frikë që të ngrin zemrën. i hyri acari në shpirt. Rrinte me acar në zemër. 5. përd. mb. Shumë i pastër e i ngrirë (për veshjen). i ka petkat acar.

Balash; * Njihet si kau (si kali) balash, dallohet mirë midis të tjerëve, njihet menjëherë; e tregojnë me gisht.

Bishti më i rëndë se sqepari (do të merret e tëra); Është më i rëndë bishti se sqepari (sëpata) thuhet kur dikush, që është me detyrë e përgjegjësi më të vogël ose që ka vlera e merita më të pakta, kërkon të dalë mbi ata që kanë detyra, përgjegjësi, vlera a merita më të mëdha.

Ushtrimi 6,7 sipas kërkesës.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit.

Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 8

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shpella e Pëllumbasit (ora I) Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Shpellat në Shqipëri	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 5. Kompetenca qytetare 7. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> jep mendimin e tij rreth shpellave dhe informacioneve që ato sigurojnë për kohët e lashta; lexon për të kuptuar përmbajtjen; pasuron fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja; gjykon mbi mesazhin e tekstit. 		Fjalët kyç: Paleolit, stalagmit, stalaktit, guvë, arkeolog, turizëm familjar.	
Burimet: teksti i nxënësit, informacione nga historia, internet, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arkeologjia, Gjeografia, Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Bashkëbisedim, DRTA, INSERT, Punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja me temat e mëparshme: <i>bisedë</i> Fillohet mësimi me një bisedë rreth shpellave. – Ç’dini për shpellat? – A keni vizituar ndonjë? – Ç’informacione mund të sigurohen prej tyre? – A keni dëgjuar për shpellën e Pëllumbasit? – A kujtoni ndonjë mësim nga viti i kaluar që fliste për shpellat? Cilin? Nëse nxënësit nuk e kujtojnë dot, ua kujton mësuesja dhe është “Viti 999”, shkëputur nga libri “Shpella e piratëve” i autorit Petro Marko.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim zinxhir</i> Lexohen tri fragmentet e dhëna në tekst nga nxënësit. Nxënësit bëjnë kujdes me fjalët që i kanë të paqarta, të cilat i shpjegojmë së bashku.			
3. Demonstrim i rezultateve të arritura: <i>punë dyshe, punë e pavarur</i> Në fund mësuesi/ja përgjithëson bashkë me nxënësit se shpellat, përveç se janë atraktive, pra tërheqëse e të bukura për t’u vizituar si pjesë e turizmit, janë gjithashtu një burim informacioni për arkeologët dhe historianët.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit me përgjigjet më të sakta dhe të shprehura bukur.			
Detyrë shtëpie: Nxënësit përshkruajnë me shkrim ose vizatim një shpellë që kanë vizituar.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shpella e Pëllumbasit (ora II) Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Përshkrim i shpellave që kanë vizituar	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2.Kompetenca e të menduarit 4.Kompetenca për jetën,mjedisin 5.Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan një shpellë që ka vizituar; • dallon fjalët kyç të përshkrimit objektiv; • dallon fjalët kyç të përshkrimit subjektiv; • liston dhe shpjegon veçoritë e reportazhit si lloj joletrar. 		Fjalët kyç: shpellë bukuri vizitoj përshkrim objektiv subjektiv	
Burimet: teksti i nxënësit, informacione historie, internet, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi, Histori, Arkeologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bisedë, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimimit			
<p>1. Lidhja me temat e mëparshme: bisedë, diskutim</p> <p>Nxënësit lexojnë punët e tyre lidhur me përshkrimin e një shpelle që kanë vizituar. Nxënësit që kanë zgjedhur vizatimin për ta paraqitur, i vendosin punët e tyre në dërrasë të zezë duke i komentuar ato. Nxënësit gjykojnë mbi përshkrimet e lexuara nga nxënësit e tjerë, lidhur me informacione interesante që ata kanë sjellë, mënyrën e të shprehurit apo gjuhën e përdorur.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: punë e drejtuar</p> <p>Përqendrojmë vëmendjen e nxënësve te përshkrimi i shpellës së Pëllumbasit, duke u ndalur në dy koncepte:</p> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="margin-right: 20px;">Përshkrimi</div> <div style="display: flex; flex-direction: column; align-items: center;"> <div style="margin-bottom: 10px;">→ objektiv</div> <div style="margin-bottom: 10px;">→ subjektiv</div> </div> </div> <p>Qartësojmë së bashku këto koncepte dhe më pas nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të gjetur në fragment fjalët kyç të këtyre përshkrimeve. Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre.</p> <p>3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur.</p> <p>Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e tekstit, duke saktësuar të dhënat arkeologjike në lidhje më vjetërsinë e shpellës që i mësuan nga fragmenti për: kohën, vendin, zbulimet, banorët e sotëm.</p> <p>Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit aktivë dhe të saktë.</p> <p>Detyrë shtëpie: Bëni një përmbledhje të tri fragmenteve të dhëna në tekst.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII												
Tema mësimore: Llojet e homonimeve, sinonimeve dhe antonimeve Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Leksikologji		Situata e të nxënit: Peizazh													
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;															
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon homonimet, sinonimet dhe antonimet. • Përcakton llojin e tyre • Përdor sinonime, homonime e antonime në fjali sipas kërkesës. 		Fjalët kyç: homonime, sinonime, antonime, fjalë, kuptim													
Burimet: teksti i nxënësit, fjalori i gjuhës shqipe, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:													
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, shënime mbi shënime, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur,</i>															
Organizimi i orës së mësimit															
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit kujtojnë përkufizimin e sinonimeve dhe antonimeve duke sjellë dhe shembuj.															
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>analizë rastesh, punë e drejtuar.</i> Nxënësit lexojnë në heshtje fragmentin në hyrje dhe për fjalët me të zeza thonë kuptimin sipas gjykimit të tyre. Vëzhgojnë formën dhe përcaktojnë ndryshimin e tyre në kuptim. Ndërkohë në tabelë shkruajnë pyetjet e mëposhtme gjatë përgjigjeve të të cilave nxënësit plotësojnë tabelën e mëposhtme.															
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 33%;">Fjalët.....</th> <th style="width: 33%;">Llojet</th> <th style="width: 33%;">Shembuj</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Homonime</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Sinonime</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Antonime</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				Fjalët.....	Llojet	Shembuj	Homonime			Sinonime			Antonime		
Fjalët.....	Llojet	Shembuj													
Homonime															
Sinonime															
Antonime															
Tek antonimet u bëjmë të qartë nxënësve që nuk njihen si antonime format e ndërtuara me pjesëza mohuese të tipit lexoj - nuk lexoj															
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur. Ushtrime.</i> Ushtrimi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 sipas kërkesës. Një ushtrim që mund t’u jepet nxënësve për t’u punuar me shkrim mund të jetë të zëvendësojnë me sinonime një herë, dhe me antonime herën tjetër, fjalët me të zeza në tekstin e mësimit “Fjalë me kuptim të parë dhe të figurshëm”, duke e rishkruar e diskutuar rreth tij. Aty ku është e pamundur të jetë një antonim															


i mirëfilltë mund të përafrohet. Gjatë modelit me antonime mund të ndryshohen dhe fjalë të tjera që teksti të ketë kuptim.

P.sh.: rrezet e arta - rrezet e verdha (sinonim), rrezet e venitura (antonim).

malet kërcënuese - malet hijerënda (sinonim), malet mikpritëse (antonim)

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit. Përveç realizimit të situatës së të nxënësve, një vlerësim më vete mund të jetë për detyrën e mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur; ushtrimi 9 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zbulime arkeologjike - tekst joletrar		Situata e të nxënësve: Zbulimet arkeologjike në Durrës (Durrahu)	
Kompetenca: Të dëgjuarit			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca digjitale; 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon për të nxjerrë informacione për materialin e zbulimeve arkeologjike në Durrës. • Liston informacionet kryesore në tekstin e dëgjuar. • Sjell vetë informacione të dëgjuara e lexuara në mënyrë të pavarur rreth zbulimeve arkeologjike në vendin tonë. 		zbulime arkeologjike, Durrës (Durrahu), mozaik, amfiteatër.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale të nxënësve për zbulimet arkeologjike.		<ul style="list-style-type: none"> • Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia, arkeologjia, Shoqëria dhe mjedisi • Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bashkëbisedim, dëgjim i drejtuar, shkrim i lirë, pyetje përgjigje			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: bashkëbisedim</p> <p>Nxënësit janë porositur të gjejnë materiale që lidhen me zbulimet arkeologjike në vendin tonë dhe i sjellin ato duke plotësuar njëri tjetrin.</p> <p>Nxënësit flasin rreth arkeologjisë dhe zbulimeve arkeologjike në vendin tonë dhe në botë.</p> <p>Mund të bashkëbisedohet rreth këtyre çështjeve, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A ju tërheq Arkeologjia? Çfarë është ajo? - Po zbulime arkeologjike a dini ku janë bërë? 			
			

– Ç’mësojmë përmes tyre?
(Mësuesi/ja bën një grafik në dërrasën e zezë për vendet ku janë bërë zbulime arkeologjike në vendin tonë)

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

U vëmë nxënësve të dëgjojnë materialin për Durrahun dhe tekstin “Amfiteatri i Durrësit”.
U kërkojmë të fiksojnë materialin kryesor që lidhet me: emrat e lashtë, periudhat kohore, mozaikun, fakte të tjera historike e gjeografike që jepen në të.
Për të dy pjesët që nxënësit do të dëgjojnë, shkruhen kërkesat ndaj të cilave ata duhet të jenë të vëmendshëm, të cilat ata gjatë leximit duhet t’i plotësojnë, siç janë:

Emrat e lashtë të qytetit
Koha
Emri i mozaikut

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

Nxënësit u përgjigjen këtyre pyetjeve në lidhje me materialet e dëgjuara.

- Ç’është Durrahu? (Emri i vjetër i Durrësit)
- Kur është themeluar qyteti i Durrësit? (Në vitin 627 p.K.)
- Cili ka qenë zeja kryesore e këtij qyteti (Punimi i qeramikës.)
- Cili është zbulimi më i madh në qytet dhe si quhet ai? (Mozaiku, Bukuroshja e Durrësit.)
- Çfarë dëshmon ky mozaik? (Zhvillimin urbanistik të qytetit.)
- Çfarë dëshmon viti 229 p.K për Durrësin? (Kalimin në varësi të Romës)
- Kur pati lulëzimin më të madh ky qytet? (Kur u ndërtua porti kryesor në Adriatik.)

Për tekstin “Amfiteatri i Durrësit” mund të drejtojmë këto pyetje:

- Kur është ndërtuar amfiteatri? (Në fund të shek. I e në fillim të shek. II.)
- Cili është objekti më i rëndësishëm që ka ekzistuar në amfiteatër?(Biblioteka.)
- Si u kremtua hapja e bibliotekës? (Me ndeshjen e 12 gladiatorëve.)
- Sa spektatorë mund të mbante teatri (15 000 - 20 000.)
- Jepni disa elemente përbërëse të amfiteatrit që janë zbuluar. (Shkallarja, muret rrethuese të arenës.)

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Bëni një shkrim të shkurtër informativ për njërin nga zbulimet arkeologjike në Shqipëri.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjuha standarde shqipe		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Leksikologji		Fragmente në dialektet e gjuhës shqipe	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.			
2. Kompetenca e të menduarit.			
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon dialektin e një teksti jo në standard • Përkufizon standardin si variant të gjuhës • Zëvendëson fjalët e huaja me ato shqipe • Hulumton dhe punon me periodikun e shkruar për të gjetur fjalët e huaja të panevojshme në shqip 	<p>Fjalët kyç: Gjuha shqipe, Gjuhë standarde, dialekt, fjalë e huaj.</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, analizë rastesh, punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit kanë njohuri rreth konceptit “gjuhë standarde” dhe “dialekt”. U kërkohet të japin mendimet e tyre për kuptimin e këtyre termave. Nxënësit flasin shkurtimisht për atë që dinë për dialektet.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e drejtuar, analizë rastesh.</i> U kërkohet nxënësve të lexojnë dy tekstet në hyrje të mësimit dhe të përcaktojnë variantin e gjuhës në të cilin janë shkruar ato, duke dhënë karakteristika që i dallojnë si variante. Për dialektin gegërisht dallojnë: - nga leksiku fjalët: <i>tash, jehu, mandej, shtroje</i> etj. - nga ana fonetike: <i>tue, luejt, lulzuaem, kulluet, tue</i>, (grupi <i>ue</i>) Pastaj nxënësit lexojnë materialin e tekstit për gjuhën shqipe në standard dhe dialekt.</p> <p>Nxënësit duhet të dallojnë fjalët e huaja që janë bërë pjesë e leksikut të shqipes, janë përshtatur me sistemin gramatikor dhe nuk mund të zëvendësohen, sepse nuk kanë gjegjëse në gjuhën shqipe, dhe fjalët e huaja, veçanërisht ata që kanë hyrë kohët e fundit, që mund të zëvendësohen me fjalë ekuivalente të shqipes.</p> <p>Nxënësit punojnë ushtrimin 1. Ata lexojnë informacionin për historinë e formimit të gjuhës shqipe standarde dhe ndalen në ngjarjet më të rëndësishme që kanë luajtur rol kryesor në zhvillimin e gjuhës shqipe.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur, Ushtrime.</i> Ushtrimi 2. Klasa ndahet në dy grupe dhe shkruajnë vazhdimin e secilës pjesë që është në krye të mësimit.. Nxënësit përcaktojnë variantin e parapëlqyer prej tyre duke argumentuar pse. U bëhet e qartë nxënësve se gjuha letrare dhe standardi nuk janë e njëjta gjë pasi gjuha letrare është ai variant me të cilin shkrimtarët shkruajnë veprat e tyre pa lënë jashtë pasurinë e dialekteve.</p> <p>Ushtrimi 3. Abuzoj – shpërdoroj , akoma – ende , aktivitet – veprimtari , ambient – mjedis , brutal – i ashpër Aparencë – dukje, avantazh – përparësi, balancoj – baraspeshoj, barrierë – pengesë, biografi – jetëshkrim. Ushtrimi 4 shfrytëzohen fjalët e ushtrimit 3 dhe këto fjalë: angazhim – zotim, përsipër, apel – listëprani, lidhje e drejtpërdrejtë, shkëmbim përvoje, eksplozion – shpërthim, aspekte – fragment, moment – çast, aksion – veprim.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. Ushtrimi 5 sipas kërkesës.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: “Ujërat e ndotura” (Reportazh)- tekst joletrar		Situata e të nxënit: Mjedisi ynë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit; 3.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4.Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin; 6.Kompetenca qytetare;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet rreth mjedisit dhe mbrojtjes së tij. • Lexon për të kuptuar përmbajtjen e pjesës. • Krahason shkatërrimin e botës ujore me vdekjen e botës njerëzore nga rrezatimi radioaktiv. • Formulon bukur mesazhin e pjesës. 		Fjalët kyç: <i>mjedisi,</i> <i>ndotje,</i> <i>shoqëria,</i> <i>sensibilizim,</i> <i>atentat</i>	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; pamje nga vende të gjelbëruara dhe të dëmtuara, informacione rreth mjedisit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, gjeografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Lexim zinxhir, Diskutim, INSERT, Punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i>			
<p>Nxënësit bashkëbisedojnë rreth natyrës dhe ndikimit që ka njeriu tek ajo. Për këtë ata mund të shfrytëzojnë informacione të marra nga interneti, biologjia apo në mënyra të tjera për të diskutuar rreth mënyrave se si ndikojmë për mirë ose për keq te mjedisi. Nxënësit mund të realizojnë dhe një montazh me pamje dhe informacione rreth natyrës të cilin e paraqesim me video-projektor.</p> <p>Pyetje ndihmëse për të realizuar këtë fazë të mësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç’dini për pasuritë ujore në vendin tonë? - A keni vizituar zona ku pasuritë ujore dhe mjedisore po shkatërrohen nga dora e njeriut? - Ç’ndihmesë mund të japim ne për ruajtjen e natyrës? 			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim zinxhir, diskutim</i>			
<p>Fragmenti lexohet nga 3 nxënësve, ndërkohë që të tjerët nënvizojnë fjalët e reja, të cilat shpjegohen nga mësuesi ose bashkërisht me nxënësit.</p> <p>Nxënësit diskutojnë rreth problemeve që ngre reportazhi, si dhe mesazhit që ai përcjell.</p>			
Pyetje rreth të kuptuarit			
<p>Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e tregimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç’ lloj shkrimi është kjo pjesë? (Reportazh) - Ç’ tipare ka ky lloj shkrimi? (Rikujtohen veçoritë e reportazhit) - Cila ishte përmbajtja e secilës pjesë? 			

- Rikthehemi te paragrafi i parë. Autori përdor një fjalë që të bën përshtypje. Cila është kjo fjalë? Është fjala atentat. Me ç’kuptim e përdor autori këtë fjalë?
 - Vendosini fragmentit një titull tjetër?
- Dëgjohen dhe vlerësohen mendimet e nxënësve.

Këtu mund të përdorim dhe INSERT-in.

√	+	-	?
Nxënësit e dinë informacionin që po lexojnë	Informacioni i ri për nxënësit	Nxënësit e dinin ndryshe informacionin e ri	Informacioni shtesë

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit punojnë ushtrimet e tekstit 1, 2, 3, 4, 5, 6. Ata ndalen kryesisht në krahasimin e botës natyrore me atë njerëzore, si dhe si do të vepronin ata nëse do të ishin anëtarë të ndonjë organizate në mbrojtje të mjedisit.

Ushtrimi 1. Cilat janë disa nga atentatet që njeriu i bën detit?

Hedhja e mbetjeve të ndryshme urbane, derdhja e lëndëve kimike, etj.

Ushtrimi 2. Cilat janë disa nga shkaqet që njerëzit e dëmtojnë detin?

Pakujdesia, egoizmi, padituria për dëmet e mëdha që sjell dëmtimi i ujit të detit.

Ushtrimi 3. Cilat janë disa nga pasojat që shkaktohen në det nga atentatet e njerëzve?

Ngordhja e gjallesave të detit, specie e rralla po zhduken, po krijohen mostra nga transformimet genetike si pasojë e ndotjeve të mëdha, etj.

Ushtrimi 8.

Vlerësimi: Përgëzoi nxënësit për thellësinë e gjykitimit dhe mënyrën e të shprehurit.

Detyrë shtëpie: Përpikuni të shkruani një reportazh të ngjashëm.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Reportazhi (ora e parë)		Situata e të nxënësve:	
Kompetenca: Të shkruarit		Reportazh "Valbona"	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca qytetare; 6. Kompetenca personale; 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon reportazhin si shkrim publicistik. • Liston veçoritë dhe karakteristikat e reportazhit. • Përcakton rregullat e shkrimit të një reportazhi. 	<p>Fjalët kyç: shkrim, reportazh, ngjarje, problematikë</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, modele reportazhesh nga burime të ndryshme, https://www.youtube.com/watch?v=Y6e2cCxsGgs</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë e drejtuar me modele, analizë rastesh, punë e pavarur.</i></p>	


Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Stuhi mendimi*

Bëhet prezantimi i temës dhe rezultateve të të nxënit. Nxënësit janë njohur me dy modele reportazhesh të shkruara, “Shpella e Pëllumbasit” dhe “Ujërat e ndotur”. Nxënësit gjatë orës së parë kanë zbërthyer kuptimisht pjesët, ndërsa në orën e dytë kanë bërë analizën gjuhësore dhe nxjerrë karakteristikat e reportazhit si shkrim publicistik. Nxënësit rikujtojnë këto njohuri shkurt duke thënë se çfarë kujtojnë me reportazh dhe çfarë karakteristikash ka një shkrim i tillë.

Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kujtuar pjesët e marra përmes metodës stuhi mendimi.

- Ç’ lloj shkrimi ishin pjesët “Shpella e Pëllumbasit” dhe “Ujërat e ndotur ? (Reportazh)
- Ç’ tipare kishte ky lloj shkrimi? (Përmenden dhe njëherë veçoritë e reportazhit dhe llojet e tij.)
- Cila ishte përmbajtja e secilës pjesë?
- Cila është gjuha e përdorur?



2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Analizë rastesh, punë e drejtuar me modele.*

Nxënësit mund të kenë, veç modelit të librit, dhe modele të tjera, të gjetura prej tyre ose të paraqitura me video-projektor. Nëse kemi mundësi mund të vendosim me video-projektor reportazhe nga të nxënësve ose reportazhin për Valbonën sipas linkut të mësipërm që është zgjedhur për kohën e kufizuar.

Nxënësit veçojnë karakteristikat e këtij lloj shkrimi.

Gjatë shkrimit të një reportazhi duhen pasur kujdes këto rregulla:

- **Titulli i reportazhit** duhet të jetë tërheqës, por edhe të ketë lidhje me temën.
- Të paraqiten **fakte nga e përditshmja.**
- Mund të përdoren **shprehje letrare** tërheqëse.
- Në mbyllje duhet të paraqitet **qëllimi** pse e kemi shkruar reportazhin, pra, **mesazhi të jetë i qartë dhe i dukshëm.**
- Të përdoren tipa fjalësh të larmishme, në funksion të tematikës së trajtuar,
- Të mbahet parasysh struktura e shkrimit të reportazhit etj.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

Rikujtojmë strategjitë e të shkruarit dhe, pasi përzgjedhim me nxënësit disa tema, bëhet planifikimi i punës me shkrim. Nxënësit mund të punojnë me kopjen e parë për aq sa mjafton koha.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Plotësohen fjalët kyç në ushtrimet e f. 40.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Reportazhi (ora e dytë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të shkruarit		Punët me shkrim të nxënësve	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca qytetare. 6. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Liston karakteristikat e reportazhit. • Përcakton rregullat për të shkruar një reportazh. • Shkruan vetë një reportazh me një nga temat e zgjedhura. • Përdor saktë rregullat e drejtshkrimit gjatë punës. • Diskuton për të vlerësuar reportazhin e tij dhe të shokëve. 		shkrim, publicistik, reportazh.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale model nga burime të ndryshme siguruar nga nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur me shkrim, Diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimin			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Nxënësit rikujtojnë shpejt e shpejt përkufizimin për reportazhin, veçoritë, karakteristikat strukturore, tematikat që trajtohen, rregullat që duhen ndjekur.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur me shkrim</i> Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në kopjen e parë të reportazhit, duke e redaktuar dhe duke bërë korrigjimet e nevojshme, si drejtshkrimore dhe të pikësimit.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Diskutim</i> Nxënësit lexojnë punimet e tyre përfundimtare duke bërë vlerësimet dhe dhënë mendimet e tyre rreth punës së shokëve.</p> <p>Vlerësimi: Vetëvlerësim dhe vlerësim me notë nga mësuesi.</p>			

MORFOLOGJI

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Klasat e fjalëve.		Situata e të nxënit: <i>Fantazma dhe plani 3+4</i>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin 4. Kompetenca qytetare. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon klasat e fjalëve të dhëna; • klasifikon fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme; 		<p>Fjalët kyç: klasë fjalësh, emër, e ndryshueshme, e pandryshueshme,</p>	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, punë e pavarur</i>			
<p>Organizimi i orës së mësimit</p>			
<p>1. Lidhjen temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë në çift.</i></p> <p>Nxënësit punojnë me fragmentin e dhënë në tekst, duke dalluar klasat e fjalëve që janë paraqitur me të njëjtën ngjyrë.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Mbajtjen e strukturuar e shënimeve</i></p> <p>Bazuar në fragmentin e dhënë në tekst, klasifikojmë fjalët në grupe në bazë të klasës së tyre, gjë që çon në formimin e 10 klasave të fjalëve në gjuhën shqipe. Vendoset tabela e klasave të fjalëve para nxënësve dhe diskutohet përmes shembujve për ndarjen e saj në dy grupe: fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. (Sqarohen nxënësit për kriterin mbi të cilin bëhet kjo ndarje.)</p>			
<p>2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punohen ushtrimet 1 dhe 2 në grupe dyshe.</p> <p>Punohen ushtrimet 3, 4 në mënyrë individuale.</p>			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit bazuar në aktivizimin dhe përgjigjet e tyre të sakta.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Svetlana Aleksieviç “Zëra nga Çernobili” (ora e parë) - tekst joletrar Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Katastrofa e Çernobilit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 3.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 5.Kompetenca personale. 6.Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Shpreh mendimin e tij rreth armëve bërthamore dhe dëmet që ato shkaktojnë. Zgjeron njohuritë e tij lidhur me katastrofën e Çernobilit. Flet për ndjesitë që ngjallin ngjarje të tilla duke i argumentuar. Dallon termat shkencore të përdorura dhe i shpjegon ato me fjali. 		Fjalët kyç: central bërthamor, armë kimike, rrezatim, katastrofë, Çernobil, rrezatim, frikë, trishtim	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacione mbi armët bërthamore dhe centralet bërthamore		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Gjeografi, Kimi, Fizikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Bashkëbisedim, DRTA, INSERT, Punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Nxënësit sjellin informacionet e tyre në lidhje me centralet dhe armët bërthamore. Kjo pjesë e mësimit mund të zhvillohet dhe në formë bashkëbisedimi mësues-nxënës. <ul style="list-style-type: none"> -A njihni raste të përdorimit të armëve bërthamore? - Ç’dëme kanë shkaktuar ato? -Ç’ mendim keni për përdorimin e tyre? (Përmenden rastet e bombave atomike në Hiroshimë dhe Nagasaki) Në fund mësuesi/ja përgjithëson bashkë me nxënësit informacionin e nevojshëm në lidhje me centralet dhe armët bërthamore, përdorimin e tyre në masë dhe dëmin që ato shkaktojnë.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>DRTA, INSERT</i> Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse përmes së cilës prezanton titullin e pjesës dhe autoren. Përqendrohet vëmendja e nxënësve në leximin e fragmentit të dhënë. Gjatë leximit ata nënvizojnë fjalët e reja dhe termat shkencore të përdorura. Me ndihmën e mësuesit ato shpjegohen të ilustruara me fjali. Pyetje rreth të kuptuarit: Për të kuptuar përmbajtjen, nxënësit zhvillojnë garën me pyetje-përgjigje, ku synohet formulimi i saktë i pyetjeve dhe përgjigjeve.			

- Ç’ lloj shkrimi është kjo pjesë? (Libër në formë monologu)
- Ç’ të veçantë ka kjo pjesë?
- Përse autorja e titullon këtë tregim “Zëra nga Çernobili”?
- Si e përshkruan autorja situatën?

Mësuesi/ja i nxit nxënësit të pyesin dhe ndërhyjnë vetëm kur pyetjet dhe përgjigjet s’janë të formuluar si duhet.

- Ndaluni në tekst dhe ilustroni mendimin.
- Lexoni dhe njëherë dy paragrafët e parë.
- Ç’ figura letrare ka përdorur autori?
- Si e përshkruan autorja vendin e saj?
- Ç’ tregon kjo pjesë për lidhjen e autores me vendlindjen dhe atë kohë?

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Punohen ushtrimet e tekstit 1, 2, ku nxënësit shpjegojnë ndjesitë që shoqërojnë ngjarje të tilla, si:

- pasiguria
- frika
- dyshimi për të ardhmen

Dëgjohen mendimet e nxënësve dhe vlerësohen nga mësuesi.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe origjinale.

Detyrë shtëpie: Detyra f. 43, ushtrimi 4 dhe 5.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Svetlana Aleksieviç “Zëra nga Çernobili” (ora e dytë) - tekst joletrar</p> <p>Kompetenca: Të lexuarit</p>		<p>Situata e të nxënit: Armët bërthamore</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;</p> <p>2.Kompetenca e të menduarit;</p> <p>3.Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin;</p> <p>6.Kompetenca qytetare;</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh mendimin e tij rreth armëve bërthamore dhe ekzistencës së tyre. • Shpjegon domethënien e shprehjeve të caktuara nga fragmenti. • Krahason rolin e të qenit shikues në një ngjarje dhe të qenit dëshmitar në të. • Përgjithëson ose jep idetë e tij lidhur me ndërgjegjësimin e secilit për të dhënë ndihmën e tij atëherë kur duhet. 		<p>Fjalët kyç: Ndjenja, shikues, dëshmitar, mesazh, ndërgjegjësim</p>	

<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; Informacione rreth rrezatimit radioaktiv,</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Fizikë, Kimi</p>
--	--

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Bashkëbisedim, Diskutim, Punë e drejtuar, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimit:

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Rrjeti i diskutimit*

Pasi nxënësit janë njohur me problematikën e tekstit, mësimi fillon me pyetjen:

-A mendoni se katastrofa e Çernobilit kishte pasoja globale dhe afatgjata?

Nxënësit mund të ndahen në dy grupe, sipas përgjigjes Po ose Jo që i japin kësaj pyetjeje. Këmbëngulet nga mësuesi/ja që ata të argumentojnë përgjigjet e tyre.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Diskutim, Punë e drejtuar*

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të drejtojnë vëmendjen në tekst dhe të ilustrojnë me pjesë nga teksti shprehjet e dhëna në ushtrimin 2, që lidhen me situatën që solli për njerëzit kjo ngjarje.


Nxënësve u kërkohet të komentojnë shprehjet e autores, që lidhen drejtpërdrejt me mesazhet e pjesës.

Te ushtrimi 2 nxënësit duhet të bëjnë dallimin mes përjetimeve të situatave, kur janë shikues të një ngjarjeje dhe dëshmitarë të saj.

Nxënësit përgjithësojnë idenë e dhënies së ndihmës të secilit, në raste katastrofash si dhe mbi ndryshimin e politikave që çojnë në zhvillimin e këtyre armëve.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, organizues grafik*

Nxënësit diskutojnë mbi llojin e tekstit duke paraqitur veçoritë e tij dhe i përmbledhim njohuritë në një *organizues grafik*.



Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe të formuluar saktë.

Detyrë shtëpie: Vlerësoni llojin e tekstit dhe gjuhën e përdorur. Gjykoni mbi domethënien e dy paragrafëve të fundit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lakimi i emrave Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Morfologji		Situata e të nxënit: <i>Njeriu që ndiqte kuajt</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin 4. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: • dallon lakimet e emrave bazuar në mbaresat e tyre; • lakon emra të gjinive të ndryshme.		Fjalët kyç: lakim lakimi I lakimi II lakimi III lakimi IV	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë në dyshe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhjen temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë në dyshe.</i></p> <p>Nxënësit punojnë me fragmentin e dhënë në tekst, duke dalluar emrat dhe gjininë e tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Mbajtjen e strukturuar e shënimeve</i></p> <p>Bazuar në fragmentin e dhënë në tekst, nxënësit i kthejnë emrat që gjetën në fragment në numrin njëjës, rase emërore, trajta e shquar. Duke iu referuar gjinisë dhe mbaresës nxënësit përcaktojnë lakimin e tyre.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punohen ushtrimet 1 dhe 2 në grupe dyshe.</p> <p>Punohen ushtrimet 3, 4 në mënyrë individuale.</p>			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit bazuar në aktivizimin dhe përgjigjet e tyre të sakta.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Emrat e dygjinishëm Kompetenca: Njohuri për gjuhën- Morfologji		Situata e të nxënit: Përshkrimi i natyrës duke përdorur emrat: <i>liqen, vizatim, pallat, vend.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 2. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 3. Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë emrat e dygjinishëm. • Të përshtatë fjalët përcaktuese me emrat e dygjinishëm. • Të përdorë në fjali emrat e dygjinishëm. 		Fjalët kyç: emër, gjini, i dygjinishëm, përshtatje.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Edukatë shoqërore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë individuale, punë e drejtuar, organizues grafik, shkrim i lirë, diskutim,</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë e drejtuar</i> Pasi nxënësit realizojnë përshkrimin me fjalët kyçe të dhëna, përcaktojnë gjininë e emrave dhe përshtatjen e me to të fjalëve përcaktuese.			
2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>organizues grafik, shkrim i lirë</i> Paraqesim në tabelë dy alternativa të shumësit të grupeve emërore në fjali dhe qarkojmë përgjigjen e saktë. Bazuar në këto shembuj, përkufizohen emrat e dygjinishëm:			
<pre> graph LR A[Emrat e dygjinishëm] --> B[Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresën -e] A --> C[Emrat e lëndës, të gjinisë mashkullore, që e formojnë shumësin me mbaresën -ra] </pre>			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë individuale, diskutim</i> Kthejmë në shprehje njohuritë e marra duke punuar ushtrimet 1,2,3,4,5.			
Vlerësimi: Bazuar në arritjet e nxënësve sipas grupeve apo individëve, përgëzohet nxënësit për pjesëmarrjen dhe bëj vlerësimin e përgjigjeve me gojë apo me shkrim.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, f. 187			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fatos Baxhaku “Heroi që nuk deshëm ‘ta identifikojmë” (ora e parë) - tekst letrar Kompetenca: të lexuarit		Situata e të nxënit: Heronjtë dhe ne. Bisedë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 3.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4.Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin 5.Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh mendimin e tij mbi heronjtë dhe veprat që ata bëjnë. • Lexojnë për të kuptuar përmbajtjen e pjesës. • U përgjigjet pyetjeve për të kuptuar përmbajtjen. • Përgjithëson veçoritë e tekstit të dhënë. 		Fjalët kyç: Hero i rastësishëm, identifikoj, liqen, fëmijë, vdekje, vlera, antivlera	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; materiale në internet për këtë ngjarje.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, DRTA, Kllastër, Pyetje-përgjigje, Punë e drejtuar</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i> Zhvillojmë së bashku me nxënësit bisedën rreth heronjve dhe konceptit që ata kanë për ta. <ul style="list-style-type: none"> - Ç’ është një hero? - Përse quhen të tillë? - Cilët janë heronjtë me të cilët jeni rritur? - A mund të quhet hero një njeri i zakonshëm? 			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>DRTA, Punë e drejtuar, Kllaster</i> Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse përmes së cilës prezanton titullin e pjesës dhe autorin e saj. Jep të dhëna shkurt për gazetarin Fatos Baxhaku dhe shkrimin gazetaresk.			
<i>Lexim i drejtuar</i> Mësuesi/ja (ose nxënësi), lexon pjesë-pjesë tekstin duke tërhequr vëmendjen e nxënësve për zërthimin e përmbajtjes.			
Pjesa 1: Fillimi deri te <i>andëj nga kodrat e Liqenit Artificial të Tiranës.</i> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Pse ngjarja, sipas gazetarit është e pazakontë? <input type="checkbox"/> Kujt i kushtohet kjo pjesë? <input type="checkbox"/> Si quhet personazhi? <input type="checkbox"/> Cilat janë të dhënat personale të personazhit? <input type="checkbox"/> Kur dhe ku ndodhi ngjarja? 			
Pjesa 2: deri te <i>miqtë e Pandit, dëshmitarët e rastit.</i> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Çfarë ndodhi ndërsa <i>Pandi Toçe shëtiste</i> ? 			

- ☞ Çfarë kanë pare dëshmitarët?
- ☞ Cili është gjesti që e bën atë hero?
- ☞ Pse lagjja prej 30000 banorësh u trondit nga kjo ngjarje?

Pjesa 3: deri teE gjithë kjo histori ngjethëse heroizmi kaloi krejt në heshtje.

- ☞ Si e përjetoi fëmija që shpëtoi gjendjen?
- ☞ Si e përjetoi familja humbjen?
- ☞ Si e përjetuan njerëzia rreth e rrotull ngjarjen?

Pjesa 4: deri te.... ai dha jetën në mënyrën më heroike të mundshme.


- ☞ Si e përcolli shtypi këtë ngjarje?
- ☞ Si e përcollën njerëzit e thjeshtë gjestin heroik të këtij heroi të pazakontë?
- ☞ Ç’qëndrim mbajti shtypi?
- ☞ Pse gazetari është shumë i indinjuar nga qëndrimi i shtypit?

Pjesa 5: deri në fund.

- ☞ Pse mbahet ky qëndrim ?
- ☞ Pse fjala hero nuk ka më peshën e duhur?
- ☞ Cilat duhet të jenë vlera e vërtetë e njeriut?

Pas leximit nxënësit diskutojnë rreth çështjeve që janë dhënë për diskutim.

Përqendrohet vëmendja e nxënësve në përcaktimin e veçorive të tekstit përmes kllasterit.



3. Prezentimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Punohen ushtrimet 1, 2, ku nxënësit gjykojnë mbi hyrjen e shkrimit dhe ç’ka dashur autori të thotë.

Vlerësimi: Mësuesi/ja përgëzon për arritjet duke vlerësuar nxënësit që kanë dhënë pargjigje më të sakta dhe ata që ishin më aktivë.

Detyrë shtëpie: Dalloni figuracionin e përdorur në tekst.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fatos Baxhaku “Heroi që nuk deshëm ‘ta identifikojmë” (ora e dytë) - tekst joletrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Shembuj vetjakë kur jeni ndier “heronj”	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2.Kompetenca e të menduarit 5.Kompetenca personale 6.Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon raste nga jeta reale kur është ndier “hero”. • Shpjegon arsyen pse autori nuk përdor tone të larta, as makabre (të frikshme) që shoqërojnë fatkeqësitë. • Shpjegon mënyrën e shtjellimit të subjektit nga autori duke argumentuar. • Gjykon mbi vetën e parë shumës të përdorur në shkrim. • Analizon gjuhën e shkrimit. • Dallon elementet e kritikës e të revoltës. • Formulon mesazhin e shkrimit. 		Fjalët kyç: hero, njeri i zakonshëm, ironi, revoltë, shoqëri, vlera	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; materiale në internet për këtë ngjarje.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Punë e pavarur, Punë e drejtuar</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i> Zhvillohet me nxënësit biseda rreth heronjve dhe konceptit që ata kanë për heronjtë. Nxënësit sjellin në klasë raste të përvojave të tyre reale, kur ata në një mënyrë ose tjetër, janë ndier heronj në miniaturë. Dëgjojnë me vëmendje rrëfimet e nxënësve duke vlerësuar të shprehurit e tyre dhe veçantitë e përjetimeve të secilit.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e drejtuar</i> Vëmendja e nxënësve përqendrohet në shpjegimin e mënyrës me të cilën autori ka filluar shkrimin. Gjithashtu ata gjykojnë përse autori nuk ka dashur të identifikojë personazhet që marrin pjesë në ngjarje. Nxënësit gjykojnë mbi mesazhet e pjesës, atë ç’ka autori ka dashur të nxjerrë në pah, duke përdorur për këtë vetën e parë të numrit shumës, duke dhënë mendimin e tij mbi vlerat që i jep ajo shkrimit.			
Te analiza e gjuhës së tekstit nxënësit ilustrojnë me pjesë nga teksti kritikata e autorit, duke dalluar gjuhën: <ul style="list-style-type: none"> ☞ ironike: ☞ revoltuese: 			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur</i> Nxënësit gjykojnë mbi mesazhin e shkrimit, duke e formuluar bukur atë.			
Vlerësimi: Mësuesi vlerëson mendimet origjinale të nxënësve.			
Detyrë shtëpie: Ese: “Të gjithë bëhemi heronj kur kemi dëshirë të ndihmojmë të tjerët.”			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i emrave me dy trajta shumësi		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Shpend Bengu: <i>Gjirokastra</i> . Përshkrim	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë emrat në fjalitë e dhëna; • të kthejë në numrin shumës emrat; • të shpjegojë mënyrën e formimit të shumësit të emrave sipas gjinive; • të dallojë emrat e dygjinishëm duke përcaktuar mbaresat e tyre. 		emër, trajta e shumësit, mbaresë, emër i dygjinishëm	
Burimet: teksti i nxënësit, enciklopedi, internet, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Shkrim i lirë, bisedë e kombinuar me shpjegim, punë e pavarur, ushtrime.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. <i>Shkrim i lirë</i>			
Përshkrimi i qytetit të Gjirokastrës. Nxënësit përshkruajnë qytetin e Gjirokastrës duke përdorur emra të gjinive të ndryshme. Përcaktojnë numrin e tyre.			
2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Bisedë e kombinuar me shpjegim</i>			
Shkruaj në tabelë emra të gjinisë mashkullore dhe femërore dhe nxënësit shkruajnë shumësin e tyre. Mbi këtë bazë përgjithësojmë:			
Shumësi i emrave femërorë:		me mbaresën -a	
		njëlloj si njëjësi me	
		mbaresën -e	
Shumësi i emrave mashkullore:		me mbaresën -ë	
		me mbaresën -a	
Në grupin e emrave të dhënë, nxënësve u shpjegohet se ka emra që kanë dy trajta shumësi: <i>element, portokall, vit, gosti, jastëk</i> etj.			
3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur, ushtrime</i>			
Punohen në klasë ushtrimet 1, 2, 3, 4.			
Vlerësimi: Sipas planifikimit të mësuesit.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, 7 (Nxënësit zgjedhin njërën nga detyrat alternative).			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Drejtshkrimi i zanores ë në trup të fjalës. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Situata e të nxënës: Fragmenti i dhënë në tekst ku nxënësit nënvizojnë zanoren -ë- në fjalët me të zeza.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon zanoren -ë- paratheksore; dallon zanoren -ë- pastheksore; shpjegon rastet e përdorimit të zanores -ë- paratheksore dhe pastheksore; përdor në fjali fjalët e shkruara drejt me zanoren -ë- paratheksore dhe pastheksore. 		Fjalët kyç: zanore paratheksore, pastheksore, drejtshkrim	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri, poster me rregullat e drejtshkrimit të zanores -ë- ne trup të fjalës (nëse është e mundur, përdoret video –projektori)		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë dyshe, bisedë e kombinuar me shpjegim, punë e pavarur.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Punë në grup dysh.</i> Nxënësit qarkojnë fjalët që kanë zanoren -ë- dhe përcaktojnë nëse ajo është e theksuar apo jo.</p> <p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Bisedë e kombinuar me shpjegim</i> Pasi vendos në tabelë posterin me rregullat drejtshkrimore të zanores -ë-, përgjithësohen përmes shembujve rregullat për drejtshkrimin e zanores -ë- në trup të fjalës theksohet (që kjo zanore mund të jetë paratheksore dhe pastheksore). Zanorja -ë- paratheksore shkruhet: - në rrokjen e parë dhe në fjalët e prejardhura prej tyre (<i>kërcej, këmishë</i>) - në fjalët e prejardhura nga tema me bashkëtingëllore duke marrë -ë si mbështetëse (<i>armiqësi, besnikëri</i>) - në fjalët e formuara nga temë me -ë (<i>anëtar, bardhësi</i>) - tek emrat femërorë me -ëz (<i>drejtëz, lidhëz</i>) Zanorja -ë- pastheksore shkruhet: - tek emrat dhe mbiemrat me -ës, -ësh (<i>Kukës, mijëshe</i>) - tek mbiemrat me -ët (<i>i dobët, i errët</i>) U tërhiqet vëmendja nxënësve në rastet e mospërdorimit të zanores -ë- para dhe pastheksore.</p> <p>3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. <i>Ushtrime.</i> Punohen ushtrimet 1, 2, 3 në grupe dyshe, kurse ushtrimet 4, 5 punohen individualisht. Mësuesi kërkon që nxënësit të përpiqen të riprodhojnë rregullat e drejtshkrimit të mësuara gjatë orës.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësoj përgjigjet e sakta të nxënësve, aktivizimin e tyre dhe inkurajoj nxënësit më pak aktivë.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII				
Tema mësimore: Diktim		Situata e të nxënit:					
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;							
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Shkruan saktë tekstin e diktuar nga mësuesi • Përdor si duhet grupet e zanoreve në fjalë • Drejtshkruan djalët e prejardhura, të përbëra e të përngjitura. 		Fjalët kyç: diktim, drejtshkrim, grup zanor, fjalë të prejardhura, të përbëra, të përngjitura.					
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:					
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>diktim me të lexuar dhe plotësim.</i>							
Organizimi i orës së mësimit							
Fillimisht diktohet një tekst i parapërgatitur që përmban grupe zanore dhe fjalë të prejardhura, të përbëra e të përngjitura për të gjithë klasën, më pas klasa ndahet në grupe.							
1. Shkruani saktë tekstin e diktuar		2 pikë					
Matematika përbën një fushë të njohurive abstrakte të ndërtuara me ndihmën e arsytimit logjik mbi koncepte të tilla si numrat, figurat, strukturat dhe transformimet. Në Greqinë antike matematika përjetoi një zhvillim të paparë nga një plejadë e tërë matematikanësh siç janë: Pitagora, Talesi, Platoni, Eudoksi, Euklidi, Arkimedi etj. Njohuritë matematikore të grekëve të vjetër i përvetësuan dhe i pasuruan arabët, të cilët quhen edhe themelues të algebrës. Është i gabueshëm mendimi i njerëzve për të cilët matematika është e pakuptueshme. Shumica e simboleve që përdoren sot në matematikë, nuk ishin zbuluar deri në shekullin XVI. Matematika shkruhet me fjalë dhe kjo e kufizonte zhvillimin e saj. Euleri ishte ai që futi në matematikë një numër të madh simbolesh të cilat përdoren edhe sot.							
Grupi A							
2. Qarkoni formën e saktë të fjalëve.		6 pikë					
olimpjadë – olimpiadë	përkthys – përkthyes						
muaj – muaj	e diel – e djelë						
akuarium – akuarjume	botus – botues						
3. Shkruani 5 fjalë të përngjitura që në përbërje të tyre të kenë fjalën <i>kurrë</i>.		5 pikë					
4. Gjeni gabimet dhe i korrigjoni ato.		16 pikë					
Ishte e njëmijëta herë që përpiqeshin sa e sa lufëtarë, msues e atdhetar që me devotëshmëri janë përpjekur të ngrinin të lirë flamurin tonë kombtar, por kjo u bë falë vajzrisë e djalrisë shqipëtare.							
Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-10	11-13	14-18	19-23	24-26	27-29

Grupi B		
1. Qarkoni formën e saktë të fjalëve.		6 pikë
objekt – obiekt	bankjer – bankier	
miell – mjell	i gëzushëm – i gëzueshëm	
ndërtues – ndërtus	variant – varjant	
2. Shkruani 5 fjalë të përngjitura që në përbërje të tyre të kenë fjalën <i>gjithë</i>.		5 pikë
3. Gjeni gabimet dhe i korrigjoni ato.		16 pikë
Në qiell u çpalos flamuri shqipëtar që prej kohësh në Shqipri nuk çpalosej. Pak prej tyre u bënë të famshëm, se shumë mbetën anonimë dhe u përjetësuan vetëm në këngë. Qenë poetët e vjershtarët që përjetsuan kujtimin e tyre.		
Nota	4	5
Pikët	0-7	8-10
	6	7
	11-13	14-18
	8	9
	19-23	24-26
	10	27-29

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Umberto Eko “Ma hiq qafe atë celular!” (ora e parë) – tekst joletrar		Situata e të nxënit: Unë, babai, gjyshi im	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2.Kompetenca e të menduarit 4.Kompetencapër jetën, sipërmarrjen, mjedisin 5.Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja:		fotografi, celular, sy mekanik, njerëz të qytetëruar, regjistrim, fatkeqësi, kujtesë,	
<ul style="list-style-type: none"> Bën dallimin midis brezave. Parashikon përmbajtjen e fragmentit bazuar në titullin e tij. Lexon për të kuptuar përmbajtjen. Realizon pemën e mendimit për llojin e tekstit të dhënë, esesë. 			
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacion mbi autorin Umberto Eko		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, Parashikim i përmbajtjes, Pema e mendimit, Punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Bashkëbisedim*

Nxënësit krahasojnë veten e tyre me babanë dhe gjyshin, duke nxjerrë në pah ndryshimet në breza. Biseda bëhet argëtuese ndërkohë që ata tregojnë për ngjashmëritë dhe ndryshimet me prindërit e gjyshërit, duke u ndalur kryesisht, në mënyrën e jetesës së tyre në ditët e sotme.

Bashkëbisedimi fokusohet te teknologjia në ditët e sotme.

Mund t’u drejtohen pyetje të tilla, si:

- A jeni të tërhequr nga teknologjia?
- Çfarë ju tërheq më shumë?
- Po celulari sa i rëndësishëm është në përditshmërinë dhe jetën tuaj?
- Ç’vend zë ai në kohën tuaj?

(Mësuesi/ja bën një grafik në dërrasën e zezë për teknologjinë)

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Parashikim me terma paraprakë, Lexim i drejtuar, Pema e mendimit.*

Nxënësit njihen me jetën dhe veprën e autorit Umberto Eko dhe më pas u kërkohet nxënësve të parashikojnë përmbajtjen e fragmentit, duke u nisur nga titulli.

Mësuesi/ja zhvillon shkruan në dërrasë të zezë fjalët kyç: *Fotografi, sy mekanik, njerëz të qytetëruar, regjistrim, fatkeqësi, kujtesë, celular*, dhe u kërkohet nxënësve të krijojnë një situatë me këto fjalë.

Pas situatave të sjella nga nxënësit, lexohet titulli i pjesës dhe nxënësit krahasojnë situatën e krijuar prej tyre me atë që sjell titulli.


Nxënësit lexojnë pjesë-pjesë tekstin dhe parashikojnë ç’mund të ndodhë më pas, duke argumentuar parashikimet e tyre.

Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e fragmentit.

- Ç’ lloj shkrimi është kjo pjesë? (Ese)
- Pse është ese? Ç’ tipare ka ky lloj shkrimi?
- Si e fillon shkrimin autori?
- Ç’do të thotë autori me togfjalëshin “sy mekanik”?
- Pse autori e titullon pjesën “Ma hiq qafe atë celular!”?
- Ç’ tregon kjo pjesë për rolin e celularit në jetën tonë sot?
- Jepni mendimin tuaj, duke gjetur ngjashmëritë dhe të veçantat midis “fotografimit në mendje” dhe fotos në celular.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Pema e mendimit, Punë e pavarur*

Nxënësit realizojnë pemën e mendimit për llojin e tekstit, duke synuar paraqitjen e veçorive të tij.



Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe të formuluar bukur.

Detyrë shtëpie: Ese “Teknologjia, pjesë e jetës sime.”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Umberto Eko “Ma hiq qafe atë celular!” (ora e dytë) – tekst joletrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Sa i dobishmë është për mua celularit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. 5. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon për mjetet e teknologjisë në jetën e tij të përditshme. • Shpjegon rëndësinë e tyre në jetën e tij. • Krahason përjetimet që ka marrë ai nga momente të paregjistruara apo të fotografuara me momente që i ka përjetësuar përmes aparatit fotografik apo telefonit. • Gjykon mbi gjuhën e përdorur nga autori dhe mesazhin e esesë. 		Fjalët kyç: Fotografi, regjistrim, kujtesë, ndjesi, përjetim	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; foto të pajisjeve teknologjike që janë në përdorimin e përditshëm		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fotografia, historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Diskutim, Punë e drejtuar, Punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
1. Lidhja me temat e mëparshme: <i>Bashkëbisedim</i> Nxënësit flasin për rëndësinë që kanë mjetet e teknologjisë në jetën e tij, duke u ndalur: <ul style="list-style-type: none"> - Ç`vend zënë ato në jetën e tij? - Si e kanë ndryshuar ato jetën e tij? - Avantazhet dhe disavantazhet e tyre. 			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Diskutim, Punë e drejtuar</i> Mësuesi drejton vëmendjen e nxënësve në dy aspekte: <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësinë e mjeteve të teknologjisë; - Shqetësimi dhe keqardhja e autorit për përdorimin e tyre këto. Nxënësit diskutojnë rreth mënyrës se si autori e ka shprehur mendimin e tij duke nxjerrë në pah dy anët e zhvillimit. Dëgjohen mendimet e nxënësve. Nxënësit, bazuar në përvoja personale, krahasojnë momente të jetuara, të cilat i kanë fotografuar apo regjistruar me momente të cilat i kanë ruajtur në kujtesë. Ata flasin lidhur me përjetimet dhe ndjesitë në secilin rast. Nxënësit diskutojnë rreth mendimit nëse ajo që autori do të thotë është se po kthehemi në qenie robotike, larg ndjenjave, larg njerëzores. Dëgjohen mendimet e nxënësve.			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë e pavarur</i> Punohen ushtrimet e tekstit, duke gjykuar mbi gjuhën e përdorur, si dhe temën dhe mesazhin e esesë.			
Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit për mendimet e tyre, formulimin e tyre dhe argumentet që ata japin.			
Detyrë shtëpie: Shkruani disa argumente pro dhe kundër mbi përdorimin e mjeteve të teknologjisë.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Teksti enciklopedik. Kompetenca: të folurit		Situata e të nxënit: Fjalori enciklopedik shqiptar.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca qytetare;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon fjalorin enciklopedik si lloj të tekstit joletrar. • Jep karakteristikat e fjalorit enciklopedik. • Nxjerr informacionet e duhura nga një fjalor enciklopedik. 		Fjalët kyç: fjalor, enciklopedik, tekst, informacion.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale të nxënësve, fjalorë enciklopedikë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkenca e natyrës	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, diskutim, lexim i pavarur i materialeve, punë e pavarur,</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Nxënësit kanë informacion për fjalorët dhe, pasi rikujtojnë njohuritë rreth tyre, si përkufizimin e përgjithshëm të fjalorit, si libër fjalësh, ku fjalët klasifikohen sipas fushës së përdorimit, si fjalorë dy e më shumë gjuhësh, fjalorë shpjegues, ku shpjegohet kuptimi i fjalës, fjalorë shkencorë, ku shpjegohet kuptimi i fjalëve nga fusha e shkencës etj. deri sa vijnë tek fjalori enciklopedik si fjalor që përmbledh informacione nga të gjitha fushat e dijes.</p> <p>Mund të fillojë ora dhe me një bashkëbisedim, ku u jepet përgjigje pyetjeve të tilla, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A keni punuar me fjalorë? - Me cilët fjalorë punoni më shpesh? - Çfarë jepet në fjalorë? - Ju lexoni më shumë në fjalorët e printuar si libër apo në fjalorët elektronikë? - Ç’ është <i>Fjalori Enciklopedik Shqiptar</i>? - Ç’kërkoni më shumë në të? - Cili është fjalori elektronik që ju vizitoni më shpesh në internet? 			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim i pavarur i materialeve, diskutim</i></p> <p>Për efekt kohe e ndajmë klasën në tri skuadra dhe ndajmë në mënyrë afërsisht të barabartë dhe materialin që duhet të lexohet.</p> <p>Skuadra I – Histori dhe Teksti për bimët mjekësore Skuadra II – Letërsi Skuadra III – Kulturë dhe Arkeologji</p>			

Nxënësit për secilin material që lexojnë japin përgjigje për këto çështje:

- ☞ Llojin e informacionit që jepet (fusha e dijes).
- ☞ Të dhënat objektive të informacionit dhe detajet. Të dhënat subjektive.
- ☞ Listojnë të dhënat më të rëndësishme në tekstin që lexojnë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Diskutim, Punë në çift ose në grupe të vogla.*

Pasi shqyrtojnë çështjet sipas ndarjes së teksteve, kalohet në një diskutim se çfarë karakteristike të përbashkët kanë këto si tekste joletrare informuese.

(Të dhënat janë kryesisht objektive dhe të bazuara në fakte reale, ka të dhëna shkencore që jepen me një gjuhë standarde, të kuptueshme, ruhet terminologjia shkencore e fushës së dijes ku bëjnë pjesë, por në mënyrë të kuptueshme.)

Punohet rubrika *Diskutim*, në f..51.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Sipas detyrës së dhënë në tekst, nxënësit duhet të ndërtojnë një fjalor enciklopedik për të gjitha kategoritë e dijes që njihin. (Detyra mund të jetë për vlerësim në dosje.)

MODEL MËSIMI PËR BISEDAT LETRARE

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Bisedë letrare		Situata e të nxënit: Libri i përzgjedhur nga mësuesi dhe nxënësit.	
Kompetenca : Të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit (sipas planifikimit)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin 5. Kompetenca personale 6. Kompetenca qytetare 7. Kompetenca digjitale 			
Shënim. Mund të hiqet ndonjë, nëse nuk gjen vend te Biseda letrare dhe në veçanti në librin e përzgjedhur.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
Ora I			
<ul style="list-style-type: none"> • jep informacion shkurtimisht për librin dhe autorin e tij; • përmbledh shkurt ngjarjet e librit duke u bazuar në elementet e strukturës dhe të subjektit; • ndërton pyetje, gjëza e enigma rreth librit për shokët; • u përgjigjet pyetjeve që lidhen me të kuptuarit dhe interpretimin e librit; • përshkruan personazhet duke përdorur teknika të ndryshme. 			

<p>.ORA II</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bën analizën gjuhësore e stilistikore të librit • Evidenton pjesët më të bukura nga libri duke argumentuar pse • Komenton me ditarët e të nxënësve pjesë e shprehje të spikatura nga libri Shprehje, fragmente, personazhe etj. • Shkruan ese (tekste vlerësuese) rreth vlerave të librit • Ilustron me vizatime ngjarje e personazhe nga libri • Lidhe jetën, ngjarjet e personazheve me jetën e tij. <p>Nëse libri i përzgjedhur mund të jetë parashikuar në plan të lexuarit në një fragment, mund të merren orët dhe biseda të zhvillohet për tre ose dhe katër orë</p> <p>Ora III</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bën reklamën e librit për një gazetë, revistë a emision • Dramatizon pjesë për teatër nga libri. • Krijon një fjalor me fjalë kyçe nga libri • I dërgon një letër shkrimtarit për librin. • Krijon një korrespondencë imagjinare mes personazheve • Krahason librin e autorit me një tjetër të tij ose me një libër tjetër me të njëjtën tematikë. • Silleni ngjarjen e kohëve të vjetra në kohë moderne • Shkruani një mbyllje tjetër për librin <p>Këto pika mund të ndahen në grupe brenda klasës për t'u realizuar plotësisht.</p>	<p>Fjalët kyç: libër, personazh, vend, kohë, pjesa më e bukur, përdorime të figurshme të fjalës etj.</p>
<p>Burimet: teksti i përzgjedhur, përvoja të nxënësve</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare në varësi të librit, si:</p> <p>a) Shoqëria dhe mjedisi Shkencat e natyrës Arte Tik dhe Teknologji Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti</p> <p>b) Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave Të drejtat e njeriut Vendimmarrja morale Mjedisi Bashkëjetesa paqësore</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë e pavarur, diskutim , Diagram Veni, tabela e Koncepteve të personazhit, kllaster, ditarët e të nxënësve, analiza të ndryshme gjuhësore, shkrimi i një letre, shkrime të lira, shkrime esesh, karrige e nxehtë, empatia, punë në grupe etj.</p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Librat e bisedave letrare mund të përzgjidhen nga diskutime, anketime duke pasur parasysh gjendjen në bibliotekën e shkollës ose bibliotekën personale të nxënësve. Kjo përzgjedhje mund të bëhet në fillim të çdo tremujori dhe mund të përzgjidhen, nëse shihet e arsyeshme, dhe libra që kanë fragmente në tekst për të shfrytëzuar orët e tyre. Rezultatet e të nxënësve sipas të cilave duhet të punojë nxënësi jepen që në fillim me përzgjedhjen e librit. Për rezultatet e të nxënësve të orës së tretë mund të ketë diskutime me nxënësit për përzgjedhjen e tyre sipas mundësive.</p>	

Po marrim gradualisht secilin rezultat të nxëni për të realizuar një siaps orëve hapat që do të ndjekin orën dhe strukturën e saj.

Ora I

- Jep informacion shkurtimisht për librin dhe autorin e tij.

Nxënësit japin titullin, temën e tij dhe shkurtimisht flasin për biografinë e autorit.

- Përmbledh shkurt ngjarjet e librit duke u bazuar në elementet e strukturës dhe të subjektit.

Rruga që ndjekim mund të jetë sipas gjykimit tonë ku mund të punojmë me *hartën e tregimit* duke evidentuar elemente të subjektit, si; parashtrimi, pika e lidhjes, konflikti, pika kulmore, zgjidhja e konfliktit. Mund të shihet si një përmbledhje e shkurtër.

- Ndërton pyetje, gjëza e enigma rreth librit për shokët

Për të nxitur të menduarit kritik e për t’ia bërë nxënësit më tërheqës librin, sugjerohet që pyetjet rreth të kuptuarit dhe interpretimit të ndërtohen nga vetë ata.

Kjo fazë mund të bëhet dhe pas analizës së personazheve duke përfshirë dhe ata në pyetje.

Mund të jepen gjëza dhe enigma që lidhen me ngjarje, vende e momente kohore që tregojnë të lexuarit me vëmendje të një vepre.

- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me të kuptuarit dhe interpretimin e librit

Lidhet me pikën e mësipërme.

- Përshkruan personazhet duke përdorur teknika të ndryshme

Për përshkrimin e personazheve nxënësit mund të punojnë me një nga teknikat që u pëlqen, si: Diagrami i Venit, (nëse ka për të krahasuar) Kllaster, shkrim i lirë, tabela e koncepteve të personazheve.

Personazhet	Cilësi fizike	Cilësi morale	Ku duken	Mendime	Veprime	Gjykimi yt për të

ORA II

Nxënësi:

- bën analizën gjuhësore e stilistikore të librit, ndalet në përdorimet e figurshme të fjalës, leksiku, fjalori me fjalët e reja, llojet e fjalive, raportet e përshkrimeve me dialogët,
- evidenton pjesët më të bukura nga libri dhe i përzgjedh për t’i analizuar, duke argumentuar pse. dhe i rendit ato sipas preferencës,
- komenton me anë të ditarëve të të nxënit pjesë e shprehje të spikatura nga libri, fragmente, personazhe etj.
- shkruan ese (tekste vlerësuese) rreth vlerave të librit.
- Formulon idetë dhe mesazhet që transmeton libri dhe autori përmes tij.
- ilustron me vizatime ngjarje e personazhe nga libri. brenda mundësive dhe mund të lihet si detyrë për nxënës që kanë talent dhe fantazi në pikturë.
- lidh jetën, ngjarjet e personazheve me jetën e tij. etj përmes *empatisë* ose *karriges së nxehtë* nxënësit vë veten në rolin e personazhit ose gjykon se si do sillej ai vetë në të njëjtat situata.

Ora III

- Bën reklamën e librit për një gazetë, revistë a emision.

Këtu mund të shfrytëzojë njohuritë digjitale dhe realizon me softuere të ndryshme reklama për gazeta, revista, emisione të ndryshme, individuale ose në grup.

- Dramatizon pjesë për teatër nga libri.

Në grup mund të realizohen kthime të fragmenteve në pjesë dramatike dhe luhen në role. Aktivitetet dhe ky që mund të zhvillohet në grup.

- Krijon një fjalor me fjalë kyçe nga libri.

Mund të jenë vende, personazhe, ngjarje, veprime, sende etj. që lidhen me librin dhe bëhen në trajtën e një fjalori.

- I dërgon një letër shkrimtarit për librin.

Shkrimi mund të lidhet me mesazhet e idetë, por mund të bëhen dhe sugjerime se çfarë do të donin të ishin ndryshe në libër.

- Krijon një korrespondencë imagjinare mes personazheve.

Punë me imagjinatë që zhvillon të fantazinë dhe fjalorin e nxënësve.

- Krahason librin e autorit me një tjetër të tij ose me një libër tjetër me të njëjtën tematikë.

Mund të realizohet me një shkrim krahasues ose Diagram Veni.

- Silleni ngjarjen e kohëve të vjetra në kohë moderne.

Sipas fantazisë dhe në varësi të ngjarjeve të librit nxënësit rikrijojnë pjesë nga teksti në kohë të ndryshme imagjinare.

- Shkruani një mbyllje tjetër për librin.

Lihen të lirë në fantazinë e tyre, por duke ruajtur linjën logjike të ngjarjes.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim. Pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm dhe domosdoshmërisht pjesë e vlerësimit në dosje.

Detyrat dhe puna e pavarur. Sipas gjykimit dhe rezultateve të të nxënësve që do të përcaktojmë për secilën orë.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mbiemri		Situata e të nxënësve: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, I. Kadare	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon mbiemrat në fjalitë e dhëna; • përcakton veçoritë gramatikore të mbiemrit; • lakon mbiemrat e dhënë brenda grupeve emërore. 		mbiemër, përshtatje me emrin, cilësi	
Burimet: teksti shkencor, tabela e lakimit të mbiemrit sipas gjinive. e - libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Edukatë shoqërore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë në grupe dyshe, tabela e konceptit, punë e drejtuar, analizë rasti, punë e pavarur, diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Punë në grupe dyshe*

Nxënësit punojnë në grupe dyshe duke u përqendruar te fjalët me të zeza në fragmentin e dhënë. Ata gjejnë se ç’tregojnë ato dhe me çfarë lidhen në fjali.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Tabela e konceptit, punë e drejtuar*

Rishkruhen në tabelë grupet emërore ku bëjnë pjesë mbiemrat, të fragmentit të mësipërm dhe plotësohet *tabela e konceptit* për mbiemrin.

Klasa e fjalës	Gjini	Numër	Rasë	I nyj./I panyj.	Lidhet me emrin	Vendi
Mbiemri	+	+	+	+	+	Zakonisht pas emrit

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, diskutim*

Kthejmë në shprehje njohuritë e marra: Punojmë ushtrimet 1, 2, 3

Vlerësimi: bazuar në arritjet e nxënësve sipas grupeve apo individëve, përgëzohen nxënësit për pjesëmarrjen dhe bëhet vlerësimi i përgjigjeve me gojë apo me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 4, 5 f. 217.


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkallët e mbiemrit Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Nxënësit krahasojnë mbiemrin <i>i lartë</i> në tre rastet e përdorura në fragmentin e dhënë në tekst	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon shkallët e mbiemrit; shpjegon si formohet secila shkallë; përdor mbiemrat e shkallëve të ndryshme në fjali. 		Fjalët kyç: mbiemër, shkallë, pohore, krahasore, sipërore	
Burimet: teksti shkencor, tabela e shkallëve të mbiemrit, ilustruar me shembuj, e -libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Muzikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e drejtuar, punë e pavarur, organizues grafik, diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Punë e pavarur, diskutim*

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, duke krahasuar mbiemrat *i lartë*, *më i lartë*, *shumë i lartë* në fragmentin e dhënë në tekst.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: Organizues grafik. Pasi nxënësit japin mendimet e tyre rreth mbiemrit *i lartë* në të tria rastet, përgjithësohet përmes organizuesit grafik (kllaster).



Qartësohen mënyrat e formimit të shkallës krahasore dhe sipërore.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, diskutim*

Kthejmë në shprehje njohuritë e marra: Punojmë ushtrimet

Vlerësimi: sipas planifikimit të mësuesit.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 4, 5 (nxënësit zgjedhin alternativën e dëshiruar).

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë njoftime Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Punë me modele	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca qytetare;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Jep përkufizimin e njoftimit si lloj shkrimi. Evidenton veçoritë e këtij lloj shkrimi. Analizon modele njoftimesh për të nxjerrë rregullat e shkrimit të tyre. Shkruan njoftim për një ngjarje të caktuar. Diskuton dhe vlerëson njoftimeve e shkruara prej tyre. 		Fjalët kyç: njoftim, struktura e njoftimit ngjarje.	

<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, modele njoftimesh siguruara nga burime të ndryshme nga nxënësit.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Edukim fizik, Arte</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë e drejtuar me modele, analizë rasti, punë e pavarur, diskutim.</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; <i>Stuhi mendimi</i> Prezantojmë temën dhe rezultatet e të nxënësve për të. Ndërkohë nxënësit e njohin termin “njoftim”, ndaj mund të japin mendimet e tyre për njohuritë që kanë rreth këtij shkrimi duke sjellë shembuj të ndryshëm që i kanë me vete me porosi të mësuesit.</p> <p>U drejtohen pyetje të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A keni shkruar ndonjë njoftim? - Çfarë informacioni shkruhet zakonisht në njoftime? - Si jepet informacioni në njoftime? - Ç’ do të thotë fjala “njoftim”? Cila është rrënja e fjalës? - Ç’ lloj teksti është njoftimi? <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e drejtuar me modele, analizë rastesh, punë e pavarur</i> Nxënësit udhëzohen të punojnë me modelin e tekstit ose dhe me ato që kanë sjellë vetë për të nxjerrë, jo vetëm veçoritë e këtij lloj shkrimi, por edhe rregullat që mund të ndiqen për t’i shkruar njoftimet. Për modelet e dhëna nxënësit konkludojnë rreth strukturës së njoftimit, përmbajtjes së secilit element të strukturës, tematikës për të cilën shkruhet etj.</p> <p>Pasi diskutohen çështjet që u jepen nxënësve temat që janë dhënë në tekst dhe shkruajnë një njoftim për njërën prej tyre. Klasa mund të ndahet në pjesë për të pasur larmishmëri tematikash.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Diskutim</i> Lexohen dy deri në tri njoftime për secilën temë dhe bëhen diskutime rreth mënyrës së realizimit duke bërë vlerësimt dhe vetëvlerësime</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit mund të bëjnë dhe një njoftim në shtëpi për t’u ushtruar.</p>	

<p>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: III</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Shkruajmë rregullore Kompetenca: Të shkruarit</p>		<p>Situata e të nxënësve: Rregullorja e Brendshme e Shkollës</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. • Kompetenca e të menduarit. • Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. • Kompetenca qytetare. 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jep përkufizimin e rregullores si lloj shkrimi. • Evidenton veçoritë e këtij lloj shkrimi. • Analizon modele rregulloresh për të nxjerrë rregullat e shkrimit të tyre. • Shkruan një rregullore sipas tematikës së përzgjedhur. • Diskuton për të vlerësuar rreth rregulloreve të shkruara prej tyre. 	<p>Fjalët kyç: Rregullore Struktura e rregullores</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; modele rregulloresh nga burime të ndryshme, Rregullorja e Brendshme e Shkollës</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: fushat e veprimtarisë shoqërore, shkencore, artet etj.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë e drejtuar me modele, punë e pavarur, analizë rastesh, diskutim</i></p>	

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Stuhi mendimi*


Prezantojmë temën dhe rezultatet e të nxënit për të dhe kërkojmë që nxënësit të flasin shkurtimisht për rregulloren si lloj shkrimi, duke e përkufizuar atë dhe duke listuar rregullore që ata kanë pasur për të zbatuar.

U drejtohen pyetje të tilla si:

- A keni lexuar ose shkruar ndonjë rregullore?
- Përse shkruhet një rregullore?
- Çfarë informacioni shkruhet zakonisht në rregullore?
- Përse shërben rregullorja?
- Ç’ do të thotë fjala “rregullore”? Cila është rrënja e fjalës?
- Ç’ lloj teksti është rregullorja?

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar me modele, analizë rasti, punë e pavarur.*

Fillimisht punohet me modelin e rregullores në tekst, por mund të sigurohet për çdo bankë një pjesë nga Rregullorja e Brendshme e Shkollës. Nxënësit analizojnë strukturën në trajtë pikash, renditjen e rregullave në një rregullore, terminologjinë e përdorur, llojet e fjalive, kohën e foljeve dhe elemente të tjera gjuhësore.

 Plotësojnë me fjalët e tyre rregulloren e dhënë si model në tekst dhe më pas u kërkohet të shkruajnë vetë një rregullore të shkurtër për klasën.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Diskutim*

Lexohen rregulloret e klasës të formuluar nga nxënësit dhe përzgjidhen e renditen në mënyrë të tillë, që të krijohet një rregullore përfundimtare. Për këtë ngrihet një grup sipas dëshirës së nxënësve. Ky proces mund të realizohet në shtëpi.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit.

Detyrat dhe puna e pavarur. Rregullorja e klasës mund të lihet në disa grupe të realizohet dhe gjatë një ore edukative bëhet përzgjedhja për ta vendosur në mur.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për mbiemrin Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: <i>Përshkrimi i shokut të bankës duke përdorur sa më shumë mbiemra</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon mbiemrin në fjali; • përcakton veçoritë e tij gramatikore; • lakon mbiemrat e dhënë brenda GE; • përdor mbiemrat në shkallë të ndryshme. 		Fjalët kyç: mbiemër, i nyjshëm, i pa nyjshëm, numri, gjinia, shkallët e mbiemrit,	
Burimet: teksti shkencor, e-libri, tabela e shkallëve të mbiemrit, ilustruar me shembuj		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Muzikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë e pavarur, ushtrime, punë.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhje e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. <i>Stuhi mendimi: Rikujtojmë njohuritë e marra rreth mbiemrit</i> – Ç’tregon mbiemri? – Me cilën fjalë lidhet? – Cilat janë veçoritë e tij gramatikore? – Si paraqitet cilësia përmes shkallëve?			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë individuale, punë në grupe dyshe</i> Nxënësit punojnë me shkrim në fletore duke përshkruar shokun / shoqen e bankës. Ata duhet të përdorin mbiemra të shkallëve të ndryshme, në numër dhe gjini të ndryshme.			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Ushtrime.</i> Punohen në mënyrë të pavarur ushtrimet 1, 2, 3. Nxënësit përqendrohen në shkallët e mbiemrit në ushtrimin 4 dhe në përshtatjen e mbiemrit me emrin në ushtrimin 6.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe vë në pah pikat e forta dhe të dobëta lidhur me mbiemrin.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 9, f. 199.			

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Trajtat e shkurtra të bashkuara të përemrit vetor		Situata e të nxënit: “Aventurat e Tom Sojerit”, Mark Tuen	
Kompetenca: Njohri për gjuhën - Mbiemri			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • dallon trajtat e shkurtra të përemrit vetor; • lakon përemrat vetorë; • shpjegon formimin e trajtave të shkurtra të bashkuara; • dallon trajtat e shkurtra u, të nga pjesëza u dhe pjesëza të e lidhore 		përemër vetor, trajtë e shkurtër, lakim, trajtë e shkurtër e bashkuar.	
Burimet: teksti shkencor, tabela e lakimit të përemrave vetorë, e - libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, shpjegim dhe mbajtje e shënimeve, punë e pavarur, punë e drejtuar.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *punë dyshe, punë e drejtuar.*

Nxënësit përpiqen të gjejnë përemrat vetorë në fragmentin e dhënë, duke përcaktuar vetën e tyre, gjininë (kur ajo dallohet), numrin e rasën.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Shpjegimi dhe mbajtja e shënimeve.*

Vendoset tabela e lakimit të përemrit vetor para nxënësve dhe përqendrohet vëmendja e tyre te trajtat e shkurtra të përemrit vetor, në rasën dhanore dhe kallëzore.

Me ndihmën e nxënësve sqarohet formimi i trajtave të shkurtra të bashkuara. (formimi i tyre bëhet përmes bashkimit të trajtave të shkurtra të rasës dhanore në veta të ndryshme me trajtën e shkurtër të rasës kallëzore të vetës III njëjës ose shumës).

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Ushtrime*

Punojmë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, ndërsa punojnë individualisht ushtrimet 3, 4, 5.

Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit bazuar në përgjigjet e tyre, aktivizimin dhe përqendrimin e tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 8, f. 202.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i apostrofit te trajtat e shkurtra të bashkuara Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Situata e të nxënit: <i>Përralla shqiptare</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 6. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon trajtat e shkurtra të bashkuara që shkruhen me apostrof; shpjegon rastet e përdorimit të tij duke ilustruar me shembuj; ndërton fjali duke përdorur trajtat e shkurtra të bashkuara me apostrof. 		Fjalët kyç: apostrofi, trajta e shkurtër e bashkuar, drejtshkrimi	
Burimet: teksti i nxënësit, tabela e trajtave të shkurtra të bashkuara		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Edukatë shoqërore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, punë e pavarur.</i>			
<p>Organizimi i orës së mësimt</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Punë në dyshe</i> Nxënësit punojnë në dyshe me fragmentin e dhënë duke dalluar trajtat e shkurtra të bashkuara (kryesisht ato që shkruhen me apostrof)</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Mbajtja e strukturuar e shënimeve</i> Në tabelën e trajtave të shkurtra, nxënësit veçojnë ato që shkruhen me apostrof, duke u përpjekur të shpjegojnë në fletore se si janë formuar ato. Bazuar në këto raste përgjithësojmë rastet e përdorimit të apostrofit.</p> <div style="text-align: center;"> <p>Apostrofi</p> </div> <p>Nuk shkruhen me apostrof <i>ma, ta</i>, ku kemi shkrirje dhe jo rënie të -ë-së.</p> <p>3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura: <i>punë e pavarur</i> Kthejmë në shprehje njohuritë e marra duke punuar ushtrimet 1, 2, 3, 4.</p> <p>Vlerësimi: Bazuar në arritjet e nxënësve sipas grupeve apo individëve, përgëzoj nxënësit për pjesëmarrjen dhe bëj vlerësimin e përgjigjeve me gojë apo me shkrim.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, 6, f. 203</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përemri vetvetor dhe dëftor		Situata e të nxënit: <i>Fragmentet e dhëna ku nxënësit dallojnë kuptimin e fjalëve me të zeza</i>	
Kompetenca: Njohri për gjuhën - Morfologji			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon përemrat vetvetorë dhe dëftorë; përcakton veçoritë e përemrit dëftor dhe vetvetor; krijon fjali me përemrin dëftor dhe vetvetor; dallon duke ilustruar me shembuj përemrin vetor nga ai dëftor. 		Fjalët kyçe: përemër dëftor, përemër vetor, lakim	
Burimet: teksti i nxënësit, e-libri, tabela e klasave të fjalëve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, bisedë e kombinuar me shpjegim, punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Punë dyshe</i> Nxënësit përqendrohen te fragmenti i dhënë duke synuar të kuptojnë se ç'tregojnë fjalët me të zeza: Alba dhe veten. 1. Vetën që kryen veprimin - Alba 2. Vetën që pëson veprimin - Alba</p> <p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Bisedë e kombinuar me shpjegim</i> Bazuar në fragmentin e mësipërm, plotësojmë organizuesi grafik për përemrin dëftor dhe vetvetor.</p>			
Mësuesi sqaron dallimin mes përemrit vetor dhe dëftor.			
3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur dhe me klasën</i> Punohen ushtrimet 1, 2, 3 në klasë.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit bazuar në aktivizimin dhe përgjigjet e tyre të sakta.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, f. 207			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjojmë njoftime, lajme të ndryshme Kompetenca: Të dëgjuarit		Situata e të nxënët: Lajme mbi problemet mjedisore në botë	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca qytetare; 6. Kompetenca digjitale; 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon për të nxjerrë informacionin kryesor nga lajmet. • Dallon karakteristikat kryesore që përmban një lajm. • Lexon vetë lajme e njoftime që lidhen me probleme të ndryshme, siç janë problemet mjedisore. 		Lajm Strukturë e lajmit Ngjarje	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, njoftime e lajme që sjellin nxënësit në lidhje me ngrohjen globale dhe shfrytëzimin e energjisë diellore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkenca dhe shoqëria, shkencat e natyrës, • mjedisi,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, dëgjim i materialeve në DVD, diskutim, pyetje-përgjigje, lexim tekstesh të ndryshme, punë e pavarur, diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim ose Stuhi mendimi</i> U kërkohet nxënësve të thonë çfarë kuptojnë me fjalën lajm. Për këtë është më e mirë të praktikohet stuhia e mendimit, përmes së cilës nxënësit mund të arrijnë vetë në përfundimin se çfarë është një lajm.</p> <p>Lajmi është diçka që një informacion i ri për të cili nuk e ke ditur ndonjë gjë më parë”.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Dëgjim i materialeve, organizues grafik, pyetje- përgjigje, diskutim</i> Nxënësit dëgjojnë lajmin për energjinë diellore në tekstin digjital ose të lexuar nga mësuesja dhe më pas plotësojnë me të dhënat e tij kërkesat e dhëna në libër. Materiali i dytë synon që nxënësit të dallojnë veçoritë e lajmit. Pasi nxënësit dëgjojnë lajmin, duhet të tregohen të kujdesshëm për të fiksuar elementet kryesore të lajmit dhe ta plotësojnë ushtrimin 2 të tekstit me informacionet nga lajmi që kanë dëgjuar.</p> <p>Disa nxënës lexojnë plotësimet që kanë bërë dhe diskutohet rreth tyre.</p>			
<p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë e pavarur</i> Disa nga nxënësit lexojnë lajme që i kanë shkëputur nga gazetatat, ndërsa nxënësit e tjerë mbajnë shënime që lidhen me informacionet që sjellin ato lajme, duke iu referuar organizuesit grafik. Pas çdo leximi nxënësit që dëgjojnë informacionet e dhëna, plotësojnë njëri-tjetrin dhe bëjnë vlerësime për saktësinë e tyre.</p>			
Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit, me gojë ose me notë.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kundërajtori i vjetër (ora I)		Situata e të nxënit: Koha e luftës. Bisedë	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 5. Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • shpreh mendimin e tij për kohën e luftës; • lexon për të kuptuar përmbajtjen; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes; • ritregon bukur përmbajtjen e tekstit. 		kundërajror, luftë, pushtim, kala, aeroplan, bombë	
Burimet: teksti i nxënësit, informacione rreth luftës, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>bisedë, lexim zinxhir, punë e drejtuar, punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja me temat e mëparshme: <i>bisedë</i></p> <p>Nxënësit bisedojnë për Luftën Nacionalçlirimtare sipas informacioneve që kanë dëgjuar apo marrë nga të afërmit, nga librat, filmat apo interneti.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç’dini për luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare? - Cilët pushtues erdhën në Shqipëri? - Në ç’ vite është zhvilluar kjo luftë? - Keni lexuar ndonjë libër apo keni parë ndonjë film, i cili trajton ngjarje të luftës Antifashiste? Pse u quajt kështu? <p>Nëse nxënësit nuk kanë informacionin e duhur rreth kësaj periudhe, mësuesi/jai ndihmon, duke iu kujtuar dhe tituj filmash si: “Tomka dhe shokët e tij”, “Debatik”, “Mëngjese lufte” etj, në të cilët jepet dhe mënyra se si i përjetuan fëmijët këto ngjarje e si morën pjesë në këtë luftë.</p> <p>Dëgjohen mendimet e nxënësve dhe vlerësohen</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: lexim zinxhir, punë e drejtuar</p> <p>Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse përmes së cilës prezanton titullin e pjesës dhe autorin e saj. U kërkohet nxënësve të flasin ç’dinë për shkrimtarin Ismail Kadare dhe veprat që njohin prej tij. Më pas ndalet të libri “Kronikë në gur”?</p> <ul style="list-style-type: none"> - A e ka lexuar ndonjëri prej jush librin “Kronikë në gur”? - Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet në këtë vepër? - A dini ç’është kundërajtori? <p>- Pyetje rreth të kuptuarit</p> <p>Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e tregimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç’ lloj shkrimi është kjo pjesë? (Tregim) - Ç’ tipare ka ky lloj shkrimi? 			

- Përse autori e titullon këtë tregim “Kundërajtori i vjetër”?
- Si e përshkruan autori kundërajtorin?
- Ndaluni në tekst dhe ilustroni mendimin.
- Lexoni dhe njëherë dy fjalitë e para.
- Ç’ figura letrare ka përdorur autori?
- Si e përshkruan autori qytetin?
- Ç’ tregon kjo pjesë për lidhjen e autorit me qytetin dhe atë kohë?

Këtu gërshetohen dhe ushtrimi 1 dhe 2 në tekstin e nxënësit.

Ritregimi i përmbajtjes

Ushtrimi 3

Tema dhe mesazhi

Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për ushtrimin 4:

Cila është tema e këtij tregimi? Po mesazh a mund të nxjerrim prej tij? Ç’gjurmë kanë lënë te rrëfimtari kujtimet e fëmijërisë?

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe, ditarët e të nxënët

Shembuj dhe ilustrime	Figurat letrare	Komenti im

Ushtrimi 5

Shembuj dhe ilustrime Figurat letrare Komenti im

Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit që ishin aktivë gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Detyrë, f. 58.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kundërajtori i vjetër (ora II)		Situata e të nxënët: Ndjesitë e kohës së luftës. Bisedë	
Kompetenca: Tekst letrar			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç			
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
2. Kompetenca e të menduarit			
5. Kompetenca qytetare			
6. Kompetenca personale			

<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e tij rreth ndjesive që shkakton gjendja e luftës; komenton shprehje të caktuara të fragmentit; dallon dhe shpjegon figuracionin e përdorur; përmbledh veçoritë e tekstit rrëfimtar. 	<p>Fjalët kyç: ndjesi, luftë, kundërajror i vjetër, tekst rrëfimtar</p>
<p>Burimet: teksti i nxënësit, informacione për LNÇL përvoja të nxënësit, e-libri</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bisedë, koment, organizues grafik, punë e drejtuar, punë e pavarur, ditari i të nxënimit

Organizimi i orës së mësimimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Kontrolli i detyrave të shtëpisë

Mësuesi aktivizon 2 -3 nxënës për të lexuar detyrat e zhvilluara. Më pas pyet nxënës të tjerë për të plotësuar detyrën.

Mësuesi/ja jep dhe informacion shtesë për veprën “Kronikë në gur”

2. Ndërtimi i njohurive të reja: organizues grafik

Nxënësit gjykojnë rreth veçorive të tekstit rrëfimtar duke plotësuar kllasterin në tabele.

Ushtrimi 6: Ditari dypjesësh.

Pjesë nga teksti	Ndjenjat fëminore

Ushtrimi 7: punë e pavarur ose në grupe


Fjalët e mëposhtme tregojnë se sa i vjetër ishte ky qytet i gurtë. Kjo lidhje jepet përmes epitetit “i vjetër” dhe simbolit “kalasë”. Të tre objektet janë simbole të lashtësisë dhe simbole të qytetit.

Ushtrimi 8: ditarët e të nxënimit

Shprehja	Figura letrare	Shpjegimi im
Qyteti ynë boshatisej papritur	Metaforë	
Qyteti ynë kish mbetur pa pushtet	Personifikim	
Qyteti ynë nuk e duroi bombën	Personifikim	

3. Demonstrim i rezultateve të arritura:, punë e pavarur, punë në grupe

Ushtrimi 9: Me motivin kryesor lidhet fjala kundërajror.



Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin në plotësimin e kllaserit.

Detyrë shtëpie: Bëni një krijim me titull “Nëpër udhët e qytetit të gurtë”.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: Përemri pyetës Kompetenca: Njohri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënët: Dialog			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 5. Kompetenca personale					
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: • dallon përemrin pyetës në fjali; • veçon përemrat e lakueshëm nga ato të palakueshëm; • përdor në fjali trajta të ndryshme të përemrave pyetës.		Fjalët kyç: përemër pyetës, i lakueshëm, i palakueshëm			
Burimet: teksti shkencor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Qytetari			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, tabela e konceptit, punë e drejtuar, punë e pavarur</i>					
Organizimi i orës së mësimit					
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë dyshe</i> Në dialogun e dhënë në tekst, nxënësit ndalen te fjalët e zeza duke treguar se ç’tregojnë ato dhe ç’të përbashkëta kanë.					
2. Ndërtimi i njohurive të reja: Bazuar në rastet e mësipërme, përpiqemi bashkë me nxënësit të përcaktojmë veçoritë gramatikore të përemrit pyetës duke plotësuar tabelën e konceptit.					
Përemri pyetës	Ç’tregon?	Shoqërohet me emër ose jo	Lakohet	Dallon gjininë	Numri
Kush	Pyet për frymorë	Jo	Po	Jo	Njëjës
Cili	Pyet për sende dhe frymorë	Po	Po	Po	Njëjës, shumës
Sa / I sati	Pyet për sasinë	Po	Po	Jo / Po	Njëjës, shumës
Çfarë	Pyet për sende dhe frymorë	Po	Jo	Jo	Nuk e dallon
Ç’	Pyet për send, lëndë, mjet, shkak	Po	Jo	Jo	Nuk e dallon
3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimin 1, ndërsa punojnë individualisht ushtrimet 2, 3, 4, 5. Nxënësit bëjnë kujdes në përshtatjen e përemrave në numrin, gjininë dhe rasën e duhur.					
Vlerësimi: Bazuar në arritjet e nxënësve sipas grupeve apo individëve, përgëzohen nxënësit për pjesëmarrjen dhe bëhet vlerësimi i përgjigjeve me gojë apo me shkrim.					
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6. f. 210.					

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për përemrat Kompetenca: Njohri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Tregim i shkurtër me lloje të ndryshme përemrash	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin 4. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • dallon përemrat vetorë, dëftorë, pyetës; • përshtat në gjini, numër dhe rasë përemrat me fjalët e tjera; • përdor në fjali lloje të ndryshme përemrash. 		Fjalët kyç: përemër dëftor vetor, pyetës, trajtë e shkurtër	
Burimet: Teksti nxënësit, e-libri, Enciklopedi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e drejtuar, shkrim i lirë, punë dyshe, punë e pavarur.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë e drejtuar, shkrim i lirë</i> Nxënësit shkruajnë një tregim të shkurtër ku përdorin përemra të ndryshëm, duke i dalluar ato dhe duke i emërtuar ato.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim</i> Diskutohen me klasën tregimet dhe dallohen të gjitha llojet e përemrave të përdorur.			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>punë dyshe, punë e pavarur.</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2. Të udhëhequr nga mësuesi, nxënësit punojnë ushtrimet 3, 4, 5 ku përqendrohen në trajtat e shkurtra të përemrit vetor dhe dallimin e tyre nga pjesëza u dhe më, të. Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 6, 7, 8, ku synojnë të vendosin përemrat në trajtat e kërkuara.			
Vlerësimi: Sipas planifikimit të mësuesit.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 9, 10, f. 212.			

TEST SEMESTRI I

GRUPI A

EMRI _____

KI-VII

I. NJOHURI LETRARE

Pasi të lexoni tekstin, do t’ju jepni përgjigje kërkesave të mëposhtme.

Herman Hesse

DEMIANI

Po e filloj rrëfenjën time, kur isha djalosh dhjetëvjeçar. Aso kohe isha nxënës në shkollën latine të qytezës sonë.

Dy botëra rropateshin atje; nga dy polet vinin dita dhe nata. Njëra botë ishte shtëpia prindërore, mirëpo ajo ishte e ngushtë, madje tepër e ngushtë, dhe përfshinte vetëm prindërit e mi. Kjo botë, në pjesën më të madhe, më ishte e njohur: ajo quhej nënë dhe baba, dashuri dhe rreptësi, shëmbëllesë dhe mësim. Kjo botë ishte e mbushur plot shkëlqim dhe pastërti, me biseda të ngrohta dhe miqësore, duar të lara dhe duar të pastra, pra, shprehi të mira. Këtu këndohej korali i mëngjesit, këtu festoheshin Krishtlindjet. Duhet t’i përmbahesh rregullit të saj që jeta të jetë më e mirë dhe më e rregullt, më e qartë dhe më e pastër.

Ndërkaq bota tjetër fillonte mu në mjedisin e kësaj bote atërore dhe ishte krejt ndryshe; i vinte era ndryshe, fliste ndryshe, premonte dhe synonte ndryshe. Në këtë botën e dytë kishte shërbyese dhe djalosha zanatçinj, rrëfenja me fantazma dhe thashetheme, aty kishe një rrëke gjërash të tmerrshme dhe misterioze, gjëra të tilla si kasaphanë dhe burgje, njerëz të dehur dhe gra sharamane, lopë të porsalindura, kuaj të plandosur për tokë, rrëfenja vjedhjesh, vrasjesh, vetëvrasjesh. Gjithë këto gjëra të bukura dhe të llahtarshme njëherësh, të egra dhe mizore, i gjeje kudo, në rrugicën aty afër, në shtëpinë aty afër, policët dhe endacakët t’i zinte syri kudo.

Ishte e mrekullueshme që këtu te ne kishte paqë, rregull dhe qetësi, detyrim dhe ndërgjegje të pastër, falje gabimesh dhe dashuri. Dhe më e çuditshmja ishte si kufizoheshin këto dy botëra me njëra-tjetrën, sa afër që ishin! Për shembull, shërbyesja jonë Lina, kur mbrëmjeve e zhytur në mendime, me zërin kumbues këndonte bashkë me ne këngën, i përkiste atërores dhe amënores, na përkiste neve, në dritë dhe rrugë të drejtë. Fill pas kësaj, në kuzhinë apo në stallë, kur më tregonte mua përrallëzën për njeriun pa kokë, ose kur zihej me gratë në mishtoren e vogël në qoshen e rrugës, ajo ishte një tjetër, i përkiste një bote tjetër; plot të fshehta dhe të papritura.

Nganjëherë e dija: qëllimi im i vetëm në jetë ishte të bëhesha si nëna dhe babai, aq i shndritshëm dhe i pastër, aq superior dhe i rregullt, mirëpo ja që deri atje rruga ishte e gjatë, duhej mbaruar shkolla e, për ta bërë këtë gjë, duhej nxehur karrigia. Madje kishte edhe rrëfenja për djem të humbur, të cilët u jepeshin aventurave dhe unë të gjitha këto i lexoja me pasion.

Gjithmonë kthimi tek atërorja dhe tek e mira ishte aq çlirues dhe madhështor, sa që unë e ndieja që kjo ishte e vërteta, e mira dhe e dëshirueshmja. Por, megjithatë, njëra pjesë e rrëfenjës, e cila sillej poshtë së keqes dhe humbëtirës, vazhdonte të ishte më joshëse. Mirëpo këtë s’e thoshte askush dhe as e mendonte kush. Vetëm se ishte disi e pranishme, si një parandjenjë dhe mundësi në thellësinë e ndjenjave të mia. Kur unë e përfytyroja diellin, mund ta mendoja poshtë në rrugë, në panair apo në ndonjë tavernë, por kurrë në shtëpinë tonë.

Përgjigjuni pyetjeve.

1. Në cilën moshë e kanë pikënisjen kujtimet e autorit? (1 pikë)

- a. Pesëvjeçare
- b. Dymbëdhjetëvjeçare
- c. Dhjetëvjeçare
- d. Njëzetvjeçare

(1 pikë)

2. Ky tekst është një:

- a. tregim
- b. autobiografi
- c. biografi
- d. rrëfim

3. Në periudhën që rrëfen djali është nxënës në: (1 pikë)

- a. kolegjin e qytetit
- b. shkollën latine të qytetit
- c. shkollë fetare të qytetit
- d. shkollën e mesme të qytetit

4. Si dëshironte të ishte Demiani në jetë? Pse? Ku duket kjo? (3 pikë)

5. Çfarë përfaqëson figura e shërbyeses, Linës? (1 pikë)

6. Emërtoni figurën letrare të nënvizuar. (1 pikë)

Kjo botë ishte e mbushur me biseda të ngrohta (_____) dhe miqësore (_____) me duar të lara (_____) dhe duar të pastra(_____).

7. Si e kuptoni fjalinë përmbyllëse? (1 pikë)

Kur unë e përfytyroja diellin, mund ta mendoja poshtë në rrugë, në panair apo në ndonjë tavnë, por kurrë në shtëpinë tonë.

8. Bëni një ese të shkurtër argumentuese nisur nga dy botët e Demianit. (4 pikë)

“Bota që unë do të zgjidhja...”

II. PËRDORIMI I GJUHËS

1. Klasifikoni fjalët sipas ndërtimit. (4 pika)

Djalosh, njerëz, dhjetëvjeçar, festoheshin, Krishtlindjet, rrëfenja, thashetheme, gjërash, burgje, gjithsecili.

Fjalë të parme	Fjalë të prejardhura	Fjalë të përbëra	Fjalë të përngjitura

2. Në fjalën *thellësinë* gjeni: (3 pikë)

mbaresën _____, prapashtesën _____, rrënjën _____.

3. Shkruani fushën leksikore të fjalës *qytezë* me të paktën pesë fjalë. (2 pikë)

qytezë _____, _____, _____,
 _____, _____, _____, _____.

4. Gjeni të paktën dy fjalë sinonime dhe dy fjalë antonime në fragmentin e dhënë. (2 pikë)

Botë plot shkëlqim dhe pastërti, duar të lara dhe duar të pastra. Duhet t’i përmbahesh rregullit të kësaj bote që jeta të jetë më e qartë dhe më e pastër. Gjithë këto gjëra të bukura dhe të llahtarshme njëherësh, të egra dhe mizore.

Sinonime

Antonime

_____, _____, _____, _____,

5. Formoni dy fjali ku folja *qesh* të përdoret një herë në kuptim të parë e një herë në kuptim të figurshëm. (2 pikë)

6. Shkruani dy kuptime të fjalës *bar* (homonime). (2 pikë)

7. Për fjalën e nënvizuar jepni një sinonim të saj nisur nga konteksti. (1 pikë)

...kuaj të plandosur për tokë.

8. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara. (3 pikë)

Kjo (_____) botë, më ishte e njohur, ishte *plot* (_____) shkëlqim dhe pastërti, *sepse* (_____) ishte me biseda të ngrohta dhe miqësore.

9. Shkruani lakimin e emrit të nënvizuar. (1 pikë)

Kthimi tek *atërorja* (_____) ishte aq çlirues.

10. Jepni shumësin e grupit emëror *mjedis i panjohur*. _____ (1 pikë)

11. Formoni fjali me të dyja format e shumësit të emrit *brinjë*. (2 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-9	10- 13	14-16	17-23	24-30	31-33	34 -36

Çelësi i testit të semestrit I

Gr. A

Demiani

1. C

2. D

3. B

4. 1 pikë për çdo pjesë të testit.

Demiani dëshironte të ishte si prindërit e tij, pavarësisht se bota e rrugës i dukej interesante.

Nganjëherë e dija: qëllimi im i vetëm në jetë ishte të bëhesha si nëna dhe babai, aq i shndritshëm dhe i pastër, aq superior dhe i rregullt, mirëpo ja që deri atje rruga ishte e gjatë, duhej mbaruar shkolla e, për ta bërë këtë gjë, duhej nxehur karrigia.

5. Figura e Linës përfaqëson njeriun e zakonshëm që kishte mundur të gjente një punë të denjë, njerëz me të cilët ndihej mirë, ku mund të ishte e qetë dhe pozitive, por që në vetvete vinte nga një botë tjetër si bota e rrugës dhe për të mbijetuar ndonjëherë duhej të ishte si ata. Çdo përgjigje e përafërt pranohet.

6. Epitet

7. Duhet të dalë në pah ideja se bota e rrugës duhet njohur, për të mos u bërë pre a viktimë e saj.

8. Dy pikë për idenë e shprehur qartë dhe të argumentuar si duhet;

një pikë për strukturën;

një pikë për gabimet drejtshkrimore.

Përdorimi i gjuhës

9. Klasifikoni fjalët sipas ndërtimit.

10.

Fjalë të parme	Fjalë të prejardhura	Fjalë të përbëra	Fjalë të përngjitura
njerëz, gjërash, burgje,	djalosh, festoheshin rrëfenjë	Krishtlindjet, dhjetëvjeçar,	thashetheme, gjithsecili

11. Në fjalën *thellësinë* gjeni

mbaresën -në, prapashtesën -si, rrënjën thellë.

12. Për më pak se 5 fjalë merr vetëm 1 pikë.

13. Sinonime - *shkëlqim dhe pastërti; të lara dhe të pastra; më e qartë dhe më e pastër; të egra dhe mizore.*
Antonime - të bukura dhe të llahtarshme.

14. Qesh në kuptimin e parë: *Djali, vajza, nëna qeshi.*

Në kuptim të figurshëm: *Hëna qesh; dielli qesh.*

15. a. *E piva kafenë* në një bar.

b. *Bari i njomë sapo qe kositur.*

16. Sinonimi ...*kuaj të plandosur* për tokë – të rrëzuar, të palosur.

17. Përcaktoni klasën.

Kjo – përemër dëftor; *plot* – ndajfolje; *sepse* – lidhëz.

18. Shkruani lakimin e emrit të nënvizuar. Kthimi tek *atërorja*... – lakimi III.

19. Jepni shumësin e grupit emëror: *mjedis i panjohur* – *mjedise të panjohura*.

20. Formoni fjali me dy format e shumësit të emrit.

Format janë p.sh., *brinjat e maleve, brinjët e qengjit.*

TEST SEMESTRI I

GRUPI B

EMRI _____

KI-VII

I. NJOHURI LETRARE

Pasi të lexoni tekstin, do t’ju jepni përgjigje kërkesave të mëposhtme.

BUKËPJEKËSI

Bukëpjekësi ngrihet çdo ditë pa zbardhur. Ndërsa të tjerët flenë ai del nga shtëpia pa zhurmë, ecën me hapa të lehtë sa ju nuk do të mund të dëgjoni rrëshqitjen e tij në këtë orë të mëngjesit, në këtë rrugë të fjetur.

Ai ndez furrën, hedh miellin në magje e me duart e mëdha shtupake, zë brumin, dhe nuk ka si të mos mendojë për djalin e madh që muajin tjetër kthehet nga ushtria.

Atëherë gjërat do të bëhen më të lehta thotë me vete, dhe buzën vë në gaz.

Kur drita të ketë feksur, ai do të nxjerrë bukët e para nga furra, e me dashurinë e një ati të mirë do t’i rendisë ato në raftet e drunjta. Aroma e tyre do ta hijeshojë edhe më tepër mëngjesin, atje në fund të rrugicës ku ndodhet furra e tij. Pastaj ai do të ndezë një cigare dhe do të presë njerëzinë, se njerëzia është ende duke fjetur.

Pikërisht në këto çaste qetësie, i rrethuar nga tymi i duhanit dhe avulli erëmirë i bukëve, ai mendon për vajzën e vogël që mbush njëzet, dhe për të nipin që këtë vit shkon në klasën e parë, mendon për kumbullën që këtë vit ka çelur më herët dhe motin e thatë.

Pastaj shikon duart e argasura, si fallxhori përpiqet të deshifrojë vragat e tyre, plot naivitet zhvesh vitet që ka mbi shpinë, qesh si fëmijë.

Njerëzit vijnë atëherë kur fryma e dritës ka mbushur botën. Ai u buzëqesh, përshëndetet me ta, e zakonisht flet pak. Të gjithë largohen nga dyqani me bukët e tij në duar, ndërsa ai thinjet përditë. Njerëz, njerëz, njerëz që lënë dyqanin me bukët e tij të bukura, të bëra nga duart, dashuria, malli dhe kujtimet e bukëpjekësit. Kështu gjithçka thuret me të njëjtin ritëm.

Kur nata derdhet në këmbët e rrugicës, kur portat e avllive mbyllen, dritat bëhen të rralla, e zhurmat fashiten, pikërisht atëherë nëse ende s’ju ka marrë gjumi, e bëni kujdes do të ndieni një vringëllimë zinxhiri dhe rënkimin e një porte, e më pas asgjë.

Me çapa të vegjël, duke u lëkundur në barkun e errësirës, herë duke pirë një cigare e herë duke u kollitur, dhe sigurisht duke menduar për motin dhe dhimbjen në shpatull ai do të ecë drejt portës së shtëpisë, për t’u rrethuar nga njerëzit e dashur.

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

1. Për çfarë mendon bukëpjekësi sapo fillon punën?

- Për djalin student jashtë shtetit
- Për djalin që kthehet nga ushtria
- Për nipin që shkon në klasë të parë
- Për vajzën e vogël që mbushte njëzet vjet

(1 pikë)

2. Ky tekst është një:

- tregim
- autobiografi
- përrallë
- legjendë

(1 pikë)

(1 pikë)

3. Emërtoni figurat letrare të nënvizuara.

(2 pikë)

Pastaj shikon duart e argasura, *si fallxhori* (_____) përpiqet të deshifrojë vrangat tyre, plot naivitet *zhvesh vitet* (_____) që ka mbi shpinë, qesh si fëmijë.

4. Si e kuptoni fjalinë?

(1 pikë)

Njerëz, njerëz, njerëz që lënë dyqanin me bukët e tij të bukura, të bëra nga duart, dashuria, malli dhe kujtimet e bukëpjekësit.

5. Ilustroni me shembuj nga teksti këto cilësi të bukëpjekësit:

(3 pikë)

prind i përkushtuar;

fisnik në sjellje;

njeri i vuajtur, por që nuk ankohej.

6. Renditni sipas radhës veprimet që bën bukëpjekësi derisa bukët bëhen gati për klientët e tij.

(1 pikë)

7. Bëni një ese të shkurtër argumentuese me temë “Profesioni im”. (4 pikë)

(1 pikë)

II. PËRDORIMI I GJUHËS

1. Klasifikoni fjalët sipas ndërtimit.

bukëpjekësi, atëherë, njerëzia, erëmirë, bukëve, rrëshqitjen, dikur, vajzën mbush,

Fjalë të pame	Fjalë të prejardhura	Fjalë të përbëra	Fjalë të përngjitura

(4 pikë)

2. Në fjalën *mendon* gjeni:

mbaresën _____, prapashtesën _____, rrënjën _____.

(3 pikë)

3. Shkruani fushën leksikore të fjalës *furrë* me të paktën pesë fjalë.

(2 pikë)

4. Jepni sinonimin e fjalës së nënvizuar ... ndërsa ai thinjet përditë.

(1 pikë)

5. Gjeni fjalët antonime me njëra-tjetrën në fjalinë e mëposhtme.

Nuk ka si të mos mendojë për djalin e madh që muajin tjetër kthehet nga ushtria, për vajzën e vogël që mbush njëzet dhe nipin që këtë vit shkon në klasë të parë.

(1 pikë)

6. Formoni dy fjali ku folja *djeg* përdoret një herë në kuptim të parë e një herë në kuptim të figurshëm.

(2 pikë)

7. Shkruani dy kuptime të fjalës çel (homonime).

(2 pikë)

8. Për fjalën e nënvizuar jepni si përdoret në gjuhën standarde duke u nisur nga konteksti.

... portat e avllive mbyllen. _____

(1 pikë)

9. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara.

I rrethuar nga (_____) tymi i duhanit dhe (_____) avulli i bukëve ai mendon për vajzën që (_____) mbush njëzet.

(3 pikë)

10. Shkruani lakimin e emrit të nënvizuar.

Kur nata derdhet në këmbët e rrugicës dritat (_____) bëhen të rralla.

(1 pikë)

11. Jepni njëjësin e grupit emëror *raftet e drunjta*. _____

(1 pikë)

12. Formoni fjali me të dyja format e shumësit të emrit *grykë*.

(2 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-9	10- 13	14-16	17-23	24-30	31-33	34 -36

Çelësi i testit të semestrit I

Gr. B

Bukëpjekësi

1. B

2. A

3. Emërtoni figurat letrare:

a. si fallxhori – krahasim,

b. zhvesh vitet – metaforë.

4. Duhet të dalë ideja që ai e donte profesionin e tij dhe çdo gjë e bënte me dashuri. Ishte një njeri fisnik dhe i përkushtuar. Mënyra se si komunikonte me njerëzit i bënte bukët më të mira e më të shijshme.

5. Ilustroni me shembuj nga teksti këto cilësi të bukëpjekësit.

Një prind i përkushtuar nuk ka si të mos mendojë për djalin e madh që muajin tjetër kthehet nga ushtria, për vajzën e vogël që mbush njëzet vjet dhe për të nipin që këtë vit shkon në klasën e parë.

Fisnik në sjellje. Ai u buzëqesh njerëzve, përshëndetet me ta e zakonisht flet pak.

Njeri i vuajtur por që nuk ankohej. Me çapa të vegjël, duke u lëkundur në barkun e errësirës, herë duke pirë një cigare e herë duke u kollitur, dhe sigurisht duke menduar për motin dhe dhimbjen në shpatull ai do të ecë drejt portës së shtëpisë.

6. Rendit sipas radhës veprimet që bukëpjekësi bën derisa bukët bëhen gati për klientët e tij.

Ndez furrën, hedh miellin në magje e me duar zë brumin, i vendos me përpjekje në furrë, i nxjerr nga furra, i rendit ato në raftet e drunjta.

7. Dy pikë për idenë e shprehur qartë dhe të argumentuar si duhet;

një pikë për strukturë;

një pikë për gabimet drejtshkrimore.

Përdorimi i gjuhës

1. Klasifikoni fjalët sipas ndërtimit.

Fjalë të parme	Fjalë të prejardhura	Fjalë të përbëra	Fjalë të përngjitura
<i>bukëve, vajzën, mbush</i>	<i>njerëzia, rrëshqitjen,</i>	<i>bukëpjekësi, erëmirë</i>	<i>atëherë, dikur</i>

2. Në fjalën mendon gjeni:

mbaresën -n, prapashtesën -o, rrënjën mend.

3. Shkruani fushën leksikore të fjalës *furrë* me të paktën pesë fjalë.

Për më pak se pesë fjalë merr një pikë.

4. Jepni sinonimin e fjalës së nënvizuar *thinjet* – *zbardhet*.

5. Gjeni fjalët antonime me njëra-tjetrën në fjalinë e mëposhtme:

djalin e madh – për vajzën e vogël.

6. Formoni dy fjali ku folja *djeg* përdoret një herë në kuptim të parë e një herë në kuptim të figurshëm.

Kuptim i parë - *djeg drutë*, kuptim i figurshëm - *djeg malli*.

7. Shkruani dy kuptime të fjalës *çel* si homonime.

Çel derën, çel lulja.

8. Për fjalën e nënvizuar jepni formën e saj në gjuhën standarde nisur nga konteksti.

avllive – mureve rrethuese

9. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara.

nga – parafjalë, *dhe* – lidhëz, *që* – përemër lidhor

10. Shkruani lakimin e emrit të nënvizuar.

dritat – lakimi III

11. Jepni njëjësin e grupit emëror *raftet e drunjta* - *raft(i) i drunjtë*.

12. Formoni fjali me të dyja format e shumësit të emrit *grykë*.

grykët e sëmura

grykat e maleve

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kujtime nga vendlindja (ora e parë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Vendlindja ime	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca qytetare. 5. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për objekte, vende e ngjarje nga vendlindja e tij. • Analizon modele kujtimesh nga vendlindja për të nxjerrë veçoritë e këtyre lloj shkrimesh. • Krahason fotot me shkrimin rreth të njëjtit vend. • Shkruan vetë rreth një objekti, ngjarje a vendi të rëndësishëm në kujtimet e tij. 		Fjalët kyç: kujtime, objekte, ngjarje, vendlindje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, modele kujtimesh nga burime të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi; Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar me modele, punë e pavarur me shkrim.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Prezantojmë temën dhe rezultatet e të nxënit për të. Pyesim nxënësit për vendlindjet e tyre ose atë të prindërve të tyre duke sjellë ndër mend se çfarë kujtimesh kanë nga vizitat që kanë në këto vende, ngjarje ose objektet që u kanë mbetur në mendje. U drejtohen pyetje të tilla si: <ul style="list-style-type: none"> – Cila është vendlindja juaj? Po e prindërve tuaj? – Ç’ të veçanta ka vendlindja juaj? – Ç’ndjesi ju zgjohen kur shkoni atje? – Si është lidhja juaj me atë vend? – Ç’dini për historinë e vendlindjes suaj? 			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar me modele Nxënësit kthehen në pjesën “Kundërajtori i vjetër”, në të cilin diferencojnë fragmentet që tregojnë kujtimet e autorit nga vendlindja dhe çfarë jepet në to. Krahas pjesës ndalen në fragmentin që shoqëron pamjet nga Gjirokastra dhe bëjnë krahasimin e asaj që shohin e kuptojnë përmes fotos dhe asaj që përcillet përmes shkrimit. Nxënësit tregojnë se cila nga të dyja jep më shumë informacion, cila të emocionon dhe jep më shumë nga kujtimet e poetit. Si e ka përshkruar autori, vetën e përdorur, çfarë përfshin në kujtimet e tij?			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur</i> Nxënësit planifikojnë dhe hedhin mendime të tyre rreth ngjarjeve, vendeve ose objekteve që lidhen me kujtimet e tyre nga vendlindja e tyre ose e prindërve të tyre.			


Vlerësimi: Vlerësim me gojë gjatë analizës së modeleve.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit mund të punojnë me shkrimin e tyre në shtëpi duke marrë informacion nga prindërit e tyre për vende e objekte që lidhen me vendlindjen.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kujtime nga vendlindja (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Vendlindja ime	
Kompetenca: Të shkruarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca qytetare. 5. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Shkruan për kujtime ngjarjesh, vendesh e objektesh nga vendlindja e tij. • Përdor saktë rregullat e drejtshkrimit në kujtimet e tij. • Diskuton për shkrimet e shokëve të tij. 		kujtime, vende, ngjarje, objekte, vendlindje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë a pavarur me shkrim, diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit flasin dhe një herë shkurtimisht për ato ngjarje, vende e objekte që u kanë mbetur në mendje nga vendlindja tyre ose e prindërve. Lexohen detyrat e shtëpisë dhe interpretohen ato nga nxënësit.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur me shkrim</i> Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Nxënësit përfundojnë punën duke e korrigjuar dhe nga ana drejtshkrimore.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>diskutim</i> Bëhet leximi i punimeve të nxënësve dhe më pas diskutimi rreth tyre. U lihet kohë 5 minuta të bëjnë dhe korrigjimet e fundit. Disa nga shkrimet mund të përzgjidhen për turin e galerisë ose qendrën e shkrimeve në klasë a shkollë.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mitrush Kuteli “Unë një e Çuli dy ” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Rrëfenjat dhe ne. Bisedë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2.Kompetenca e të menduarit 6.Kompetenca personale 5.Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon për të kuptuar përmbajtjen. • Dallon elementet fantastikë në rrëfenjë. • Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja. • Përmbledh tregimin me tri fjali. 		Fjalët kyç: fëmijë, lojëra, dëshira, mërgim	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; “Tregime të moçme shqiptare”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, Parashikim me terma paraprakë, lexim zinxhir, Pyetje-përgjigje, Punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja me temat e mëparshme: <i>Bashkëbisedim</i> Zhvillohet një bashkëbisedim rreth rrëfenjave dhe nëse nxënësit kanë dëgjuar rrëfenja apo kanë lexuar të tilla. <ul style="list-style-type: none"> – Ç` karakteristika kanë rrëfenjat? – A keni dëgjuar për shkrimtarin Mitrush Kuteli? – Keni lexuar ndonjë vepër të tij? Bazuar në njohuritë që nxënësit kanë rreth Kutelit, i përgjithësojmë ato duke plotësuar informacionin rreth jetës dhe veprës së tij.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Parashikim me terma paraprakë, Lexim i drejtuar</i> Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë fjalët kyç: <i>lojë, fëmijë, Çuli, Çili, mërgim, familje, nuse, fëmijë, miq,</i> dhe iu kërkohet nxënësve të krijojnë një situatë me këto fjalë. Pas situatave të sjella nga nxënësit, lexohet titulli i pjesës dhe nxënësit krahasojnë situatën e krijuar prej tyre me atë që sjell titulli. Nxënësit lexojnë pjesë-pjesë tekstin dhe parashikojnë ç`mund të ndodhë më pas, duke argumentuar parashikimet e tyre. Gjatë leximit ndalohet në fjalët dhe shprehjet që nxënësit nuk i kuptojnë. I shpjegojmë së bashku duke i përdorur në fjali. Pas leximit punohen ushtrimet 1, 2 të rubrikës <i>Kuptimi dhe mesazhi</i> , për të kuptuar përmbajtjen dhe mesazhin e pjesës.			
3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur</i> Ushtrimi 3. Nxënësit përmbledhin tregimin me tri fjali që lidhen me shokët, lojërat dhe dëshirat e fëmijëve. Diskutohet nga klasa çdo përmbledhje dhe bëhen korrigjimet e duhura.			
Vlerësimi: Mësuesi përgëzon nxënësit për arritjet si dhe jep udhëzimet për orën pasardhëse			
Detyrë shtëpie: U jepet detyrë ushtrimi 8.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mitrush Kuteli “Unë një e Çuli dy ” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Mjedisi ku zhvillohet ngjarja	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen e mjedisin. 5. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh me fjalë se si e mendon ai të ardhmen e tij. • Krahason lojërat e fëmijëve në fragment me lojërat që ata bëjnë. • Gjykon mbi veprimet e personazheve. • Përgjithëson veçoritë e rrëfenjës, si lloj i veçantë i prozës. 		Fjalët kyç: rrëfenja, e ardhmja, lojëra fëmijësh	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; “Tregime të moçme shqiptare”		• Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Lojë imagjinatë, Punë e drejtuar, Diagram Veni, Organizues grafik veçoritë e rrëfenjës</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Bisedë Dy nxënës lexojnë detyrat e shtëpisë. Më pas pyeten nxënësit se cili është mjedisi që vjen përmes këtij fjalor të pasur. Zhvillohet biseda rreth këtij mjedisi dhe njohjes që kanë nxënësit për të.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar, organizues grafik Diagram i Venit			
Përqendrohet vëmendja e nxënësve në krahasimin e lojërave të fëmijëve të fragmentit me veprimet e të rriturve. Plotësohet grafiku me raste të organizimit të familjes, mënyrën e jetesës, marrëdhëniet me të tjerët. Pasi të punohen ushtrimet 5, 6 do të diskutohet <i>Pse lojërat e fëmijëve sjellin dëshirat, hallet e brengat e të rriturve?</i> Ushtrimi 9: Gjeni disa shprehje të tjera që ju bëjnë për të qeshur:			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Organizues grafik veçoritë e rrëfenjës</i> Punohet së bashku me nxënësit për organizuesin grafik, që nxjerr në pah veçoritë e rrëfenjës.			



Vlerësimi: Mësuesi vlerëson arritjet e nxënësve duke vënë në pah pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve.

Detyrë shtëpie: Bëni hartën e personazheve duke argumentuar mendimet e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rëndësia e lojërave		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të folurit		Lojërat që luaj unë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare. 7. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për rëndësinë e lojërave në fëmijëri e çdo moshë. • Liston llojet e lojërave të pëlqyera prej tij. • Argumenton mendimin e tij për lojërat e shëndetshme. • Jep rregullat e disa lojërave që luan ose i pëlqen. 		lojë, e shëndetshme, fizike, elektronike, moshë, rregulla	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Sporte dhe shëndet, Tik dhe teknologji, Bashkëjetesa paqësore, Të drejtat e njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, stuhi mendimi, diskutim, shkrim i lirë			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Bashkëbisedim, stuhi mendimi. Nxënësit përmes bashkëbisedimit ose stuhi mendimi, japin sipas mendimit të tyre kuptimin e fjalës “lojë”, llojeve dhe preferencës së tyre mes lojërave elektronike dhe atyre fizike në përgjithësi.			

2. Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim

Nxënësit diskutojnë me radhë për çështjet që jepen në libër rreth lojërave.

- Nxënësit klasifikojnë llojin e lojërave në momente të ndryshme të fëmijërisë së tyre.
- Cilët janë shokët tuaj të lojës në momente të ndryshme të jetës?
- Çfarë roli kanë lojërat në jetën tuaj?
- Cila lojë ju pëlqen më shumë? Pse?
- Thoni rregullat e saj.
- A ju ka ndodhur të shkelni rregullat e lojës dhe çfarë ka ndodhur në një rast të tillë?
- A ka lojëra që ndahen sipas seksit? Po vajza që luajnë lojëra djemsh dhe anasjelltas?

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Për disa minuta nxënësit mund të bëjnë një ese të shkurtër, ku të japin mendimet e tyre për rëndësinë e lojërave fizike për shëndetin në përgjithësi dhe tek ata vetë në veçanti.

Dëgjohen disa shkrime dhe diskutohet rreth mendimeve që jepen.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.

Detyrë shtëpie: Detyra f. 63

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Foljet gjysmëndihmëse Situata e të nxënës: Fragmenti i dhënë në tekst ku nxënësit		Situata e të nxënës: fragmenti i dhënë në tekst, ku nxënësit dallojnë foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse	
Kompetenca: Njohri për gjuhën - Morfologji			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon folje me kuptim të plotë leksikor; • dallon foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse; • shpjegon funksionet e foljeve ndihmëse dhe atyre gjysmëndihmëse; • krijon fjali me foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse 		Fjalët kyç: folje, kuptim i plotë leksikor, folje ndihmëse, gjysmëndihmëse	
Burimet: teksti shkencor, tabelë e foljeve ndihmëse / gjysmëndihmëse		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë e drejtuar, bisedë e shoqëruar me shpjegim, kllaster, punë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:

Fillohet me një *stuhi mendimi* rreth foljes:

Ç’tregon folja? Në cilin grup të klasave të fjalëve bën pjesë ajo? Cilat janë veçoritë e saj gramatikore?

2. Ndërtimi i njohurive të reja:

Drejtohet vëmendja e nxënësve në fragmentet e dhëna në libër për foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse. Ata dallojnë rastet e përdorimit të së njëjtës folje herë si folje me kuptim të plotë leksikor dhe herë si folje ndihmëse / gjysmëndihmëse. Përmes këtyre shembujve, përkufizohen konceptet: folje ndihmëse dhe gjysmëndihmëse.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Punohen në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, kurse ushtrimet 3, 4 punohen individualisht.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen bazuar në përgjigjet e tyre të sakta dhe pjesëmarrjen aktive.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 5, f. 215.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zgjedhimi jovepror i foljeve në mënyrën dëftore dhe lidhore Kompetenca: Njohri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Diskutim rreth foljeve me të zeza në fragmentin e dhënë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> identifikon foljet në formën joveprore të mënyrës dëftore dhe lidhore; kupton dhe shpjegon formimin e formës joveprore të foljes; zgjedhon foljen në formën joveprore të mënyrës dëftore dhe lidhore. 		Fjalët kyç: folje, formë joveprore, zgjedhim, mënyra dëftore, mënyra lidhore	
Burimet: teksti mësimor, e-libri, tabela e zgjedhimit të foljeve të formës joveprore në mënyrën dëftore dhe lidhore		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, punë dyshe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, organizues grafik</i>			


Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:

Nxënësit diskutojnë në grupe dyshe mbi foljet me të zeza të dhëna në tekst. Nxënësit përpiqen të përcaktojnë vetën, kohën dhe mënyrën e foljeve.

2. Ndërtimin e njohurive të reja:

Bazuar në shembujt e mësipërm, paraqiten përmes organizuesit grafik mënyrat e formimit të formës joveprore të foljes.



Mësuesi vendos tabelën e zgjedhimit të foljes në mënyrën dëftore dhe lidhore të formës joveprore.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrime.

Mësuesi organizon një lojë shpejtësie me nxënësit për të realizuar zgjedhimin e foljes në këto dy mënyra duke kaluar nga njëra vetë në tjetrën, nga njëra kohë në tjetrën. Në këtë lojë përfshihen të gjithë nxënësit sipas bankave. Punohen në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, kurse ushtrimet 3, 4 punohen individualisht.

Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe janë aktivë gjatë orës së mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, fq. 240.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Naum Prifti “Njeriu që ndiqte kuajt” (ora e parë) - tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Bisedë për filmin “Pylli i lirisë”	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Kompetenca personale. 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh mendimin e tij për kalin dhe zbutjen e tij. • Lexon për të kuptuar përmbajtjen. • Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja. • U përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës. • Përmbledh shkurt tregimin. 	<p>Fjalët kyç: Vlashi, njeriu që ndiqte kuajt kalë, garë njeriu kafsha</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; filmi “Pylli i lirisë”, informacione mbi kafshët,</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, kinematografi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, Lexim zinxhir, Punë e drejtuar, Punë e pavarur</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja me temat e mëparshme: <i>Bisedë</i> U vihet nxënësve të shikojnë sekuenca nga filmi “pylli i lirisë”, skenat ku Vlazi ndiqte kalin. Shkëmbehet shkurt informacioni mbi shkrimtarin Naum Prifti, veprën dhe jetën e tij, si dhe veprën nga është shkëputur fragmenti.</p> <p>Bashkëbisedohet për arsyen që e shton Vlazin të ndjekë dhe të zërë kalin në pyll. – Çfarë bën Vlazi në pyll? – Pse do ta zërë kalin?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim në heshtje, Punë e drejtuar.</i> Ndahet klasa në tri grupe dhe i jepet secilit grup të punojë me një nga pyetjet e rubrikës <i>Kuptimi dhe mesazhi</i>. Nxënësit lexojnë tekstin në heshtje dhe nënvizojnë pjesët që u kërkon ushtrimi. Pas kësaj ata duhet t’u japin përgjigje kërkesave dhe të nxjerrin bashkërisht mesazhin e pjesës. Ndërkohë që lexojnë nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk ua dinë kuptimin. Bashkërisht shpjegohen fjalët e reja.</p> <p>3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur</i> Në përfundim të orës së mësimit mund të kërkohet nga nxënësit të thonë ose ta shkruajnë përmbledhtasi përmbajtjen e pjesës.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe realizojnë bukur përmbajtjen.</p> <p>Detyrë shtëpie. Jepet detyra e f.66.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Naum Prifti “Njeriu që ndiqte kuajt” (ora e dytë) - tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Portretizimi i Vlashit, si njohës i mirë i botës së kalit dhe aftësitë e tij.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/jja: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon marrëdhëniet e Vlashit me kalin. • Gjykon mbi gjuhën dhe stilin e përdorur në tekst. • Diskuton për marrëdhënie e njerëzve me kafshët. 		Fjalët kyç: Njeriu Kali Marrëdhëniet	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; foto artistike me kafshë të ndryshme, vizatime, informacione rreth jetës së kafshëve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Edukim figurativ.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Ditarët e të nxënit, Punë e pavarur, Punë e drejtuar</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Diskutim*

U kërkohet nxënësve të diskutojnë për portretin e Vlashit (detyra e shtëpisë) duke nxjerrë në pah aftësitë e tij, si njohës i mirë i botës së kafsh, karakteristikat e kalit dhe marrëdhëniet që vendos ai me të.

Përgëzohen nxënësit për portretizimin e Vlashit dhe për të shprehurit e saktë të ideve të tyre.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar, Ditarët e të nxënit*

– Me anë të ditarit dypjesësh punohen ushtrimet 4, 5, 7, 8, 9. Për të kursyer kohë mund të punohet me grupe. Në këtë etapë të mësimit nxënësit duhet të thellohen në interpretimin dhe vlerësimin e situatave të dhëna në fragment.

Ushtrimi 4.

Pjesë nga teksti	Komenti
Te mori uri, bir ?... Mo s’ki frikë, o bir ,	

Ushtrimi 5

Pjesë nga teksti	Komenti
<i>Kam gruan sëmurë; ditë për ditë po dobësohet</i>	

Ushtrimi 7:

Gjeni në tekst fjalë të tjera të rralla dhe shpjegojini ato. Çfarë ngjyrimesh i japin rrëfimit fjalë të tilla dialektore?

Fjalët e rralla dialektore	Shpjegimi i tyre	Ngjyrimet emocionale

Ushtrimi 8

Pjesë nga teksti - Similituda	Formimi i tyre gjuhësor

Ushtrimi 9:

Analizoni gjuhën e rrëfimit. Përdorimin e:	Shpjegimi Pse përdoren këto mjete gjuhësore?
a. Foljeve b. Mbiemrave Figuracioni a. epitetet b. metaforat	a. b.

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura. Diskutim

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit më aktivë dhe që japin mendime origjinale.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese “Unë mendoj se njerëzit duhet të mbrojnë jetën e kafshëve.”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Vazhdimi i një tregimi (ora e parë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të shkruarit		“Njeriu që ndiqte kuajt”	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Analizon rrjedhën e ngjarjeve në pjesën “Njeriu që ndiqte kuajt”. Plotëson në tekst pyetjet që kanë të bëjnë me vazhdimin e tregimit. Shkruan vetë fundin e tregimit”. 		tregim, pika e lidhjes, zhvillim, mbyllje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; filmi “Pylli i lirisë”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Kinematografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: analizë rasti, punë e drejtuar me modele, punë e pavarur me shkrim, diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *analizë rasti, punë e drejtuar*

Lexohen detyrat e shtëpisë dhe diskutohen ato.

Prezantojmë temën dhe rezultatet e të nxënësve për të dhe u kërkojmë nxënësve, të na thonë elementet e strukturës së një tregimi: hyrje, zhvillim, mbyllje.

Për ilustrim nxënësit i gjejnë këto elemente të strukturës në fragmentin e plotë.

I kthehemi dhe njëherë tregimit “Njeriu që ndiqte kuajt” dhe ndalemi në disa prej pikave të tij, duke u ndalur në: hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit.

Nxënësit tregojnë lidhjen mes hyrjes, **pikës së lidhjes** së fragmentit dhe vazhdimit të tij, cila është ajo pikë që lidh një paragraf me tjetrin kuptimisht duke e pasur si hyrje.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e pavarur me shkrim*

Nxënësit punojnë duke iu përgjigjur pyetjeve, të cilat formojnë skemën për të vazhduar tregimin duke pasur parasysh renditjen e tyre dhe fjalët kyç që i ndihmojnë, f. 67.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Diskutim-vlerësim*

Dëgjohen disa nga punimet e nxënësve, diskutohet për to duke bërë vlerësime ose vërejtjet e duhura sidomos për koherencën mes paragrafëve nga një pyetje te tjetra.

Vlerësimi: Vetëvlerësim e vlerësim me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësve iu lihet për detyrë të vazhdojnë tregimin në shtëpi.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Vazhdimi i një tregimi (ora e dytë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënësve: “Njeriu që ndiqte kuajt”	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; Kompetenca e të menduarit; Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Liston elementet e strukturës së një tregimi. Përcakton rrugën që ndiqet për vazhdimin e një tregimi. Shkruan vazhdimin e pjesës “Njeriu që ndiqte kuajt”. Përdor saktë rregullat e drejtshkrimit. Diskuton për të vlerësuar vazhdimet më të mira. 		Fjalët kyç: hyrje, zhvillim, mbyllje, vazhdim, pjesë.	

Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; filmi “Pylli i lirisë”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kinematografi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, punë a pavarur me shkrim, diskutim</i>	
Organizimi i orës së mësimit	
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i> Kontrollohen detyrat e shtëpisë dhe diskutohen ato. Bëhen krahasime midis vazhdimeve të ndryshme të nxënësve.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja <i>Punë e pavarur me shkrim</i> Nxënësit kontrollojnë punën e nisur. Kjo mund të bëhet dhe në grupe dyshe, kur vetë ata të bëjnë vlerësimin e punës së tyre dhe të shokut. Redaktohen dhe korrigjohen nga ana drejtshkrimore punët e tyre me shkrim.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>diskutim</i> Bëhet leximi dhe më pas diskutimi rreth tyre. Më e mira është të bëhet një vlerësim me gojë, por mund të bëhen dhe vërejtje për të përmirësuar punët e nxënësve.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore Ushtrime për zgjedhimin jovepror të foljeve Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji</p>		<p>Situata e të nxënit: Nxënësit kthejnë foljet e fjalive të dhëna në formën joveprore</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca qytetare 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon formën joveprore të foljeve; kthen foljet nga forma veprorë në joveprore; zgjedhon foljet në formën joveprore. 		<p>Fjalët kyç: folje, formë joveprore, formë veprorë, zgjedhim.</p>	
Burimet: teksti shkencor, tabela e zgjedhimit të foljeve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e pavarur, shkrim i lirë, punë e orientuar, punë në grupe dyshe.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhjen e temës mësimore me njohuritë e mëparshme: punë e pavarur

Nxënësve u jepen disa fjali të cilat shkruhen në tabelë, ku foljet janë në formën veprorë. Ata do t'i kthejnë ato në joveprorë. Nxënësit korrigjojnë njëri-tjetrin në përgjigjet e tyre.

2. Ndërtimin e njohurive të reja: punë e orientuar

Nxënësit, të orientuar nga tabela e zgjedhimit të foljeve, realizojnë zgjedhimin e foljeve në formën veprorë dhe joveprorë.

3. Demonstrimin e rezultateve të arritura

Nxënësit punojnë ushtrimin 1, ku nxënësit përcaktojnë mënyrën e formimit të formës joveprorë. Në ushtrimin 2 dhe 3 nxënësit bashkojnë formën veprorë me formën joveprorë të foljes, duke përcaktuar edhe kohën e tyre dhe mënyrën. Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 4, 5, 6, 7.

Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit bazuar në shprehitë e fituara gjatë orës, duke inkurajuar nxënësit që hasin vështirësi.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 11, f. 220.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Anton Pappleka “Vdekja e lisanajës” (ora e parë) - tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Fëmijëria ime	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. 6. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Shpreh mendimin e tij lidhur me kohën e fëmijërisë. Lexon fragmentin e dhënë për të kuptuar përmbajtjen. Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja. Realizon përmbajtjen e pjesës. 		Fjalët kyç: lisanajë, djaloshi, drurë, lisa, pres, pyll i shkretë, fëmijëria	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; pamje nga vendlindja		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi, Biologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë, Lexim në heshtje, punë e drejtuar, punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Bisedë*

Përmes një bisede nxënësit flasin për fëmijërinë e tyre.

- Si është fëmijëria juaj?
- Çfarë ju pëlqen më shumë të bëni?
- Ç’ju ka ngelur në mendje nga koha kur keni qenë më të vegjël?
- Cilat kanë qenë lojërat që luanit më shpesh?

Vlerësojmë së bashku të shprehurit e nxënësve si dhe idetë e tyre.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Lexim në heshtje*

Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse përmes së cilës prezanton titullin e pjesës dhe autorin e saj.

Nxënësit lexojnë fragmentin e dhënë në heshtje dhe ndërkohë u kërkohet të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja. Shpjegojmë me nxënësit ato duke i përdorur në fjali.

Mund të kërkohet që nxënësit të thonë shkurtimisht përmbajtjen e pjesës.

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, punë me klasën*

Punohen ushtrimet e rubrikës *Kuptimi dhe mesazhi*.

Gjatë punës për zërthimin e përmbajtjes duhet pasur kujdes, që nxënësi të flasë konkretisht për atë që i kërkohet, duke e lidhur ngushtë përgjigjen e tij me ilustrime nga pjesa.

Në përfundim të orës nxënësit shkruajnë përmbajtjen e fragmentit dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit për arritjet duke dalluar nxënësit më të mirë gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Dalloni dhe emërtoni figurat letrare.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Anton Papeka “Vdekja e lisanajës” (ora e dytë) - tekst letrar</p> <p>Kompetenca: Të lexuarit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 4. Kompetenca për jetën, pjesëmarrjen, mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare. 		<p>Situata e të nxënit: Figuracioni i përdorur në fragment</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan fragmentin e dhënë në pjesë, bazuar në kohën kur zhvillohen ngjarjet. • Dallon dhe emërton figurat letrare. • Diskuton rreth botës së bimëve, drurëve dhe rolit që ato kanë në jetën tonë. • Gjen fjalët kyç që përshkruajnë pyllin, besimet e pleqve, ndjesitë e djalit. • Përshkruan ndjesitë e tij për pyllin e lulëzuar dhe atë të shkatërruar. 		<p>Fjalët kyç: Ndjesi, lisanajë, natyrë, e lulëzuar, shkatërruar</p>	

Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; pamje nga zona pyjore	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografi, Biologji
---	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Diskutim, Bisedë, Punë e drejtuar, Punë e pavarur, Punë dyshe*

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja me temat e mëparshme: *diskutim*

Nxënësit diskutojnë rreth figurave letrare të gjetura. I emërtojnë ato dhe verësojnë njëri-tjetrin për saktësinë e tyre.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e drejtuar*

Nxënësit bisedojnë rreth natyrës, drurëve, pemëve dhe rëndësisë që ato kanë.

- Përse janë të rëndësishëm bimët në jetën tonë?
- Ç`rol luajnë ato në natyrë dhe në jetën e përditshme?
- Ç`njohuri keni marrë nga biologjia apo aftësimi teknologjik rreth tyre?

Dëgjojmë mendimet e tyre dhe i vlerësojmë ato.

Nxënësit ndajnë fragmentin në pjesë bazuar në kohën kur zhvillohen ngjarjet.

Bazuar në këto ndarje që kanë bërë, ata përshkruajnë ndjesitë që shoqërojnë secilën pjesë.

3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, ditari i të nxënësve*

Nxënësit punojnë ushtrimet e tekstit, duke u ndalur në fjalët kyçe që realizojnë përshkrimin e lisanjës në dy gjendjet e saj, besimet e pleqve dhe ndjesitë e djalit. Punohen ushtrimet 5, 6, 7.

Ushtrimi 8

Në tregim lisanja jepet me dy pamje të kundërta. Gjeni figurat stilistike me të cilat përshkruhet:

- lisanja e fëmijërisë
- lisanja e kohës së tanishme

Figurat letrare	Lisanja e fëmijërisë	Lisanja e kohës së tanishme
epitete		
krahasime		
metafora		

Ushtrimi 9: Plotësoni fjalët kyçe me anë të të cilave përshkruhet:

Fjala	Fjalët kyçe
Pylli: Besimet e pleqve: Ndjesitë e djalit:	

Ushtrimi 10. Gjeni ndryshimin kuptimor ndërmjet fjalëve:

Dru-ja; një copë dru, send i pajetë.

Shumësi – dru-të

Dru-ri; dru si një qenie e gjallë e pyllit, gjallesë me shpirt.

Shumësi – dru-rët.

Po numri shumësi ndryshon.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e tyre, pjesëmarrjen në mësim dhe përqëndrimin e tyre.

Detyrë shtëpie. Përshkruani ndjesitë tuaja për pyllin e lulëzuar dhe të masakruar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mbrojtja e mjedisit (Poster) Kompetenca: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca qytetare; 6. Kompetenca digjitale; 		Situata e të nxënit: Problemet globale të mjedisit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Liston problemet globale që lidhen me mjedisin. • Ilustron me foto posterash për mjedisin. • Përkufizon posterin si lloj shkrimi. • Ndahen në grupe për të realizuar një poster. • Prezanton një poster realizuar në grup. • Diskuto dhe vlerëson posterat e realizuar nga shokët për të përzgjedhur më të mirët. 		Fjalët kyç: Poster, vizatim, mesazh, digjiturë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; foto posterash për natyrën, materiale rreth problemeve të mjedisit, përvoja të nxënësve, https://www.google.al/search?q=postera+per+mjedisin		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi, Mjedisi Bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Stuhi mendimi, Punë në grupe Diskutim, vëzhgim i modeleve të posterave, Punë e pavarur në grup</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; <i>Bashkëbisedim, stuhi mendimi</i> Përmes bashkëbisedimit u kërkohet nxënësve të listojnë disa nga problemet më të mëdha mjedisore sot. U drejtohen pyetje të tilla, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç’ probleme hasen sot për mjedisin? - Po ne si mund të ndihmojmë për një mjedis sa më të pastër? - Ç’ndjesi ju zgjon një mjedis i pastër dhe një mjedis jo i pastër? - Çfarë e dëmton më shumë mjedisin? <p>Më pas kërkohet të japin mënyra dhe rrugë se si mund të sensibilizohet opinioni publik që të mbrojtë mjedisin. (Postera, veprimtari praktike etj.)</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Diskutim, punë në grupe, punë e pavarur</i> Nxënësit kthehen në tekst dhe përkufizojnë ashtu si e mendojnë posterin si lloj shkrimi për të sensibilizuar rreth një fenomeni, duke përdorur veç fotos, vizatimit dhe një thënie që godet në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë si mesazh.</p>			

U prezantojmë nxënësve disa postera dhe diskutohet shkurtimisht si është dhënë mesazhi përmes tyre. Përmes punës në grup nxënësit përgatitin nga një fletëpalosje për situatat e dhëna në f.72.

<https://www.google.al/search?q=postera+per+mjedisin>

Më pas nxënësit punojnë të pavarur ose në çift për të realizuar një poster.



3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Vëzhgim, Diskutim

Prezantojnë posterat e përfunduar, diskutojnë për vizatimin dhe thënien në to dhe vlerësojnë posterat më të mirë, të cilët ekspozohen në klasë.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur; Detyra, f.. 72 ose përfundohen posterat e nisur.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Markus Zuzak “Hajdutja e librave” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Shkrimi i një tregimi të shkurtër me fjalët kyç	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Shkruan një tregim me fjalët kyçe të dhëna. Lexon fragmentin e dhënë për të kuptuar përmbajtjen. Dallon në fragment kontekstin historik në të cilin janë vendosur ngjarjet, duke i ilustruar nga teksti. Përshkruan bukur personazhin kryesor duke u ndalur në dëshirat dhe marrëdhënien që ka me shokun e saj. 		Fjalët kyç: libër, hajdute, bibliotekë, erë libri, kryetar, dhuratë	

<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacion për Luftën e Dytë botërore</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Parashikim me terma paraprakë, Lexim zinxhir, punë dyshe</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e mësimit me temat e mëparshme: <i>Parashikim me terma paraprakë</i> Nxënësit shkruajnë një tregim të shkurtër me fjalët kyçe të dhëna: <i>bibliotekë, hajdute, dhomë, zonja, erë libri, dhuratë.</i></p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Lexim zinxhir, punë e drejtuar</i> - Lexim zinxhir Lexojmë fragmentin dhe krahasojmë versionet e nxënësve me atë të librit. Pas leximit të tekstit nxënësit përqëndrohen në momentet historike që dalin në fragment, duke dhënë një ide më të plotë rreth tyre bazuar në njohuritë e marra për Luftën e Dytë Botërore.</p> <p>Pyetje rreth të kuptuarit Punohen ushtrimet e rubrikës Kuptimi dhe mesazhi. Ndahet klasa në dy grupe dhe secili punon një nga ushtrimet (1 dhe 2). Ata nënvizojnë në libër: Grupi I – shenjat ku dallohen gjurmët e luftës. Grupi I – dëshirat e Lizelit dhe marrëdhëniet e saj me Rudin.</p> <p>3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: Nxënësit përshkruajnë personazhin kryesor, Lizelin, dhe Rudin. Në varësi të kohës u kërkohet nxënësve të thonë shkurtimisht përmbajtjen e pjesës.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet me gojë, si dhe me shkrim.</p> <p>Detyrë shtëpie: Ese: “Unë dhe librat.”</p>	

<p>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: III</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Markus Zuzak “Hajdutja e librave” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit</p>		<p>Situata e të nxënit: Unë dhe libri. Bisedë</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. 5. Kompetenca personale. 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lexon esenë që ka përgatitur si detyrë shtëpie, ku tregon për marrëdhënien që ka me librat. • Krahason personazhin kryesor, Lizel, me bashkëmoshatarët e tij sot. • Përgjithëson rëndësinë që kanë librat për Lizelin, duke e lidhur këtë me kontekstin historik, në të cilin zhvillohen ngjarjet. 	<p>Fjalët kyç:</p> <p>libri, marrëdhënie me librin, kohë lufte, bashkëmoshatarë</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacione rreth luftës</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Kinematografi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bisedë, Diskutim</i> Zhvillohet një bisedë e shkurtër për dëshirën që kanë nxënësit për të lexuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - A ju pëlqen të lexoni libra? Pse? - Ç`lloj librash ju pëlqejnë më shumë? - A ju ka ndodhur ndonjëherë të vidhni libra, nga dëshira për ta lexuar? <p>Më pas nxënësit lexojnë esetë e shkruara në shtëpi, ku tregojnë për marrëdhëniet e tyre me librin.</p> <p>Evidentohen ato ese ku janë shprehur me origjinalitet marrëdhëniet e lexuesit me librin.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Diskutim, Harta e personazhit, Punë e drejtuar</i> Mësuesi e përqendron vëmendjen e nxënësve te personazhi kryesor, Lizeli, duke bërë krahasimin e saj me bashkëmoshatarët e saj, sot. Ky krahasim bëhet për të evidentuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> -dëshirat e saj -lojërat e saj -marrëdhënien e saj <p>Nxënësit gjykojnë mbi rëndësinë që kanë librat për momentin historik kur zhvillohen ngjarjet (Lufta e Dytë Botërore)</p> <p><i>Harta e personazhit</i> Nxënësit bazuar në punën e mësipërme dhe në fragmentin e dhënë në tekst ndërtojnë hartën e personazhit për Lizelin, duke e argumentuar atë me veprimet e saj.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë e pavarur, punë me klasën</i> Nxënësit punojnë ushtrimet 6, 7, 8, 9, 10, 11</p> <p>Vlerësimi: Mësuesi vlerëson përgjigjet e nxënësve</p> <p>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 12, f.75</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Libri dhe lufta Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënit: Diskutim: Lufta dhe libri	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 2. Kompetenca e të menduarit. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. 6. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Jep mendimin e tij rreth librit dhe luftës. • Lexon fragmentet e dhëna në tekst për të kuptuar përmbajtjen. • Gjykon mbi ngjarje të tilla, si dhe ndjesitë që ato përcjellin. • Jep mendimin e tij se si njerëzit mund të jetojnë në paqe, mes librit dhe diturisë dhe jo dhunës e luftës. 		Fjalët kyç: libër, dituri, luftë, vdekje, shkatërrim	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacione e pamje nga lufta, CD, video-projektor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, diskutim, punë e drejtuar, shkrim i lirë</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bisedë, diskutim,</i> Me video-projektor paraqiten foto bibliotekash me libra dhe përbri fotove, vende të shkatërruara nga lufta. Në këtë kontekst ata diskutojnë rreth këtyre çështjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç`janë librat? - Ç`përfaqësojnë ata? - Ç`përfaqëson lufta? <p>Nxënësit argumentojnë mendimin se si ato (libri dhe lufta) përfaqësojnë dy kahet e kundërta të të njëjtit proces, zhvillimit. Ndërsa libri sjell zhvillim e lumturi te njerëzit, lufta sjell shkatërrim e lot.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Diskutim, Punë e pavarur</i> Nxënësit drejtohen në tekst për të lexuar dy fragmentet e dhëna, për të kuptuar përmbajtjen e tyre. Nxënësit diskutojnë rreth tonit të tekstit, notave plot dhembshuri dhe nostalgji që i përshkojnë ato. Nxënësit diskutojnë rreth idesë se si njerëzit duhet të jetojnë në paqe, mes librit dhe diturisë e jo mes dhunës e luftës. Nxënësit gjithashtu diskutojnë rreth mesazhit të secilit fragment. Për t`u thelluar në përmbajtjen e fragmenteve punohen ushtrimet 1, 2 3, 4 të tekstit.</p>			
<p>3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>organizues grafik</i> LIBRI LUFTA</p>			
Detyrë shtëpie: Shkruajmë një ese “Libri dhe lufta”			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zgjedhimi vepror i foljeve në mënyrën habitore dhe kushtore Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Studimi i fjalëve me të zeza në fragmentin e dhënë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 5. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> identifikon foljet në mënyrën habitore dhe kushtore; përcakton formën e foljeve të dhëna; përdor në fjali folje në formën veprorë të mënyrës habitore dhe kushtore. 		Fjalët kyçe: <i>zgjedhim,</i> <i>forma veprorë,</i> <i>folje,</i> <i>mënyra habitore,</i> <i>mënyra kushtore.</i>	
Burimet: teksti shkencor, tabela e zgjedhimit të foljeve veprorë në mënyrën habitore dhe kushtore		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë dyshe, bisedë e kombinuar me shpjegim, punë e pavarur, kllaster</i>			


Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. *Punë dyshe.*

Nxënësit punojnë në dyshe dhe përcaktojnë mënyrën se si e paraqesin foljet veprimin

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Bisedë e kombinuar me shpjegim*

Nga përfundimet që nxënësit nxjerrin, bashkë me ndihmën e mësuesit, plotësojnë organizuesin grafik lidhur me foljen në mënyrën habitore dhe kushtore.



Orientohet vëmendja e nxënësve te tabela e zgjedhimit të foljeve.

3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. *Ushtrime.*

Mësuesi realizon zgjedhimin e foljeve në këto dy mënyra duke kaluar nga njëri nxënës në tjetrin, në të gjitha kohët dhe vetat. Nxënësit punojnë ushtrimet 1, 2, 3.

Vlerësimi: Vlerësohen përgjigjet e sakta të nxënësve, aktivizimi i tyre dhe inkurajohen nxënësit më pak aktivë.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 4, 5, f. 223.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Zgjedhimi vepror i foljeve në mënyrën dëshirore dhe urdhërore Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Diskutim për foljet dhe kuptimin e tyre	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon foljet në formën veprorë të mënyrës dëshirore dhe urdhërore; zgjedhon foljet në kohët përkatëse të mënyrës dëshirore e urdhërore; kthen foljet nga mënyra dëftore në dëshirore e urdhërore. 		Fjalët kyç: <i>folje,</i> <i>zgjedhim,</i> <i>mënyra dëshirore,</i> <i>mënyra urdhërore,</i> <i>forma veprorë.</i>	
Burimet: Teksti mësimor, e -libri, tabela e zgjedhimit të foljeve në mënyrat dëshirore e urdhërore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim, punë dyshe, mësimdhënie e ndërsjellë, punë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimit:			
1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Diskutim</i> Në fragmentin e dhënë në tekst, nxënësit ndalen te foljet me të zeza duke shpjeguar kuptimin e tyre.			
2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Mësimdhënie e ndërsjellë</i> Duke u bazuar në tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrat dëshirore e urdhërore, përgjithësojmë bashkë me nxënësit mënyrën e formimit të formave foljore të kohëve të këtyre mënyrave.			

<p>Mënyra dëshirore</p> <p>→ E tashmja (punofsha)</p> <p>→ E kryera (paça punuar)</p>
<p>Mënyra urdhërore</p> <p>→ E tashme, veta II njëjës (puno-)</p> <p>→ E tashme, veta II shumës (punoni)</p>
<p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur / punë dyshe.</i></p> <p>Nxënësit punojnë dyshe ushtrimet 1, 2. Tregohet kujdes në ushtrimet 3, 4, ku nxënësit duhet të kthejnë foljet në mënyrën urdhërore, si dhe të krijojnë fjali me këto mënyra në ushtrimin 5.</p>
<p>Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe janë aktivë gjatë orës.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, f. 226</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Renata Velsh “Jakobi ndien si ne” (ora e parë) – tekst letrar</p> <p>Kompetenca: Të lexuarit</p>		<p>Situata e të nxënit: “Jam dhe unë si ti”, montazh me video-projektor</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. Kompetenca personale. Kompetenca qytetare. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Shpreh mendimin e tij rreth njerëzve me aftësi ndryshe. Zbërthen përmbajtjen e pjesës me ndihmën e pyetjeve. Nxjerr temën dhe idenë e pjesës. Ritregon përmbajtjen e fragmentit. 		<p>Fjalët kyç: njeri me aftësi ndryshe, ndien si ne, shoqe, bamireshi, keqardhje, ecim së bashku</p>	
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; CD me foto dhe thënie rreth njerëzve me aftësi ndryshe</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Psikologji</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë, diskutim, punë në dyshe, punë e pavarur, lexim zinxhir</p>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja me temat e mëparshme: *Bisedë*

Përmes video-projektorit shfaqet një montazh për njerëzit me aftësi ndryshe, ku propagandohet mesazhi “Jam dhe unë si ti”. Nxënësit japin mendimet rreth materialit duke e plotësuar atë, nëse është e nevojshme.

Biseda mund të realizohet rreth këtyre pyetjeve:

- Ç’ do të thotë “Njeri me aftësi ndryshe”?
- Çfarë problem mund të kenë njerëz të këtyllë?
- Në ç’ mënyrë duhet të sillemi me ta?

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Lexim zinxhir, Diskutim*

Nxënësit informohen për autorin dhe veprën nga është shkëputur fragmenti dhe më pas lexohet fragmenti nga disa nxënës.

Pas leximit zinxhir, shpjegohen së bashku fjalët e reja dhe shprehjet. Kurse përmes punimit të ushtrimeve 1, 2, 3, 4, 5 nxënësit kuptojnë përmbajtjen, si dhe e ritregojnë atë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Ushtrimi 5. Nxënësit formulojnë temën dhe mesazhin e pjesës, të cilat shkruhen në tabelë. Gjithashtu ritregohet përmbajtja e fragmentit, të cilat i vlerësojmë së bashku.

Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit me aftësi në të shprehur dhe mendimet më origjinale.

Detyrë shtëpie: Shkruaj raste nga përvoja vetjake, lidhur me njerëzit me AK.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Renata Velsh “Jakobi ndien si ne” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Miku im-mbështetja ime	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit; 2. Kompetenca e të menduarit; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin; 5. Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për shokun/shoqen e tij të ngushtë dhe marrëdhënien që ka me të. • Shpjegon qëndrimet që shoqëria mban ndaj njerëzve me aftësi ndryshe. • Komenton fjalë e shprehje nga teksti. • Dallon dialogun, si bazë e tekstit, dhe mënyrën se si ndryshon ai gjatë pjesës. • Gjen elementet e komunikimit në tekst. • Shpjegon përdorimin e drejtpërdrejt ose jo të fjalëve në paragrafin e fundit të tekstit. 		Fjalët kyç: miqësi, mbështetje, mur, brengë, dialog	

Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacione të ndryshme rreth personave me aftësi ndryshe	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Psikologji
--	--

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Bisedë, punë e drejtuar, punë e pavarur, punë dyshe*

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e mësimit me temat e mëparshme: *bisedë*

Nxënësit flasin rreth shoqes ose shokut të ngushtë, duke shpjeguar se ç’do të thotë shoqëria për ta.

- Ç’ është një shok i ngushtë për ty?
- Përse është i nevojshëm ai?
- Kush konsiderohet i tillë?

Dëgjohen me vëmendje përgjigjet e nxënësve dhe përgëzohen për mendimet origjinale.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Diskutim, punë e drejtuar*

Mësuesi/ja drejton vëmendjen e nxënësve në dialogun ndërmjet dy shoqeve për të dalluar tonin e tij gjatë pjesës. Ata tregojnë si ndryshon ai dhe pse, duke ilustruar nga teksti.

Nxënësit vendosin veten në vend të Anës dhe shpjegojnë si do të silleshin ata.

- A vepron saktë Ana?
- A ka të drejtë të mërzhitet ajo?
- A është gabim të jesh i ndryshëm?
- Ç’do t’i thoshit Anës në këtë rast?
- Ç’gjë e ndihmoi Anën për t’ia lehtësuar dhimbjen?

Nxënësit kujtojnë shprehje dhe fjalë të urta rreth miqësisë, duke u ndalur tek:

“Më mirë një mik, se një çiflik”.

Nxënësit gjykojnë rreth saj, duke vlerësuar vërtetësinë e saj, bazuar në përvoja personale.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Ditarët e të nxënit, Diskutim*

Ushtrimi 6

Rastet që Ana ka të drejtë të mërzhitet	Ilustrimet nga teksti
Vëllai ishte me aftësi ndryshe.	
Njerëzit talleshin me të.	
Ana kishte jetuar me shpresë se ai do të shërohej.	
Lea turpërohej po të rrinte me vëllanë e saj.	
Disa njerëz e mëshironin pa të drejtë Jakobi.	

Ushtrimi 8

Brenga e Anës	Ilustrime

Punohen në formë diskutimi ose bashkëbisedimi ushtrimet e tekstit 7, 9, 10, 11, 12, 13

Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe origjinale, duke inkurajuar ata që janë më pak aktivë.

Detyrë shtëpie: Detyra f. 79

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për zgjedhimin vepror në mënyrën habitore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënësve: <i>Përshkrim duke përdorur folje në mënyra të ndryshme</i>	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/jja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon foljet në mënyrën habitore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore; • zgjedhon foljet në këto mënyra; • kthen foljet në kohë dhe mënyra të ndryshme; • krijon fjali me folje të kohëve të ndryshme në këto mënyra. 		Fjalët kyç: folje, zgjedhim, habitore, kushtore, urdhërore, dëshirore	
Burimet: teksti mësimor, e-libri, tabela e zgjedhimit të foljeve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e pavarur, shkrim i lirë, punë e orientuar, punë dyshe.</i>			
Organizimi i orës së mësimin			
1. Lidhja e temës mësimore me njohuritë e mëparshme: <i>punë e pavarur</i> Nxënësit realizojnë një përshkrim duke përdorur folje të këtyre mënyrave. Identifikojnë foljet, përcaktojnë kohën dhe mënyrën e tyre.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e orientuar</i> Nxënësit realizojnë tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrën dëshirore, habitore, kushtore dhe urdhërore. Ata ndihmohen nga mësuesi kur është e nevojshme, si dhe nga vetë nxënësit.			
3. Demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Punë në dyshe</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimet 1, 2, ndërsa me ushtrimin 3, 4, nxënësit shkathtësohen në përcaktimin e kohëve të foljeve, si dhe në kthimin e foljeve nga një kohë në tjetrën. Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 5, 6, 7, 8.			
Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit bazuar në shprehitë e fituara gjatë orës, duke inkurajuar nxënësit që hasin vështirësi.			
Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 9, 10, f. 228 (nxënësit mund të zgjedhin alternativën që dëshirojnë).			

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Format e pashtjelluara të foljes		Situata e të nxënësve: <i>Fragmenti i dhënë në tekst</i>	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin 6. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> identifikon format e pashtjelluara të foljes në fjali; shpjegon funksionin që ato kanë në fjali; përcakton dhe shpjegon ndërtimin e tyre; përdor në fjali forma të pashtjelluara. 		formë e pashtjelluar, folje, pjesore, përcjellore, mohore, paskajore	
Burimet: teksti mësimor, e-libri,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë në grupe dyshe, bisedë e kombinuar me shpjegim, punë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë në grupe dysh</i> Nxënësit përqendrohen te fjalët me të zeza në fragmentin e dhënë. Ata përpiqen të ndryshojnë kohën, vetën, numrin e tyre. Cilat janë përfundimet që ata arrijnë?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>bisedë e kombinuar me shpjegim</i> Nisur nga përfundimet që nxënësit arrijnë përmes shembujve, përgjithësojmë bashkë me nxënësit përkufizimin e formave të pashtjelluara. I paraqesim më pas ato grafikisht në tabelë.</p> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 15px; padding: 5px; margin-right: 10px;">Format e pashtjelluara</div> <div style="display: flex; flex-direction: column; gap: 5px;"> <div>→ Pjesore (<i>punuar</i>)</div> <div>→ Paskajore (<i>për të punuar</i>)</div> <div>→ Përcjellore (<i>duke punuar</i>)</div> <div>→ Mohore (<i>pa punuar</i>)</div> <div>→ Forma e tipit <i>me të</i> (<i>me të punuar</i>)</div> </div> </div> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Ushtrime.</i></p> <p>Vlerësimi: Sipas planifikimit të mësuesit.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, f. 231.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjuha e ndjesive Kompetenca: Të dëgjuarit		Situata e të nxënit: Kënga e zogjve, dritare për të parë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca personale; 6. Kompetenca digjitale;			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon për të nxjerrë informacionin kryesor nga ajo që dëgjon. • Nxjerr informacionin kryesor që lidhet me shqisat nga materiali në DVD. • Përgjigjet për pyetje rreth të kuptuarit të tekstit të dëgjuar. 		Fjalët kyç: këngë, zogj, shqisa, shikim, prekje, ndjenja, vajzë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Vendimmarrja morale	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar, shkrim i lirë, Dëgjim i materialeve në DVD, Diskutim, Pyetje-përgjigje, Imagjinatë e drejtuar, Shkrim i lirë.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar, shkrim i lirë</i> Nxënësve u kërkohet të imagjinojnë sikur u mungon shqisa e të parit dhe të bëjnë një shkrim të shkurtër sesi do ta eksploronin botë përmes shqisave të tjera. Lexohen krijimet dhe diskutohen mendimet më interesante.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Dëgjim i materialeve në DVD, Diskutim</i> U vendosim nxënësve të dëgjojnë materialin në DVD për të nxjerrë informacionin kryesor rreth tij. Pyesim nxënësit për detaje nga teksti që lidhen me të dëgjuarit dhe vëmendjen. Mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje për të kuptuarit e asaj që dëgjoji.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ç’ tregohej në këtë pjesë? - Ç’ mësojmë ne për Gertrudën? - Pse autori e fillon pjesën me fjalinë: <i>Universi i saj i errët kufizohej nga muret e asaj dhome....</i> - Ç’ përfaqësonte kënga e zogjve për Gertrudën? - Pse autori e titullon pjesën “Gjuha e ndjesive”? - Ç’ tregon kjo pjesë për ne? <p>Përgjigjet e mundshme për pyetjet: Gertruda nuk shikonte, ndaj mësoi t’i njihje gjërat përmes;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të prekurit duke kuptuar të ngrohtët, të ftohtët, të vakët etj.; • tingujve e këngës së zogjve; • veprimeve, si lëvizjeve, shtrirjes, lidhjes etj. 			

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur

- Cila është shqisa që nuk e hasëm në tekst, por është shumë e rëndësishme për të njohur dhe eksploruar botën? (Të nuhaturit, përmes saj mund të mësojmë shijen e gjërave.)
- Ç’mendim keni për Getrudën në fillim dhe më pas duke njohur botën?
- Çfarë mesazhi na përcjell ajo? (Njeriu pavarësisht gjërave që nuk mund t’i ketë, duhet ta eksplorojë dhe të jetë pjesë e botës duke e shijuar me sa mundet jetën.)

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Vazhdojeni tregimin, por në zhvillimin e tij duke ruajtur linjën e tregimit në lidhje me shqisën e të nuhaturit të ushqimeve, luleve, aromës së tokës etj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përshkruajmë “Katër Stinët” e Vivaldit Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: “Koncerti i pranverës” Vivaldi	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon “Koncertin e Pranverës” Vivaldit për të zbërthyer tingujt me fjalë. • Shkruan përshtypjet ndjesitë e tij gjatë dëgjimit të koncertit. • Diskuton rreth përshkrimeve të shokëve të tij për t’i vlerësuar ato. 		Fjalët kyç: Shqisat, të dëgjuarit, të vështruarit, të nuhaturit, të prekurit, të shijuarit	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; “Katër stinët” e Vivaldit, përvoja të nxënësve , https://www.youtube.com/watch?v=GRxofEmo3H		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Muzikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, Dëgjim i Koncertit të Vivaldit, Punë e pavarur me shkrim, Diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Bashkëbisedim*

Përmes një bashkëbisedimi nxënësit flasin shkurtimisht rreth muzikës së dëgjuar dhe tregojnë pse u pëlqen muzika. Në veçanti u kërkohet të japin për ndjesitë që u shkakton dëgjimi i muzikës klasike.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Dëgjim i Koncertit të Vivaldit, Punë e pavarur me shkrim*

Mësuesi/ja vë në video-projektor (ose thjesht në dëgjim me DVD), “Koncertin e Pranverës” së Vivaldit bashkë me pamjet që e shoqërojnë. Nxënësve u kërkohet të japin ndjesitë e tyre kur dëgjojnë fragmentin, çfarë tingujsh, zhurmash, vijnë nga tingujt dhe ndjesi të tjera të përjetuara përmes të gjitha shqisave. Bëhet një përshkrim sipas përjetimeve të shqisave sipas faqes 81.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Diskutim*

Lexohen shkrimet e nxënësve dhe diskutohet rreth tyre. Nxënësit mund të vlerësojnë shkrimet më të mira.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nëse shkrimet nuk kanë përfunduar mund të përfundojnë në shtëpi.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lë Klezio “Letër babait” (ora e parë) - tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Bisedë: <i>Shkolla ime</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Shpreh mendimin e tij rreth shkollës dhe ndjesive lidhur me të. Kupton përmbajtjen e fragmentit përmes leximit të pjesës. Përshkruan vendet ku shkon vajza, personazhi kryesor. Përmbledh me disa fjali përmbajtjen e fragmentit. 		Fjalët kyç: mol, ujë, zhytem, dëshirë, letër, baba, mungesë, burg	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; informacion rreth autorit Lë Klezio		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Psikologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Lexim zinxhir, Punë e pavarur, Punë dyshe</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e mësimit me temat e mëparshme: *Bashkëbisedim*

Nxënësit diskutojnë rreth shkollës dhe gjithçka që lidhet me të:

- Ç’do të thotë shkollë për ju?
- Ç’përfaqëson ajo?
- Ç’ndjesi përjetoni aty?
- A e shikoni si një vend që të mërzitshëm e të lodhshëm apo si një vend argëtues e ndihmues, që ju ngjall konfidencë personale, aftësi të ndryshme?
-

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Lexim zinxhir*

Mësuesi/ja zhvillon një bisedë hyrëse në të cilën prezanton titullin e pjesës dhe autorin e saj. Nxënësit informohen rreth jetës dhe veprës së autorit Lë Klezio dhe më pas njihen me përmbajtjen e fragmentit përmes tre nxënësve që realizojnë leximin e tij.

Për të zbërthyer përmbajtjen e pjesës, punohen ushtrimet e rubrikës *Kuptimi dhe mesazhi*. Drejtohet vëmendja e nxënësve në përshkrimin e vendeve ku vajza është, duke dhënë detaje lidhur me plazhin (molin), si dhe shkollën, gjërat që ajo do etj. Kjo punë realizohet në dyshe dhe më pas dëgjohen mendimet e tyre dhe bëhen plotësime.

Ushtrimi 2 kërkon që nxënësit të përmbledhin me katër fjali, siç shkruhen në një letër të zakonshme, fjalët që i shkruan vajza babait.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Nxënësit duhet të realizojnë përmbajtjen e fragmentit me shkrim.

Ushtrimi 3 i orienton se si të ritregohet letra duke u mbështetur në katër fjalitë e krijuara, të cilat shërbejnë si pika plani për të të treguar më hollësisht përmbajtjen.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe të shprehura bukur.

Detyrë shtëpie. Jepet detyra e tekstit, f. 84, e cila i parapërgatit nxënësit për të zbërthyer e interpretuar pjesën.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lë Klezio “Letër babait” (ora e dytë) - tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënët: Bisedë. Kur keni ndier nevojën t’i shkruani një letër babait dhe pse?	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin. 5. Kompetenca personale. 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon arsye që mund t'i jetë mërzitur shkolla. • Shpjegon pse vajza ndihej në atë mënyrë sipas mendimit të tij. • Tregon përvoja personale se si i kalon ai momentet e vështira në jetën e tij. • Gjykon mbi gjuhën dhe stilin e shkrimit. 	<p>Fjalët kyç: letër, babai, momente të vështira, ndjenja</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Psikologji</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, Diskutim, Punë dyshe, Punë e pavarur</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Diskutim</i> Kontrolli i detyrave të shtëpisë Dy-tre nxënës lexojnë detyrat e shtëpisë, të cilat ndihmojnë për të hapur një diskutim për arsyet pse ndonjëherë mund të ndihen keq në shkollë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kur keni ndier nevojën t'i shkruani një letër babait dhe pse? - Nëse nuk e kanë realizuar, por e kanë pasur në mendje, ç'do t'i thoshin? <p>Gjykojmë së bashku për mënyrën e të shprehurit.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Diskutim, Punë dyshe, organizues grafik</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshe për të nxjerrë në pah gjendjen shpirtërore të vajzës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - momenti në mol - gjendja në shkollë - ekzistenca e shumë dëshirave që ka ajo. <p>Nxënësit diskutojnë rreth tyre, duke marrë detaje dhe nga teksti. Nxënësit shpjegojnë sipas mendimit të tyre përse vajza ndihej në këtë mënyrë. Ç'i mungonte asaj? Nxënësit japin përvoja personale lidhur me si i kapërcejnë ata momentet e vështira në jetën e tyre. Punohen ushtrimet 4, 5, 6, 7.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ushtrimi 8, 9. Nxënësit gjykojnë për stilin e të shkruarit të letrës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me kë ngjason më shumë, prozë apo poezi? - Përse nuk ka një rregullsi në rendin e të shkruarit? <p>Vlerësimi: Përgëzohen nxënësit që japin përgjigje të sakta e të formuluar mirë.</p> <p>Detyrë shtëpie: Gjeni fjalët kyç që pasqyrojnë gjendjen shpirtërore të vajzës brenda mureve të shkollës dhe jashtë saj.</p>	

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për format e pashtjelluara Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Tekst i dhënë ku nxënësit nënvizojnë format e pashtjelluara dhe foljet.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin 4. Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: • dallon format e pashtjelluara në fjali; • shpjegon funksionin që ato kanë në fjali; • përdor format e pashtjelluara në fjali.		Fjalët kyç: formë e pashtjelluar, paskajore, pjesore, përcjellore, mohore	
Burimet: teksti shkencor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e pavarur, ushtrime, punë dyshe.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit rikujtojnë njohuritë rreth formave të pashtjelluara: Ç’janë format e pashtjelluara? Si formohen ato? Ç’funksione kanë ato?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në grupe dyshe</i> Nxënësit përqendrohen në ushtrimin 1 në tekst, duke punuar në grupe dyshe, ata dallojnë format e pashtjelluara të foljes dhe ato të shtjelluara. Emërtojnë format e pashtjelluara dhe shpjegojnë si formohen ato.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Ushtrime</i> Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 2, 3, 4, 5, 6, 7.</p> <p>Vlerësimi: mësuesi përgëzon nxënësit aktivë dhe inkurajon nxënësit më pak aktivë.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 9, 10, f. 233 (nxënësit zgjedhin alternativën e dëshiruar).</p>			

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lidhëzat dhe llojet e tyre Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Morfologji		Situata e të nxënit: Fragmenti i dhënë në tekst	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon lidhëzat në fjali; shpjegon funksionin e lidhëzave në fjali; dallon lidhëzat sipas marrëdhënieve që krijojnë; dallon lidhëzat sipas formimit të tyre. 		Fjalët kyç: lidhëzat, lidh, gjymtyrë, pjesë fjalie lidhëzat bashkërenditëse lidhëzat nënrenditëse	

Burimet: teksti shkencor, tabela e lidhëzave	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimi, punë në grupe dyshe, mbajtja e strukturuar e shënimeve, punë e pavarur.	

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*


Nxënësit rikujtojnë njohuritë që kanë marrë për lidhëzat.

- Ç’janë lidhëzat?
- Cili është funksioni i tyre?
- Sa llojesh janë ato?

Nxënësit udhëzohen të punojnë me fragmentin e dhënë ku dallojnë lidhëzat, llojin e tyre.

2. Ndërtimin e njohurive të reja: *Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Vendos tabelën e lidhëzave përpara nxënësve dhe, duke përgjithësuar njohuritë mbi bazën e fjalive të dhëna në tekst, synojmë të zbulojmë bashkë me nxënësit marrëdhëniet që krijojnë lidhëzat mes pjesëve.



3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrime

Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet 1 dhe 2 për të dalluar lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse. Në ushtrimin 3 ata dallojnë kur ato lidhin dy gjymtyrë dhe kur lidhin dy pjesë të një fjalie të përbërë. Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 4, 5, 6.

Vlerësimi: vlerësohen nxënësit që japin përgjigje të sakta dhe aktivizohen gjatë orës.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 7, f. 236.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Letra personale dhe zyrtare Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënësve: Letër një miku a shoku, që ndodhet larg.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Liston karakteristikat e letrës personale. • Shkruan një letër personale. • Diskuton rreth letrave të shkruara nga shokët e tij. 		Fjalët kyç: letër personale, letër zyrtare, strukturë.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Informatikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Punë e drejtuar me modele, Diskutim, Punë e pavarur.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim, punë e drejtuar me modele.</i> Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për vendin që zë në jetën e tyre, komunikimi me letra dhe mendimi që ata kanë për këtë lloj komunikimi, duke u nisur dhe nga përvojat e prindërve të tyre. U drejtohen pyetje të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A komunikoni me letra me njëri-tjetrin? - Çfarë dhe kujt i shkruani më shpesh? - Si ka ndryshuar komunikimi në ditët e sotme? - Cilat mjete të teknologjisë i kanë zëvendësuar letrat? - Ç’ ndryshim ka midis një letre të shkruar me dorë dhe një e-maili? <p>Nxënësit orientohen për të punuar me letrën shembull në tekst që të nxjerrin karakteristikat e letrës personale në çdo element të strukturës së saj.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur me shkrim</i> Nxënësit listojnë elementet e strukturës së letrës personale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Data (kujdes drejtshkrimin dhe mënyrën e shkrimit të saj). • Personi të cilin i drejtohet letra dhe mënyra si i drejtohem (në letrën personale i drejtohet i/e dashur..., në letrën zyrtare: <i>I nderuari z/znj..., I respektuari z/znj...</i>). • Hyrja, që nënkupton përshëndetjen e zakonshme. • Zhvillimi përmban atë për të cilën duam të shkruajmë. • Përfundimi që lidhet me përshëndetjen përmbyllëse. • Autori apo ai, që shkruan letrën. 			

Në letrën personale mund të përdorim shprehje emocionale dhe një gjuhë të përditshme.
Duke iu referuar modelit nxënësit punojnë për t'i shkruar një letër një shoku a miku të ngushtë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Nxënësit lexojnë letrat, që shkruan dhe diskutojnë për mënyrën se si u janë përmbajtur karakteristikave.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë së bashku me letrën zyrtare.

Detyrë shtëpie: Shkruajini një letër një personi që e keni idhull.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Letra zyrtare Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënët: Letër drejtuar Drejtorit të shkollës ose Kryetarit të Bashkisë	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca qytetare. 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Liston karakteristikat e letrës zyrtare. • Përcakton rregullat në shkrimin e një letre zyrtare. • Shkruan një letër zyrtare për një problem mjedisor. • Diskuton rreth letrave të shkruara nga shokët e tij. 		Fjalët kyç: letër zyrtare, strukturë.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, modele letrash zyrtare		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Informatikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e drejtuar me modele, punë e pavarur me shkrim, diskutim, Diagrami i Venit			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Punë e drejtuar me modele, diskutim*

Lexohen dhe diskutohen detyrat e shtëpisë.

Nxënësit flasin për përdorimin dhe njohuritë që kanë rreth letrave zyrtare duke bërë dallimin e tyre me letrën personale. Punohet me modelin e letrës në tekst ose me modele letrash zyrtare që nxënësit kanë gjetur për të nxjerrë karakteristikat e kësaj lloji letrë.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e pavarur me shkrim*

Nxënësit pasi listojnë karakteristikat e letrës zyrtare, shkruajnë një letër zyrtare.

Letra zyrtare i drejtohet një zyrtari, një institucioni, kompanie etj.

- Data sipas rregullave të drejtshkrimit, shkruhet në të djathtë të letrës zyrtare, në krye të saj.
- Kujt i drejtohet letra me mënyrën se si i drejtohet (i/e nderuar zoti/zonja...).
- Pjesa hyrëse përmban prezantimin e shkurtër, por të qartë të dërguesit të letrës.
- Zhvillimi, që ka shkurtimisht qëllimin e shkrimit të letrës pa kaluar në tema të tjera.
- Përfundimi, që përmban përgjigjen e pritshme dhe të dhëna për të komunikuar.
- Drejtuesi i letrës në formën me respekt.....

Nxënësit shkruajnë një letër zyrtare drejtuar një punonjësi të bashkisë për një problem mjedisor që ata kanë si shqetësim.


3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Diskutim, Diagrami i Venit*

Nxënësit lexojnë dhe vlerësojnë sipas rregullave, që nxjerrin shkrimin e letrës zyrtare.

Përmes Diagramit të Venit bëjnë dallimin midis letrës personale dhe letrës zyrtare.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë së bashku me letrën personale.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Dagmar Hoshtfeld “Koni, miqtë dhe ethet e festës” (ora e parë) – tekst letrar</p> <p>Kompetenca: Të lexuarit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare. 		<p>Situata e të nxënit: Punë me tekstin</p>	

Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon pjesën për të kuptuar përmbajtjen e pjesës. • Diskuton për mënyrën e komunikimit të bashkëmoshatarëve të tij në jetën shkollë. • Gjykon, propozimet dhe vendimet e marra në grup duke argumentuar mendimin e tij. • Punon në grup për të organizuar një festë në shkollë. 	Fjalët kyç: Koni, shokët, festë, shkollë, propozim, vendim.
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Vendimmarrja, Të drejtat e njeriut.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, lexim zinxhir, punë e pavarur, stuhi mendimi, karrige e nxehtë.</i>	
Organizimi i orës së mësimit	
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Pyesim nxënësit nëse kanë organizuar ndonjëherë festa në shkollë dhe si ia kanë dalë për këtë. Dëgjojen me vëmendje përgjigjet e tyre duke u kërkuar të argumentojnë se si ia kanë arritur ose nëse nuk kanë mundur, pse nuk e kanë realizuar dot një festë në shkollë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja; Lexim zinxhir Bëjmë prezantimin e temës, titullit të pjesës dhe autorit. Një orë më parë u kemi kërkuar nxënësve të gjejnë informacion duke përkthyer ose nëse kanë pasur mundësi të lexojnë vepra të autores, të flasin për ato që dinë rreth saj. Nëse nuk ka informacion nga nxënësit u sigurojmë atyre këtë informacion rreth saj.</p>	
	Dagmar Hoshtfeld lindur më 1960 në Këln të Gjermanisë ku dhe jeton sot në fshat të vogël. Fillimisht ajo ka dashur të bëhet veterinere, por kur djali i saj mbushi gjashtë muaj, ajo filloi të shkruante libra për fëmijë e të rinj, që mbartin humor dhe aventura. Ajo njihet me seritë “Conni & Co”, “Carlotta”, romanet me fantazi “Kristin dhe Unicorn” etj.
Kalojmë në leximin zinxhir të pjesës, nga dy ose tre nxënës, të cilëve u kërkohet të lexojnë rrjedhshëm, në mënyrë të kuptueshme dhe të vetëdijshme, të përdorin intonacionin e duhur në dialogë dhe të respektojnë shenjat e pikiësimit. Ndërkohë nxënësit veçojnë fjalë e shprehje të cilat nuk ua dinë kuptimin dhe në përfundim të leximit të pjesës i shpjegojmë ato së bashku.	
Punohet Ushtrimi 1 i rubrikës <i>Kuptimi dhe mesazhi</i> . <ul style="list-style-type: none"> • Kujdestarët – Filipi dhe Laura • Vendimi që u mor – të krijohet një disko • Alternativat e propozuara – piceri, kampionat me gjuajtje të lira në portë, internet - kafe, • Argumentet pro propozimeve – pjekja dhe shitja e picave duket e realizueshme dhe fitimprurëse 	

për një festë, gjuajtjet e lira në portë në trajtën e një kampionati, kompjuterat e nxënësve dhe interneti si një mundësi realizimi për internet-kafe.

- **Argumente kundër propozimeve** – disave nuk u pëlqen futboli, internet-kafe ishte e vështirë të realizohej për shkak të amortizimit të rrjetit elektrik dhe me shumicë votash fiton “Disko”

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Punë e pavarur, diskutim, karrige e nxehtë.*

Pasi nxënësit kanë përmbledhur shkurtimisht tematikën e pjesës, paraqesin punën e bërë për zgjidhjen e ushtrimit 1.

Në këtë rubrikë mund të ngremë disa nxënës në rolet e nxënësve që bënë propozimet duke i realizuar ato në vetën e parë.

Kështu një ose dhe dy nxënës për rol japin propozimet një nga një duke argumentuar pse dhe me fantazinë e tyre. Kështu dikush mund të thotë unë propozoj “Piceri”, sepse mund t’i realizojmë dhe me produkte gjysmë të gatshme, se një festë që shpenzon energji kërkon t’i zëvendësojë ato. Pranoen alternativa të ndryshme nga nxënësit edhe për kampionatin e gjuajtjeve, internet kafenë dhe disko.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Dhënies së detyrës i lihet një kohë e mjaftueshme për të bërë ndarjen në grupe të klasës dhe realizimin e një projekti për të realizuar një festë në shkollë ose klasë. Projekti mund të realizohet në të gjitha paralelet ku secila klasë vendos për atë që do të realizojë dhe mund të realizohet në një nga ditët e veçanta si; festa e Ditës së Verës ose 1 Qershorit.

Nxënësve u lihet detyrë të sjellin propozime duke argumentuar përzgjedhjet e tyre dhe si mendojnë të shpenzojnë fitimet që do të nxirren nga festa.

Kjo detyrë do vazhdojë për t’u realizuar si projekt dhe të lexohet në rubrikën “ Të flasim”, “Marrëveshja në grup”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Dagmar Hoshtfeld “Koni, miqtë dhe ethet e festës” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënësve: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare. 			

<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton rreth pjesës duke argumentuar përzgjedhjet dhe kundërshtitë e tij. • Përcakton mënyrën e realizimit të marrëveshjes në grup. • Argumenton propozimin e tij për një festë në shkollë. • Punon në grup për një projekt feste në shkollë. • Gjen përdorime të figurshme të fjalës. • Shpjegon kuptimin e shprehjeve të figurshme në tekst. • Analizon gjuhën e përdorur dhe mënyrën e realizimit të një liste. 	<p>Fjalët kyç:</p> <p>Koni, miqtë e saj, propozime, argumente, vendime, listë, festë.</p>				
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Vendimmarrja Të drejtat e njeriut</p>				
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje-përgjigje rreth pjesës, diskutim, punë e pavarur, punë në grup.</p>					
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Pyetje-përgjigje rreth pjesës,</i></p> <p>Nxënësit flasin për tematikën e pjesës dhe ndihmohen me disa pyetje për të parë të kuptuarit e pjesës.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet? (Në shkollë, në një klasë të shtatë gjatë orës së lirë të mëngjesit.) – Për çfarë po diskutonin nxënësit? (Për organizimin e festës së shkollës.) – Çfarë kishin organizuar disa nga paralelet e tjera të shkollës? (Ndërtimin e një treni fantazmash, fushë minigolfi, përgatitjen e piteve me fruta dhe kekëve me çokollatë). – Për çfarë do të shkonin kursimet dhe paratë që do të mblihdeshin? – (Kursimet do të shkojnë në arkën e klasës, për rregullimin e saj dhe të tjera qëllime pozitive.) – Pse diskutimi mes nxënësve ishte i këndshëm dhe i mundimshëm? – (Sepse shprehën dëshirat e tyre, por i mundimshëm, sepse nuk mund të bihej dakord lehtë mes tyre.) – A u morën vesh mes tyre nxënësit? Pse? <p>Fillimisht jo, sepse disa nga propozimet e para nuk mund të realizoheshin: se nuk përfshinin dëshirat e gjithkujt (minikampionati i futbollit); për shkak të kushteve teknike (vjetrimi i rrjetit elektrik për një internet-kafe). Më në fund vendosën për të organizuar një disko, sepse kjo fitoi shumicën e votave. Pra, vendimi u mor në një votim të lirë, frymë mirëkuptimi dhe tolerance për mendimet e të tjerëve në organizimin e bashkëjetesë në grup.</p> <p>Përmes <i>rrjetit të diskutimit</i> u kërkohet nxënësve të mbështesin dhe argumentojnë mendimin e tyre për vendimin që u mor për të realizuar një disko. Nxënësit japin argumentet e tyre pro dhe kundër këtij vendimi.</p> <p>2.Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur, ditarët e të nxënësve, analizë teksti.</i></p> <p>Nxënësit rikthehen në tekst për të gjetur përdorimet e figurshme të fjalës.</p> <table border="1" data-bbox="175 1789 1420 1972"> <tr> <td>Përdorimet e figurshme</td> <td>Figura letrare</td> </tr> <tr> <td>duhet të ngrëjë këmbë diçka, ndrydhi një ofshamë një fytyrë të menduar sikur trupi i saj po prodhonte re të vogla tymi</td> <td>Metaforë Metaforë Epitet metaforik Similitudë</td> </tr> </table>		Përdorimet e figurshme	Figura letrare	duhet të ngrëjë këmbë diçka, ndrydhi një ofshamë një fytyrë të menduar sikur trupi i saj po prodhonte re të vogla tymi	Metaforë Metaforë Epitet metaforik Similitudë
Përdorimet e figurshme	Figura letrare				
duhet të ngrëjë këmbë diçka, ndrydhi një ofshamë një fytyrë të menduar sikur trupi i saj po prodhonte re të vogla tymi	Metaforë Metaforë Epitet metaforik Similitudë				

Mund të përdoret dhe *ditari dypjesësh* për të realizuar detyrën.

Fragmenti	Komenti
Secila klasë duhet të ngrejë këmbë diçka.	Të propozojë, të organizojë dhe të realizojë diçka.
Me zor ndrydhi një ofshamë.	U përpoq të mos shfaqte shqetësimin dhe pakënaqësinë e saj.
Bëri një fytyrë të menduar.	Shprehu hezitim, pakënaqësi
Kur shikimet e tyre u takuan.	U panë sy më sy, tregon për mënyrën se si kuptoheshin miqësinë e ngushtë etj.
Koni pati ndjesinë sikur trupi i saj po prodhonte re të vogla tymi.	Pas kalimit të situatës së zjarrtë të diskutimeve, Koni ndihej e lodhur, e preokupuar për të realizuar projektin e nisur.
Diskutimi ishte i këndshëm, por dhe shumë i mundimshëm.	I këndshëm, sepse gjithkush mund të shprehte dëshira të realizueshme ose jo, por i mundimshëm, sepse duhej të arrihej në një vendim të kënaqshëm për të gjithë.
Ethet e festës ishin qetësuar.	Tashmë Koni kishte filluar të qetësohej nga zhurma dhe nderzja e diskutimit dhe ishte më e kthjellët për të menduar hollësi të realizimit të festës.
Ndukte stilolapsin dhe vriste mendjen.	Shqetësimi i konit vazhdon. Gjatë bërjes së listës ajo përpiqet të mos ketë asnjë mangësi, se prej saj varej realizimi me sukses i festës.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Diskutim*

Nxënësit bëjnë analizën e dialogut mes fëmijëve duke dallur gjuhën e jetës së përditshme dhe kur është me nënkuptime. (Pjesa më e madhe janë si në jetën e përditshme, ndërkohë që me nënkuptime janë diskutimi mes Paulit dhe Anës, Konit dhe Filipit.)

Karakteristike për një diskutim në grup janë mënyra e propozimit të kujdestarëve, pjesa gjatë votimit dhe marrjes së vendimit.

Në përfundim lexohet detyra e shtëpisë duke lënë kohë të mjaftueshme për vazhdimin e kërkesës së saj, e cila do të finalizohet gjatë rubrikës “Të flasim”.

Secili nxënës argumenton propozimin e tij për atë që do të bëjë në një festë të shkollës. Propozimet hidhen në votë dhe fiton propozimi me më shumë vota.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë sipas pjesëmarrjes së nxënësve gjatë të dy orëve, por ky vlerësim me notë mund të finalizohet duke iu bashkangjitur realizimit të orës “Të flasim”.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit ndahen në grupe për të marrë përsipër detyrat e tyre dhe listojnë atë që do të bëjnë për festën.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lidhëzat nënrenditëse Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Morfologji		Situata e të nxënit: Nxënësit ndërtojnë me kutizat përkufizimin për lidhëzat.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon lidhëzat nënrenditëse • Përcakton llojin e marrëdhënieve që ato vendosin • Përcakton llojin e tyre në bazë të kuptimit • Formon fjali me lidhëza nënrenditëse 		Fjalët kyç: Lidhëza, lidhëza nënrenditëse, marrëdhënie varësie, fjali e përbërë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; tabela e lidhëzave		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Edukatë shoqërore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë në dyshe, punë me klasën, organizues grafik, mësimdhënie e ndërsjellë, punë e pavarur, punë në dyshe</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës mësimore me njohuritë e mëparshme: <i>punë në dyshe, punë me klasën,</i> Nxënësit bashkojnë kutizat e duhura për të formuar përkufizimin e lidhëzave nënrenditëse. Nxënësit punojnë në dyshe. Përkufizimi: Lidhëzat nënrenditëse lidhin kryesisht dy pjesë fjalie nga të cilat njëra është kryesore dhe tjetra e varur.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Mësimdhënie e ndërsjellë</i> Vendos tabelën e lidhëzave para nxënësve dhe përmes shembujve nxënësit arrijnë të kuptojnë llojin e marrëdhënieve që ato vendosin mes pjesëve të një fjalie, si dhe llojin e tyre bazuar në kuptimin që ato shprehin. Saktësohet se ato janë 10 llojesh duke drejtuar vëmendjen e nxënësve tek tabela e lidhëzave</p>			
<p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</p> <p>Nxënësit punojnë në dyshe për të klasifikuar lidhëzat në bashkërenditëse dhe nënrenditëse, si dhe për t'i grupuar ato sipas llojit të tyre (ushtrimi 1,2). Nxënësit punojnë individualisht ushtrimet 3,4,5. Tabela e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse</p>			
Lidhëzat bashkërenditëse			
Lloji	Lidhëzat		
shtuese	<i>as, dhe, e, edhe, si (e)dhe, as...as..., hem...hem..., si...si..., si... ashtu (e)dhe etj.</i>		
kundërshtore	<i>po(r), kurse, megjithatë, megjithëkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, porse, veç, veçqë, veçse, vetëm, vetëm se etj.;</i>		

veçuese	<i>a, apo, ose, daç... daç, ja... ja, ndo... ndo, qoftë... qoftë, ose... ose, o... o;</i>
përmbyllëse	<i>andaj, ndaj, pa, prandaj, domethënë etj.</i>

Lidhëzat nënrenditëse

Lloji	Lidhëzat
ftilluese	<i>se, që, në, nëse.</i>
vendore	<i>ku, tek, nga, kudo, ngado, tekdo, deri ku, gjer ku, nga ku, që ku, kudo që, ngado që.</i>
kohore	<i>kur, sa, si, tek, që, derisa, gjersa, pasi, mbasi, ndërsa, po(r)sa, qëkurse, sapo, teksa, kurdo që, kurdoherë që, para se, posa që, që kur, që se, qysh se, sapo që, sa herë (që), sa kohë (që) etj.</i>
shkakore	<i>se, sepse, si, pasi (mbasi), derisa, gjersa, përderisa, kur, që, sapo, meqenëse, meqë, ngaqë, ngase, duke qenë se, nga frika se, nga shkakun që, për arsye se, për shkak se, posa që, sapo që etj.</i>
qëllimore	<i>që, me qëllim që, në mënyrë që.</i>
krahasore	<i>sa, se, sesa</i>
mënyrore	<i>si, siç, ashtu si(ç), po(r) si, sikurse, sikundërse etj.</i>
kushtore	<i>në, po, nëse, kur, sikur, në qoftë se, në është se, në rast se, po qe se, me kusht që etj.</i>
rrjedhimore	<i>sa, saqë, që, aq sa, kështu që.</i>
lejore	<i>megjithëse, megjithëqë, ndonëse, sado(që), sido(që), edhe në, edhe në qoftë se, edhe po, edhe pse, edhe sepse, edhe sikur.</i>

Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit bazuar në shprehjet e fituara gjatë orës, duke inkurajuar nxënësit që hasin vështirësi.

Detyrat dhe puna e pavarur. Ushtrimi 7, f. 260

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për lidhëza Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Morfologji		Situata e të nxënit: Nxënësit dallojnë lidhëzat në fjalitë e ushtrimit 1	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; Kompetenca qytetare. 			

<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon lidhëzat nënrenditëse dhe bashkërenditëse. • Shpjegon marrëdhëniet që ato vendosin në fjali. • Bashkon fjalitë e thjeshta duke përdorur lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse. 	<p>Fjalët kyç: Lidhëza bashkërenditëse, lidhëza nënrenditëse, lidh gjymtyrë pjesë fjalie</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; Tabela e lidhëzave</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, pema e mendimit, punë e pavarur, punë e drejtuar</i></p>	


Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *punë dyshe*

Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 1 për të dalluar lidhëzat, duke i ndarë ato në bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

2. Ndërtim i njohurive të reja: *pema e mendimit*

Nxënësit realizojnë pemën e mendimit për lidhëzat bazuar në njohuritë e marra.



3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Punohen në mënyrë të pavarur ushtrimi 2, ku nxënësit grupojnë lidhëzat sipas formimit. Nxënësit lidhin fjalitë e thjeshta me lidhëzat e duhura, si dhe duke i plotësuar ato në ushtrimet 5, 6, 7.

Vlerësimi: Mësuesi përgëzon nxënësit për arritjet e tyre duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 8, 9, f. 240 (nxënësit zgjedhin alternativën e dëshiruar).

Shënim. Kjo temë mund të organizohet si projekt, ku nxënësit të bëjnë një plan për zhvillimin e një veprimtarie me rastin e mbylljes së vitit shkollor ose me një rast feste.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Marrëveshja në grup Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënët: Festë në shkollën tonë...	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për rregullat e marrëveshjes në grup. • Merr pjesë në diskutime në grup për të realizuar një marrëveshje. • Respekton rregullat e marrëveshjes në grup gjatë një diskutimi 		diskutim, grup, organizim, projekt, marrëveshje	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: shoqëria dhe mjedisi, vendimmarrja morale, të drejtat e njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, punë në grupe</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>diskutim</i> Nxënësit lexojnë detyrën nga tema “Koni, miqtë dhe ethet e festës”, duke përcaktuar në të listën e veprimtarive që propozohen dhe personat që do drejtojnë grupet për secilën veprimtari. Ata propozojnë disa kandidatë, por më parë listojnë cilësitë që duhet të ketë ai. Duhet të dalin në pah cilësi, si: të qenit i paanshëm, organizator dhe drejtues i mirë, tolerant, por që respekton rregullat dhe të tjerët etj. Lista e veprimtarive propozohet dhe miratohet nga e tërë klasa duke u ndarë në grupe për realizimin e secilës.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë në grupe</i> Pasi nxënësit ndahen në grupe sipas mundësive që kanë për realizimin e saj, zgjedhin kryetarin e grupit dhe planifikojnë listën e gjërave e punëve që do të kryejë secili duke rënë në marrëveshje.</p>			
<p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Diskutim.</i> Nxënësit demonstrojnë për veprimtaritë që do bëjnë si dhe kush di t'i realizojë ato.</p>			
<p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë. Për vlerësimin me notë mund të bashkëngjitet vlerësimi nga tema e leximit. Secili material individual, fletëpalosje, reklama mund të jenë pjesë e dosjes.</p>			
Detyrat dhe puna e pavarur; Realizimi i projektit.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ritregojmë me shkrim (ora e parë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Fragment nga “Meri Yll”	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Kujton rregullat për të realizuar një përmbledhje. • Përcakton rrugën për kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë. • Nis ritregimin me shkrim të fragmentit nga “Meri Yll”. 		Fjalët kyç: Hyrje, zhvillim, mbyllje, ritregim, ligjëratë e drejtë, e zhdrejtë, përmbledhje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, libri “Meri Yll”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Njohuri për shoqërinë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, DRTA, stuhi mendimi, punë e drejtuar, punë e pavarur me shkrim.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i></p> <p>Prezantojmë temën dhe u kërkojmë nxënësve të përshkruajnë rrugën që ndjekin për të thënë përmbajtjen dhe përmbledhjen e një tregimi.</p> <p>Nxënësit listojnë elementet e strukturës së një tregimi dhe kujtojnë rregullat e realizimit të një përmbledhje, ndër të cilat duhet të theksojmë;</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Ndahet pjesa në paragrafë. b. Për secilin paragraf përcaktohen fjalët kyç dhe informacioni kryesor që mbart. c. Riformulohet në bazë të fjalëve kyç informacioni kryesor i çdo paragrafi. d. Lidhen në një tekst përmbledhës fjalitë, që mbartin informacionin kryesor të çdo paragrafi. 			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e drejtuar, DRTA</i></p> <p>Nxënësit bëjnë dallimin mes një ligjërate të drejtë e të zhdrejtë dhe specifikojnë dallimet mes tyre.</p> <p>Mësuesi/ja së bashku me nxënësit jep rregullat për të kthyer një ligjëratë të drejtë në të zhdrejtë, që është elementi kryesor kur ritregojmë një pjesë.</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Heqja e shenjave të pikësimit, karakteristike për ligjëratën e drejtë, si: thonjëza, dy pikat, viza para dialogut. b. Pjesa lajmëruese dhe pjesa përmendëse lidhen e formojnë një fjali të përbërë. c. Kur duam të kthejmë nga veta e parë në vetën e tretë, ndyshon veta për përemrat e foljet, por në rastin tonë veta e parë mund të ruhet. d. Koha e foljeve kalon në të shkuarën. 			

U kujtojmë nxënësve që në një ritregim nuk ka një kthim të drejtpërdrejtë të ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë, por mund të punohet dhe me fantazi në realizimin e hyrjes, zhvillimit e mbylljes, pa ndryshuar pjesën nga ana kuptimore, pra që procesi i ritregimit me shkrim është dhe një proces krijues.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

Nxënësit nisin punën për ritregimin e fragmentit nga “Meri Yll”, duke bërë hyrjen dhe lidhjen e saj me zhvillimin.

Lexohen disa nga hyrjet e bëhen korrigjimet e duhura, nëse ka probleme dhe për të përmirësuar punën në vazhdim, me zhvillimin dhe mbylljen.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë rreth hyrjes dhe vetëvlerësim.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit mund të punojnë me ritregimin dhe në shtëpi dhe porositen të lexojnë librin “Meri Yll”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ritregojmë me shkrim (ora e dytë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të shkruarit		Punët me shkrim	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Realizon ritregimin e një pjese me shkrim. • Përdor saktë rregullat e drejtshkrimit. • Diskuton rreth shkrimeve në klasë për të bërë vlerësimin e tyre. • Korrigjon punën e tij në bazë të vërejtjeve që bëhen. 		Ritregim me shkrim, hyrje, zhvillim, mbyllje.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim, punë e pavarur me shkrim, diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *diskutim*

Nxënësit kujtojnë rregullat, që ndoqën për të bërë ritregimin e një pjese me shkrim, lexohen një pjesë e mirë e punëve, që janë bërë në shtëpi dhe diskutohet për problemet që kanë punët e gjithsecilit. Nxënësit orientohen të gjejnë vetë problemet dhe të japin format e duhura për to.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e pavarur*

Nxënësit punojnë për formën përfundimtare të ritregimit, duke bërë korrigjimet e duhura dhe në drejtshkrim, duke dorëzuar një punë sa më afër të saktës.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *diskutim*

Nëse del koha lexohen disa nga punët e tjera të nxënësve dhe diskutohet për realizimin e tyre

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Figurat kryesore letrare Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Poezi të ndryshme	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Liston figurat kryesore letrare duke shpjeguar mënyrën e ndërtimit të tyre. • Dallon figurat kryesore letrare në fragmente poezie. • Analizon nga ana metrike poezitë e dhëna. • Shpjegon mënyrën e ndërtimit dhe efektin stilistik të figurave në shembujt e dhënë. 		Fjalët kyç: <i>Figura letrare, poezi, analizë metrike</i>	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, fragmente poezish nga libra të ndryshëm për analizë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, recitim, punë e pavarur, punë e drejtuar, analizë shembujsh, diskutim, ditarët e të nxënit, shënime mbi shënime</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Recitim, stuhi mendimi*

U kërkohet nxënësve të recitojnë vargje nga një poezi që atyre u pëlqen dhe u ka mbetur në kujtesë. Nxënësit japin vetë një koment të shkurtër rreth asaj që i pëlqen në këtë poezi.

Gjatë diskutimit duhet të dalë në pah veçoritë e poezisë:

- ☞ zakonisht shprehen mendime e ndjesi të poetit,
- ☞ shkruhet në vargje,
- ☞ dallohet për figuracionin e pasur (për figurat letrare).

Nxënësit vetë mund të japin vetë përkufizimin e figurave letrare, që njihin nga vitet e kaluara, si një përdorim i fjalës, jo në kuptim të drejtpërdrejtë, por në mënyrë figurative, që transmeton më me emocion ndjenja, mendime, dhe vlera estetike e artistike.

Listohen figurat kryesore që njihin duke ilustruar dhe me shembuj.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *shënime mbi shënime, punë e drejtuar*

Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re; Tekstin poetik dhe tiparet e tij.

Vargu, rima, ritmi, strofa. Jepet shpjegimi për secilin prej tyre. Më pas kalohet te figurat letrare.

Nxënësve u kërkohet që për secilën figurë të japin përkufizimin dhe ta ilustrojnë atë me shembuj.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, diskutim, ditarët e të nxënësve.*

Punohen ushtrimet e librit. Ndahet klasa në grupe të vogla dhe i jepet të punohet një nga ushtrimet. U lihet kohë e mjaftueshme, pastaj zgjidhja e ushtrimit diskutohet me klasën. Përgjigjet e ushtrimeve

Ushtrimi 1.

- **Epitet:** I bekuar
- **Krahasim:** si pëllumb i shkruar
- Strofa është katërvargëshe dhe vargu është tetërrokësh

Ushtrimi 2

- **Epitete:** Të qeshur, të bukur, delikatë,
- **Krahasim:** si vazo e çmuar,
- **Metaforë:** nënat fshehin ëndrrat, flenë fluturimet mbi drurë, flenë rrufetë në thellësi të reve, fusha

ul supin te era.

Ushtrimi 3

- **Epitete:** vjeshtarak,
- **Metaforë:** dremit liqeri pa kufi, ndaj fundesh u përflak
- **Krahasim:** porsi me zjarr e me flori

Ushtrimi 4

- **Metafora:** sjellin zemrën e vendlindjes sime, blejmë nga një pjesë të verës
- **Epitet metaforik:** të martën e blertë, të martën e verdhë, verës së pjekur.

Ushtrimi 5

Epitete: e lirë, cung,

Metaforë: i thanë fjalës, të besosh se je e lirë, ke ngrënë rrokjet e tua, ke mbetur cung, prej saj doli gjak, ajo e besoi, ajo hapi gojën.

Personifikim: liria jeton, pas vdekjes udhëton,

Ushtrimi 6


Nga analiza metrike nxënësit njihin vetëm strofën, vargun, rimën dhe theksin, ndërsa ritmin jo.

Vargu është tetërrokësh, theksi parafundor dhe rima a puthur AA/BB.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Gjeneroj fragmente poezish që ju pëlqejnë dhe bëni me ditar dypjesësh komentimin e dy prej tyre. Për këtë perifrizoni, jepni kuptimin e vargjeve të drejtpërdrejtë e të nënkuptuar, figurat letrare dhe analizën metrike të poezisë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pasthirrmat Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Morfologji		Situata e të nxënit: Legjenda e Gjergj Elez Alisë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Dallon pasthirrmat në fjalitë e dhëna. • Shpjegon funksionin e pasthirrmave në fjali. • Dallon llojet e pasthirrmave sipas domethënies. • Dallon përdorimin e së njëjtës fjalë si pasthirrmë dhe klasë tjetër fjale. 		pasthirrmë, klasë e pandryshueshme, vullnet, ndjesi, qëndrim, emocionuese, nxitëse.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; tabela e lidhëzave		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Edukatë shoqërore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Shkrim i lirë, bisedë e kombinuar me shpjegim, punë e pavarur, punë e drejtuar</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Shkrim i lirë</i> Nxënësit shkruajnë legjendën e <i>Gjergj Elez Alisë</i> bazuar në ilustrimet e dhëna, duke përdorur sa më shumë pasthirrma, të cilat janë të dhëna në ilustrimet përkatëse. Përgëzoj nxënësit për punën e bërë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Bisedë e kombinuar me shpjegim</i> Analizohet roli që luajnë pasthirrmat në legjendën <i>Gjergj Elez Alia</i> dhe më pas formulohet së bashkë me nxënësit përkufizimi i pasthirrmave. Njëkohësisht plotësohet një grafik organizues për veçoritë e pasthirrmave.</p>			
<pre> graph TD A(Pasthirrmat) --> B(Klasë e pandryshueshme fjalësh) A --> C(Shprehin ndijime, ndjenja a vullnet të folësit) A --> D(Nuk i emërtojnë ato) A --> E(Lloji) E --> F(Emocionuese) E --> G(Nxitëse) E --> H(Të përshëndetjes) </pre>			
(oh, bobo, uh, qyqja) (o, ore, more, të lumtë) (mirëdita, mirë se erdhe, faleminderit)			
<p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Ushtrime</i> Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 1, 2 duke dalluar pasthirrmat dhe llojin e tyre. Punohen individualisht ushtrimet 3, 4. Në ushtrimin 5 nxënësit dallojnë kur, e njëjta fjalë, është pasthirrmë ose klasë tjetër fjalësh.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen në bazë të përgjigjeve të sakta dhe pjesëmarrjes aktive.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, f. 264</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Martin Camaj “Një ditë e ka dhe korbi” (Tekst poetik) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon me intonacion poezinë. • Flet për jetën dhe veprimtarinë letrare të Camajt. • Përgjigjet për pyetje rreth të kuptuarit të saj. • Interpreton figurat dhe ndjesitë e poetit në poezi • Analizon gjuhën e poetit duke dhënë vlerësimet për Camajn përmes saj. • Shkruan një prozë poetike në dialekt duke u bazuar në poezinë e Camajt. 		Fjalët kyç: Korbi, pëllumb, figura, një ditë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; <i>materiale nga interneti, përvoja të nxënësve</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, lexim i poezisë, analizë vargjesh, diskutim, ditarët e të nxënit.</i>			
Organizimi i orës së mësimimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim</i> Nxënësit janë porositur të lexojnë diçka rreth jetës dhe veprimtarisë letrare të Camajt dhe flasin rreth tij me informacionet që kanë. Duhet të dalë në pah ajo pjesë e jetës së Camajt që lidhet me vendin dhe kontributin e tij në gjuhën shqipe, ndaj mësuesi/ja e orienton bisedën drejt kësaj tematike.			
Informacion për mësuesin/en			
<div style="display: flex; align-items: flex-start;">  <div> <p>Martin Camaj lindi në Temal të Dukagjinit më 21 korrik të vitit 1925; vdiq më 12 mars të vitit 1992 në Muni. Ishte shkrimtar dhe albanolog, një figurë e madhe e letrave dhe pedagogjisë shqipe.</p> <p>Në Romë doktorohet dhe drejton revistën “Shejzat” si kryeredaktor, nën përkujdesjen e Ernest Koliqit.</p> <p>Në vitin 1961 dhe vendoset në Muni të Gjermanisë, ku bëhet profesor i studimeve albanologjike. Në Muni, ai ligjëron letërsinë shqiptare deri në vdekje,. Është përfshirë thujse në të gjitha antologjitë dhe veprat ku flitet për shkrimtarët shqiptarë.</p> </div> </div>			

Tituj të veprave

Nji fyell ndër male - Prishtinë 1953
Kanga e vërrinit - Prishtinë 1954
Djella (novelë) - Romë 1958
Legjenda - Romë 1964
Lirika mes dy moteve - Muni 1967
Poezi (1953-1967)- Muni 1967
Njeriu më vete dhe me të tjerë - 1978
Poezi 1981
Drandja (proza poetike)- Muni 1981
Rrathë (novelë) - 1981
Shkundullima - 1985
Karpa (novelë)- 198

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i poezisë,*

Meqë poezia është në dialekt e lexon mësuesi/ja fillimisht dhe më pas lexohet nga dy ose tre nxënës. Kërkohej gjatë leximit respektimi i veçorive të dialektit, intonacioni i duhur dhe kuptueshmëria. U kërkohej nxënësve që gjatë leximit të nxjerrin fjalë që nuk ua dinë kuptimin dhe shpjegohen ato së bashku.

Shpjegim fjalësh

shkrep – shkëmb me majë të mprehtë, shkëmb i thepisur; majë shkëmbore e zhveshur, shkrep.
e u ruente mos me lshuemun za – e ruhej mos të lëshonte zë, të mos i dëgjohej zëri;
hijen e hullive – hijen e ullinjve
gazullim – ngazëllim, hare, gëzim, lumturi

Poezia ka një simbolikë të fuqishme

(U shpjegojmë nxënësve se ç’ është simboli si figurë letrare. Simboli është përdorimi i një figure me një domethënie të veçantë. P.sh.: Pëllumbi simbolizon paqen, dafina – nderimin, flamuri – atdheun etj.)

Në qendër të poezisë është jeta e korbit në një ditë të vetme. Poeti nisur nga domethënia biblike e korbit, që mendohet në fillim ka qenë një pëllumb, që simbolizon mirësinë, paqen, butësinë dhe lumturinë, por për shkak të një mëkati është kthyer në korb e i duhet të jetë gjithmonë jo vetëm i zi në pamje, por dhe në shpirt, duke lajmëruar të keqen me një zë të çjerrë.

Ai vjen këtu, ku jetojnë pëllumbat, nga vende të largëta, nga shkrepat, dhe përpiqet t’u bashkohet pëllumbave, por dallon mes tyre nga ngjyra. Ata jetojnë në harmoni me njëri-tjetrin, ndërsa korbi është i vetëm dhe nuk mund të ndjekë vallen e tyre.

Vendi ku janë pëllumbat është i butë, i gëzueshëm, i paqtë (nën hijen e ullinjve) dhe ai ëndërron që dhe një ditë të vetme të jetë si ata, ndaj autori e titullon “Një ditë e ka dhe korbi”. Ai gjatë gjithë ditës lakmoi foletë e tyre dhe iu duk se qe një pëllumb dhe përmes kësaj autori do të japë idenë që lufta për mbijetesë do të jetë gjithmonë lufta mes së mirës dhe së keqes dhe duhet të triumfojë dhe e mira. Një ide tjetër, që mund të fshihet pas titullit mund të jetë se çdo njeri dhe çdo e keqe në thelb mund të ketë dhe diçka të mirë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Pyetje -përgjigje, ditarët e të nxënës*

Pasi u bëhet e qartë nxënësve simbolika e korbit, pëllumbit, ullinjve, sipas asaj që thamë më lart, përmes pyetjeve duhet të aftësojmë vetë nxënësit në zbërthimin kuptimor dhe interpretues të poezisë.

Pyetjet që mund t’u drejtojmë janë:

- Çfarë thuhet përmes vargut të parë, të dytë e të tretë?

(Që një korb, një qenie jo e mirë vjen në një vend të bukur, të qetë e paqësor, ku jetojnë në harmoni, me njëri-tjetrin pëllumbat.)

- Po në tri-katër vargjet e tjera?

(Autori tregon se korbi trembet që të bëhet pjesë e pëllumbave, e sheh veten larg tyre, gëzimit, fluturimit të tyre, jo vetëm për ngjyrën, por për vetminë dhe atë që ai përfaqëson.)

- Po në dy vargjet e fundit?

(Që çdo e keqe në vetvete ka dhe diçka të mirë, shembulli mund të jepet për njerëzit.)

- Pikën 2 dhe 3

Në pikën tre lihen nxënësit të shprehin lirshëm duke argumentuar mendimin e tyre.

- **Pika 4.** (Ngjyra- a bardhë e pëllumbave, e zeza e korbit)

Tinguj-zhurma e flatrave gjatë fluturimit të pëllumbit në harmoni dhe krra-krra e korbit.

- **Gjuha dhe pasuria e saj.**

Hulli, lshuemun za, gazullim etj.

- **Pika 6** (mund të jepet antiteza) - (e bardhë – e zezë), (korbi – pëllumbat), (shkrepa – dhé i butë).

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.


Detyrat dhe puna e pavarur. Bëni një prozë poetike mbështetur te poezia. U shpjegojmë nxënësve që proza poetike shkruhet në rreshta dhe shpreh si në poezi ndjenja të poetit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Migjeni “Ekstazë pranverore” (Tekst poetik) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Stuhi mendimi për pranverën	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon bukur me intonacion dhe në mënyrë të vetëdijshme poezinë. • Zbërthen poezinë nga ana kuptimore. • Nxjerr në dukje idetë, mesazhin e poetit. • Shpjegon efektin stilistik të figurave letrare. • Komenton vargje nga poezia. • Bën analizën metrike të poezisë. 		Fjalët kyç: Punë me tekstin. Pranvera, gëzim, jetë, dallëndyshe, vesa, jeta, andrra.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, informacione nga interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologjia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, diskutim, lexim i poezisë, ditarët e të nxënit.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Stuhi mendimi*

Mësuesi/ja bën grafikun në dërrasën e zezë për pranverën. Nxënësit sjellin idetë dhe mendimet e tyre për pranverën.



Nxënësit njihen me jetën dhe veprimtarinë e Migjenit si shkrimtar dhe mësues. U kërkojmë që të rifreskojnë njohuritë rreth tij dhe shkurtimisht i prezantojnë ato. Njihen nxënësit me titullin e poezisë. U shpjegohet fjala *ekstazë*.

Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla)

Lindi në Shkodër më 13 tetor 1911. Pas kryerjes së shkollës fillore, gjysmë të mesme dhe seminarit ortodoks, punoi si mësues në fshatin Vrakë, në Shkodër dhe në Pukë.. “Vargjet e lira” është përmbledhja e poezive të tij, ndërsa “Novelat e qytetit të veriut” përmbledhje e prozave, të cilat u botuan vetëm pas vdekjes.. Ndër vjershat më të spikatura mund të përmenden “Të birtë e shekullit të ri”, “Recital i malësorit”, “Kanga e rinisë”, etj. Ndërsa në prozë, “Luli i vocërr”, “Legjenda e misrit”, “... bukën tonë të përditshme falna zot”, etj. Ndërroi jetë me 26 gusht 1938.

Fjalor

Ekstazë – shkalla më e lartë e entuziazmit të njeriu, gjendje shpirtërore shumë e gëzueshme, dehje shpirtërore; gjendje shpirtërore e jashtëzakonshme e një njeriu që ka humbur vetëdijen, është shkëputur nga bota që e rrethon dhe bën veprime të çuditshme për shkak se vuan nga ndonjë sëmundje nervore, për shkak të veprimit ngacmues të ndonjë ilaçi etj.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i poezisë, ditarët e të nxënësve*

Në varësi të nivelit të nxënësve, poezinë mund ta lexojë mësuesi/ja ose përzgjidhen nxënës me diksion, intonacion dhe shqiptim të qartë në dialekt. Bëhet leximi i poezisë dy ose tre herë dhe shpjegohen fjalë e shprehje që kanë nxjerrë nxënësit gjatë të lexuarit.

U kërkohet nxënësve të tregojnë me fjalët e tyre për çfarë bën fjalë poezia dhe kalohet në zbërthimin e saj gradualisht sipas rubrikave në tekst.

Për të punuar sa më shumë nga ushtrimet e librit klasa mund të ndahet në grupe.

Punohet me ditarët e të nxënësve **ushtrimi 1** nga rubrika *Kuptimi dhe mesazhi*.

Gëzimi	<i>Nëpër ftyrat tona rrëshqiti një gëzim strofa I</i>
Entuziazmi rinor	Strofa II
Ngazëllimi në tinguj	Strofa III
Bukuria e lulëzimit	Strofa IV

Pyetja 2 plotësohen në tekst karakteristikat e pranverës, si: gjelbëron gjithçka, ringjallet natyra, kthehet zhurma e natyrës, gurgullojnë përrrenjtë nga shkrija e borës, kthehen dallëndyshet, gjallërohet natyra nga kënga e zogjve etj.

Pyetja 3

Sepse në pranverë çdo gjë ka një lloj ringjalljeje, zgjimi. Nga vera dhe vjeshta nuk do ishte e njëjta ndjesi, sepse gjatë vjeshtës ritmi i gjallërisë bie, së bashku me gjethet, me shirat dhe të ftohtit, kurse gjatë dimrit thahet e fle gjithçka, ka vetëm zymtësi dhe ngjyra të errëta. (Nxiten nxënësit që të shprehin sa më gjerësisht ndjesitë e tyre.)

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Pyetja 4

Lajmëtarja e parë e pranverës është dallëndyshja dhe vesa pas borës, ngricës dhe brymës është e para gjë e freskët, e shkëlqyeshme, larg ftohtësisë së dimrit.

Pyetja 5

Fole – aty ku lind e krijohet jeta, ku mbrohet dhe rigjenerohet ajo.

Lulëzim – ndryshim për mirë në natyrë dhe në shpirtin e njerëzve, ashtu sikurse dhe natyra shpërthen gjatë pranverës.

Pyetja 6

Këtu i orientojmë nxënësit drejt idesë që pranvera nuk është thjesht ardhja e një stine të re në natyrë, por simbolizon një shpresë për një jetë e re që do ndërtohet në vazhdim, sepse shpresa për ndryshimin e kësaj jete të rëndë (që e nënkupton dimri) në të cilën po jeton poeti po ndryshon. Ndaj kjo stinë nuk ndryshon vetëm jetën e poetit, por lind shpresa për të gjithë njerëzit.

Pyetja 7

- Folje kyç: erdhi (pranvera, dallëndyshja), triumfon (bylbyli), shkëlqen (vesa)
- Emra kyç: gëzim, lulëzim, cicërim, vesa, jeta, andrra, agimi, rreze etj.
- Mbiemra kyç: e re, e bukur, e arta.
- Punë e pavarur në dy grupe me anë të ditarëve të të nxënit:


Ushtrimi 8.

Vargjet	Komenti

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe pasi të lexohet detyra e shtëpisë mund të bëhet dhe me notë.

Detyrat dhe puna e pavarur; me ditarët e të nxënit ndajmë klasën në tre skuadra për të bërë një analizë të plotë të çdo strofe. Figurat letrare, efekti stilistik i tyre, mesazhi që jepet, vargu, rima që i japin muzikalitet poezisë etj.

Poezia jepet për t’u mësuar përmendësh me dëshirë dhe është pjesë e vlerësimit së bashku me detyrën dhe paraqitjen e nxënësit gjatë gjithë orës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Lasgush Poradeci “Poradeci” (Tekst poetik) tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin, Liqeni i Pogradecit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për jetën dhe veprimtarinë letrare të Lasgush Poradecit. • Lexon bukur, me intonacion, në mënyrë shprehëse poezinë. • Zbërthen poezinë nga ana kuptimore. • Interpretin figurat dhe kuptimet e dyta të vargjeve. • Analizon strukturën e poezisë për të dhënë efektin stilistik të vargjeve dhe rimave. • Krahason poezinë me të tjera poezi të ngjashme të poetit. • Komenton vargje të poezisë. 		Fjalët kyç: Poradeci, liqeri, perëndim, natë, varka, vargje, rimë, figura.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: shkenca, gjeografia, shoqëria.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, ditarët e të nxënit, pyetje-përgjigje, lexim i poezisë, diskutim, diagram Veni, punë e drejtuar.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit e njohin Lasgush Poradeci nga viti i kaluar me poezinë “Mëngjes” dhe kanë lexuar rreth tij. Ndaj u kërkohet të rifreskojnë njohuritë në lidhje me jetën dhe veprimtarinë e tij letrare dhe ta prezantojnë shkurt në klasë.			
		Lasgush Poradeci lindi më 27 dhjetor 1899 në Pogradec. Në vitin 1921 ai shkoi në Rumani, për të ndjekur studimet e larta. Në verën e vitit 1924 Qeveria e Fan Nolit i dha bursë dhe kështu arriti t’i përfundonte studimet e larta në Grac (Austri) në Fakultetin e Filologjisë Romano-Gjermane. Lasgush Në veprën e tij jetoi shqetësimi atdhetar i mbrojtjes së kombit dhe të traditës. Ai është nga lirikët tanë më të mëdhenj, i cili u shqua për ndjeshmërinë dhe ëmbëlsinë poetike më të cilën i këndoi Shqipërisë dhe dashurisë. Më 12 nëntor të vitit 1987, Lasgush Poradeci, vdiq, duke lënë pas një krijimtari të bukur, e cila kishte fituar zemrën e lexuesit dhe kishte tërhequr vëmendjen e disa studiuesve të shquar të kulturës sonë.	

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar, lexim i poezisë, diskutim.*

Lexohet poezia bukur nga dy –tre nxënës, duke u kërkuar të respektojnë intonacionin, ritmin dhe rimat gjatë interpretimit.

Shpjegohen fjalët e shprehjet e panjohura që përmban fjalori i tekstit dhe fjalë të tjera që nxënësit nuk ua dinë kuptimin dhe bëhet shpjegimi i tyre së bashku.

Pas leximit, punohen ushtrimet e tekstit të cilat i ndihmojnë nxënësit të zbërthejnë përmbajtjen, gjuhën dhe stilin e poezisë.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, ditarët e të nxënës, pyetje-përgjigje.*

Pyetja 1. Këtu mund të jepet informacion rreth pozitës gjeografike të Pogradecit dhe liqenit të Ohrit. Ata ndodhen në juglindje të Shqipërisë, Ohrit është një nga liqenet më të thellë e më të mrekullueshëm të Ballkanit me një florë e faunë të jashtëzakonshme nënujore, me pika turistike të mrekullueshme si Tushemishti e Driloni; i ndarë në mes Maqedonisë dhe Shqipërisë duke lënë pas kufijve Shën Naumin, dikur i përkiste Shqipërisë.

Nxënësit sjellin informacione që kanë lexuar rreth vendlindjes së poetit.

Pyetja 2. Poezitë e tij janë të lidhura ngushtë me liqenin, jo vetëm se është nga Pogradeci, ku ka lindur e ka jetuar aty pjesën më të madhe të jetës së tij, por dhe sepse ky liqen është shpirti i qytetit, një mrekulli që e vlerëson, jo vetëm si pasuri natyrore, por dhe si të lidhur ngushtë me jetën e njerëzve dhe si pjesë e pandashme e jetës së qytetit.

Pyetja 3 dhe 4. Moment mbrëmjeje, perëndimi, kur po bie nata dhe qetësia po pushton qytetin, po fle jeta dhe fashitet zhurma dhe gjallëria.

Nxënësit duhet të sjellin imazhet e mbrëmjes, ku pamjen më të madhe e më të bukur e zë liqeni, me diellin që thuaje ka perënduar plotësisht, varka në liqen, shtëpi të vogla karakteristike etj.

Nëse në klasë kemi nxënës që kanë prirje për pikturë, mund t’ua kërkojmë ta pikturojnë peizazhin ose t’ua japim detyrë në shtëpi.

Pyetja 5

II E kudo jeta po hesht, ashtu si mbaron një ditë, mbaron edhe jeta e njeriut.

III Errësira mbuloi vendin dhe të gjithë flenë.

IV I vetmi që s’pushon është Drini i përrallshëm, që buron nga Shëndaumi dhe kalon mes për mes nër Shqipëri. (poeti shpreh dhimbjen e tij për Shqipërinë që është ngushtuar gjatë historisë)

Pyetja 6.

Poeti duket se u jep shpirt sendeve e gjërave pa jetë si; ... perëndimi përhapet, krahin’ e gjerë më s’po qit as pipëlim.

Poeti shkrihet me natyrën; ... futet zemra djaloshare m’u në fund të shpirtit tim,

Duket se gjithçka fle, fle dhe jeta, njerëzit, ...në Liqer hesht një lopatë...

Pyetja 7

Krahas emrave të përveçëm, si *Mal të Thatë, Shëndnaumi*, poeti edhe Liqer e shkruan me të madhe, sepse e identifikon atë si me qytetin e Pogradecit edhe me liqenin e Ohrit.

Pyetja 8

- Emra: perëndim, liqeri, pëlhurë, fshat, natë etj
- Folje: përhapet, bie, bëhet fir, kërcet, hesht, ra, u dergj, e zuri gjumi etj.
- Mbiemra: i vagëlluar, djaloshare, e arratur, e gjerë, i përmallshëm etj.
- Ndajfolje; dal-ngada-dalë, mes-për-mes.

Për efekt kohe pikat e tjera mund të jepen detyrë shtëpie duke u kombinuar si një koment i plotë.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë duke pasur parasysh dhe zhvillimin e detyrës.

Detyrat dhe puna e pavarur. Klasa mund të ndahet në dy grupe.

Grupi I – bëjnë krahasimin e poezisë “Mëngjesi” me poezinë “Poradeci”. Udhëzohen nxënësit të kenë parasysht se detajet që mund të krahasohen janë: mesazhi, tematika, veçoritë e liqenit në secilën poezi, momentet kohore që prezanton poeti, rima, vargu, figuracioni etj.

Grupi II – mund të bëjë komentin e poezisë me ditarin dypjesësh. Udhëzohen të kenë parasysht në çdo strofë figurat letrare, kuptimin, momentin kohor që përshkruhet, rimën, vargun, pikësimin, tripikëshi, fjalët në dialekt etj.

Disa nga figurat letrare janë:

epitete – i vagëlluar (i vakët, i fikur, i shuar), djaloshare, i gjerë, i përmallshëm,

krahasime – si një hije,

metafora – shkumb i natës që po bie, jeta ra, u dergj, e zuri nata, zotëroi errësira,

Tripikëshi ka funksion që të japë vazhdimësinë e mendimit të poetit, imagjinatën e momentit, kur qyteti, liqeni fle, ndarja e ndajfoljeve të përngjitura me vizë në mes për të zgjatur shqiptimin dhe kuptimin e asaj që shprehin.

Nxënësit mund ta shoqërojnë poezinë me vizatime sipas fantazisë së tyre ose edhe me ndonjë poezi origjinale.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Pjesëzat Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Morfologji		Situata e të nxënit: “Ditari i Ana Frankut”	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 5. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon pjesëzat në fjali. • Shpjegon funksionin e tyre në fjali. • Ilustron me shembuj nuancat e tyre kuptimore. • Përdor në fjali pjesëzat. 		pjesëza, ngjyrim kuptimor, të pandryshueshme.	
Burimet: Teksti shkencor, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë dyshe, mësimdhënie e ndërsjellë, punë e pavarur, pema e mendimit.</i>			


Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Punë dyshe*

Nxënësit përqendrohen në fragmentin e dhënë nga “Ditari i Ana Frankut”, duke dalluar çfarë janë fjalët me të zeza. Ata përpiqen të dallojnë ngjyrimet e tyre kuptimore.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Mësimdhënie e ndërsjellë, pema e mendimit*

Nxënësit përmes punës në dyshe kuptojnë funksionin që kryejnë fjalët me të zeza në fjali. Bazuar në përgjigjet e tyre bëjnë përkufizimin e pjesëzave.



Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ismail Kadare “Kinema e vjetër” (Tekst poetik) tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për jetën dhe veprimtarinë letrare të Kadaresë. • Lexon poezinë dhe tregon përmbajtjen e poezisë. • Interpreton vargje nga poezia dhe nxjerr mesazhin e tyre. • Krahason kujtimet e poetit në poezi me ato në pjesën “Kundërajtori i vjetër”. • Analizon poezinë nga ana gjuhësore. 		Fjalët kyç: poezi, kujtime, kinema, fëmijëri	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bashkëbisedim, stuhi mendimi, karrige e autorit, lexim i poezisë, analizë kuptimore dhe gjuhësore, Diagram Veni, ditarët e të nxënit.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Bashkëbisedim*

Bashkëbisedohet me nxënësit për shkrimtarin Ismail Kadare, për të cilin ata kanë lexuar dhe folur gjerësisht, ndaj e rikujtojnë atë dhe pak nga ngjarjet në pjesën “Kundërajtori i vjetër”.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i poezisë*

Leximi i poezisë bëhet nga nxënësit dy ose tri herë. Nëse ka fjalë e shprehje, që nxënësit nuk i kuptojnë bëhet shpjegimi i tyre bashkërisht.

Punohen me nxënësit kërkesat e të tre rubrikave, të cilat i ndihmojnë nxënësit të thellohen dhe të zbulojnë bukurinë e poezisë. Klasa sipas niveleve mund të ndahet në tri grupe.

Grupi i parë punon për kuptimin e mesazhin

Grupi i dytë për interpretimin dhe vlerësimin

Grupi i tretë për stilin dhe gjuhën.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, pyetje- përgjigje*

Çdo grup prezanton arritjet e veta.

Pika 1

Kinemaja – vendi më argëtues; *lozin filma, / shesin kikirikë.*

Kinemaja – vendi që lidh me botën përtej kufirit; bota fund s’kish e anë, / *bota ngjante e shkëlqyer.*

Nxënësit duhet të përpiqen të sjellin ndjesitë e poetit në këto vargje.

Pika 2 Strofa e dytë nënkupton gjendjen e kinemasë në periudhën e Pasluftës.

Pika 3

Rënia fizike të objekteve materialeve: strofa e dytë, strofa a parafundit

Rritje shpirtërore e individit: strofa e parafundit

Interpretimi i poezisë mund të bëhet *me karrigen e nxehtë.*

Për disa minuta u kërkojmë nxënësve të mendojnë pyetje që lidhen me interpretimin e poezisë. Sipas dëshirës së nxënësve për këtë mund të zgjidhen dy ose tre nxënës.

Nisur dhe nga teksti nxënësit drejtojnë pyetje rreth lidhjes shpirtërore të poetit me këtë vend, lidhjen mes së sotmes dhe së shkuarës përmes kujtimeve dhe këtij objekti. Nxënësit duhet të lidhin ndjesitë e tyre duke i krahasuar ato me të poetit rreth objekteve që kanë lënë mbresa në fëmijërinë e tyre.

Analiza gjuhësore ditari trepjesësh.

Nxënësit rikthehen në tekst dhe dallojnë figurat letrare, shpjegojnë efektin e tyre stilistik me

Figura	Lloji	Komenti rreth saj
E vjetër, e braktisur, të përsëritur, të pashkruar, i menduar i gëzuar, të vjetra, të rëndë, së gjerë, i shkëlqyer, të rëndë, të vithisur	Epitete metaforike	Në të poeti përshkruan kujtimin e tij për kinemanë, gjendjen shpirtërore që i ka falur në fëmijëri, por dhe nostalgjinë që i jep tani.
Si hamall këto stole do t’i marr me vete	Similitudë	Përmes këtij krahasimi do të shpjegojë se tashmë poeti është larg këtij vendi fizikisht, por shpirtërisht me kujtimet nostalgjinë dhe ndjenjat e tij ai do kthehet e do të jetë i pranishëm.

Nostalgjinë për fëmijërinë poeti e shpreh jo vetëm me kinemanë, por edhe me vende që i kujtojnë fëmijërinë, si: xhamia, Qafë e Pazarit, portieri Qani etj.

Ushtrimi 8. Përdorimi i mbiemrave të prejardhur kryesisht nga foljet, si: *të shkruara, të gëzuara, të përsëritura, të vithisura* etj.

Autori përdor vargun e shkurtër për t’i dhënë ritëm poezisë dhe të jep ndjesinë e se po nxiton për të sjellë të gjitha kujtimet e tij pa harruar asnjë.

Mungesa e rimës së rregullt të çon në idenë se qëllimi i poezisë së autorit nuk është të ndërtojë vargje të bukura, strikte në strukturë dhe të plota. Më shumë se një poezi të mirëfilltë ai sjell një rrëfim në vargje, ndjesitë e tij rreth një kujtimi dhe kujdeset që kjo të vijë e plotë, ashtu si është në mendjen e poetit, spontane dhe e thjeshtë pa zbukurime të tepërta.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë pas kontrollit të detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur; Bëni krahasimin e poezisë me pjesën “Kundërajtori i vjetër”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kryefjala Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënit: Gjen dhe diskuton për përdorimin e kryefjalës në fragmentin <i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon kryefjalën si gjymtyrë kryesore në fjali; • dallon grupin emëror të kryefjalës dhe bërthamën e saj; • përcakton klasë e fjalëve me të cilën shprehet kryefjala; • përshtat kryefjalën me kallëzuesin; • ndërton fjali me kryefjalë të shprehura në mënyra të ndryshme. 		Fjalët kyç: kryefjalë, grup emëror, emër, përemër	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur, analizë rastesh. INSERT</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësve u kërkohet të kujtojnë njohuritë që kanë për grupet kryesore në fjali, grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor. Nxënësit rikujtojnë përbërësit e çdo grupi dhe funksionin e tyre në fjali. Nxënësit punojnë në tekst për plotësimin e skemës për funksionet e fjalëve dhe grupeve të fjalëve në fjali.			

2. Ndërtimi i njohurive të reja: analizë rasti, INSERT, punë e drejtuar.

Nxënësit punojnë për disa minuta në tekst me fragmentin nga romani i Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, për të gjetur kryefjalën dhe me çfarë shprehet ajo. Ata punojnë me shenjat e tabelës **INSERT** mbi materialin teorik dhe diskutojnë kryesisht për njohuritë e reja në të.

√	+	-	?
Njohuri që nxënësi i ka marrë	Njohuri të reja që nxënësi i kupton	Njohuri të reja që nxënësi i di ndryshe	Njohuri që nxënësi nuk i kupton

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur, ushtrime.

Ushtrim 1, nxënësit nënvizojnë fillimisht kryefjalën dhe kallëzuesin dhe përcaktojnë cilat gjymtyrë i takojnë njërit dhe tjetrit grup.

a. Grupi i kryefjalës (**ngjarjet** e mëdha popullore, një **grup** i madh ekskursionistësh, ne, dy nga shikuesit - është grup me bërthamë një numëror);

b. grupi i kallëzuesit ose grupi foljor (**ushqejnë** shpirtin e artistit, **do t’i ngjitej** në këmbë malit më të lartë të krahinës sonë, dje **lexuam** një gazetë për një ujëvarë të ngrohtë, **duartrokisnin** pa pushim)

Ushtrimi 2, nxënësit dallojnë kryefjalët dhe gjejnë me se shprehen. (kështjellarët - emër, ata - përemër vetor, i cili - përemër lidhor, kali i xhindosur - grup emëror, të gjithë - përemër i pacaktuar, cili - përemër pyetës, zhurmat e patkonjve të kalit - grup emëror, ai - përemër vetor.

Ushtrimi 3, 4, 5, 6, 7, 8 sipas kërkesës.

Ushtrimi 7; Kujdes përdorimin e përemrit çfarë, si kryefjalë se mund të ngatërrohet me kundrinorin shembull; Çfarë ndodhet në pyll?

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve bëhet për detyrën e shtëpisë dhe për performancën e tij gjatë gjithë situatës së të nxënësit dhe çdo etape mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyrë shtëpie ushtrimi 9 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kallëzuesi Kompetenca: Njohuri për gjuhën – Sintaksë		Situata e të nxënësit: Mëngjes (fragment nga Jakov Xoxa)	
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçe 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;			
Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon kallëzuesin si gjymtyra kryesore në fjali; • dallon llojet e kallëzuesit dhe me se shprehen; • Dallon kallëzuesit në fjali; • Ndërton fjali me lloje të ndryshme kallëzuesish. 		Fjalët kyçe: kallëzuesi, tregon veprim e gjendje, kryefjalë, kallëzues foljor, emëror, i thjeshtë, i përbërë,	

Burimet: Teksti i nxënësit, përvojat e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:																				
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, pema e mendimit, punë e pavarur, punë e drejtuar, tabela e koncepteve,</i>																					
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi me gojë ose me shënim i detyrave të shtëpisë. Nxënësit flasin dhe kujtojnë shkurtimisht njohuritë për gjymtyrët kryesore në fjali dhe ndalen veçanërisht në njohuritë që kanë për kallëzuesin.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja; <i>analizë rasti, tabelë konceptesh, diskutim.</i> Nxënësit marrin në analizë tekstin në hyrje të mësimit: nënvizojnë me ngjyrë të kuqe kryefjalën dhe me blu të gjithë kallëzuesit. Përcaktojnë me se shprehen kallëzuesit. U kërkojmë nxënësve të rikthehen në materialin teorik në tekst dhe të plotësojnë tabelën e koncepteve sipas kërkesave të dhëna në lidhje me kallëzuesin.</p> <table border="1" data-bbox="204 871 1439 1144"> <thead> <tr> <th>Kallëzuesi</th> <th>Çfarë tregon</th> <th>Si gjendet</th> <th>Me se shprehet</th> <th>Lloji i kallëzuesit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>zbardhte</td> <td>veprim</td> <td>Ç'bënte?</td> <td>Me folje</td> <td>Kallëzues foljor i thjeshtë</td> </tr> <tr> <td>Ishte e ngrënë</td> <td>gjendje</td> <td>Si ishte?</td> <td>Me foljen ndihmëse jam+mbiemër</td> <td>Kallëzues emëror</td> </tr> <tr> <td>Nisi të shkrinte</td> <td>veprim</td> <td>Ç'bënte?</td> <td>Me folje gjysmë-ndihmëse dhe folje në lidhore</td> <td>Kallëzues i përbërë foljor</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vëmë theksin në dallimin e kallëzuesit emëror dhe mënyrën e tij të shprehurit, kallëzuesin foljor të përbërë në dallim nga kallëzuesi i thjeshtë, sidomos ai i shprehur me folje në kohë të përbëra. Ndërtohet së bashku me nxënësit <i>harta e konceptit</i> dhe më pas verifikohet me skemën që është në libër.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur . Ushtrime.</i></p> <p>Ushtrimi 1.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kallëzues emëror. Jam + GE (ishin plot me fëmijë), • Frynte (kallëzues i thjeshtë foljor) • vazhdonte të ishte e butë (kallëzues emëror, <i>jam</i> + mbiemër që tregon dhe vazhdimësi) • është e para këngë lahute (kallëzues emëror jam+GE), • kam dëgjuar (kallëzues i thjeshtë foljor, në kohë të përbërë) • ishin prej atij druri (kallëzues emëror jam+GE) • kishte (kallëzues i thjeshtë foljor), • erdhi, bëhej (kallëzues të thjeshtë foljorë), • duhet të ketë qenë (kallëzues foljor i përbërë, që tregon domosdoshmëri), • kujtohet (kallëzues i thjeshtë foljor), • mbaj mend, mbylli (kallëzues i thjeshtë foljor shprehur me shprehje frazeologjike), • ishte shumë ftohtë (kallëzues emëror, shprehur me jam+ GE) • shkëlqente, kërciste (kallëzues të thjeshtë foljorë) 		Kallëzuesi	Çfarë tregon	Si gjendet	Me se shprehet	Lloji i kallëzuesit	zbardhte	veprim	Ç'bënte?	Me folje	Kallëzues foljor i thjeshtë	Ishte e ngrënë	gjendje	Si ishte?	Me foljen ndihmëse jam+mbiemër	Kallëzues emëror	Nisi të shkrinte	veprim	Ç'bënte?	Me folje gjysmë-ndihmëse dhe folje në lidhore	Kallëzues i përbërë foljor
Kallëzuesi	Çfarë tregon	Si gjendet	Me se shprehet	Lloji i kallëzuesit																	
zbardhte	veprim	Ç'bënte?	Me folje	Kallëzues foljor i thjeshtë																	
Ishte e ngrënë	gjendje	Si ishte?	Me foljen ndihmëse jam+mbiemër	Kallëzues emëror																	
Nisi të shkrinte	veprim	Ç'bënte?	Me folje gjysmë-ndihmëse dhe folje në lidhore	Kallëzues i përbërë foljor																	

Ushtrimi 2 mund të punohet me tabelë.

Folja (kallëzuesi)	Mënyra	Koha	Veta	Numri
ishin	dëftore	e pakryer	III	shumës
frynte	dëftore	e pakryer	III	njëjës
vazhdonte	dëftore	e pakryer	III	njëjës
të ishte	lidhore	më se e kryer	III	njëjës
është	dëftore	e tashme	III	njëjës
kam dëgjuar	dëftore	e kryer	III	njëjës
kishte, ishte	dëftore	e pakryer	III	njëjës
erdhi	dëftore	e kryer e thjeshtë	III	njëjës
bëhej, duhej	dëftore	Pak	III	Njëjës
të ketë qenë	lidhore	E kryer	III	Njëjës
kujtohet	dëftore	tashme	III	njëjës
mbaj	dëftore	tash	I	njëjës
mbylli	dëftore	e kryer e thjeshtë	III	njëjës
shkëlqente, kërciste	dëftore	pakryer	III	njëjës

Ushtrimi 3, nxënësit dallojnë llojet e kallëzuesit. Përgjigjet:

- është vepra më me vlerë (kallëzues emëror *jam+ge*)
- nisi të më pëlqente (kallëzues foljor i përbërë *nisi+pëlqej*)
- kishin filluar të dëgjoheshin (kallëzues foljor i përbërë, *filloj+dëgjoj*)
- kishin lulëzuar (kallëzues foljor i thjeshtë, shprehur me folje në kohë të përbërë)
- jepnin (kallëzues foljor i thjeshtë)
- vinte (kallëzues foljor i thjeshtë)
- mund të shihte (kallëzues foljor i përbërë, tregon mundësi, *mund+ shoh*)
- vazhdonte të binte (kallëzues foljor i përbërë, tregon vazhdim veprimi, *vazhdon+bie*)
- kishte hyrë (kallëzues foljor i thjeshtë, shprehur me folje në kohë të përbërë)
- është perlë e rrallë (kallëzues emëror, *jam+ge*)
- janë zogj të mëdhenj (kallëzues emëror, *jam + ge*)
- kishte nisur të dilte (kallëzues foljor i përbërë, tregon fillim veprimi, *nis+dal*)
- pushoi së kënduari (kallëzues foljor i përbërë, tregon përfundim veprimi, përfundoj+ emrin në asnjans së kënduari)
- mund t'i ketë habitur (kallëzues foljor i përbërë, tregon mundësi, *mund+ habit*)
- harruan (kallëzues foljor i thjeshtë)
- të duartrokasin (kallëzues foljor i thjeshtë)

Vlerësimi: Vlerësimi i rezultateve të të nxënësve bëhet për detyrën e shtëpisë dhe për performancën e tij gjatë gjithë situatës së të nxënësve dhe çdo etape mësimore dhe në veçanti ushtrimeve **Ushtrimi 5, 6** sipas kërkesës.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimi 4 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Piktura dhe fotografia Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënit: Pranvera	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon mënyrat e shprehjes së ndjesive në poezi, pikturë, fotografi dhe muzikë. • Dallon fotografinë nga piktura duke krahasuar pamje me të njëjtën tematikë. • Kombinon foto e piktura me “4 stinët e Vivaldit”. 		Fjalët kyç: fotografi, pikturë, stinë, muzikë, fjalë.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve . Linke për materialet që nevojiten gjatë zhvillimit të orës së mësimi. https://www.youtube.com/watch?v=GRxofEmo3HA “ 4 stinët e Vivaldit” https://www.google.al/search?q=paint+of+spring&espy link ku mund të përzgjidhen pamje pikturash në sezone të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, Diagram Veni, vëzhgim i materialeve të ndryshme në video-projektor.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim, Diagrami Venit, Punë e drejtuar</i></p> <p>Përmes Diagramit të Venit, nxënësit krahasojnë mjetet që përdor poeti, piktori dhe kompozitori për të paraqitur stinën e pranverës.</p> <p>Nxënësve që janë zotërues të mirë të programeve të ndryshme kompjuterike, u kërkojmë të sjellin në power point piktura me tematikë stinët e ndryshme të vitit. Shoqërohen foto a piktura nga stinë me muzikën “4 stinët” e Vivaldit”. Do të ishte mirë të siguroheshin edhe katër poezi për çdo stinë. Nxënësit specifikojnë çfarë shprehet në secilin krijim dhe cilat janë mjetet që e realizojnë atë, pra, poeti përdor fjalën, piktori ngjyrën, kompozitori notat muzikore.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur</i></p> <p>Vendosim në video-projektor foto dhe piktura të nxjerra nga interneti shoqëruar në sfond nga “4 stinët” e Vivaldit dhe u kërkojmë nxënësve të krahasojnë foto dhe piktura me të njëjtën tematikë. Nxënësit dallojnë veçoritë e një fotoje dhe të një pikturë.</p>			

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Lexohen krahasimet e nxënësve dhe diskutohet për to.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit mund të fiksojnë në foto momente nga stina, në të cilën janë dhe të realizojnë një pikturë sipas fantazisë së tyre në lidhje me të njëjtën stinë. Nëse dëshirojnë kompletojnë dhe me poezi albumin e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Staikos “Edukimi i Herakliut” (ora e parë) - tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Dymbëdhjetë bëmat e Herakliut, Mitologji	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Sjell informacione për figurën mitologjike të Herakliut dhe bëmat e tij. • Lexon pjesën për t’u njohur e ritreguar përmbajtjen. • Jep gjykimet e tij rreth jetës së Herakliut duke përdorur empatinë. • Shpjegon fjalë e shprehje të reja përmes kontekstit. 		Fjalët kyç: Herakliu, bari, princ, Virtutja, Vese.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale për Herakliun.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, mitologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, lexim në heshtje, punë e pavarur INSERT, Punë në grupe.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Nxënësit janë porositur që më parë të lexojnë rreth jetës dhe figurës mitologjike të Herakliut dhe bëmave të tij që të mund të kuptojnë sa më mirë figurën e tij në fragmentin e librit. Ata flasin për origjinën, edukimin e tij, bëmat dhe vazhdimësinë e figurës së tij.			

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim në heshtje, punë e pavarur*
 Punohet rubrika Kuptimi dhe mesazhi. Nxënësit lexojnë në heshtje pjesën dhe nënvizojnë në libër, sipas kërkesave të ushtrimeve 1-4. Paraqiten para klasës rezultatet e arritura.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *lojë në role, diskutim.*
 Mund të lexohet pjesa në role. Gjithashtu ritregohet përmbledhtazi përmbajtja e pjesës.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë me notë mund të realizohet orën e dytë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Ese me temë “Heroizmi i parë që më duhet të kryej është të zgjedh rrugën e virtytit”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Edukimi i Herakliut (ora II)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca qytetare. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • diskuton për krijimet e shokëve të tij në detyrat e shtëpisë; • jep gjykimin e tij rreth figurës së Herakliut nisur nga veprimet dhe mendimet e tij; • analizon gjuhën dhe stilin e autorit për të shpjeguar përdorimin e figurshëm të fjalëve; • formulon bukur idetë dhe mesazhin e pjesës. 		Herakliu, Edukim, gjuha, personazh,	
Burimet: teksti i nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e pavarur, punë e drejtuar, tabela e koncepteve të personazhit, diskutim, ditarët e të nxënit.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë e pavarur</i>			
Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë, duke vlerësuar vetë nxënësit krijimet më të mira.			
Një nxënës përmbledh shkurt me gojë përmbajtjen e pjesës dhe ngjarjeve rreth Herakliut.			

2. Ndërtimi i njohurive të reja: tabela e koncepteve të personazhit

Për ta përshkruar figurën e Herakliut, nxënësit punojnë me **tabelën e koncepteve** të personazhit që të detajojnë cilësitë fizike e tij morale.

Personazhi i Herakliut

Gjendja shoqërore	Cilësi fizike	Cilësi morale	Edukimi	Veprime	Gjykimi juaj rreth tij
Princ mbretëror, I nipi i heroit Perse	I fuqishëm, shtatmadh I fortë, Forcë të pamposhtur	I ditur, I papërmbajtur, zemërak, me sedër, i ndjeshëm, punëtor, i pastër, i ndershëm, i mençur, me aftësi të jashtëzakonshme, mirëbërës i njerëzve	Mësoi gramatikën, dijet dhe artet	Godet mësuesin e tij, Qau, u pendua, ndihmonte barinjte, sillej si fshatarët, ndjek rrugën e virtytit	Pranohen të gjitha alternativat logjike të nxënësve

Nxënësit japin gjykimet e tyre për figurën e Herakliut, por dhe të babait e të mësuesit. Gjithashtu nxënësit përcaktojnë llojet e personazheve, duke evidentuar që Vesja dhe Virtutja janë personazhe imagjinare, që autori i përdor për të nxjerrë veçori të personazhit të Herakliut. Përmes këtyre gjykimeve jepen idetë dhe mesazhi që përcjell autori përmes këtij fragmenti.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur me tekstin, ditari trepjesësh

Pika 11 mund të punohet paralel me analizën e figurave në tekst.

Pika 12 dhe 13 punohet në libër shkurtimisht.

12. frikacak, i hileqar, e shëmtuar, i varfër, arrogant, keqbërës. Përpiqemi të sjellim antonime leksikore dhe jo të ndërtuara me të kundërtat e tyre, si i ndershëm - i pandershëm.

13. shpirt i pastër - epitet metaforik.

Nxënësit rikthehen në tekst për të punuar me stilin dhe gjuhën e përdorur. Për disa minuta nxënësit nxjerrin nga teksti përdorimet e figurshme dhe përcaktojnë me ditar trepjesësh efektin e tyre stilistik. Nëse nuk përfundohet në klasë vazhdohet detyrë shtëpie.

Figura	Lloji	Komenti (efekti stilistik)
I guximshëm	Epitet	Për të dhënë jo vetëm cilësi fizike, por dhe një mendje të mprehtë e guximtare për shkak të dijeve e inteligjencës që zotëronte.
Sytë i shkëlqenin	Metafora	Përmes tyre jepet që Herakliu nuk fitoi vetëm cilësi fizike e veçori të mira të karakterit, por u zhvillua në një formë të tillë fizike që i dha dhe hijeshi fizike e në karakter.
Si thëngjinj të ndezur	Krahasim	Bashkëngjitet në komentin e mësipërm
Të fuqishëm	Epitet	Tregon se si u përsos fizikisht Herakliu në jetën mes barinjve
Me një grusht mund të bënte copë gjoksin e një luani	Hiperbolë	
Hodhi shtat	Metaforë	
Vrau mendjen	Metaforë	Para se të veprojë, mendon thellë.

Vlerësimi: Sipas gjykimet të mësuesit nxënësit vlerësohen me notë, duke pasur parasysh tërë etapat gjatë të dy orëve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdohet analiza e figurave nëse nuk përfundohet në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Sporti në Greqinë e lashtë Të folurit		Situata e të nxënit: Lojërat olimpike	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca qytetare 6. Kompetenca digjitale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • flet për sportin në lashtësi, veçanërisht në Greqi; • evidenton disiplinat, karakteristikat dhe traditën në lojërat olimpike; • përcakton simbolet dhe çmimet e lojërave olimpike; • përcakton vazhdimësinë e sportit nga Greqia e lashtë deri sot; • krahason disiplinat sportive sot me ato në antikitetin Grek; • përshkruan mbresat e tij nga vëzhgimi i lojërave olimpike; • argumenton preferencat e tij për sporte të veçanta dhe sportistë të veçantë. 		sporte, lojëra olimpike, sportistë, disiplina, çmime, simbole.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve, materiale të ndryshme lidhur me temën.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Edukim fizik dhe sporte. Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, hulumtim i pavarur, Diagram Veni.			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: diskutim</p> <p>Nxënësit janë porositur të sjellin materiale të ndryshme në lidhje me sportet në Greqinë e lashtë. Për të mos pasur përsëritje, klasa ndahet në grupe me tematika rreth asaj që do të hulumtojnë.</p> <p>Grupi I. Historia e sportit në Greqinë e lashtë</p> <p>Grupi II. Llojet e sporteve në Greqinë e lashtë (atletika)</p> <p>Grupi III. Llojet e sporteve në Greqinë e lashtë (boksi, mundja)</p> <p>Grupi IV. Lojërat olimpike (Qëllimi, veshjet, vendi)</p> <p>Grupi V. Traditat dhe karakteristikat e lojërave olimpike</p> <p>Grupin VI. Lojërat olimpike sot</p> <p>Nxënësit hulumtojnë por dhe ndërtojnë pyetje rreth materialeve që kanë hulumtuar e të cilat do t'i ngrenë si çështje diskutimi.</p> <p>Më poshtë ka materiale që lidhen me çështjet e mësipërme.</p> <p>Kishte tri gara vrapimi në distanca të ndryshme. E para, me gjatësi prej 200 metrash, bëhej rreth stadiumit. E dyta, e ngjashme me garat e sotme të 400 metrave, përfshinte dy xhiro rreth stadiumit, dhe e fundit ishte gara prej rreth 4 500 metrash.</p> <p>Pjesëmarrësit në pesëgarësh konkurronin në pesë disiplina: vrapim, kërcim së gjati, hedhje disku, shtize</p>			

dhe mundje. Ndeshjet e tjera përfshinin boksen dhe pankratin, që përshkruhet «një sport i dhunshëm, një kombinim i boksit pa doreza me mundjen». Pastaj ishte edhe gara me karroca që përshkonte një distancë prej tetë xhirosh rreth stadiumit. Karrocën ishin të lehta, të hapura nga pas me rrota të vogla dhe tërhiqeshin nga dy apo katër mëza ose kuaj.

Boksi ishte jashtë mase i dhunshëm dhe ndonjëherë vdekjeprurës. Shpërfytyrimin e tmerrshëm të boksierëve e dëshmojnë statujat dhe mozaikët e lashtë. Boksierët mbështillnin përreth grushteve rripa lëkure të ashpër ku fusnin copa metalike që të bënin copë e çikë. Është e lehtë të kuptosh pse një boksier me emrin Stratofonte nuk e njohu veten në pasqyrë, pasi kishte bërë boks për katër orë rresht.

Në mundje, sipas rregullave, duhej ta kapje kundërshtarin vetëm në pjesën e sipërme të trupit dhe fituesi ishte ai që e rrëzonte tri herë kundërshtarin përtokë. Por, ndryshe nga mundja, në pankrat çdo lloj kapjeje ishte e lejuar. Kundërshtarët mund të shkelmonin, të grushtonin ose t'i ndrydhnin kyçet njëri-tjetrit. Ndalohej vetëm nxjerrja e syve, gërvishtja dhe kafshimi. Qëllimi ishte ta bllokoje kundërshtarin përtokë dhe ta detyroje të dorëzohej. Disa e konsideronin «shfaqja më e mrekullueshme në të gjithë Olimpin».

Garat me karroca ishin më prestigjiozet dhe më të famshmet ndërmjet aristokratëve, pasi fituesi nuk ishte kalorësi, por pronari i karrocës dhe i kuajve. Çastet vendimtare në garë ishin në fillim të saj kur kalorësit duhej të qëndronin në korsi, dhe për më tepër kur merrnin kthesën në fund të korsisë. Gabimet ose shkeljet e rregullave mund të shkaktonin aksidente që e bënin këtë garë të famshme edhe më spektakolare.

Çmimet

«A nuk e dini se në një garë vrapojnë të gjithë vrapuesit, por vetëm një e merr çmimin?» –tha apostulli Pavël. Gjëja më e rëndësishme ishte të fitojë. Nuk kishte medalje argjendi apo bronzi, vend të dytë apo të tretë. Në ekspozitë shpjegohet: «Fitorja, 'Nike', ishte qëllimi përfundimtar i atletit. Vetëm kjo mjaftonte, meqë fitorja ishte pasqyra e vërtetë e karakterit të tij si fizik, ashtu edhe moral, dhe ishte krenaria e qytetit.»

Çmimi që i jepej fituesit në Lojërat panhelenike ishte thjesht simbolik—një kurorë gjethesh Pavli e quajti «një kurorë të prishshme». Megjithatë çmimi mbartte një domethënie të madhe. Ai përfaqësonte vetë forcën e natyrës që ia jepte fuqinë e saj fituesit.

Kurorat Olimpikë bëheshin me gjethe ulliri të egër, me degë pishe, me gjethe dafine dhe me selino të egër. Në vende të tjera, organizuesit e lojërave ofronin çmime në para ose çmime të tjera për të tërhequr konkurruesit profesionistë.

Qyteteve greke u pëlqente të shijonin famën e atletëve të tyre. Këto fitore i kthenin ata në figura heroike në vendin ku banonin. Kthimi i fituesve festohej me parakalime triumfale nëpër rrugë. Lojërat Olimpikë mund t'i duken gjithkujt sot si diçka shumë moderne, por në fakt nuk është ashtu. Olimpiada vjen nga lashtësia. Por nëse do të krahasonim lojërat e atëhershme me ato të sotme, a do të gjenim vallë gjëra të përbashkëta? Le ta bëjmë këtë krahasim në disa aspekte...

Çfarë vishnin apo nuk vishnin atletët e lashtësisë?

Së pari, duhet thënë se Lojërat Olimpikë ishin ekskluzivisht të rezervuara për meshkujt, sepse ato ishin më shumë të fokusuar te sportet marciale dhe ndeshjet fizike. Madje gratë nuk lejoheshin as të ishin spektatore. Megjithatë gratë mund të ndesheshin në ndeshje të tjera, por edhe atëherë jo vetë, por duke u përfaqësuar nga karrocën e garave që i kishin në pronësinë e tyre. E vetmja grua që arriti një rekord në këtë garë me karrocën e saj ishte një princeshë spartane. Një nga arsyet e përjashtimit të grave nga garimet ishte ndoshta se atletët, boksierët dhe mundësit, të gjithë ishin tërësisht lakuriq në garim. Fjala e vjetër greke që përdoret për fjalën “të ushtrohesh”, donte të thoshte fjalë për fjalë “të jesh i zhveshur”. Të gjitha termat gjimnastikore që përdorim sot, vijnë nga ajo periudhë e Greqisë së lashtë dhe një pjesë e madhe kanë kuptim fetar.

Ku zhvilloheshin ndeshjet?

Olimpiada zhvillohej në “stadion” apo “stadium”. Aty kryheshin fillimisht edhe garat e 200 metrave. Më pas u shtuan me gara 400 metra për të arritur tek 5000 metërshi, kërcimi së larti, së gjati, mundja ekstreme dhe përlëshjet e ndryshme dhe më pas erdhën edhe garat me karroca e kuaj.

Qëllimi i lojërave

Lojërat Olimpikë organizoheshin për nder të zotave, si të Zeusit, motrës së Zeusit, Herës, apo heroit Pelops, i cili konsiderohet edhe si një nga themeluesit e Lojërave Olimpikë. Por ishte Zeusi ai që merrte të gjitha nderet, adhurimet dhe blatimet, përfshi edhe ngritjen e tempujve të mëdhenj me statuja të arta dhe të fildishta pjesërisht, të krijuara nga një artist i famshëm i kohës me emrin Fidias i Athinës. Pikërisht tempulli i Zeusit, i krijuar prej tij, konsiderohej si një nga shtatë mrekullitë e botës së lashtë.

Ku zhvilloheshin lojërat?

Lojërat janë zhvilluar gjithmonë në të njëjtin vend, në një vend shumë të largët në veriperëndim të Peleponezit, që njihej me emrin Olimpia, dhe ishte shumë e vështirë që të mbërrije aty. Zakonisht shkohej me këmbë edhe nga njerëz që ndodheshin në qendrat e Spartës dhe Athinës. Garuesit dhe spektatorët vinin jo vetëm nga vendet më të rëndësishme të Greqisë, por edhe nga e gjithë bota helenike që fillonte nga Spanja e deri në Gjeorgji shumë më përtej pellgut të Egjeut. Pas pushtimeve të Aleksandrit të Madh, i cili vdiq në vitin 323 para Krishtit, grekët do të shtriheshin edhe në zona të tilla të largëta, si Afganistani dhe Sindi.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim

Nxënësit ndërtojnë pyetje që lidhen me hulumtimet e kryera dhe ia drejtojnë njëri-tjetrit, duke pasur parasysh që të kenë një rrjedhë logjike nga historia deri në lojërat olimpikë sot.

Gjatë diskutimeve nxënësit duhet të orientohen të flasin qartë, pa gabime, kuptueshëm, në standard dhe të të respektojnë rregullat e diskutimit

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit

Nxënësit krahasojnë lojërat olimpikë sot me ato në Greqinë e lashtë bazuar në informacionet që u përthithën gjatë ndërtimit të njohurive.

Nxënësit flasin dhe për sportin dhe sportistin e tyre të preferuar duke argumentuar mendimet e tyre. (nuk duhet t'i kalohet e gjithë hapësira kësaj pjese).

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë, por dhe me notë, duke vëzhguar hulumtimet dhe pjesëmarrjen në diskutim.

Detyrat dhe puna e pavarur; nëse nuk përfundohet një nga pikat në prezantimin e njohurive, vazhdohet me shkrim në shtëpi.

Informacion shtesë për mësuesin**Sporti në antikitetin grek**


Greqia e lashtë dallohej për shumëllojshmërinë dhe veçantinë e sporteve. Më të praktikuarat ishin: *garat e vrapit, kërcimi së gjati, mundja, boksi, hedhja e shtizës, hedhja e diskut dhe garat me karroca*. Shumica e sporteve lidhen ngushtë me kulturën luftarake të qytetërimit antik grek dhe vetëm burrat mund të merrnin pjesë. *Lojërat Olimpikë* mendohet të jenë zhvilluar për herë të parë në një fshat të vogël të Peloponezit, në vitin 776 p.K. për të nderuar *Zeusin*. Olimpiada nuk ishte vetëm një aktivitet sportiv, por edhe përfaqësim i aftësive individuale të pjesëmarrësve, të kulturës, por mbi të gjitha për të treguar respektin ndaj perëndive. Në rast se gjatë periudhës së zhvillimit të lojërave lindnin armiqësi, kjo cilësohej si sakrilegj duke qene se ato shërbenin për të nderuar Zeusin. Që nga fillimi e deri në përfundim të Lojërave Olimpikë shpallej një armëpushim që ndalonte çdo lloj lufte apo mosmarrëveshje midis popujve greke. Edhe nëse dikush dënohej me vdekje, ekzekutimi i tij bëhej në përfundim të aktivitetit olimpik. I ashtuquajtur “armëpushim olimpik” u lejonte grekëve të bashkoheshin në mënyrë paqësore për të garuar midis tyre në ditët e zhvillimit të lojërave olimpikë. Kampionëve olimpikë u janë kushtuar shumë këngë, shumica e të cilave janë shkruar nga Pindari. Statujat, relievet, mozaikët dhe pikturat në vazo prej balte që u ekspozuan në Kolose paraqisnin pamje nga këto gara. Numri i disiplinave ishte mjaft i kufizuar. Programi i Lojërave të lashta Olimpikë nuk përfshinte kurrë më shumë se dhjetë lloje garash.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Prometeu i lidhur (ora I)		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin, jeta e Eskilit	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • flet shkurtimisht për jetën e Eskilit dhe veprën e tij “Prometeu”; • lexon në role fragmentin • shpjegon fjalë e shprehje të reja nga teksti duke përdorur shembuj dhe kontekstin e pjesës; • shpreh bukur mesazhin që përcjell pjesa. 		Prometeu, Pushteti, Hefesti, tragjedi.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve, materiale të nxënësve në lidhje me Eskilin.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bashkëbisedim, lexim në role, punë e drejtuar, punë e pavarur, punë me klasën.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: bashkëbisedim

Nxënësit janë porositur të sjellin materiale në lidhje me Eskilin dhe veprën e tij “Prometeu”, për të cilat flasin shkurtimisht, pasi prezantohet titulli dhe autori i pjesës.



Eskili ka pasur një veprimtari shumë të gjerë letrare. Ka shkruar rreth 90 tragjedi, nga të cilat janë ruajtur të plota: *Lutëset*, *Persët*, *Të shtatë kundër Tebës dhe Agamemnoni*, *Koforet*, *Eumenidet*, që janë pjesë përbërëse të trilogjisë Orestia (5). Përveç tragjedisë *Persët*, të gjitha të tjerat i kanë marrë subjektet nga mitet dhe legjendat e lashta, përmes të cilave Eskili shprehu shpirtin e kohës, përplasjet politike e shoqërore, virtytet dhe veset.

Tragjedia “Prometeu i mbërthyer” është një nga veprat më madhështore të Eskilit. Kjo tragjedi është pjesë përbërëse e një trilogjie, dy pjesët e tjera të së cilës *Prometeu zjarrsjellës* dhe *Prometeu i çliruar* nuk janë ruajtur. Sipas mitit, Prometeu krijoi me baltë njeriun e parë, i cili me kohë, u shumëzua, Që të mos i linte në mjerim dhe padije, shkoi te qerrja e zjarrtë e Diellit (Helios), vodhi një shkëndijë, të cilën e vuri në një kallam dhe këtë burim të zjarrit hyjnor ua solli njerëzve. Kjo e bëri Zeusin të tërbohet nga mëria, dhe të urdhërojë Pushtetin, Dhunën dhe Hefestin ta mbërthejnë Prometeun në një shkëmb në malet e Skithisë në Kaukaz. Këtu fillon dhe veprimi i tragjedisë që zhvillohet në atë vis të egër e të shkretë,

ku nuk ka shkelur këmbë njeriu. Derisa Prometeu është duke u ankuar për këtë ndëshkim të padrejtë, dëgjohej frushullima e flatrave të nimfave oqeanide, që vijnë nga larg për ta ngushëlluar së bashku me babanë e tyre, Oqeanin, i cili i shpreh keqardhjen heroit dhe orvatet ta bindë që të pajtohet me Zeusin. Por Prometeu pranon më mirë të vuajë se sa t'i përulet tiranit. Oqeani largohet. Prometeu i tregon korit të nimfave oqeanide të mirat që i ka sjellë njerëzimit. Zeusi, i tërbuar nga qëndrimi i paepur i titanit, dërgon Hermesin për ta kërcënuar dhe për ta detyruar t'i zbulojë të ardhmen, por Prometeu hesht. Heshtja e tij shpreh më shumë se çdo fjalë urrejtjen për tiranin. Atëherë Zeusi nuk duron më dhe e gjuan me rufe Prometeun, i cili groposet bashke me shkëmbin ku ishte mbërthyer, në fund të dheut. Hefesti i bindet urdhrin të Zeusit, por i dhimbset Prometeu, ashtu siç i dhimbset edhe Oqeanit, veçse këta nuk arrijnë të kuptojnë se si mund të guxojë ndokush të ngrihet kundër Zeusit. Ato që ndiejnë një dhembje me të vërtetë të thellë për Prometeun, janë nimfat oqeanide, që janë plotësisht të ndërgjegjshme për karakterin mizor të Zeusit.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i pjesës në role*

Përzgjidhen 4 nxënës që të lexojnë me intonacion, në mënyrë të vetëdijshme dhe shprehëse rolet e Prometeut, Pushtetit, Hefestit, Kori.

Leximi në role mund të përsëritet dy tri herë. Ndërkohë gjatë leximit nxënësit veçojnë fjalë e shprehje që nuk i kuptojnë, duke i shpjeguar së bashku përmes kontekstit dhe ilustruar me shembuj.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, punë me klasën.*

Kalohet në zërthimin e përmbajtjes së fragmentit. U kërkojmë nxënësve të ndërtojnë pyetje rreth tekstit, duke ndjekur një rrjedhë logjike. Për këtë përdoren pyetjet e tekstit. Nëse nga nxënësit nuk dalin plotësisht pyetje rreth të kuptuarit, ndërhyjmë me pyetje shtesë.

- *Si fillon fragmenti dhe çfarë tregohet në të?* Fragmenti hapet me fjalët e Pushtetit, i cili ndodhet në majën më të lartë të një shkëmbi të maleve të Skithis, ku bashkë me Hefesin duhet të zbatojë urdhrin e Zeusit për të mbërthyer Prometeun.
- *Si reagon Hefesti, kur Pushteti i drejtohet për të zbatuar urdhrin e Zeusit?* Hefesti i vjen keq që është i detyruar të dënojë Prometeun, një tjetër perëndi, por nuk mund të shkelë urdhrin e Zeusit.
- *Pse po dënohet Prometeu?* Sepse u vodhi zjarrin perëndive dhe u dha njerëzve, asaj race që ai duket se krijoi vetë dhe nuk donte ta linte në errësirë, ndërkohë që Zeusi kërkonte ta zhdukte si racë, për të krijuar një tjetër racë të pastër dhe dhënia e zjarrit i bëri ata më të qëndrueshëm, filluan të bëheshin më të ditur dhe të dilnin nga errësira jo vetëm fizike, por dhe mendore.
- *Si arriti t'ua merrte zotave zjarrin?* Prometeu ua mori fshehurazi dhe pa më të voglën dëshirë.
- *Pse konsiderohet si më i vuajturi dhe më madhështori për njerëzimin?* Konsiderohet si më i vuajturi, sepse dënimi i tij pas prangosjes në shkëmb ishte një torturë e paimagjinueshme. Mëlçia e tij do të hahej nga shqiponjat dhe ai jo vetëm që s'do të vdiste, por do të vuante në pafundësi.
- *Kujt i drejtohet ai me thirrjen e tij?* Ai u drejtohet atyre që janë si ai, perëndive dhe hyjnive të tjera se sa i padrejtë i duket ai vendim, për ta dënuar atë që është i një rangu me ta.

Në përfundim nxënësit nxjerrin mesazhin që ka dashur të japë autori përmes këtij fragmenti.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit, me gojë dhe me notë pas orës së dytë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra. Komentoni vargjet.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII	
Tema mësimore: Prometeu i lidhur (ora II)		Situata e të nxënit: punë me tekstin		
Kompetenca: Të lexuarit				
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale 				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore				Fjalët kyç:
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përcakton simbolikën e zjarrit të Prometeut; • evidenton elemente që e bëjnë këtë pjesë një vepër tragjike; • jep gjykimin e tij rreth figurës së Prometeut nisur nga fjalët dhe veprimet e tij; • argumenton mendimin e tij rreth personazheve të tjera në fragment; • shpjegon funksioni e figurave në tekst. 				Promete, Pushtet, Hefesti, Zeusi
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve.				Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: ditarët e të nxënit, punë e pavarur				

Organizimi i orës së mësimt:

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Tabela e personazhit.*

Kontrollohen detyrat dhe lexohen duke diskutuar dhe bërë vlerësimet e nevojshme. Nxënësve u kërkohet të rikthehen në tekst për të analizuar personazhet të cilët mbartin dhe mesazhin që jep autori në këtë fragment.

Personazhet	Cilësitë	Ku duken	Mendime	Veprime	Gjykimi yt
Prometeu	I vuajtur, i do njerëzit i drejtë, i dhembshur, i guximshëm, fatkeq	Vuan një dënim shumë të rëndë, nga dashuria për njerëzit. Për t'u dhënë atyre zjarrin, dritën hyri në armiqësi me tërë perënditë e sidomos me Zeusin, i drejtë, mendonte që njerëzit, si edhe perënditë, kishin të drejtë të përmirësonin jetën e tyre; i dhembshur, ndiente keqardhje për njerëzit dhe donte t'i nxirrte nga padituria dhe errësira; i guximshëm, kur iu kundërvu Zeusit; fatkeq sepse pas mirësisë që bëri jo vetëm nuk u shpërblye me mirënjohje, por u dënua barbarisht.	Mendonte se edhe njerëzit duhet ta kishin zjarrin për të dalë nga errësira, u mësoi artet e shumë dituri të tjera	U dha zjarrin njerëzve, Duron torturat	

Pushteti	Servil i Zeusit	Zbatonte verbërisht urdhrat e tij.			
Hefesti	I dhembshur, jo aq i guximshëm	Nuk iu kundërvu Zeusit dhe shkoi të zbatonte urdhrin e Zeusit, ndonëse i padrejtë			

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: ditarët e të nxënës, punë e pavarur.

Nxënësit rikthehen në tekst për të gjetur ato elemente që e bëjnë këtë pjesë një fragment tragjedi. Për shembull: lidhe me vargonj..., pse tregon mëshirë..., në pranga më mbërthyen, ... o i mjeri unë... etj. Kalohet në analizën figurative, që me ditar trepjesësh shpjegohen jo vetëm për llojin, por edhe efektin stilistik. Ndhijmohet nxënësit të shohin veç figurave që njihin, dhe prishjen e rendit të zakonshëm të fjalëve, inversionin.

Figura	Lloji	Efektin stilistik
Më i largëti cep Njerëzve ua dha Dashurinë për njeriun ta harrojë, të rreptin urdhër	Inversion	Do të theksojë se në ç’vend të shkretë larg njerëzve dhe të egër do të prangosej Prometeu.
Së shkretë Të rreptë Etër qiellorë, këmbëshpejtë, të mbërthyer në pranga	epitet	
Fjalët e Hefestit,	Pyetje retorike	Kërkon të japë dyshimin, dhembjen, dashurinë e Hefestit për Prometeun.
O ju burime lumenjsh të kulluar	Apostrof	I drejtohet natyrës së mrekullueshme, sepse nuk e dëgjon kusht tjetër dhembjen e tij.
Dy vargjet te Prometeu	Pyetje retorike	Ndonëse Prometeu e dinte që do të dënohej për zjarrin që vodhi, ai sërish e bëri se dashuria për njerëzit që më e madhe dhe dënimi nuk mund ta trembte.
Të mbërthyer, fatkeq,	Epitet	Gjendjen e dëshpëruar në të cilën ndodhet
Oh i mjeri unë	Epitet pasthirmë	Vuajtjet e tij...
Lot të hidhur	Epitet	Dhembja për gjendjen e Prometeut dhe pamundësia për të bërë gjë
Si me vello i mbështjellin	Similitudë	Pamja e vuajtur e Prometeut në sytë e tyre
Madhështor	Mbiemër	Dhe pavarësisht nga vuajtjet, para syve të gjithkujt ai është i pamposhtur dhe madhështor

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit, me gojë dhe me notë.

Detyrat dhe puna e pavarur: pika 6, nënpika b.


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për kryefjalën e kallëzuesin Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënit: <i>Një mëngjes i zakonshëm.</i> Krijimi i një teksti përshkrues me fjali të thjeshta, për të gjetur kryefjalën dhe kallëzuesin.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalinë e dhënë zgjeron grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit sipas kërkesës ndërton fjali me kallëzues të llojeve të ndryshme dhe kryefjalë të shprehur në mënyra të ndryshme 		Fjalët kyç: gjymtyrë kryesore, kryefjalë, kallëzues.	
Burimet: teksti i nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>pema e mendimit, punë e pavarur, punë e drejtuar, shkrim i lirë.</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit. Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit rikujtojnë njohuritë rreth gjymtyrëve kryesore dhe i pasqyrojnë ato në skemën e pemës së mendimit duke i ilustruar me shembuj.			
<pre> graph TD A[Gjymtyrët kryesore të fjalisë] --> B[kryefjala] A --> C[kallëzuesi] B --> D[Ç'tregon] B --> E[Me se shprehet] C --> F[Ç'tregon] C --> G[Llojet] G --> H[Kallëzues foljor] G --> I[Kallëzues emëror] H --> J[I thjeshtë] H --> K[I përbërë] K --> L["(Me se shprehet)"] </pre>			
2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Ushtrime</i> Ushtrimi 1, 2, 3, 4, 5, 6 sipas kërkesës. Ushtrimi 7. <ul style="list-style-type: none"> <i>Oborri i shkollës</i> - kryefjalë, <i>ishte mbushur</i> - kallëzues i thjeshtë foljor, <i>Disa nga rregullat e shkollës sonë</i> - kryefjalë, <i>të tilla janë</i> - kallëzues emëror (jam + përemër) <i>Arbeni</i> - kryefjala, <i>kush është</i> - kallëzues emëror <i>Notat muzikore</i> - kryefjalë, <i>u shpikën</i> - kallëzues i thjeshtë foljor <i>Kënga e zogjve</i> - kryefjalë, <i>nisi të shuhej</i> - kallëzues i përbërë foljor 			
Vlerësimi: Sipas realizimit të rezultateve të të nxënit dhe për të gjithë performancën e nxënësit dhe në orët më parë.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 8			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kundrinorët. Kundrinori drejtë		Situata e të nxëniet: Punë me tekstin.	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë			
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:: <ul style="list-style-type: none"> dallon kundrinorët në fjali si pjesë e grupit foljor. identifikon kundrinorin e drejtë; përcakton klasat e fjalëve me të cilat shprehet kundrinori i drejtë; diskuton për rolin e kundrinorit të drejtë në fjali; ndërton fjali me kundrinorë të drejtë sipas kërkesës. 		Fjalët kyç: kundrinori drejtë, gjymtyrë e dytë.	
Burimet: Teksti i nxënësit, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, INSERT</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*

Kontrollohet, diskutohet dhe vlerësohet detyra e shtëpisë. Kalohet në disa pyetje rreth grupit foljor në fjali dhe gjymtyrëve të tij duke veçuar gjymtyrët e dyta në përgjithësi dhe kundrinorët në veçanti. Nxënësit mund të plotësojnë skemën e mëposhtme:



Në bazë të njohurive që kanë, nxënësit flasin për ato që dinë në lidhje me kundrinorët.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *analizë rastesh, punë e drejtuar, diskutim, INSERT*

Nxënësit lexojnë tekstin në hyrje të mësimit dhe nga njohuritë që kanë për kundrinorët i veçojnë ata duke thënë llojin nëse munden dhe me se janë shprehur. Shënohen në tabelë nga përgjigjet e nxënësve, klasat e fjalëve me të cilat shprehen kundrinorët në bazë të llojit.

Nxënësit heqin ndonjë nga kundrinorët dhe përcaktojnë domosdoshmërinë e tij në fjali. U kërkohet nxënësve të punojnë në tekst me shenjat e tabelës INSERT dhe diskutohen njohuritë sipas kategorizimit të njohurive.

√	+	-	?
Njohuri që nxënësi i ka marrë	Njohuri të reja që nxënësi i kupton	Njohuri të reja që nxënësi i di ndryshe	Njohuri që nxënësi nuk i kupton

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Bashkëbisedim, stuhi mendimi*

Përmes një bashkëbisedimi ose stuhisë së mendimit, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të flasin shkurt për aventurat dhe historinë e Odisesë. Në veçanti u kërkohet të flasin shkurtimisht për aventurat e tij në ishullin e Circes. Nxënësit mund të përdorin si burim informacioni edhe ekranizimet edhe përshtatjet e ndryshme, përveç poemës së Homerit.

2. Ndërtimi i njohurive të reja; *Dëgjim i materialit në disk ose i lexuar nga mësuesi/ja, diskutim,*

U kërkohet nxënësve që të dëgjojnë me vëmendje tri pjesët me të njëjtën tematikë. U tërheqim vëmendjen, që të mund të mbajnë shënime se për çfarë flitet në secilin tekst dhe ndonëse nga e njëjta tematikë, të tregojnë mënyrën e si e sjell informacionin secila prej tyre.

Materiali mund të dëgjohet në disk me mjete të digjitalizuara ose mund të lexohet secili fragment nga nxënës që kanë interpretim, intonacion, kuptueshmëri dhe qartësi.

Pas dëgjimit ata plotësojnë me informacionin e marrë kërkesat e librit.


Mund të lexohen tekstet edhe një herë, me qëllimin që nxënësit të dallojnë karakteristikat e personazheve, që sillen në to dhe të dallojnë si shprehet ndikimi i mitologjisë në poezinë moderne.

Mund edhe t'i udhëzojmë ku trajtohet figura e Circes (sirenës), si personazh mitologjik, ku trajtohet si një detaj për të cilin jepet informacion dhe ku si një motiv për të shkruar një poezi.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura; *diskutim, punë e pavarur, Diagrami i Venit.*

Nxënësit lexojnë punën e bërë për t'u dhënë përgjigje kërkesave të ushtrimit 1.

- Ata duhet të dallojnë që fragmenti nga “Odisea” i Homerit është një poemë epike, “Kënga e sirenavë” një tekst informativ dhe “Lorelai” një poezi lirike. Nxënësit bëjnë dallimin mes mënyrës se si e trajtohet figura e sirenavë në të tri fragmentet.
- Fragmenti i Homerit nga “Odisea” është poemë epike ku Circa (figura mitologjike e sirenës) trajtohet si një personazh që rrëfen dhe dialogon ngjarje që kanë zhvillim, ndërsa teksti i dytë “Kënga e sirenavë” është një tekst informativ, ku jepet një informacion për sirenat dhe konkretisht një prej tyre që vjen nga mitologjia, Lorelai. Në poezinë e Hajnes “Lorelai” kemi një shprehje të ndjenjave (trishtimi) e mendimeve të poetit, (ndaj është një poezi lirike), rreth natyrës dhe konkretisht duke parë statujën e kësaj figure mitologjike, Lorelait. Pra ndikimi i mitologjisë greke ndihet në poezinë e Hajnes dhe kjo sepse gjithmonë mitet, folklori janë burim frymëzimi për të rikrijuar ngjarje e shkruar poezi për shkrimtarët e çdo kohe.
- U kërkojmë nxënësve të krahasojnë këto tri tekste me Diagram Veni **Të tri tekstet flasin për sirenat**



E përbashkëta është se të tri tekstet flasin për sirenat.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Gjeni një fragment nga “Prometeu i mbërthyer” (nga teksti shkollor), nxirrni të dhëna nga Interneti për figurën e Prometeut dhe krahasojni me poezinë “Përralla e re për Prometeun dhe shtegtimin e tij” nga Fahredin Gunga, disident, poet i letërsisë moderne shqipe.

Përcaktoni llojin e tekstit dhe si e trajton figurën e Prometeut secila prej tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ymer Aga (ora I)		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin.	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • flet për motivin e këngës popullore “Ymer Aga”; • lexon me intonacion pjesë për t’u përgjigjur r pyetjeve për të kuptuarit e përmbajtjes • shpjegon përmes kontekstit fjalë e shprehje nga fondi popullor; • diskuton rreth mesazheve që transmeton pjesa. 		Folklor, Ymer Aga, baladë, personazh, besa	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve , materiale të ndryshme të nxënësve për baladat. https://www.youtube.com/watch?v=xCOq_52f_bY (kënga e Ymer Agës”, kënduar nga rapsodët.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: vëzhgim i materialit në videoprojektor, punë e drejtuar, pyetje-përgjigje, diskutim			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: diskutim.</p> <p>Nxënësit janë porositur që të lexojnë materiale rreth baladave, motiveve dhe heronjve të saj. Flasin shkurtimisht (çfarë janë baladat, baladat më të njohura, heronjtë, motivet etj).</p> <p>Balada është një formë e veçante e letërsisë gojore, në të cilën janë të përziera elementet epike e dramatike, por ku zotërojnë edhe elementet lirike. Emri i saj del nga folja neolatine Ballare (<i>vallëzoi</i>).</p> <p>Në qendër të baladës nuk janë temat kolektive e heroike. Në qendër të saj është tragjika individuale, kurse koncepti themelor i saj është nderi apo besa e dhënë.</p> <p>Strukturën përmbajtësore të baladës nuk e karakterizon as përshkallëzimi epik, as një paraqitje kronologjike. Por kapërcimet e mëdha dhe përqendrimi në situata themelore të zhvillimeve psikologjike. Dallimet e baladës si formë në letërsi lidhen me tepër me atë se cili është elementi që mbizotëron në strukturë, elementi dramatik, lirik a po epik. Disa balada të njohura janë:</p> <p>“Halil Garria”, “Qaj Maro, qaj moj bijë” , “Ymer Aga”, “Kënga e Dhoqinës” etj</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: vëzhgim i materialit në videoprojektor, punë e drejtuar në tekst, lexim i pjesës.</p> <p>Bëhet leximi i fragmentit dhe nxënësit specifikojnë momentin që përshkruhet në të nga e gjithë historia. Nxënësit ndërkohë veçojnë fjalë e shprehje të reja, që nuk u dinë kuptimin dhe i shpjegojmë së bashku,</p>			

duke shfrytëzuar kontekstin e vargjeve. U bëhet e ditur nxënësve se baladat gjenden në disa variante nga një zonë në tjetrën, por dhe nga një popull në tjetrin.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e drejtuar, pyetje-përgjigje.*

Nxënësve u kërkohet të imagjinojnë historinë e Ymer Agës para momentit që jepet në fragment. Pa bërë komente vendosim të dëgjohet balada e plotë, e kënduar nga rapsodë popullorë në video- projektor.

https://www.youtube.com/watch?v=xCOq_52f_bY

Pasi dëgjojnë këngën, nxënësit flasin shkurtimisht për historinë që dëgjohet dhe trajtohet në të. Kjo bën të mundur që nxënësit, duke njohur historinë, të kuptojnë fragmentin. Nxënësve u drejtohen pyetje që zërthejnë motivin e trajtuar në këtë baladë, që vjen në formë të plotë për të gjitha baladat.

- Çfarë motivi trajtohet në këtë baladë? Ilustro me vargje nga pjesa.
- Çfarë i ka ndodhur heroit kryesor në të?
- Si e ka zgjidhur autori popull mbajtjen e fjalës së Ymer Agës? Ilustro.
- Cilat janë shenjat nga të cilat e dallon nusja të shoqin? Ilustro.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit hulumtojnë për të gjetur variante të tjera të kësaj balade dhe përfundimet e mundshme të saj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ymer Aga (ora II)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin.	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • sjell variante të tjera të baladës së Ymer Agës; • portretizon Ymer Agën fizikisht dhe për botën shpirtërore; • bën analizën strukturore të pjesës; • nxjerr shembuj nga pjesa, karakteristike për një baladë. 		baladë, Ymer Aga, Besë.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve, materiale të ndryshme për baladat		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e pavarur, analizë teksti, analizë personazhi.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *diskutim*

Bëhet kontrolli i detyrave dhe diskutohet gjerësisht për variantet që ka kjo baladë dhe sidomos për variantin ulqinak “Ymer Agë Ulqini” dhe përfundimin e saj.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *analizë teksti, analizë personazhi, ditarët e të nxënësve*

Kalohet në analizën e figurës së Ymer Agës. Nxënësit japin tipare të figurës së tij, sidomos ato që lidhen me karakterin, duke e ilustruar me vargje.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *analizë strukturore*

Nxënësit analizojnë llojin e vargut, rimës dialogut, subjektit, zgjidhjes etj. Gjithashtu nxënësit nxjerrin dhe tregojnë karakteristikat e baladës.

Punohen ushtrimet e tekstit.

Vlerësimi: sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë.


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kundrinori i zhdrejtë		Situata e të nxënësve: <i>Tregime të moçme shqiptare</i>	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon kundrinorët në një tekst të dhënë; • përcakton llojin e kundrinorëve; • tregon me se shprehet kundrinori; • ndërton fjali me kundrinorë sipas llojit. 		gjymtyrë, kundrinor, i drejtë, i zhdrejtë, me parafjalë, pa parafjalë.	
Burimet: Teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, pema e mendimit, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, tabela e koncepteve.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve, *stuhi mendimi, diskutim.*

Kontrollohen detyrat e shtëpisë, diskutohen ato dhe bëhet një vlerësim i përgjithshëm i tyre.

Nxënësit plotësojnë sërish skemën e gjymtyrëve kryesore dhe të dyta të fjalisë.



2. Ndërtimi i njohurive të reja: analizë rasti, diskutim, tabela e koncepteve.

Nxënësit punojnë me tekstin në krye të mësimit për të gjetur kundrinorët dhe për të përcaktuar llojin e tyre. U jepet nxënësve një listë pyetjesh të cilave u përgjigjen dhe plotësojnë tabelën e konceptit si më poshtë:

Kundrinori	Lloji	Me se shprehet	Pyetja me të cilën gjendet	Vendi në fjali

Nxënësit japin vetë shpjegimet në lidhje me të gjitha konceptet që lidhen me kundrinorët duke i ilustruar dhe me shembuj. Punohet ushtrimi 1 dhe diskutohet rreth saj.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrime, punë e pavarur

Ushtrimi 1 punohet sipas kërkesës. *Vashën (e)* kundrinor i drejtë. *Fjalën (e)* kundrinor i drejtë. *(I)* kundrinor zhdrejtë pa parafjalë i shprehur me trajtë të shkurtër. *Javos (i)* kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë.

Kujdes! Grupet e fjalëve: *me gjithë gurë e drurë, (me shtatë krerë e shtatë brirë, me sytë si pishtarë, me gojën..., me flatra...)* janë përcaktorë. *Tym e flakë* (kundrinor i drejtë), *barin, lulet dhe shkurret* (kundrinor i drejtë).

Ushtrimi 2 sipas kërkesës. Kihen parasysh udhëzimet e dhëna në temën “Kundrinori i drejtë”, ushtrimi 4, por këtë radhë në anë të kundërt.

P.sh.: Hëna e plotë zbehu ndriçimin e yjeve. Ndriçimi i yjeve u zbeh nga hëna e plotë.

Ndryshimet e ndodhura janë:

- Folja nga veprorë kthehet në joveprorë
- Kundrinori i drejtë në kryefjalë
- Kryefjala në kundrinor të zhdrejtë me parafjalë

Ushtrimi 3. Sipas kërkesës mund të punohet dhe me tabelën e koncepteve:

Kundrinori	Lloji	Me se shprehet
<i>të gjithë këtë krahinë të madhe (e)</i>	kund. i drejtë	GE dhe trajtë të shkurtër
<i>shoqen time të klasës (e)</i>	kund. i drejtë	GE dhe trajtë të shkurtër
<i>shokëve të mi të klasës (u)</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	GE dhe trajtë të shkurtër
<i>me një dritë të kulluar</i>	kund. i zhdrejtë me parafjalë	GE dhe parafjalë
<i>trimat (i)</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	emër dhe trajtë të shkurtër
<i>Gjergjit (i)</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	emër dhe trajtë të shkurtër
<i>shokëve të mi (u)</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	GE dhe trajtë të shkurtër
<i>për detin</i>	kund. i zhdrejtë me parafjalë.	emër me parafjalë

Vlerësimi: Vlerësimi i rezultateve të nxënësve bëhet për detyrën e shtëpisë dhe për performancën e tyre gjatë gjithë situatës së të nxënësve dhe çdo etape mësimore dhe në veçanti të ushtrimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
-------------------------------------	----------------------------	---------------------	-------------------

Tema mësimore: Kthejmë vargjet në prozë (ora I) Kompetenca: Të shkruajmë	Situata e të nxënimit: Kostandini e Doruntina
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon një shkrim në vargje nga një prozë me të njëjtën tematikë; evidenton ndryshimet që ndodhin nga njëri lloj shkrimi te tjetri; nxjerr rregullat se si mund të kthehet një shkrim në vargje në prozë; përshtat vargje në prozë nga kënga e Ymer Agës. 	Fjalët kyç: vargje, prozë, parshtatje, figura.
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve, , pjesë në vargje e prozë me të njëjtën tematikë, "Balada e Kostandinit dhe Doruntinës" (apo Kënga e Dhoqinës", e-libri.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, Diagram Veni, punë në çift, punë e drejtuar me modele, punë e pavarur, diskutim.</i>	

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Stuhi mendimi*

Prezantohet tema dhe rezultatet e të nxënimit për të, dhe u kërkohet nxënësve të kujtojnë se cilat vepra, që bëjnë fjalë për të njëjtën ngjarje, i kanë gjetur në prozë e në vargje. Këtu mund të kujtojnë veprat e Homerit që janë në vargje dhe të përshtatura në prozë për nxënësit, apo cikli i kreshnikëve që vjen nga Kuteli në “Tregime të moçme shqiptare” etj.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Diagram Veni, diskutim, punë në çift*

Nxënësve u jepen si modele balada në vargje “Kënga e Dhoqinës” dhe në prozë balada “Kostandini dhe Doruntina”, për të punuar në çift.

KËNGA E DHOQINËS...

Ditën e pashkës së madhe/
Seç u ther një ka në fshat/
Vajta mora një ok mish/
Dhe e hodha në kusi/
Na del një gjarpër i zi
U fut brenda në kusi

Dhe helmoi djemtë e mi...
Nëntë djem e nëntë nuse
Të nënta me djem në duar,
Nëntë djepe i përmbysi.
Nëntë pajë i zhuriti
nëntë varre mi bitisi.

Lanet paç,o Kostandin,
Lanet paç o biri im,/
Ma dhe Dhoqinën në fqinj
Më le vetëm për vajtim..
Kostandin ç’të të thotë nëna?
Po tani që m’u bë gjëma,

Ku është besa që më dhe?
Dhoqinën ti, ku ma ke?

E martove aqë larg..
Larg e larg mërguarë..
Tre male kaptuarë..
Ç’e vajton nëna mbi varr
Dhe u kthye duke qarë..

U ngris dita erdh akshami
Kostandini u ngrit nga varri
Gur i varrit u bë kalë
Dheu i varrit ju bë shalë
Mirë kalin e shaloi,
Mori udhën edhe shkoi..
Tre malet i kaptoi
Dhoqinën vate kërkoi..

Na ish dit e pashkës madhe
Dhoqina luante valle
Rrobat qëndisur me ar
Njihej që ish der’ e parë...

Preu vallen nusëria
Dhoqina njohu vëllanë
E njohu, dolli mënjanë

Edhe Kosta ju afrua
Mirdita motra Dhoqinë
Mir se erdhe Kostë vëllai
Për të keq a për të mirë..?
Në më erdhe për të mirë
Do vete të bëj stolinë...

Në më erdhe për të keq
Të vishem si kallogre

Po ç’i do rrobat e tjera?
Ashtu si të zuri hera!
U nis kali e po shkonte
Kali udhës turfollonte...
Udhësë tek shkonin
Te pemët dëgjonin
Zogjtë që cicëronin
Ciliviu, ciliviu...

Kini parë a s’kini parë
Di veta hipur mbi kalë
Shkon i vdekuri me të gjallë..

Në varr te qisha arrinë..
Ik në shtëpi moj Dhoqinë
Se unë do ngjatoj dorinë..
Atje sipër në lëndinë...

Dhoqina u nis në portë..
Kostandini u fut në gropë..

Hap, moj nënë derën,
Jam Dhoqina vetëm
Lipsu, moj murtajë e shkretë,
Vjen këtu të më gënjesh
Ti më hëngre nëntë djemtë
Nëntë djem e nëntë nuse
Nëntë nuse e nëntë djepe
Kërkon dhe mua me vete...?

Hape, nënë, çfarë thua...?
Hape nënë derën
Jam Dhoqina vetëm...
Me kë erdhe moj Dhoqinë.../
Kam ardhë me Kostandinë
Ç’Kostandin, të ardhhtë gjëma?
Kostandini vdekur../
ç’bën tre vjet pa treturë../
Nëna hapi derën
Sheh Dhoqinën vetëm..
Një në prag e një në derë
Plasnë si qelqi në verë..

Besa e Kostandinit

Ish njëherë e një mot një nënë shumë e mirë i kish nëntë bij të hijshëm. Të dhjetën kishte një bijë të bukur mbi shoqet të gjitha, që ia thoshin Dhoqinë.

Vasha u rrit e u bë për t’u martuar. Të gjithë e dëshironin askush s’guxonte ta zërë nuse, sepse nuk e ndjente veten të zotin. Atëherë na vjen një trim i largët; i mirë, i hijshëm, i fisëm dhe nis dërgon shkesë që ta kërkojë Doruntinën nuse. E ëma dhe të vëllezërit e mëdhenj nuk donin t’ia jepnin, sepse trimi, ndonëse i mirë e i fisëm, ishte nga një vend shumë i largët. Vetëm i vogli, Kostandini donte.

–T’ia japim, zonja mëmë, – thosh ai, – trimi është i mirë. Më ka hyrë në zemër.

– Kostandin, biri im, çfarë po thua ti kështu? – ia kthente e ëma. – Aq larg do ma shpiesh Dhoqinën time?

– Të jap besën, zonja mëmë, se kur ta duash ti Dhoqinën, qoftë për gaz, qoftë për helm, vete unë e ta sjell!

Mëma dhe të vëllezërit u bindën dhe e martuan Dhoqinën me trimin e largët. Bënë dasmë nëntë ditë. Të dhjetën trimi mori nusen e shkoi te dheu i tij i largët. Mëma e vasha qanë me lot kur u ndanë ...

... Shumë luftëra u luftuan atë mot dhe të nëntë vëllezërit dolën të luftojnë për vendin e tyre dhe u vranë një pas një të gjithë.

Kur iu vranë gjashtë, që të gjashtë trima e të dashur, ajo derdhi vetëm nga një lot për secilin e bëri vetëm nga një vajtim. Po kur nisën t’i vriten dhe të tjerët, mëmës iu këput zemra dhe lëshoi një psherëtimë të madhe sa uturoi tërë vendi:

– Mjerë unë, ç’helm i madh të mos kem Dhoqinën pranë në këtë zi që më mbuloi shtëpinë!

Kur u vra djali i fundit, Kostandini, mëma shkuli leshrat e bardha e thirri:

– Bobo, ç’vdekje! Ti më more bijtë e mi e tani kush mund ta dijë a s’ma ke marrë edhe bijën time të vetme, bijën time të dëshiruarën!

Kur u gdhi e shtuna e të vdekurve, mëma vajti te varret e të bijve. Bëri një vajtim, po mbi varr të Kostandinit ndezi dy qirinj dhe bëri dy vajtime, qau me ngashërime dhe thirri tre herë:

– O Kostandin! O Kostandin! O Konstandin!

Pastaj u shemb përdhe, pushtoi gurin e varrit e u trua:

– Kostandin, o biri im, ku është besa që më dhe, se do ma sillje Dhoqinën, tët motër? Besa jote vdiq bashkë me ty e kalbet në varr të zi!

Në mesnatë Kostandini u ngrit nga varri. Guri i varrit u bë kalë i zi si nata. Edhe dheu i zi u bë shalë e zezë si nata. Rrotulla që mbante gurin u bë fre i argjendtë. Trimi i hipi kalit, u përkul përpara, uli kryet dhe i ra me shporet. Kaptoi si frymë male e fusha, hodhi lumenj e përrenj, la prapa katunde, kodra , pyje...

Kostandini arriti te shtëpia e motrës kur kish dalë dielli dhe pa një luzmë vashash të bukura tek këndonin e vallonin dhe u afrua të pyesë:

– Gëzuash, o vasha të bardha! A është me ju Dhoqina, motra ime?

Dhoqina e pa vetë dhe i thirri:

– Kostandin, o im vëlla!

Dhe iu afrua e përqafoi. Kostandini i tha:

– Dhoqinë, motra ime! Eja të shkojmë. Të do zonja mëmë në shtëpi!

– Më thuaj vëlla, si të vij unë atje? Po të më dojë për gaz , do të vete të marr stolitë më të mira, por po të më dojë (mos qoftë e thënë) për helm, do vete të vishem me të zeza.

– Eja motër, ashtu si je!.

E mori në vithe të kalit. Kali ikën si shakullimë. Ata kapërcejnë si në ëndërr male e fusha, pyje e kodra, lumenj e përrenj. Hëna e yjet kanë shtangur.

Gjatë udhës, motra e pyet vëllanë:

– Kostandin, vëllai im, përse shpatullat e gjëra të janë mbushur me myk?

– Doruntinë, motra ime, shpatullat m’i ka mbuluar tymi në luftë.

– Kostandin, vëllathi im, përse flokët e derdhura i ke gjithë pluhur?

– Doruntinë, motra ime, gjatë udhës kishte shumë pluhur dhe m’i pluhurosi flokët.

– Kostandin, vëllathi im, përse vëllezërit e mi të bukur si drita, s’kanë dalë përpara të na presin?

– Dhoqinë, motra ime, ndoshta janë në lodër e s’presin të vemi sonte.

– Kostandin, vëllathi im, përse dritaret e shtëpisë janë mbyllur sot krejt?

– Dhoqinë, motra ime, i kemi mbyllur se fryn erë e fortë e dimrit nga deti.

Kur arrinë pranë kishës, Kostandini i tha motrës:

– Ti shko përpara se unë dua të hyj të përgjunjem!

Kostandini shkoi e hyri prapë në varr të zi. Kali u bë prapë gur, shala u bë dhë dhe freri i argjendtë u bë rrotullë. Dhe përsëri rreth e qark zotëroi heshnja e vdekjes.

Ndërkaq Dhoqina ngjiti shkallët dhe trokiti gazmend në derë.

– Mëmë, hapma derën!

– Kush je ti që trokëllin aty tek dera?

– Hapma, zonja mëmë. Jam jot bijë, Dhoqina.

– Ikë tutje nga ke ardhur, o vdekje e shkretë. Ti m’i more të nëntë e tani ke ardhur të më marrësh dhe mua që të mos e shoh më Dhoqinën time!

– Ç’po thua ashtu, zonja mëmë? Nuk ma njeh zërin? Beso, zonja mëmë, jam unë vetë, Dhoqina jote.

– Ngul gishtin te vrima e kyçit që të ta shoh e të ta njoh.

Dhoqina nguli gishtin e vogël te vrima e kyçit - atë gisht të hollë e të bardhë. Mëma ia njohu sakaq e i hapi derën.

– Kush të solli këtu, o zemra ime?

– Më solli Kostandini, im vëlla.

– Cili Kostadin, moj bijë? Kostandini im ka vdekur bashkë me të tetë vëllezërit e tjerë. U vranë në luftë...

Dhe si rrinin të dyja, njëra tek pragu e tjetra në derë, plasën si qelqi me verë...

Nxënësit punojnë për të nxjerrë dallimet, por dhe për të parë se cilat elemente janë të përbashkëta pra që janë ruajtur nga shkrimi në vargje te ai në prozë.

Nxënësit listojnë në trajtë rregullash këto veçori sipas të cilave do bëhet kthimi në prozë i vargjeve, si: ruajtja e emrave të personazheve dhe të vende, ngjarjeve dhe rrjedhës së tyre, numrat domethënës karakteristikë, figuracioni, fjalët që janë të vjetra, por mbartin peshë kuptimore, dialogët kryesorë dhe cilësitë e personazheve.

Nxënësve u sugjerohet që ashtu si te ritregimi (dhe ky një lloj ritregimi është) ku ne dhe mund të krijojmë pa ndryshuar të gjitha ato që thamë, mund të fusin elemente krijimtarie që përshtaten.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Për shkak të kohës së kufizuar mund t’u kërkojmë nxënësve të punojnë vetëm me pjesën hyrëse të këngës “Ymer Aga”. Lexojmë vetëm përshtatjen e këtyre vargjeve që të mund të bëjmë vërejtjet e duhura për ecurinë.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe vetëvlerësim.

Detyrat dhe puna e pavarur. Meqë ky proces kërkon kohë nxënësit mund të punojnë në shtëpi për ta përfunduar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përshtatim vargjet në prozë (ora II)		Situata e të nxënët: Punë me shkrim	
Kompetenca: Të shkruarit			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshtat vargjet në prozë nga kënga “Ymer Aga”; • respekton rregullat për përshtatjen e vargjeve në prozë; • përdor rregullat e drejtshkrimit të gjuhës; • diskuton për të vlerësuar rreth punëve që ka krijuar vetë. 		përshtat, vargje, prozë.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve, e-libri.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e pavarur, diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi, diskutim.</i> Nxënësit rikujtojnë rregullat që duhet të ndjekin për përshtatjen e vargjeve në prozë dhe lexojnë punimet e përfunduara në shtëpi. Diskutohet rreth punëve dhe bëhen vërejtjet e duhura.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur.</i> Nxënësit bëjnë korrigjimet e duhura sipas vërejtjeve dhe rregullave të drejtshkrimit.			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>diskutim</i> Lexohen punët përfundimtare, bëhet vlerësimi i tyre me gojë dhe nga vetë nxënësit.			
Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim.			

TEST SEMESTRI II

GRUPI A

EMRI _____

KLASA VII

I. NJOHURI LETRARE

Pasi të lexoni tekstin, do t’ju jepni përgjigje kërkesave të mëposhtme.

MITRUSH KUTELI

TË FALEM TY

(fragment)

I

Të falem ty, o gjuhë-shkëmb,
me rrënjët thellë në shkëmbenj,
që çave qiellin kur t’ u vrënj
dhe shembe bisha e shtërpënj,
po mbete prapë:

shkrep e shtëng:

të falem, gjuhë shkrepëtim,
që shkrep në qiej e vrungullon,
me bujë pyjesh bubullon,
me gjëmë detesh uturon,
dhe je, siç ishe:

vetëtim;

të falem ty, o gjuhë - hoj,
ty, zëth i nënës - qetësi,
ty, këngë e foshnjës - kaltësi,
ty afsh’ i zemrës - dashuri -
gjithmon e ëmbël
mjaltë zgjoi.

II

Të falem ty o gjuhë e fisit tim,
siç nuk i falem asnjë perëndi -
se tempull i përjetshëm më je ti,
dhe ti mburoje nëpër mot të zi:
ti, dritë e krittë nëpër errësi,
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.

Lexoni poezinë dhe rrethoni alternativën e saktë.

1. **Kjo poezi është:**
 - a. poezi lirike
 - b. poezi epike
 - c. prozë poetike

(1 pikë)

2. **Kjo poezi i kushtohet:** (1 pikë)
- a. atdheut
 - b. njerëzve të vendit të tij
 - c. gjuhës shqipe
 - d. natyrës shqiptare

3. **Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë që autori jep në vargjet e figurshme:** (2 pikë)
- Të falem ty, o gjuhë-shkëmb,
me rrënjët thellë në shkëmbenj

4. **Në cilat vargje del:** (2pikë)
- A. trashëgimia e gjuhës,
 - B. hijeshia dhe bukuria e saj?

5. **Gjeni një krahasim dhe një epitet në vargjet e mëposhtme** (2 pikë)
- Të falem ty o gjuhë e fisit tim,
siç nuk i falem asnjë perëndi -
se tempull i përjetshëm më je ti,
dhe ti mburoje nëpër mot të zi:
ti, dritë e kirtë nëpër errësi,
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.

Krahasim _____ epitet _____

6. **Bëni skemën e rimës së vargjeve në poezinë e mësipërme.** (1 pikë)

7. **Gjeni fjalët kyç që tregojnë krenarinë e autorit për gjuhën e vendit të tij.** (2 pikë)

8. **Shkruani me fjalët tuaja mesazhin që përcjell autori në këtë poezi.** (2 pikë)

9. **Bëni një ese të shkurtër me temë "Gjuha, identiteti i një kombi".** (4 pikë)

II. Përdorimi i gjuhës

1. **Nënvizoni mbiemrin në shkallën sipërore.** (1 pikë)

Të falem ty o gjuhë e fisit tim,
siç nuk i falem asnjë perëndi -
dhe ti mburoje nëpër mot fort të zi:
ti, dritë e kiritë nëpër errësi,
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.

2. **Gjeni trajtën e shkurtër të përemrit vetor dhe thoni rasën.** (2 pikë)

Të falem ty, o gjuhë - hoj,
ty, zëth i nënës - qetësi,
ty, këngë e foshnjës - kaltërsi,
ty afsh' i zemrës - dashuri -
gjithmon e ëmbël
mjaltë zgjoi.

Trajta e shkurtër _____ rasa _____

3. **Formoni fjali ku:** (3 pikë)

a. përemri ajo të përdoret si përemër dëftor;

b. kryefjala të shprehet me përemër pyetës;

c. folja vazhdoj të ketë funksion gjysmëndihmës.

4. **Folja e nënvizuar në vargun të falem ty, është në:** (1 pikë)

- a. dëftore joveprore
- b. lidhore veprare
- c. lidhore joveprore
- d. kushtore veprare

5. **Ktheni foljen në joveprore. Kujdes ndryshimet që ndodhin në fjali.** (1 pikë)

Ruajtja e gjuhës nderon një komb.

6. **Jepni formën veprare, mënyrën kushtore, dëshirore e habitore të foljes lexon, në vetën dhe numrin që është.**

(3 pikë)

7. **Lidhni formën e pashtjelluar sipas llojit.** (3 pikë)

duke larë	paskajore
pa larë	përcjellore
për të larë	mohore

8. **Nënvizoni një lidhëz bashkërenditëse dhe një nënrenditëse në vargjet:** (2 pikë)

Se tempull i përjetshëm më je ti,
dhe ti mburoje nëpër mot të zi:
ti, dritë e krittë nëpër errësi,
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.

9. **Nënvizoni një pasthirmë dhe një pjesëz në vargjet e mëposhtme.** (2 pikë)

Të falem ty, o gjuhë - hoj,
të falem ty, o gjuhë e fisit tim,
siç nuk i falem asnjë perëndi -

10. **Gjeni kallëzuesin dhe shkruani llojin.** (2 pikë)

Kjo gjuhë duke jetuar në popull, ka gjetur mburojën më të mirë për të jetuar gjatë.

Kallëzuesi _____ lloji _____

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-9	10-13	14-16	17-23	24-30	31-34	35 -37

ÇELËSI I ZGJIDHJEVE
TEST-SEMESTRI II
Gr. A

1. **Kjo poezi është:**
d. poezi lirike
2. **Kjo poezi i kushtohet:**
c. gjuhës shqipe
3. **Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë që autori jep në vargjet e figurshme**

Të falem ty, o gjuhë-shkëmb,
me rrënjët thellë në shkëmbenjë

Në këto vargje bëhet fjalë për qëndrueshmërinë e gjuhës dhe rrënjët e saj të thella sa vetë historia e tokës, që kur ajo është krijuar me dhé e shkëmbinj. Pikërisht për këtë autori i falet si të ishte një zot a perëndi, po aq e lashtë sa ata.

4. **Në cilat vargje del:**
Trashëgimia e gjuhës – Të falem ty o gjuhë e fisit tim,
Hijeshia dhe bukuria e saj – ty, zëth i nënës - qetësi,
ty, këngë e foshnjës - kaltësi,
ty afsh' i zemrës - dashuri -
gjithmon e ëmbël
mjaltë zgjoi.

5. **Gjeni një krahasim dhe një epitet në vargjet e mëposhtme.**
Të falem ty o gjuhë e fisit tim,
siç nuk i falem asnjë perëndi – krahasim i zgjeruar, similitudë
se tempull i përjetshëm më je ti, – epitet
dhe ti mburoje nëpër mot të zi: – epitet
ti, dritë e krihtë nëpër errësi, – epitet
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.

6. **Bëni skemën e rimës së vargjeve në poezinë e mësipërme. ABBBCA**

7. **Gjeni fjalët kyç** që tregojnë krenarinë e autorit për gjuhën e vendit të tij.

gjuhë e fisit tim, tempull i përjetshëm, mburoje, perëndi.

Pranohen dhe fjalë të tjera që mbartin peshën kryesore të kuptimit të poezisë.

8. **Shkruani me fjalët tuaja mesazhin që përcjell autori në këtë poezi.**
Nëse mesazhi është i shkurtër dhe i shprehur cekët, vetëm 1 pikë.

9. Bëni një ese të shkurtër “**Gjuha, identiteti i një kombi**”.
2 pikë për idenë,
1 pikë për strukturën,
1 pikë për drejtshkrimin.

Përdorimi i gjuhës

1. **Gjeni mbiemrin në shkallën sipërore.**
fort të zi
2. **Gjeni trajtën e shkurtër të përemrit vetor dhe thoni rasën.**
të falem ty (rasa dhanore; kujt? Ty të)
3. Formoni fjali ku:

d. përemri <i>ajo</i> të përdoret si përemër dëftor	(shoqëron një emër a ndajfolje)
e. kryefjala të shprehet me <i>përemër pyetës</i>	(kush, cili, cila, cilët, cilat, ç’, çfarë)
f. folja <i>vazhdoj</i> të jetë funksion gjysmëndihmës	vazhdoj të....
4. **Folja e nënvizuar në vargun të falem ty, është në:**
 - a. dëftore joveprore
5. **Ktheni në joveprore foljen kujdes ndryshimet që ndodhin në fjali**
Ruajtja e gjuhës nderon një komb. – Një komb nderohet nga ruajtja e gjuhës.
6. **Jepni formën veprorë, mënyrën kushtore, dëshirore e habitore të foljes lexon, në vetën dhe numrin që është.**

kushtore	do të lexonte
dëshirore	lexoftë
habitore	lexuaka
7. **Lidhni formën e pashtjelluar sipas llojit.**

Duke larë	paskajore
Pa larë	përcjellore
Për të larë	mohore
8. **Nënvizoni një lidhëz bashkërenditëse dhe një nënrenditëse në vargjet e mëposhtme.**

se tempull i përjetshëm më je ti,	nënrenditëse
dhe ti mburoje nëpër mot të zi:	bashkërenditëse

ti, dritë e kiritë nëpër errësi,
ti, perëndi, që nuk ke perëndim.
9. **Nënvizoni një pasthirmë dhe një pjesëz në vargjet e mëposhtme.**

të falem ty, o gjuhë - hoj ,	pasthirmë
Të falem ty o gjuhë e fisit tim,	pjesëz e lidhores
siç nuk i falem asnjë perëndi -	pjesëz mohuese
10. **Gjeni kallëzuesin dhe shkruani llojin.**
ka gjetur – kallëzues i thjeshtë foljor

TEST SEMESTRI II

GRUPI B

EMRI _____

KLASA VII

I. NJOHURI LETRARE

**Pasi të lexoni tekstin, do t’ju jepni përgjigje kërkesave të mëposhtme.
ATDHEU (FATOS ARAPI)**

Atdheu është dhembje, është dhembje,
Një prill i pikëlluar në shpirt.
Atdheu është kryqi, është kryqi.
E mban – edhe të mban ty – në shpirt.

Atdheu është toka e premtuar.
Ti shkel si një zot dhe s’e ke ndën këmbë.
Atdheu s’ka fjalë, ka sy të trishtuar.
Vdes dashuria në dashuri që të çmend.

Atdheu është buka e uritur:
Të ikën nga duart e dot nuk e ngop.
Ëndërr dhe ankth dhe shpresë e sfillitur.
Me sytë n’errësirë vetveten kërkon.

Atdheu është varr i hapur, është varr.
Një jetë drejt tij shkon me besë që bind.
Në një pikë loti mbyl lotin fatvrrarë.
Në një pikë loti lirinë e lind.

Atdheu yt i vogli, i vogli,
ai hyjnori, i pavdekshmi – loti.

Rrethoni alternativën e saktë.

1. **Kjo poezi është:** (1 pikë)
 - a. poezi lirike
 - b. poezi epike
 - c. prozë poetike

2. **Kjo poezi i kushtohet:** (1 pikë)
 - a. atdheut
 - b. njerëzve të vendit të tij
 - c. gjuhës shqipe
 - d. natyrës shqiptare

3. **Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë që autori jep në vargjet e figurshme.** (2 pikë)

Atdheu është toka e premtuar.
Ti shkel si një zot dhe s’e ke ndën këmbë.

4. **Nëvizoni vargje ku del:** (2 pikë)
që ne i jemi vazhdimisht borxhlinj atdheut;
që atdheu është gjëja më e shenjtë?

5. **Gjeni një krahasim dhe një epitet në vargjet e mëposhtme.** (2 pikë)
Atdheu është toka e premtuar.
Ti shkel si një zot dhe s’e ke ndën këmbë.
Atdheu s’ka fjalë, ka sy të trishtuar.
Vdes dashuria në dashuri që të çmend.
Krahasim _____ epitet _____

6. **Bëni skemën e rimës së vargjeve në poezinë e mësipërme.** (1 pikë)

7. **Gjeni fjalët kyç që shprehin dhembjen e poetit për atdheun.** (2 pikë)

8. **Shkruani me fjalët tuaja mesazhin që përcjell autori në këtë poezi.** (2 pikë)

9. **Bëni një ese të shkurtër me temë “Guri i rëndë në vend të vet”.** (4 pikë)

II. Përdorimi i gjuhës

1. **Nëvizoni mbiemrin në shkallën krahasore.** (1 pikë)

Atdheu është buka më e uritur:
Të ikën nga duart e dot nuk e ngop.
Ëndërr dhe ankth dhe shpresë krejt e sfilitur.
Me sytë n’errësirë vetveten kërkon.

2. **Gjeni trajtën e shkurtër të përemrit vector dhe shkruani rasën.** (2 pikë)
Atdheu është dhembje, është dhembje,
Një prill i pikëlluar në shpirt.
Atdheu është kryqi, është kryqi.
E mban – edhe të mban ty – në shpirt.

Trajta e shkurtër _____ rasa _____

3. **Formoni fjali ku:** (3 pikë)
përemri pyetës **kush** të jetë në rasën kallëzore;

kryefjala të shprehet me **përemër dëftor**;

folja **nis** të jetë funksion gjysmëndihmës.

4. **Folja e nënvizuar** në fjalinë Në një pikë loti **mbytet** nga lot fatvrarë është në: (1 pikë)
- dëftore veprorë
 - lidhore veprorë
 - lidhore joveprorë
 - kushtore veprorë

5. **Ktheni foljen në joveprorë. Kujdes ndryshimet që ndodhin në fjali.** (1 pikë)
Një pikë loti mbyt lotin fatvrarë.

6. **Jepni formën veprorë, mënyrën kushtore, dëshirore e habitore të foljes këndonin, në vetën dhe numrin që është.** (3 pikë)

7. **Jepni format e pashtjelluara sipas llojit të kërkuar për foljen hap.**

Paskajore _____

përcjellore _____

mohore _____

8. **Nënvizoni një lidhëz bashkërenditëse dhe një nënrenditëse në vargjet:**

Atdheu është buka e uritur:

Se ikën nga duart e dot nuk e ngop.

Ëndërr dhe ankth dhe shpresë e sfilitur.

Me sytë n'errësirë vetveten kërkon.

(2 pikë)

9. **Nënvizoni një përemër vetvetor dhe një pjesëz në vargjet e mëposhtme.**

Atdheu është buka e uritur:

Të ikën nga duart e dot nuk e ngop.

Ëndërr dhe ankth dhe shpresë e sfilitur.

Me sytë n'errësirë vetveten kërkon.

(2 pikë)

10. **Gjeni kallëzuesin dhe shkruani llojin.**

Atdheun duhet ta respektojmë kudo dhe kurdoherë.

(2 pikë)

Kallëzuesi _____ lloji _____

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-9	10- 13	14-16	17-23	24-30	31-34	35 -37

ÇELËSI I PËRGJIGJEVE

TEST-SEMESTRI II

Gr. B

1. **Kjo poezi është:**

a. poezi lirike

2. **Kjo poezi i kushtohet:**

a. atdheut

3. **Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë që autori jep në vargjet e figurshme**

Atdheu është toka e premtuar.

Ti shkel si një zot dhe s’e ke ndën këmbë.

Ideja: Me atdheun gjithkush e ka një lidhje. Në të mund të ndihesh gjithmonë i fuqishëm, jo i huaj, por që kurrë s’mund të jesh zot i tij. Ai i përket një populli, një historie një trashëgimie etj.

4. **Në cilat vargje del:**

Që ne i jemi vazhdimisht borxhlinj atdheut – Atdheu është buka e uritur:

Të ikën nga duart e dot nuk e ngop.

Që atdheu është gjëja më e shenjtë; – Atdheu është kryqi, është kryqi.

E mban – edhe të mban ty – në shpirt.

5. **Gjeni një krahasim dhe një epitet në vargjet e mëposhtme**

Atdheu është toka e premtuar. – epitet

Ti shkel si një zot dhe s’e ke ndën këmbë. – krahasim

Atdheu s’ka fjalë, ka sy të trishtuar. – epitet

Vdes dashuria në dashuri që të çmend.

6. **Bëni skemën e rimës së vargjeve në poezinë e mësipërme. ABAC**

7. **Gjeni fjalët kyç që shprehin dhembjen e poetit për atdheun.**

Dhembje, i pikëlluar në shpirt, ka sy të trishtuar, vdes dashuria, buka e uritur, ankth, shpresë e sflitur, është varr, lotin fatvrrarë.

8. **Shkruani me fjalët tuaja mesazhin që përcjell autori në këtë poezi.**

1 pikë nëse ideja vjen pjesërisht.

Thelbi i mesazhit:

Në këtë poezi autori i ngre himn atdheut, por vazhdimisht ndien se shqiptarët nuk kanë bërë mjaftueshëm për ta ruajtur identitetin, megjithëse atdheu i ka dhënë identitet gjithkujt. Atdheu ndihet si i humbur, se vetë bijtë e tij nuk e kanë gjetur vetveten.

9. **Bëni një ese të shkurtër me temë “Guri i rëndë në vend të vet”.**

2 pikë për idenë e plotë e të dhënë bukur;

1 pikë për strukturën;

1 pikë për drejtshkrimin.

Përdorimi i gjuhës

1. Gjeni mbiemrin në shkallën krahasore.

Atdheu është buka më e uritur.

2. Gjeni trajtën e shkurtër të përemrit vetor dhe thoni rasën.

E mban (atë e mban) – në shpirt. (rasa kallëzore)

3. Formoni fjali ku:

përemri pyetës kush të jetë në rasën kallëzore (kë?)
kryefjala të shprehet me përemër dëftor (ky, kjo këta, këto, etj.)
folja nis të jetë funksion gjysmëndihmës Nis të...

4. Folja e nënvizuar në fjalinë Në një pikë loti mbytet nga lot fatvlarë është në dëftore joveprore.

5. Ktheni foljen në joveprore. Kujdes ndryshimet që ndodhin në fjali.

Një pikë loti mbytet nga lotin fatvlarë. – Loti fatvlarë mbytet nga një pikë loti.

6. Jepni formën veprorë, mënyrën kushtore, dëshirore e habitore të foljes këndonin, në vetën dhe numrin që është.

Kushtore – do të këndonin, dëshirore – këndofshin, habitore – kënduakan.

7. Jepni format e pashtjelluara sipas llojit të kërkuar për foljen hap.

paskajore – për të hapur

përcjellore – duke hapur

mohore – pa hapur

8. Nënvizoni një lidhëz bashkërenditëse dhe një nënrenditëse në vargjet:

Atdheu është buka e uritur:

Se ikën nga duart e dot nuk e ngop. (nënrenditëse, bashkërenditëse)

Ëndërr dhe ankth dhe shpresë e sfilitur. (bashkërenditëse)

9. Nënvizoni një përemër vetvetor dhe një pjesëz në vargjet e mëposhtme.

Atdheu është buka e uritur:

Të ikën nga duart e dot nuk e ngop. (pjesëz)

Me sytë n'errësirë vetveten kërkon. (përemër vetvetor)

10. Gjeni kallëzuesin dhe shkruani llojin.


Atdheun duhet ta respektojmë kudo dhe kurdoherë. (kallëzues i përbërë)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shporta magjike (Ora I)		Situata e të nxënit: Përralla	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> flet për krijimtarinë popullore, përrallat; lexon me intonacion përrallën; u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së saj; përmbledh përrallën sipas rregullave që di; vë veten në rolin e personazhit për të interpretuar veprimet e tij; shpreh ndjesi e mendimet e tij se si do ta përdorte shportën magjike, nëse do ta ketë në dorë. 			Fjalët kyç: përrallë, shpirtë magjike, rom, E Bukura e Dheut
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve, materiale për përrallat.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave,	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, stuhi mendimi, lexim i drejtuar, punë e drejtuar, pyetje-përgjigje, karrige e nxehtë (empatia)			

Organizimi i orës së mësimit:

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: stuhi mendimi, hartë mendimi.

Nxënësit kanë njohuri për përrallën dhe kujtojnë elementet e saj përmes hartës së mendimit.



Përralla është një rrëfim i trilluar, plot fantazi dhe elemente të çuditshme. Ajo paraqet mendimet dhe ëndërrimet e njerëzve në formë alegorike. Përrallat nuk nisen, si ndodh me këngët legjendare, nga një fakt i vërtetë (ndoshta edhe historik), që legjendarizohet, por është një trillim i plotë, që mban kurdoherë lidhje me probleme, me situata, me mendime filozofike, morale, shoqërore, estetike të jetës njerëzore.

Shkurtimisht nxënësit flasin dhe për marrëdhëniet që kanë me përrallat që nga fëmijëria e tyre dhe çfarë lloj përrallash kujtojnë nga gjyshërit.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA, diskutim, punë e drejtuar.

Pasi prezantohet tema, fillohet leximi i saj me fragmente nga vetë nxënësit. Në çdo lexim kërkohet nga nxënësit shprehi dhe intonacion.

Ndalesa I: ... stolitë e arta. Pyetjet:

- Cili është personazhi kryesor?
- Cili është problemi i tij?

- Cilat janë objektet që ai merr me vet e në një rrugëtim të gjatë? Përse i shërben secili?
- Si mendoni se do të vazhdojë historia e djalit? A do ta shesë dot shportën?

Ndalesa II:do ta plotësoj në çast. Pyetjet:

- Çfarë ndodhi me djalin dhe shportën?
- Çfarë cilësish kishte shporta? Pse?
- Si mendoni ju çfarë mund t'i kërkojë shportës djali?

Ndalesa III;dot pajë. Pyetjet:

- Cila qe dëshira e parë e romit?
- A ju duket e arsyeshme? Pse?
- Çfarë dëshire shfaq tjetër djali?
- Si mendoni a do të realizohet ajo?

Ndalesa IV; ... thua se i kishte ndaluar fryma. Pyetjet:

- A u martua vajza e bukur me djalin rom?
- Çfarë mendonte djali si dëshirë të tretë?
- Si mendonte ta realizonte këtë?
- Çfarë hasën ata gjatë rrugës?
- Si mendoni se do të vazhdojë pjesa?

Ndalesa V ; deri në fund.

- Çfarë ndodhi me dëshirën e tretë të romit?
- Përse u konsumua ajo?
- A mendoni se veproi drejt djali?
- Si mendonte ai të realizonte dëshirën e tretë pa ndihmën e shportës?
- Ku duket kjo?
- Çfarë u bë me shportën e vogël magjike?

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim, ditarët dypjesësh, punë në grupe. Punohet ushtrimi 10. Nxënësit punojnë me ditarët dypjesësh, duke gjetur dhe ilustruar me pjesë nga teksti.

Kalohet në interpretimin e mesazhit dhe ideve që dalin nga teksti. Nxënësit diskutojnë rreth asaj që do të realizonin përmes shportës magjike. Nëse del koha, nxënësit diskutojnë rreth çështjeve të parashtruara në pikën 9.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Bëni përmbledhjen e përrallës sipas rregullave që dini.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Shporta magjike (ora II)		Situata e të nxënës: Punë me tekstin	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca personale 			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përmbledh, tregon bukur përrallën me fjalët e tij; • përshkruan dhe gjykon figurën e romit nisur nga veprimet e mendimet e tij; • veçon elementet fantastike duke i vendosur përballë atyre reale në tekst; • përcakton elementet që e bëjnë këtë pjesë një përrallë. 	<p>Fjalët kyç:</p> <p>përrallë, shporta magjike, personazhe, elemente reale, fantastike.</p>
<p>Burimet: teksti i nxënësit, e-libri</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>tabela e koncepteve të personazhit, analizë teksti.</i></p>	

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:

Nxënësve u kontrollon detyra dhe kërkohet prej tyre të rrëfejnë përrallën në mënyrë të përmbledhur; dëgjohen dy ose tri rrëfime dhe vetë nxënësit vlerësojnë rrëfimtarin më të mirë.

2. Ndërtimi i njohurive: *tabela e koncepteve të personazhit, analizë teksti.*



Kalohet në analizën e personazheve ku nxënësit veç cilësive duhet të japin gjykimin e tyre nisur nga veprimet dhe mendimet e tyre.

Personazhi	Cilësitë	Ku duken	Mendime	Veprime	Gjykimi yt për të
Djali rom	I varfër, i ndjeshëm, punëtor, i vëmendshëm dhe i respektueshëm ndaj këshillave të më të vjetërve, human, zemërgjerë etj	Mezi ngopte barkun me bukë, i ndjeshëm ndaj lotëve të nënës, mbajti mend se biçakun, si mjetin kryesor të punës, duhej ta mbante me vete etj.	Të realizonte gjërat jetike; të sakrifikonte dëshirën e tij të fundit për jetën e një fëmije; ta mbështeste lumturinë e tij te puna dhe jo te gjërat e përfuara pa mund etj.	- Tregohet zemërmirë me shportën dhe nënën që kishte djalin e sëmure, - shpenzon fatin dëshirat magjike për një veprim human	

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit rikthehen në tekst për të vënë përballë elementet fantastike të përrallës me ato reale. Ndërkohë nxënësit veçojnë ato elemente që janë karakteristike për një përrallë.

Vlerësimi: Sipas gjyimit të mësuesit me gojë e me notë, vetëvlerësim.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përralla dhe fabula Kompetenca: Të dëgjuarit		Situata e të nxënit: Ritregimi i përrallave dhe fabulave nga nxënësit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca digjitale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon për një qëllim të caktuar një përrallë dhe një fabul. • U përgjigjet pyetjeve rreth të kuptuarit të përmbajtjes. • Interpreton përmbajtjen e përrallës dhe fabulës. • Krahason përrallën dhe fabulën si lloje tekstesh. • Jep mesazhin e përrallës e të fabulës duke u nisur nga personazhet e tyre kryesore. 		Fjalët kyç: përrallë, fabul, mesazh, personazhe, figura, klishe, hyrje mbyllje	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, fabula e përralla të ndryshme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, kinematografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, dëgjim i materialeve në disk ose i leximit nga nxënësit, diskutim rreth përrallës e fabulës.</i>			
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, fabula e përralla të ndryshme		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, kinematografi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, dëgjim i materialeve në disk ose i leximit nga nxënësit, diskutim rreth përrallës e fabulës.</i>			
Organizimi i orës së mësimimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësve u kërkojmë të kujtojnë përkufizimin e përrallës e të fabulës dhe karakteristikat e secilës prej tyre.			
Përralla është një rrëfim i trilluar, plot fantazi dhe elemente të çuditshme, me anë të së cilës paraqiten në formë alegorike mendimet dhe ëndërrimet e njerëzve.			
Fabula është një krijim i shkurtër në prozë ose në vargje, që ka në qendër figurat e kafshëve, që sillen e flasin si njerëz dhe mesazhin në përfundim e japin në mënyrë të drejtpërdrejtë për njerëzit.			
Mësuesi/ja bën një grafik në dërrasën e zezë për fabulat e një për përrallat, të cilat plotësohen me mendimet dhe idetë e nxënësve.			
			

 Cilët janë fabulistët dhe mbledhësit më të famshëm të përrallave?

Mbledhësit më të famshëm në botë të përrallave janë Anderseni dhe Vëllezërit Grim, ndërsa mbledhësit shqiptarë të përrallave shqiptare janë Kostandin Kristoforidhi, Thimi Mitko, Spiro Dine etj.

Fabulistët më të njohur në botë janë Ezopi, La Fonten, fabulat e të cili i ka përshtatur në shqip Çajupi, kurse mbledhës shqiptarë të fabulave janë Naim Frashëri, Ferit Lamaj etj.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: dëgjim i përrallës “Njeri nuk do të bëhesh” dhe “Druvari dhe Mërkuri”

Nxënësve u kërkohet të dëgjojnë me vëmendje:

- për përrallën: tematikën, klishetë hyrëse e mbyllëse, personazhet, sjelljet dhe thëniet e tyre.
- Për fabulën: personazhet, detajet, fjalët dhe veprimet e personazheve, moralin

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim rreth materialit të dëgjuar
Nxënësve, pasi dëgjojnë përrallën e fabulën, u kërkohet të përgjigjen rreth tyre, për pyetjet në tekst.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyra. Kërkoni dhe gjeni material në tekstin tuaj të historisë ose në internet për luftën për pavarësi kundër osmanëve që bëri populli grek.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethanori i kohës dhe i vendit. Ushtrime		Situata e të nxënësve: Ushtrime	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> dallon rrethanorët e kohës e të vendit përcakton klasën e fjalëve me të cilat janë shprehur ato ndërton fjali me rrethanorë kohe e vendi sipas kërkesës. krahason rrethanorin e kohës e të vendit. 		gjymtyrë, rrethanor, kohe, vendi, pyetje, ku? kur?	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë e pavarur, diskutim, diagram Veni, punë e drejtuar, shkrim i lirë.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Punë e drejtuar


Bëhet kontrolli dhe leximi i detyrave të shtëpisë. Gjatë leximit u kërkohet nxënësve të specifikojnë të gjithë rrethanorët e kohës e të vendit që kanë përdorur duke përcaktuar me se janë shprehur.

Në përfundim të detyrës, nxënësit bëjnë një përmbledhje të njohurive që morën për rrethanorin e vendit e të kohës.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: punë e pavarur, Diagram Veni, diskutim.

Ushtrimi 2, 3 sipas kërkesës.

Nisur dhe nga detyra e shtëpisë nxënësit plotësojnë diagramin e Venit duke krahasuar rrethanorët e kohës e të vendit mes tyre.



3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrime

Ushtrimet 5, 6 sipas kërkesës.

Nxënësit arrijnë vetë në përfundimin se rrethanorët jo gjithmonë janë gjymtyrë e domosdoshme në fjali por e plotësojnë atë. Këtu këmbëngulet në vlerën stilistike që merr në të shkruar përdorimi i rrethanorëve sidomos në shkrimet përshkruese.

Vlerësimi: Për performancën e nxënësve gjatë gjithë situatës së të nxënësve në të dyja orët.

Detyrat dhe puna e pavarur: Fjalitë e ushtrimit 6 vazhdohen dhe pasurohen me rrethanorë vendi e kohe duke i lidhur e duke krijuar me to një tekst. Diskutohet rreth shkrimeve përfundimtare dhe rolit të rrethanorëve në to.


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënësve: Tregime të moçme shqiptare (Kuteli)	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> përkufizon rrethanorët e shkakut e të qëllimit; dallon rrethanorin e shkakut e të qëllimit në një tekst të dhënë; përcakton me se shprehen rrethanorët e shkakut e të qëllimit; krahason rrethanorët e shkakut e të qëllimit; ndërton fjali me rrethanorë shkakut e qëllimit. 		gjymtyrë, rrethanor, shkak, qëllim, emër, ndajfolje, pyetje.	
Burimet: teksti i nxënësve, e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: *Stuhi mendimi, pemë mendimi, analizë rastesh, punë e drejtuar, punë e pavarur, Diagram Veni, shkrim i lirë, diskutim, INSERT.*

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi.*

Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. U kërkohet nxënësve të kujtojnë përkufizimin e rrethanorëve dhe të plotësojnë një skemë ku të pasqyrojnë njohuritë që kanë në lidhje me ta.



Plotësohen në libër skemat e dhëna duke iu përgjigjur pyetjeve të secilës.

2. Ndërtimin e njohurive të reja: *analizë rastesh, punë e drejtuar, INSERT, diskutim.*

Nxënësit rikthehen në tekst për të punuar me fragmentin e Kutelit marrë nga “Tregime të moçme shqiptare”, gjejnë rrethanorët e shkaktit e qëllimit dhe përcaktojnë me se janë shprehur. Pas diskutimit të këtij fragmenti për rrethanorët vazhdohet me tekstin me shenjat e tabelës INSERT dhe diskutimin e njohurive për të cilat lindin diskutime dhe paqartësi nga nxënësit.

3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. *Punë e pavarur (ushtrime)*

Punohet ushtrimi 2, nxënësit dallojnë rrethanorët dhe për rrethanorët e shkaktit dhe të qëllimit thonë me se shprehën. Për efekt kohe nëse mund të punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës.

Vlerësimi me notë mund të lihet për orën në vazhdim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Faik Ballanca “Marko Boçari” (ora e parë) – tekst letrar		Situata e të nxënësve:	
Kompetenca: Të lexuarit		Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon pjesën për të kuptuar përmbajtjen e saj. • Përshkruan luftëtarët shqiptarë përmes figurës së Marko Boçarit. • Përkufizon monologun dhe efektet e tij në tekst. • Përmbledh me shkrim dhe me gojë monologun e Marko Boçarit. • Shpjegon fragmente e shprehje të tekstit me ditarët e të nxënësve. 		Marko Boçari, Suli, armë, luftëtar.	

<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, informacion nga interneti ose lexime të ndryshme për Marko Boçarin.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia, Shoqëria dhe mjedisi</p>
---	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: bashkëbisedim, lexim në heshtje, punë e pavarur, ditarët e të nxënësve, diskutim, stuhi mendimi.

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: bashkëbisedim, stuhi mendimi

Nxënësit janë porositur që më parë të lexojnë për Luftën Greko-Osmane dhe luftëtarët shqiptarë që kontribuuan në të, kryesisht për Marko Boçarin.

Nxënësit flasin shkurtimisht rreth çështjes së mësipërme duke u ndalur në figurat shqiptare, që morën pjesë dhe u dalluan në këtë luftë.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim në heshtje, punë e pavarur

Nxënësve u kërkohet të lexojnë në heshtje dhe të t’u përgjigjen tri kërkesave të rubrikës *Kuptimi dhe mesazhi*:

1. N ç’kohë dhe vend ndodh ngjarja?

Ngjarjet zhvillohen gjatë Luftës Greko-Osmane në territorin grek, ku Marko Boçari ra si hero duke luftuar në krah të luftëtarëve grekë. Dëshmi të kësaj janë emrat e vendeve që ai përmend gjatë momenteve të fundit të jetës, si Helada.

2. Çfarë mendoni se ka ndodhur më parë?

Nisur nga ky moment kuptojmë që Marko Boçari ka ardhur në ndihmë të Revolucionit grek kundër pushtimit osman dhe ku tashmë ashët plagosur për vdekje dhe këto janë pikërisht mendimet e tij të fundit në prag të vdekjes.

Përmbledhni me një fjali përmbajtjen e çdo paragrafi të pjesës.

Paragrafi I – Luftëtari po shuhet nga plagët dhe gjaku që i rrjedh me dhimbjen se nuk e derdhi gjakun për vendin e tij.

Paragrafi II – I vjen keq që po vdes në vend të huaj, i malluar për njerëzit e dashur dhe vendin e tij, krenar për betejat që ka bërë e që janë përjetësuar në këngë

Paragrafi III – Luftëtari vdes me keqardhjen e thellë se vendi i tij vuan nga vëllavrasja dhe krenar se ka

mbrojtur në vendin e huaj lirinë që do të donte ta mbronte në vendin e tij.

Paragrafi IV- ëndrra e luftëtarit ishte të prehej pranë fortifikatës së Gjergj Kastriotit.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me klasën

Lexohen dhe diskutohen përmbledhjet. Vlerësohen punimet më të mira: që kanë nxjerrë thelbin e paragrafit dhe e kanë shprehur bukur.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë. Mund të vendosen nota në përfundim të orës së dytë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Pika 5, të realizohet me ditarët e të nxënësve,

Shprehja	Komenti im
Kushedi se kur liria do të trokasë mbi atë dhé të zhuritur pëllëmbë e gjak.	Marko Boçari po vdes me pengun se e sheh të largët lirinë për trojet shqiptare.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII		
Tema mësimore: Faik Ballanca “Marko Boçari” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca qytetare.. 					
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon karakteristikat e personazhit, si luftëtar. • Dallon fjalët kyç që paraqitin në tekst jetën dhe vdekjen dhe komenton pjesët ku i has ato. • Shpjegon efektin e monologut në fragment. • Dallon veçoritë artistike të pjesës. 		Fjalët kyç: Marko Boçari, jeta, vdekja, heroi, monolog.			
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia, shoqëria dhe mjedisi			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë me klasën, ditarët e të nxënit, diskutim, harta e personazhit</i>					
Organizimi i orës së mësimi					
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë me klasën</i> Dy-tre nxënës lexojnë detyrën e shtëpisë, bëhen vlerësime dhe komente për to.					
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Harta e personazhit, Punë e pavarur, Diskutim,</i> Punohen ushtrimet 4, 5, 6					
<i>Ushtrimi 4. Harta e personazhit</i> Nxënësit bazuar në punën e mësipërme dhe në fragmentin e dhënë në tekst ndërtojnë hartën e personazhit, duke u mbështetur në pjesët e tekstit.					
Personazhi	Cilësitë	Ku duken	Çfarë thonë	Veprime	Gjykimi yt rreth tyre
<i>Ushtrimi 5. Ditarët e të nxënit</i>					
Pjesë nga teksti			Shpjegimi i tyre		
<i>Kushedi se kur liria do të trokasë mbi atë dhe të zhuritur pëllëmbë dhe gjak</i>			Vendlindja e luftëtarit është e zhuritur, shumë e vuajtur dhe bashkatdhetarët e tij kanë luftuar dhe janë përpjekur për lirinë e saj (<i>pëllëmbë dhe gjak</i>), e ai vdes me dhimbjen se liria është larg.		

Ushtrimi 6: Kalohet në vazhdimin e interpretimit të pjesës duke diskutuar për rikthimin e njeriut në fëmijëri në përgjithësi dhe të personazhit tonë në veçanti.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Ushtrimi 6. Nxënësit mund të ndahen në dy grupe dhe të nxjerrin fjalët kyç.

Ushtrimi 7: Vdekja që afrohet; s’luftoj dot, s’këndo dot, rreshken kripërat e fundit, qepallat e mia po mbyllen, po vdes, më dhemb, etj.

Jeta që largohet; dallgët që afrojnë, malet e mija, kënga btë vjetra, Pesë Puset, etj

Pasi të shpjegohet koncepti i monologut nxënësit duhet të japin si konkluzion që monologu e bën më të afërt lexuesin me personazhin dhe dhembja, gëzimi apo gjithçka ai përjeton është më a ndjeshme se sa kur e rrëfen autori në vetën e tretë.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë dhe me notë për të dyja orët.

Detyrat dhe puna e pavarur. Detyrë f. 122. Verifikoni.

Porositen nxënësit të gjejnë në albume me piktura ose në internet piktura të të huajve për shqiptarët.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Krenar si një shqiptar Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënit: Figura e shqiptarëve në artin e të huajve	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca qytetare. 6. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për pikturat që janë në libër ose që ka gjetur vetë karakterit dhe historisë që e bëjnë të ndihet krenar si shqiptar. • Sjell thënie dhe dëshmi mbi vlerësimin e të huajve për Shqipërinë e shqiptarët. • Komenton disa nga thëniet më të famshme për shqiptarët. 		Fjalët kyç: krenar, shqiptar, Shqipëri,	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale nga burime të ndryshme që lidhen me mendimin e të huajve për Shqipërinë dhe shqiptarët. https://www.google.al/search?tbm=isch&tbs=rimg%3ACc6M98ejBR2ËljjYwHnm47z2fftuBSKu0OwpbgrGO9Q		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia, Arte, Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, punë e drejtuar, koment			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Diskutim*

Nxënësit lexojnë detyrën dhe flasin për figurën e Marko Boçarit dhe për piktura të tjera që kanë në qendër luftëtarët shqiptarë.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar*

Nxënësit lexojnë materialet në libër dhe zbërthejnë përmbajtjen e thënies “Krenar si një shqiptar”, duke iu referuar thënieve nga filozofë, shkrimtarë e historianë të huaj. Mund të sillen vargje nga Bajroni dhe diskutohet rreth kontributit të tij në identifikimin e figurës së luftëtarëve shqiptarë në botë.


Për të shijuar më mirë imazhet, aty ku nuk përdoret libri digjital, mund të përdoren linqet e mësipërme për të dhënë në video-projektor imazhet e mëposhtme.



Bajroni pranë varrit të Marko Boçarit i veshur me kostum kombëtar, pikturë e Ludoviko Liparinit



Bajroni betohet mbi trupin e Marko Boçarit. Tablo nga Ludoviko Liparini




Nxënësit komentojnë këto tablo për të dhënë karakteristikat e shqiptarëve parë me sytë e të huajve dhe për të shpjeguar domethënien e shprehjes “Krenar si një shqiptar”.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Thënie të të huajve për vlerësimin e shqiptarëve.

Shënim. Drama “Epoka para gjyqit” mund të planifikohet edhe si projekt. Nëse do ta përdorni si temë projekti, udhëzuesin e keni në fund të tri orëve mësimore.



Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethanori i mënyrës dhe sasisë. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënët: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon rrethanorët e mënyrës e të sasisë; • dallon rrethanorin e mënyrës e të sasisë në një tekst të dhënë; • përcakton klasën e fjalëve me të cilat shprehen rrethanorët e mënyrës e të sasisë; • krahason rrethanorët e mënyrës e të sasisë; • ndërton fjali me rrethanorë mënyre e sasi sipas kërkesës. 		Fjalët kyç: rrethanorë, gjymtyrë, e dytë, mënyrë, sasi	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim, INSERT.</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi</i> Fillimisht kontrollohen detyrat e shtëpisë, bëhet diskutimin dhe vlerësimin e tyre U kërkohet nxënësve të kujtojnë çfarë dinë për rrethanorët e mënyrës e të sasisë dhe me modelet që jepen në tekst të plotësojnë skemën e mendimit në tekst duke bërë kështu edhe përkufizimin e tyre. (Kontrollojnë përkufizimin në rubrikën "Mbani mend".			
2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>analizë rasti, diskutim, INSERT</i> U kërkohet nxënësve të punojnë me tekstin në hyrje të mësimt për të gjetur rrethanorët e mënyrës e të sasisë. Përcaktojnë marrëdhëniet dhe kuptimin e tyre kundrejt foljes dhe me çfarë janë shprehur. <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mirë, shpejt e shpejt, nxitimthi</i> - rrethanorë mënyre shprehur me ndajfolje e shprehje ndajfoljore • <i>Shumë, disa herë</i> - rrethanorë sasi, shprehur me ndajfolje dhe GE. Nxënësit rikthehen në tekst dhe punojnë me materialin teorik me shenjat e tabelës INSERT.			
√	+	-	?
Njohuri që nxënësi i ka marrë	Njohuri të reja që nxënësi i kupton	Njohuri të reja që nxënësi i di ndryshe	Njohuri që nxënësi nuk i kupton
Në përfundim diskutohen njohuritë e reja dhe ato ku nxënësit hasin vështirësi sidomos në lidhje me kuptimet e rrethanorëve të mënyrës e sasisë.			

3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. Punë e pavarur, ushtrime.

Ushtrimi 1, 2 sipas kërkesës.

Fjala	vendi	kohe	shkaku	qëllimi	mënyre	sasie
<i>dalëngadalë, plotësisht</i>					+ ndajfolje	
<i>mbi tjegullat e shpive, buzë liqenit, mbi liqen</i>	+ GE					
<i>pak e nga pak</i>					+ shprehje ndajfoljore	
<i>kur, pastaj</i>		+ ndajfolje				
<i>pa pushim</i>					+formë e pashtj. mohore	
<i>shumë</i>						+ ndajf.

Ushtrimi 3 Për disa vjet (rr. sasie), nga qielli (rr. vendi), nga krismat e armëve (rr. shkaku) më (kund. i zhdrejtë pa paraf.) të rrugës (përc.) punën më të vështirë (kund. i drejtë), dimrit (rr. kohe) me vrap (rr. mënyre), për të jetuar (rr. qëllimi) me mua (kund. i zhdrejtë me parafjalë).

Ushtrimi 4, 5, 6 sipas kërkesës.

Vlerësimi: Në bazë të rezultateve të të nxëniet dhe detyrave të shtëpisë. Mund të bëhet edhe në orën e ushtrimeve duke parë performancën e nxënësve në të dyja orët.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7 pas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për rrethorët		Situata e të nxëniet: Ushtrime	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë			
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon rrethorët në fjali; • përcakton llojin e tyre; • ndërton fjali me lloje të ndryshme përcaktorësh. 		rrethorë, vendi, kohe, shkaku, qëllimi, mënyre, sasie.	
Burimet: teksti i nxënësit, e -libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: tabela e koncepteve, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: tabela e koncepteve

- Kontrollohet, diskutohet dhe vlerësohet detyra e shtëpisë.
- Nisur nga njohuritë që nxënësit kanë marrë në lidhje me rrethanorët, plotësojnë këtë tabelë konceptesh për to.

Rrethanor	Tregon	Pyetja me të cilën gjendet	Vendi	Shprehet me...	Shembuj
Kohe	kohën e kryerjes së një veprimi	Kur?	Para dhe pas foljes	Ndajfolje kohe Formë e pashtj. Emër me parafjalë, GE	Dje erdhi një shok i ri.
Vendi					
Shkaku					
Qëllimi					
Mënyre					
Sasie					

Në përfundim, nxënësit qarkojnë të përbashkëtat dhe diskutojnë rreth tyre.

Ushtrime. *Punë e drejtuar punë e pavarur.*

Nëse shihet e arsyeshme, një pjesë e ushtrimeve mund të zhvillohen në trajtë minitesti. **Ushtrimi 1** sipas kërkesës mund të punohet me tabelën e mëposhtme.

Rrethanorët	Lloji	Me se shprehen
<i>pa pushim,</i>	mënyre	emër në r. kallëzore
<i>shpejt e shpejt</i>	mënyre	shprehje ndajfoljore,
<i>për të sulmuar</i>	qëllimi	formë e pashtjelluar, paskajore
<i>përballë kullës lindore</i>	vendi	GE
<i>rrëmbimthi</i>	mënyre	ndajfolje
<i>nga punishtja e topave</i>	vendi	GE
<i>ditë e natë</i>	kohe	shprehje ndajfoljore
<i>që në ditët e para të ardhjes së tyre</i>	kohe	GE
<i>asnjëherë, dje</i>	kohe	ndajfolje
<i>nëpër luftërat e gjertanishme</i>	vendi	GE
<i>nga gjëmimi i saj</i>	shkaku	GE
<i>si nga tërmeti, me hollësi,</i>	mënyre	emër me parafjalë
<i>duke u futur</i>	mënyre	formë e pashtj. përcjellore
<i>herë pas here</i>	kohe	shprehje ndajfolje
<i>nëpër galeritë, drejt maleve</i>	vendi	emër me parafjalë
<i>diku, në stërkalat e tyre</i>	vendi	ndajfolje GE

Ushtrimi 2. Ushtrimi ka si qëllim të kuptohet se rendi i rrethanorëve në fjali është i lëvizshëm, dhe të diskutohet se rendi më i zakonshëm është pas foljes.

<p>Përgjigjet: nga cicërimat e</p> <p>Ushtrimi 3. Për studime - rrethanor qëllimi. Gjatë gjithë verës - rrethanor kohe. Me vrull - rr mënyre. Nga e majta e lumit - rrethanor vendi nga shirat e shumtë - rrethanor shkaku.</p> <p>Ushtrimi 4 Për të parë një ndeshje - rr qëllimi, duke bubulluar - rr. mënyre, pa ndalur fare - rr.mënyre, për të shpirë këmbët - rr. qëllimi, për të takuar nipërit - rr. qëllimi. Me ndryshimin e numrit dhe vetës së foljes, rrethanorët nuk ndryshojnë formë, pra ndonëse tregojnë rrethanën e kryerjes së një veprimi, nuk varen nga forma e saj dhe nuk përshtaten me të.</p> <p>Ushtrimi 5. Tregojmë vepruesin - nga shiu, nga Taulanti, nga nxënësit e klasës së shtatë Shkaku - nga djersa, nga bari i mbjellë breza - breza, nga njerëzit e shumtë.</p> <p>Ushtrimi 6 sipas kërkesës.</p> <p>Ushtrimi 7 Rr vendi - matanë malit (vendndodhjen) , në drejtim të veriut, (drejt e lëvizjes) përmes fushave të mbjella (pikën ku kalohet) nga Kosova, (pikënisje) në shtëpi, (përfundim lëvizje) RR kohe - deri nga vjeshta (përfundimin e veprimit), nga mëngjesi në darkë (kohëzgjatja e veprimit)</p> <p>Ushtrimi 8 Dita - ditës rr. kohe; ditën e nesërme - rr. kohe; për t'u kalbur - rr. qëllimi; në ujë e në shi - rr. vendi; brez pas brezi - rr. kohe, përherë e më shpesh - rr. kohe, që atëherë - rr. kohe, me gjithë shpirt - rr. mënyre.</p>
<p>Vlerësimi në bazë të performancës ose kritereve që mund të vendosen në minitest</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 9 sipas kërkesës.</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për gjymtyrët e dyta</p> <p>Kompetenca: Njohuri gjuhësore - Sintaksë</p>		<p>Situata e të nxënit: Ushtrime</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon gjymtyrët e dyta në fjali; • përcakton llojin e gjymtyrës së dytë; • tregon klasën e fjalëve me të cilën shprehen gjymtyrët e dyta; • ndërton tekste me gjymtyrë të dyta sipas kërkesës. 		<p>Fjalët kyç: gjymtyrë e dytë, kundrinor, i drejtë, i zhdrejtë, rrethanor, kohe, mënyre, vendi, sasië, shkaku, qëllimi.</p>	
<p>Burimet: teksti i nxënësit</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë e pavarur, punë e drejtuar. Ushtrime.</p>			

Organizimi i orës së mësimit:

1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: punë e pavarur

Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi me gojë i detyrave të shtëpisë dhe për të kujtuar njohuritë teorike, punohet nën shembullin e tabelës së koncepteve për rrethorët tabela e koncepteve edhe për kundrinorët.

Kundrinori	Tregon	Pyetja me të cilën gjendet	Vendi	Shprehet me	Shembuj
i drejtë					
i zhdrejtë pa parafjalë					
i zhdrejtë me parafjalë					

Ushtrimi 1. Fjalja 1, 4, 5 tregojnë rrethorë fjalja **2, 3** tregojnë objektin e veprimit. **Ushtrimi 2**, nxënësit gjejnë rrethorët dhe kundrinorët dhe llojin e tyre.

Fjala	Lloji	Shprehur me
<i>jashtë</i>	rr. kohe	ndajfolje
<i>gjithçka</i>	k i drejtë	përemër i pacaktuar.
<i>nën qiellin e larë nga shiu dhe të kthjelluar nga era</i>	rr. vendi	GE
<i>frikshëm</i>	rr. mënyre	ndajfolje
<i>atyre u</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	për. vetor dhe tr. e shkurtër
<i>në palcë, mbi tel, në grykë</i>	rr. vendi	emër me parafjalë
<i>nëpër vrimat e mureve të hanit</i>	rr. vendi	GE
<i>kohë të mirë</i>	kund. i drejtë	GE
<i>atë çast</i>	rr. kohe	GE
<i>këmbëkryq</i>	rr. mënyre	ndajfolje
<i>të gjithëve, u</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	për. i pac. dhe tr. e shkurtër
<i>nga gëzimi</i>	rr. shkaku	emër me parafjalë
<i>prej zemrave të tyre të djegura</i>	kund. i zhdrejtë me parafjalë	GE
<i>Adilit, i</i>	kund. i zhdrejtë pa parafjalë	emër dhe tr. e shkurtër
<i>asaj kënge, i</i>	kund. i zhdrejtë me paraf.	GE dhe tr. e shkurtër

Ushtrimi 3. nga *cicërimat e zogjve* - rr. shkaku, *për ngritjen e bibliotekave*, *për mirëmbajtjen mjediseve* - rr. qëllimi, *pa njerëz* - përcaktor, *nga llamba të pakta*-kundrinor me parafjalë, *me stilolapsin e ngulur midis fletëve* - kund. i zhdrejtë me parafjalë, *me vëmendje* - rr. mënyre, *nga pemët* - rr. vendi, *me shpejtësi* - rr. mënyre, *pa gjak* - përcaktor, *nga dëshpërimi* - rr. shkaku, *me dënësë* - rr. mënyre.

Ushtrimi 4. Rikujtohen ndryshimet që ndodhin. 1. Plepat e njomë përkunden nga era.

- Folja nga veprorë në joveprorë
- Kundrinori i drejtë në kryefjalë
- Kryefjala në kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

Ushtrimi 5, 6, 7, 8 sipas kërkesës.

Ushtrimi 9: *me përtim* - rr. mënyre, *në atë kohë* - rr. kohe, *pa masë* - rr. sasi, *me frikë* - rr. mënyre (frikshëm) *pa doreza* - rrethor mënyre, *në qytet* - rr. vendi.

Këto ushtrime mund të realizohen dhe në trajtë minitesti.

Vlerësimi: Sipas realizimit të ushtrimeve dhe detyrës së shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 10.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ekrem Kryeziu “Epoka para gjyqit” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Lidhja e Prizrenit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për motivet e dramës “Epoka para gjyqit” nisur nga fragmentet e saj. • Lexon në role pjesën. • Shpjegon motivet e dramës duke i lidhur me historinë. 		Fjalët kyç: dramë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, gjyq	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale që lidhen me ngjarjen historike të Lidhjes së Prizrenit, fragmente nga drama në You tube. https://www.youtube.com/watch?v=aq7d5AbMwOw		<ul style="list-style-type: none"> • Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Historia • Identiteti kombëtar • Shkencat dhe shoqëria 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>lexim në role, vëzhgim i materialeve në video-projektor me pjesë nga drama “Epoka para gjyqit”, diskutim, pyetje-përgjigje</i>			

Organizimi i orës së mësimimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *vëzhgim i skenës nga drama “Epoka para gjyqit” në video-projektor, diskutim*

Nxënësve u vendosim pas minutës së pestë deri në të njëzetën, një fragment nga drama “Epoka para gjyqit”, vënë në skenë nga Teatri Kombëtar dhe u kërkohet të japin një mendim rreth asaj që kuptojnë nga fragmenti.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim në role*

Kalohet në leximin e pjesës në role. Ndhimohen nxënësit të lexojnë me intonacionin e duhur dhe të interpretojnë rolin.

Nxënësit e lexojnë dy herë dhe pas leximit të dytë bëhet shpjegimi i fjalëve e shprehjeve që nuk ua dinë kuptimin.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, diskutim*

Punohet në mënyrë të pavarur **ushtrimi 1** i rubrikës *Kuptimi dhe mesazhi*. Mund të punohet edhe në grupe, në varësi të kohës. Nxënësit lexojnë në heshtje teksti dhe ilustrojnë me pjesë nga teksti dhe nga njohuritë që kanë nga historia çdo kërkesë të ushtrimit.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Komenti me shkrim i titullit të pjesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ekrem Kryeziu “Epoka para gjyqit” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon në role pjesën. • Komenton dhe shpjegon fragmente nga pjesa. • Analizon personazhet për të dhënë gjykimin e tij rreth tyre. • Përcakton karakteristikat e dramës. 		Fjalët kyç: Gjq, heronj, Lidhja e Prizrenit, dramë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; drama “Epoka para gjyqit”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi (Historia) Identiteti kombëtar	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Lexim në role, Diskutim, tabela e koncepteve të personazhit,</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Diskutim</i> Lexohen komentet për titullin dhe bëhet vlerësimi i tyre me gojë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Diskutim, tabela e koncepteve të personazhit,</i> Kalojmë në interpretimin e pjesës duke iu përgjigjur pyetjeve në tekst.</p> <p>Ushtrimi 2: Në pjesën e dytë të tekstit, kur Abdyl Frashëri dhe Sulejman Vokshi i përplasnin Tursun Beut dhe Mexhid Beut mendimet e tyre për politikën që Porta e Lartë ndoqi ndaj zgjidhjes së çështjes shqiptare dhe cenimin e lirisë së tyre, kthehen nga të akuzuar në akuzues.</p> <p>Ushtrimi 3: Kjo përgjigje e shpejtë dhe ironike e Abdyl Frashërit dëshmon inteligjencën e tij, si dhe çështjen e drejtë që mbronte ai, e cila e bënte atë të ishte më trim dhe më i guximshëm, sa arrinte t’u përplaste në fytyrë gjykatësve të tij, se ata që flisnin në emër të ligjit e shkelnin atë duke shkelur së pari të drejtën e një populli për të qenë i pavarur.</p> <p>Ushtrimi 4: Mund të punohet dhe me tabelën e koncepteve të personazhit.</p>			

Personazhet	Cilësitë	Ku duken	Çfarë thonë	Veprime	Gjykimi yt rreth tyre
Abdyl Frashëri	I guximshëm, i drejtë, i shkolluar, atdhetar orator etj.	Në mënyrën se si argumenton përgjigjet dhe veprimet e tij kundër Portës së Lartë në debat me Tursun Pashën	Që porta e lartë pengon çështjen e pavarësisë shqiptare	Iniciator së bashku me Sulejman Vokshin për thirrjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, drejtues, ideator dhe luftëtar me penë për pavarësinë e Shqipërisë.	
Sulejman Vokshi	I guximshëm, trim, i pakursyer për çështjen shqiptare, besnik ndaj bashkë-luftëtarëve dhe çështjes për të cilën lufton etj.	Kur nuk frikësohet dhe i jep përgjigjet e merituar Tursun Pashës dhe Mexhid Beut.	Dënon tradhtinë e bashkëkombësve të tij dhe është kundër çdo njeriu dhe veprimi, që pengon Pavarësinë e Shqipërisë.	Luftoi me armë për çështjen e Pavarësisë së Shqipërisë, dha kontributin kryesor në realizimin e Lidhjes së Prizrenit.	
Tursun Pashai	I shkolluar përfaqësues i Portës së Lartë, antishqiptar	Kur përpiqet të argumentojë me ligj dhe të mbrojë veprimet e tij dhe të Portës së Lartë ndaj çështjes shqiptare	Të pengonte përpjekjet e pjesëmarrësve të Lidhjes së Prizrenit të realizonin shpalljen e pavarësisë	Dënon dhe pengon me çdo mënyrë përpjekjet e luftëtarëve dhe mendimtarëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për pavarësinë e Shqipërisë.	
Mexhid Beu	Përfaqësues i Portës së lartë				

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Harta e mendimit, diskutim*

Ushtrimi 5: Është një dramë historike. Në qendër të saj janë ngjarjet historike të Lidhjes së Prizrenit dhe figura të historisë Shqiptare, si Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi etj. Ajo është një dramë, sepse është ndërtuar mbi bazën e dialogut, ka personazhe që flasin e veprojnë në skenë.

Diskutohet për dramën si një lloj letrar dhe ndërtohet në tabelë *harta e mendimit* për dramën.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë. **Detyrat dhe puna e pavarur:** Luajeni dramën sipas roleve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra Kompetenca: Njohuri gjuhësore- Sintaksë		Situata e të nxënimit: punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon fjalitë e thjeshta e të përbëra; • dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; • liston karakteristikat e fjalisë së përbërë; • përcakton llojin e fjalisë së përbërë. 		Fjalët kyç: fjali, e thjeshtë, e përbërë, kallëzues, intonacion, mjete lidhëse.	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, INSERT, punë e drejtuar, punë e pavarur.</i>			
Organizimi i orës së mësimimit			
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. • Kujtohen njohuritë që nxënësit kanë rreth fjalive të thjeshta e të përbëra. • Fillimisht nxënësit japin përkufizimin e fjalisë dhe përcaktojnë llojet sipas ndërtimit. • Për të qenë më të saktë në përkufizim plotësohet informacioni për krahasimin mes fjalisë së thjeshtë e të përbërë në tekst. <p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Analizë rasti, punë e drejtuar, INSERT</i> Rikthehen në tekst, ku dallojnë fjalitë e thjeshta e të përbëra dhe bëjnë analizën e tyre, duke i krahasuar mes tyre konkretisht. Nxënësit vënë re intonacionin e fjalisë së përbërë dhe rolin që ai ka në këto lloj fjalish. Vazhdohet me mënyrën se si realizohet lidhja mes pjesëve në fjalinë e përbërë dhe rendi i pjesëve sidomos në fjalitë e përbëra me nënrenditje duke veçuar kur këto pjesë kanë rend të lirë e kur të ngulitur. (Rend të lirë në fjalitë rrethore dhe të ngulitur në ato kundrinore, kryefjalore e përcaktore.) U kërkohet të shohin dhe një herë tekstin duke shënuar me shenjat e tabelës INSERT njohuritë në të sipas shkallës së njohjes.</p>			
√	+	-	?
Njohuri që nxënësi i ka marrë	Njohuri të reja që nxënësi i kupton	Njohuri të reja që nxënësi i di ndryshe	Njohuri që nxënësi nuk i kupton
<p>Diskutohen të gjitha rastet e diskutueshme dhe kalohet në rubrikën e ushtrimeve. Nëse nuk është dhënë më parë, jepet ose kujtohet që kallëzuesit homogjenë nuk përbëjnë fjali të përbërë.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Ushtrime</i> Ushtrimi 1 sipas kërkesës. Vetëm dy fjali të thjeshta: fjalia 5 dhe 8. Ushtrimi 2. Fillimisht ndahen fjalitë në bashkërenditëse e nënrenditëse dhe kujtohet rregulla e rendit të pjesëve. Në përgjithësi kanë rend të ngulitur pjesët në fjalinë e përbërë me bashkërenditje dhe pjesët në fjalitë e nënrenditura përcaktore. Ushtrimi 3. Sipas kërkesës. Përemrave lidhorë janë: 2. kryefjalë, 4. kund i drejtë, 5. kryefjalë. Ushtrimi 4, 5 sipas kërkesës.</p>			
Vlerësimi: Sipas rezultateve të të nxënimit.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 mund të realizohet dhe në trajtë krijimi, me një temë të caktuar.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për fjalitë e përbëra		Situata e të nxëniet: punë me tekstin	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon fjalitë e thjeshta nga të përbëra; ndan pjesët e fjalisë së përbërë; dallon mjetin lidhës dhe funksionin e tyre; ndërton fjali të përbëra të llojeve të ndryshme. 		Fjalët kyç: fjali, pjesë, mjet lidhës, bashkërenditëse, nënrenditëse.	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e pavarur, punë e drejtuar, diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>punë e pavarur,</i> Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë dhe nxënësit rikujtojnë njohuritë që kanë rreth fjalisë së përbërë, llojeve, nënlojeve, kritereve të klasifikimit, raportit mes pjesëve në secilin lloj, mjeteve lidhëse.			
2. Ndërtim dhe prezantim njohurish: <i>punë e drejtuar, diskutim</i> Ushtrimi 1. Fjalitë 1, 5 dhe e parafundit (ka kallëzues të përbërë) janë fjali të thjeshta. Ushtrimi 2. Fjalitë 2 me nënrenditje kohore Fj. 3 me nënrenditje (shkakore e përcaktore), ndodhen në mes të pjesës kryesore Fj. 4 me nënrenditje, kushtore, ftilluese kryefjalore, përcaktore Fj. 6 bashkërenditëse veçuese Fj. 7 nënrenditëse kohore, dy pjesë kryesore të bashkërenditura dhe e fundit shkakore. Gj. e fundit me nënrenditje, kryesore+ kushtore+ftilluese.			
3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrime Ushtrimi 3, 4 sipas kërkesës. Ushtrimi 5. Në fjalitë me përemër vetor në kllapa, të përdoren përemrat lidhorë. Ushtrimi 6. Për funksionin e përemrave lidhorë ndihmon forma e përemrave që janë zëvendësuar. Ushtrimi 9. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kanë rend të ngulitur.			
Vlerësimi: Vlerësimi sipas paraqitjes së nxënësve por mund të bëhen ushtrimet dhe në trajtë minitesti.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 10.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i pikës dhe pikëçuditjes në lloje të ndryshme të fjalisë Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Situata e të nxënit: punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përdor saktë shenjat e pikësimit në fund të fjalisë; • shpreh përmes intonacionit shenjat e pikësimit në fjali; • shpjegon përdorimin e shenjave të pikësimit në fjali. 		Fjalët kyç: fjali, shenjë pikësimi, pikë, pikëçuditje, intonacion, titull, nëntitull,	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve; punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim,			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: punë e drejtuar, Pasi kontrollohet dhe diskutohet detyrën e shtëpisë, u kërkohet nxënësve të thonë njohuritë që kanë në lidhje me përdorimin e shenjave të pikësimit në fund të fjalisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pika, në fund të fjalisë dëftore, pa nuancë emocionale • pikëçuditja, në fund të fjalive dëshirore, nxitëse e dëftore thirrmore, • pikëpyetja në fjalitë pyetëse • trepikëshi, kur mendimi vazhdon ose lihet për t’u nënkuptuar • 			
<p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: Punë e pavarur U kërkohet nxënësve të shohin tekstin në hyrje dhe të shpjegojnë përdorimin e pikës e pikëçuditjes në këto fjali. Shohin njohuritë rreth përdorimit të tyre në tekst dhe ilustrojnë dhe me shembuj të tjerë.</p>			
<p>3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. Ushtrime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushtrimi 1. Fjalitë dëftore janë me pikë, ato dëftore, thirrmore me pikëçuditje. • Ushtrimi 2. Fjalitë 2 (pikë, rregulla 1), fjalitë 4, 6, 7 (pikë, rregulla 2), fjalitë 8 (pikë, rregulla 1) fjalitë 10 (pikë rregulla 3) • Ushtrimi 4. Fjalitë 1 (pikëpyetje), fjalitë 2, 3, 5, 7, 8 pikë, fjalitë 4, 6 pikëçuditje • Ushtrimi 6 lidhet me rregullën e shkrimit të mijësheve pa pikë dhe me hapësirë. Pra; 273 649, 9 139, 17 594 pa pikë, 132 481, 141 168 me hapësirë mes mijësheve 			
Vlerësimi: Sipas mendimit të mësuesit.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7 sipas kërkesës.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kthejmë dramën në tregim (ora e parë) Kompetenca: Të shkruarit		Situata e të nxënit: Epoka para gjyqit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca qytetare. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Kujton rregullat për kthimin e një tregimi në dramë. • Nxjerr rregullat për kthimin e një pjese dramatike në tregim. • Kthen një fragment nga drama “Epoka para gjyqit” në tregim. • Diskuton për realizimin e dramës në tregim. 		dramë, tregim, përshtat, personazhe, ligjëratë e drejtë, e zhdrejtë.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale historike që lidhen me periudhën historike të ngjarjeve në dramën “Epoka para gjyqit”.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia, Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e drejtuar, punë e pavarur, diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi, diskutim</i> Prezantojmë temën dhe u kërkojmë nxënësve të kujtojnë se çfarë rregullash ndoqën për të kthyer një tregim në dramë. Nxënësit së pari do të kujtojnë kalimin nga ligjëratat e zhdrejtë në të drejtë, eliminimin sa më shumë të fjalëve të autorit dhe sqarimeve të tepërta. U kërkojmë nxënësve të nxjerrin prej tyre hapat që ndiqen për procesin e kundërt, pra të kthimit të një drame në tregim.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e drejtuar, punë e pavarur</i> Nxënësit kthehen në tekst dhe lexojnë rregullat që jep teksti për të plotësuar ato që thanë. U kujtojmë nxënësve se procesi i kalimit nga dramë në tregim nuk është thjesht mekanik, por një proces krijimi, i cili nuk duhet të ndryshojë elementet thelbësore, si: koha, vendi, tematika, idetë, personazhet, gjuhën e tyre, figuracionin etj. Nxënësit punojnë një fragment nga drama për ta kthyer në prozë.</p>			
<p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>diskutim</i> Lexohet puna që është bërë deri në këtë fazë, diskutohet dhe bëhen vërejtjet e duhura që të mund të vazhdohet si duhet.</p>			
Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë dhe vetëvlerësim.			
Detyrat dhe puna e pavarur. Nxënësit hulumtojnë rreth ngjarjeve që trajton drama për të qenë sa më koherentë me të dhe mund të punojnë fragmentin e mbetur në shtëpi.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Kthejmë dramën në tregim (ora e dytë)		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të shkruarit		Punë me shkrim	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca qytetare. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Liston rregullat për kthimin e dramës në tregim. • Përshtat plotësisht si tregim fragmentin e dramës “Epoka para Gjyqit”. • Diskuton për të vlerësuar rreth punimeve të shokëve të tij. 		dramë, tregim, përshtat, ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale që lidhen me temën e dramës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Shkenca dhe shoqëria.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e pavarur, diskutim</i>			
Organizimi i orës së mësimt			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi, diskutim</i> Nxënësit kujtojnë dhe njëherë rregullat për kthimin e një drame në tregim dhe i shënojmë ato në tabelë. Lexohen punimet që janë realizuar në shtëpi dhe diskutohet për mangësitë dhe mënyrën e realizimit të tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur</i> Në bazë të diskutimeve nxënësit punojnë për t’i dhënë dorën e fundit punimit të tyre, duke e korrigjuar si nga përmbajtja ashtu dhe nga ana gjuhësore.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>diskutim</i> Lexohen punët përfundimtare, diskutohet rreth tyre dhe vlerësohen më të mirat duke argumentuar çdo vlerësim me rregullat që nxorën.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim.</p> <p>Detyrë shtëpie. Gjeni material për jetën dhe veprën e Gjergj Fishtës.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjergj Fishta “Zana e vizitorit” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Flet shkurtimisht për jetën dhe veprën e Gjergj Fishtës. • Lexon bukur me intonacion dhe në mënyrë të vetëdijshme pjesën. • Shpjegon sipas kontekstit fjalë e shprehje në dialekt. • Përgjigjet për pyetje rreth të kuptuarit të pjesës. 		Fjalët kyç: Zana, Orë, Shtozovallet, Tringa, Rudinë, lugje, gurrë, këngë.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale të ndryshme për jetën dhe veprën e Fishtës, vepra “Lahuta e Malcis”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, bashkëbisedim, DRTA, diskutim, punë e pavarur</i>			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>bashkëbisedim,</i> Nxënësit janë porositur të lexojnë dhe të përgatiten për të folur për jetën, veprën e Fishtës dhe “Lahutës së malcis” në veçanti. U drejtohen pyetje të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ç’дини për Gjergj Fishtën? – Pse Fishta quhet Homeri shqiptar? – Cila është vepra që i dha këtë titull? – Ç’ trajtohet në këtë vepër? 			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim, diskutim,</i> Mësuesi/ja para se ta lexojë pjesën u kërkon nxënësve të lexojnë në libër dy informacione: Të dhëna, që është në f.129 dhe atë në fillim të f. 130. Më pas u kërkohet të tregojnë se çfarë ka ndodhur dhe ç’rol ka pasur Tringa në këto ngjarje. Pastaj mësuesi/ja lexon dy herë pjesën. Herën e dytë e lexon ngadalë dhe u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja për ta. Me ndihmën e fjalorit të librit dhe nga konteksti shpjegohen fjalët e reja.</p>			
<p>Për të zbërthyer e kuptuar pjesën, që është në dialekt dhe për të shijuar bukurinë e saj, punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4 të rubrikës Kuptimi dhe mesazhi.</p>			
<p>Ushtrimi 1. Nxënësit kanë marrë të dhëna nga informacioni që kanë lexuar në fillim të orës së mësimi. Ngjarja e vërtetë është beteja e zhvilluar ndërmjet shqiptarëve dhe malazezve, ku Tringa ka luftuar heroikisht dhe është vrarë në këtë betejë.</p>			

Ushtrimi 2. Shtojzovallet, orët, Zana,

Ushtrimi 3. Më përpara ka ndodhur një betejë, ku ka rënë Tringa, duke luftuar me armiqtë, malazeztë, për të mbrojtur trojet e veta. Këtë betejë e kanë ndjekur prej bjeshkëve të malit të Vizitorit, Zana e madhe dhe zanat e tjera. Ato e kanë parë Tringën të luftojë heroikisht, prandaj kanë vendosur ta marrin trupin e saj e t'i bëjnë nderimet e fundit në mjedisin e tyre fantastik. Në çastin që rrëfen poeti tregohet mjedisi fantastik dhe zanat me dhimbje e dashuri i bëjnë Tringës nderimet e fundit.

Ushtrimi 4. Poeti nuk e përmend fjalën “vdekje”, jo thjesht si një eufemizëm a tabu, por se gjuha që vë në gojën e Zanës është përkëdhelëse dhe autori thotë në vend të “vdekje”, “ka ra hije e randë....”.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Punë e pavarur.*

Nxënësit thonë me tri-katër fjali përmbajtjen e pjesës.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë dhe me notë pas orës së dytë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Tregoni duke imagjinuar dhe pjesën pararendëse të këtij fragmenti, ngjarjen në prozë.

Mësoni përmendësh vargje nga fragmenti.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjergj Fishta “Zana e vizitorit” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Reciton bukur vargje nga fragmenti Përshkruan figurën e Tringës paralel me natyrën ku ajo ndodhet Bën dallimin mes rrëfimit të autorit dhe fjalëve të personazhit Komenton vargje e ndjesi të poetit nga fragmenti Shpjegon efektin stilistik t(ë figurave 		Fjalët kyç: Zana e Madhe, orët, shtojzovallet, Tringa, ujë, lot, hije e randë	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; vepra “Lahuta e Malcis”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë me klasën, diskutim, punë e pavarur, ditarët e të nxënit, pyetje-përgjigje,</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *punë me klasën*

Lexohet detyra e shtëpisë dhe bëhet vlerësimi i saj me gojë. Nxënësit recitojnë vargjet e mësuara dhe gjykojnë njëri-tjetrin për interpretimin.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e pavarur, pyetje-përgjigje, ditarët e të nxënësve*

Ushtrimi 5. Nxënësit përcaktojnë ku shfaqet bukurit.

Te heroina kryesore –Tringa,

Te qeniet fantastike – Zana e Madhe, Shtojzovallet, orët, shkamb i gjallë

Te peizazhi – natyra (rudina),

Te kujtimet – e mrekullueshme kur Zana shoqëronte Tringën n’Bjeshkë.

Ushtrimi 6: Ilustrohet përmes vargjeve;

Dhembja më e fortë shprehet te vajtimi i Zanës së madhe dhe shtojzovalleve.

3. Prezantimi dhe demonstrim i rezultateve të arritura: *ditarët e të nxënësve*

Ushtrimi 7: Ilustrohet përmes vargjeve;

Rrëfimi i autorit	Veta	Fjalët e personazhit	Veta
vargun; <i>n’atë bigë..... e deri.....fsha ka ajo me të madhe</i>	Rrëfimi është në vetën e tretë si dhe e kërkon rrëfimi.	Fjalët e personazhit janë: ...çili sytë, moj drita e syvet...,	Veta e dytë dhe i drejtohen Tringës me shumë dhembje.

Ushtrimi 8:

Natyrë; bigë, breshtë, rudinë, lule t’njoma, blerim, filaditë, hana, bylbylat, gurrë etj.

Ndjenja; lot, drita e syvet, i raftë o i pikë etj.

Ushtrimi 9. *ditarët e të nxënësve*

Shprehja	Figura letare	Interpretimi im

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë e me notë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Detyra në faqen 130. U jepet detyrë nxënësve të gjejnë gojëdhëna dhe figura mitologjike shqiptare

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Gojëdhëna e figura mitologjike Kompetenca: Të dëgjuarit		Situata e të nxënit: Mite shqiptare, gojëdhëna	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dëgjon për të dalluar llojin e tekstit dhe hollësi të tij. Dallon figurat mitike dhe gojëdhënat për to. Rrëfen bukur gojëdhënat e dëgjua nga teksti. Diskuton për motivet e gojëdhënave që dëgjon. Krahason gojëdhëna të ndryshme nisur nga motivet e tyre. 		Fjalët kyç: gojëdhëna, mite, rrëfime, cikli i kreshnikëve, figura mitologjike.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>bisedë dëgjim i drejtuar, organizues grafik, diskutim, rrëfime gojëdhënash.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>bisedë</i> U kërkohet nxënësve të kujtojnë se cilat ishin figurat mitologjike në fragmentin <i>Zana e Vizitorit</i>: zana, orët, shtojzovallet. Pastaj u kërkohet të sjellin të dhëna për gojëdhënat dhe figurat mitologjike shqiptare, që kanë gjetur vetë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: dëgjim i materialeve të tekstit. Mësuesi/ja u vë nxënësve të dëgjojnë fragmentet e librit ose i lexon vetë fragmentet. Në leximin e parë kërkon prej tyre të dallojnë fjalët që janë të reja për ta dhe bëhet shpjegim i tyre. Dëgjohe disa lexime për gojëdhënën e parë dhe nxënësit nxjerrin temën dhe mesazhin që përcillet prej saj. Kalohet në mitin e dytë dhe nxënësit mund të japin të dhënat që dinë rreth “Orës së shtëpisë”.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Nxënësit pasi kanë dëgjuar disa herë gojëdhënën e dytë, hapin librat dhe plotësojnë pa lexuar në tekst, kërkesat. Lexohen punët e tyre dhe nga saktësia e plotësimin, përcaktohet përqendrimi në dëgjim.</p> <p>Pyetjet mund të merren nga libri ose mund të ndërtohen dhe nga nxënësit a mësuesi. Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. U jepet detyrë nxënësve që të gjejnë të dhëna për Bernadin Palajn dhe Shtjefën Gjeçovin dhe ndihmesën e tyre në kulturën shqiptare.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje e nënrenditje		Situata e të nxëniet: Punë me tekstin	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë			
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: • identifikon fjalitë e përbëra në një tekst; • dallon fjalitë e përbëra bashkërenditëse nga ato nënrenditëse; • ndërton fjali të përbëra me bashkërenditje e nënrenditje sipas kërkesave të dhëna.		Fjalët kyç: fjali e përbërë, bashkërenditëse, nënrenditëse, pjesë, marrëdhënie barazie, varësie.	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, shkrim i lirë, punë e drejtuar, analizë rastesh, punë e pavarur, INSERT</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë Nxënësit kanë njohuri për fjalinë e përbërë ndaj japin në një kllaster të gjitha njohuritë e tyre për të, duke pasur parasysh; <ul style="list-style-type: none"> • Pse quhen fjali të përbëra? • Sa llojesh janë? • Kur quhen bashkërenditëse e kur nënrenditëse.? 			
2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>analizë rastesh, punë e drejtuar, INSERT</i> U kërkohet nxënësve të shohin fragmentin në hyrje të mësimit dhe të punojnë për gjetjen e fjalive të përbëra duke bërë dhe ndarjen e tyre në bashkërenditëse e nënrenditëse. Merren në analizë në tabelë fjalitë 2, 3, 6, 7, 8, 9. <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ne e kuptonim se po ndodhte diçka në botën magjike të këngës.</i> • <i>Sytë a plakut njomeshin, por nuk rridhnin lot.</i> • <i>Në qiell, ku shkëlqente dielli, dukeshin zogjtë të cilët ulnin flatrat dhe, në zbrazëtinë e telave, futeshin brenda në violinë.</i> • <i>Melodia e këngës pushonte dhe plaku e lëshonte violinën para vetes, në gjuhë.</i> • <i>Ishte i kënaqur që ne e pëlqenim këngën e violinës së tij. Për të bërë analizën e këtyre fjalive, bashkë me nxënësit, dallohen kallëzuesit dhe ndahen fjalitë në pjesë. Tregohet kujdes me pjesët e fjalive që janë të ndërfutura te njëra tjetra. P.sh.: në fjalinë e tretë, pjesët e fjalisë janë: Në qiell dukeshin zogjtë <ul style="list-style-type: none"> • ku shkëlqente dielli • të cilët ulnin flatrat • dhe, në zbrazëtinë e telave, futeshin brenda në violinë. </i> 			
Për të gjitha fjalitë nxënësit vërejnë: kur pjesët e fjalive kanë marrëdhënie barazie dhe kur marrëdhënie varësie, duke pasur parasysh që pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje mund të qëndrojnë si fjali të thjeshta më vete, ndërsa të nënrenditurat jo. Mundësisht këto marrëdhënie të pasqyrohen përmes skemave të thjeshta për secilin lloj. Pas kësaj analize u kërkohet nxënësve të kthehen në tekst me shenjat e tabelës INSERT dhe ngrenë për diskutim çështje të paqarta për ta.			

√	+	-	?
Njohuri që nxënësi i ka marrë	Njohuri të reja që nxënësi i kupton	Njohuri të reja që nxënësi i di ndryshe	Njohuri që nxënësi nuk i kupton

3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. Punë e pavarur

- Për efekt kohe klasa mund të ndahet në grupe për të zhvilluar ushtrimet.
- **Ushtrimi 1** sipas kërkesës; (Th) 2, 3, 5. Të tjerat të përbëra.
- **Ushtrimi 2, 3, sipas kërkesave.** Meqë fjalitë janë me pak pjesë, mund të kërkohet të bëjnë skemat e disa fjalive.
- **Ushtrimi 4,** sipas kërkesës. Fjalitë e përbëra bashkërenditëse kthehen lehtësisht në fjali të thjeshta, sepse pjesët janë në marrëdhënie barazie ndërmjet tyre dhe kanë pavarësi nga njëra-tjetra. Mund të kthehet në fjali të thjeshtë edhe pjesa kryesore.
- **Ushtrimi 5, 7 sipas kërkesës. Për ushtrimi 7 bëni skemat për të dhënë përgjigje më të sakta.**
- **Ushtrimi 6 (K) 2, 3, 4, 6, 7, të tjerat V.**

Vlerësimi: Sipas dëshirës së mësuesit në bazë të rezultateve të të nxënëit, gjatë gjithë procesit mësuesor.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për fjalitë bashkërenditëse e nënrenditëse. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënëit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënëit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënëit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • identifikon fjalitë e përbëra nga fjalitë e thjeshta në një tekst të dhënë; • dallon fjalitë bashkërenditëse nga ato nënrenditëse • përcakton mjetin lidhës dhe llojin e tij; • diskuton marrëdhëniet ndërmjet pjesëve në fjalitë e përbëra; • ndërton fjali të përbëra sipas kërkesave të dhëna. 		<ul style="list-style-type: none"> fjali, pjesë bashkërenditëse, pjesë nënrenditëse, marrëdhënie barazie, varësie, marrëdhënie varësie, mjete lidhëse. 	
Burimet: teksti i nxënësit, e - libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e pavarur, diskutim.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Punë e drejtuar*

Kontrrollohet dhe diskutohet detyra e shtëpisë. Rikujtohen shpejt me nxënësit njohuritë e fjalisë së përbërë sipas këtyre çështjeve:

- Ç’quajmë fjali të përbërë?
- Llojet e fjalive të përbëra.
- Mjetet lidhëse.
- Marrëdhëniet ndërmjet pjesëve në fjalinë e përbërë.
-

2. Ndërtimi prezantimi dhe demonstrimi i njohurive: *Punë e pavarur, diskutim*

Ushtrime. Këto ushtrime mund të punohen edhe në trajtë minitesti.

Ushtrimi 1. Lidhëza **bashkërenditëse**; dhe, por, ndaj, veçse. **Nënrenditëse**; megjithëse, se, kur.

Ushtrimi 2, 3, 4, 5. sipas kërkesës.

Ushtrimi 6. Lidhëza: se, dhe, prandaj, sikur, që (në fjalinë e fundit) **Mjete lidhëse**; e cila, që (fjalë 3), ku (fjalë 6).

Ushtrimi 7. Përveç lidhjes së fjalive mes tyre, u kërkohet nxënësve të punojnë dhe me kthimin e gjymtyrëve, sidomos përcaktorë e rrethorë, në pjesë fjalie.

P.sh., veç shembullit të librit, mund të zhvillohet dhe kështu: Shkrimtari që tashmë i kishte flokët e thinjur, po ecte aty ku ndodhej lishja dhe i dukej se kishte pranë çunakun që kish njohur dikur.

Ushtrimi 8, 9, 10 sipas kërkesës. Për ushtrimin 9 përgjigja është se pjesët në fjalinë bashkërenditëse kanë rend të ngulitur.

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit. Vendoset një standard nëse zhvillohet një minitest.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrim 11 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ernest Koliqi “Kërcimtarja e Dukagjinit” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënët: Legjenda për Skënderbeun	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Sjell legjenda nga jeta dhe heroizmat e Skënderbeut. • Lexon me intonacion dhe në mënyrë shprehëse pjesën. • U përgjigjet pyetjeve për të zbërthyer përmbajtjen. • Ndërton vetë pyetje rreth të kuptuarit dhe interpretimit të fragmentit 		Fjalët kyç: Legjendë, Skënderbeu, Lulja, turkina.	

Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; materiale të lexuara prej tyre rreth figurës së Skënderbeut	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, lexim i drejtuar DRTA, punë me fjalorin, rrëfime të nxënësve, diskutim, pyetje-përgjigje, punë e pavarur</i>	

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Bashkëbisedim, rrëfime të nxënësve*

Përmes bashkëbisedimit, nxënësit rrëfejnë legjenda e gojëdhëna të ndryshme për Skënderbeun, duke u kujdesur që ato të trajtojnë, jo thjesht anën e heroit, por dhe anën njerëzore të Skënderbeut.

U drejtohen pyetje të tilla si:

- Kush është Skënderbeu?
- Ç’ dini për figurën e Heroit tonë Kombëtar?
- Ç’ndjenja zgjon tek ne kjo figurë?
- Po luftëtarë të tjerë të kohës së Skënderbeut a njihni?

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i drejtuar DRTA, punë me fjalorin, diskutim*

Bëhet prezantimi i titullit dhe rezultateve të të nxënit duke folur shkurt dhe rreth jetës e veprës së Ernest Koliqi.

Mësuesi/ja (ose nxënësi), lexon pjesë-pjesë tekstin dhe nxënësit flasin për atë që kuptojnë gjatë leximit duke u ndalur në elementet kyçe të përmbajtjes, si: fjalët kyç, fjalët që nuk kuptojnë, fjalët dialektore apo figurat letrare.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *pyetje-përgjigje, karrigia e nxehtë, diskutim*

Katër nxënës, dy për çdo rol vijjnë përpara klasës për të folur për përmbajtjen e pjesës, por në rolin e personazheve. Pjesa tjetër e klasës përgatit pyetje, të cilat ua drejton personazheve (dy në rolin e Lules e dy në rolin e turkinës).

Pyetjet që duhet të dalin lidhen me të kuptuarin dhe interpretimin e ngjarjeve për të dyja personazhet. Nxënësit mund të kenë të njëjtat përgjigje, por mund të shprehen në mënyra të ndryshme e të plotësojnë njëri-tjetrin.

Ndër pyetjet mund t’u bëhen personazheve janë:

Për turkinën;

- Çfarë deshe të japësh përmes kërcimit tënd?
- A ia arrite qëllimit? Pse?
- A u trishtove që e humbe konkursin e kërcimit? Pse?
- Ç’mendim ke për Lulen si kërcimtare dhe si femër?

Për Lulen:

- A ia arrite qëllimit me kërcimin tënd?
- Çfarë deshe të tregoje me të?
- Si u ndjeve kur e fitove çmimin?
- Ç’mendim ke për turkinën si kërcimtare e si femër?

Pas përgjigjeve, që mund të plotësohen dhe nga klasa, punohen ushtrimet e rubrikës *Kuptimi dhe mesazhi*.

Ushtrimi 1: Turkesha ndihej e huaj, e përlurur dhe me përlurjen e saj donte të fitonte zemrën e Skënderbeut e të fitonte çmimin.

Ushtrimi 2: Kërcimi i Lules jep dhe karakterin e saj. Ajo është jo thjesht e bukur fizikisht, por dhe shpirtërisht . Ajo përfaqëson shëndetin, bukurinë e bjeshkëve shqiptare, trimërinë, krenarinë e vendit nga vjen.

Ushtrimi 3: Autori nuk e përshkruan as anën fizike, as karakterin e Lules, sepse do ta japë si përfaqësuesen e denjë të Dukagjinit përpara kryetrimin. Me kërcimin e saj ajo përcjell bukurinë e luleve, freskinë dhe madhështinë e bjeshkëve prej nga vinte. Këtë mund ta ilustrojmë më së qarti nga teksti, kur jepet përshkrimi i valles së Lules.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Përshkruani duke vënë në kontrast përballë njëra tjetrës me fjalët tuaja dy kërcimet; të turkinës dhe të Lules.

Detyra f. 133 lihet me dëshirë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ernest Koliqi “Kërcimtarja e Dukagjinit” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Reciton fragmente nga pjesa me intonacionin e duhur. Përshkruan me detaje duke ilustruar portretin e personazheve. Gjen dhe shpjegon përdorimet e figurshme të fjalës. Komenton thënie e shprehje nga teksti me vlerë të trashëgimisë popullore. 		Fjalët kyç: Skënderbeu, Lulja, turkina, kërcim, konkurs,	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; tregimi “Kërcimtarja e Dukagjinit”,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, shkenca dhe shoqëria	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi, ditarët e të nxënit, diskutim, pyetje-përgjigje.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Stuhi mendimi.*

Bëhet kontrolli dhe leximi i detyrave të shtëpisë duke vlerësuar me gojë, por dhe me notë. Dëgjohen disa recitime dhe vetë nxënësit bëjnë vlerësimin e recitimeve të shokëve të tyre.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *ditarët e të nxënësve, pyetje –përgjigje, diskutim,*

Kalohet në diskutimin e pyetjeve rreth interpretimit dhe vlerësimit të tekstit:

Ushtrimi 5: Kur e përmend si mbesë të Lekë Dukagjinit, autori do të japë vlerat e trashëgimisë kulturore që ajo mbart, jo vetëm për nga origjina dhe për atë që Lekë Dukagjini mbart, si simbol i luftës krah Skënderbeut dhe më tepër si mbledhës i vlerës mendore e shpirtërore të tërë krahinës së Dukagjinit, Kanunit.

Lekë Dukagjini është figura e dytë arbërore e shekullit XV pas Skënderbeut, që u mundua të vazhdonte luftën edhe pas vdekjes së Heroit Kombëtar. Për studiuesit, ai me përmbledhjen e “Kanunit”, gjykohet si një figurë e plotësuar e Arbërisë Mesjetare, që ka luftuar për identitet.

Hinmizimi i trashëgimisë e bukurisë fizike, shpirtërore e kulturore shqiptare, jepet përmes valles së Lules dhe përshkrimit të kësaj valleje në paragrafin e fundit.

Ushtrimi 6. Vijnë dy imazhe me këtë tekst të Koliqit:

Kur përshkruan Tyrkinën, ndonëse një pamje magjepsëse, ajo është e mbyllur brenda mureve, si diçka pa jetë dhe e shkëputur nga realiteti, ndërsa përmes Lules autori sjell pamjet e mrekullueshme të natyrës shqiptare plot jetë, freski, hijeshi, ngjyra, zëra të gjallë e të gurgullimës, këngës së zogjve, natyrës, drurëve të lartë e të hijshëm, qiellit të kaltër e të pastër pa fund me një flad e ajër të pastër që të mbush e të jep jetë.

Ushtrimi 7. Këtu ka një sërë figurash me të cilat përshkruhet secili personazh.

Turkina	Lulja
Vallja si një lutje dashunore me lëvizje të ngadaltë, çon trupin e duert herë prapa e herë pas, vallja u ngjall u valëvit, Si një gem i lulzuem që filladi e përkulë, etj(i gjithë paragrafi dytë)	Lule të denduna, të panjehuna i çelshin ndër kambë, një amë lulesh mali e si një gurgullim krojesh të ngrita. Lëkura e fytyrës së saj ngjante e endun me rreze e fletëza prilli. Trupi përhppte anë për anë një njomësi si një lule që sapo ka çelë. E drejtë si curril uji gufues, e shpejtë si hije reje, e drithshme si drita në krue, endej shpejt, kadalë e hovshëm. ... si lirija e maleve, i lehtë si një kind flamuri që valon ndër maje të egra, si fluturimi i shqipeve, i permallshëm si kangë e harrueme...

Ushtrimi 8: *ditarët e të nxënësve*

Mbiemri ka si funksion të tregojë cilësinë e emri. përshkruajë vashat, vallet e tyre dhe te Lulja dhe bukurinë e natyrës shqiptare. Vazhdohet me ditarin tripjesësh për të gjetur figurat kryesisht epitete, metafora e krahasime dhe për të dhënë efekstin e tyre stilistik e estetik.

Mbiemrat	Komenti – roli i tyre artistik
Lutje e <i>dishpërueme</i> Duer të <i>ndeme</i> Ecje e <i>kadalshme</i> , curril uji <i>gufues</i> gurgullimë krojesh të <i>ngrita</i> e drejtë, e shpejtë, i lehtë, i permallshëm etj; habi e <i>ambël</i>	Mbiemrat japin cilësitë e valles së turbinës, që shfaq dëshpërim e mërzi. Japin bukurinë e valles, por sidomos madhështinë e valles shqiptare. Mbiemri tregon pritjen me dashuri të të gjithë të pranishmëve.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë

Detyrat dhe puna e pavarur; Ushtrimi 9 me ditar dypjesësh.

Sillni foto dhe aplikacione që tregojnë veshje popullore të zonës suaj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përshkruajmë veshje popullore (ora I)		Situata e të nxënit: Veshje të krahinës sime.	
Kompetenca: Të shkruarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca qytetare 5. Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • flet shkurtimisht për veshjet popullore shqiptare; • veçon terma e fjalë përshkuese, karakteristike për veshjet popullore, • tregon karakteristika të veshjeve popullore nga krahina e tij. 		kostum, popullor, burra, gra, krahinë, krahasoj, përshkruaj.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale shoqëruar me foto për veshjet popullore, përvoja të nxënësve, e-libri.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, arte. Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, kllaster, punë e pavarur, analizë rasti, punë e drejtuar.			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: diskutim.</p> <p>Nxënësit janë porositur që një orë më parë të kenë me vete informacione, foto mundësisht nga burime origjinale si prindërit e gjyshërit e tyre, në të cilat janë pasqyruar veshjet nga krahinat e tyre.</p> <p>Nxënësit orientohen të gjejnë dhe një herë në tekst karakteristikat e përshkrimit të veshjes popullore në pjesën “Kërcimtarja e Dukagjinit”, të cilat janë punuar konkretisht në orën e dytë gjatë të lexuarit të tekstit.</p> <p>Shkurtimisht nxënësit japin veçori të veshjes së krahinës së tyre që i gjejnë në këtë përshkrim nëse ka.</p>			
<p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: analizë rasti</p> <p>Nxënësit kthehen në tekst në përshkrimin e Konicës dhe evidentojnë të gjithë fjalët kyçe në përshkrimin e veshjes popullore duke evidentuar klasën së cilës i përkasin. (Kryesisht emra dhe mbiemra), karakteristikë e tekstit përshkruar.</p> <p>Vetë nxënësit përcaktojnë çfarë strukture duhet të ketë përshkrimi i tyre dhe ku duhet të ndalen për të përshkruar veshjet e krahinës së tyre duke i krahasuar veshjet e burrave me të grave.</p> <p>Nëse nxënësit nuk gjejnë foto origjinale mund të shfrytëzojnë burime nga interneti për t'i pasur këto foto si shoqëruese të përshkrimit të tyre.</p>			

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur, diskutim.*

Nxënësit nisin me përshkrimin e secilës prej veshjeve duke u munduar t'i krahasojnë ato.

Lexohen pjesët hyrëse të shkrimeve dhe shkurtimisht mund të bëhen vërejtjet e duhura rreth tyre. U kërkohet nxënësve që gjatë krahasimit të punojnë me paragrafë, ku çdo detaj që përshkruhet e krahasohet, të jetë i plotë dhe për secilin të ketë një paragraf që lidhet kuptimisht për të realizuar një tekst të plotë.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe vetëvlerësim.

Detyrat dhe puna e pavarur. Meqë shkrimi lidhet ngushtësisht me përvojat e prindërve e të gjyshërve të nxënësve, u kërkohet atyre të vazhdojnë në shtëpi shkrimet krahasuese përshkruese duke u konsultuar me të afërmit që i njohin më mirë ato.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përshkruajmë veshje popullore (ora II)		Situata e të nxënësve: Punë me shkrim	
Kompetenca: Të shkruarit			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit; 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; 4. Kompetenca qytetare 5. Kompetenca personale 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • liston karakteristikat e një teksti përshkrues; • përshkruan veshje popullore të krahinës së tij; • evidenton veçoritë e veshjeve të burrave e grave përmes krahasimit të tyre; • diskuton rreth përshkrimeve të shokut të tij për t'i vlerësuar ato. 		përshkrim, krahasim, veshje popullore, burra, gra.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale të tjerë nga burime të ndryshme për veshjet popullore, përvoja të nxënësve, e-libri.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: shoqëria dhe mjedisi, identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e pavarur, diskutim.</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i>			
Nxënësve u rikujtohen dhe një herë karakteristikat e një teksti përshkrues, ku mbizotërojnë emra e mbiemra dhe mënyra se si duhet të realizojnë paragrafët, duke u ndalur në çdo detaj të krahasimit mes veshjeve popullore të burrave e të grave.			
Lexohen punët që nxënësit kanë bërë në shtëpi duke bërë vërejtjet e duhura sipas rastit.			
2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>punë e pavarur.</i>			

Rishikojnë për të korrigjuar punën e tyre nga ana strukturore dhe pasuria e leksikut por dhe nga ana drejtshkrimore.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim

Rilexohen ose lexohen disa punime të tjera të nxënësve, mundësisht dhe për të njëjtën krahinë, që nxënësit të diskutojnë për të vlerësuar duke i krahasuar mes tyre. Punët përfundimtare të nxënësve të shoqërohen me foto përkatëse të veshjeve.

Punët më të mira mund të realizohen si një projekt i lidhur, mund të afishohen në turin e galerisë ose qendrën e shkrimeve.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Llojet e fjalive bashkërenditëse. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënit: <i>Shkolla ime.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon fjalitë bashkërenditëse; • përcakton llojin e tyre; • diskuton rendin e pjesëve në fjalitë bashkërenditëse; • përdor saktë presjen në fjalitë bashkërenditëse sipas drejtshkrimit; • ndërton fjali e krijime me fjali bashkërenditëse. 		Fjalët kyç: fjali e përbërë, pjesë bashkërenditëse, lidhëz, shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse, rend, presje.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, punë e pavarur, punë e drejtuar, shkrim i lirë, tabela e koncepteve.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi.*

Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë dhe rikujtohen njohuritë për fjalinë e përbërë, duke u kërkuar nxënësve përkufizimin e fjalisë së përbërë, llojet e tyre dhe ato që dinë në lidhje me fjalinë me bashkërenditje.

2. Ndërtimin e njohurive të reja: *shkrim i lirë, tabela e koncepteve.*

Nxënësve, në bazë të njohurive që kanë, u kërkohet të bëjnë një shkrim të lirë me temë “Shkolla ime”, ku të përdorin sa më shumë fjali me bashkërenditje dhe shumëllojshmëri të lidhëzave bashkërenditëse që i kanë marrë vitin e kaluar. Merren shembuj nga krijimet e tyre, rreth dy shembuj për çdo lloj, duke analizuar marrëdhëniet kuptimore ndërmjet pjesëve, pra ku shtohet informacion për njërin pjesë, ku kundërshtohet informacioni i njëres pjesë, ku veçohet dhe ku përmbillet. Vazhdohet me tabelën e koncepteve të cilën nxënësit e plotësojnë vetë nëpërmjet librit, duke u dhënë konceptet gati.

Fjalitë bashkërenditëse	Marrëdhëniet kuptimore mes pjesëve	Mjetet lidhëse	Shembuj	Përdorimi i presjes
Shtuese				
Veçuese				
Kundërshtuese				
Përmbyllëse				

Në lidhje me përdorimin e presjes, nxënësit le të përpiqen vetë, përmes shembujve të librit, të arrijnë në përfundimin se: Para lidhëzave shtuese e veçuese zakonisht nuk vendoset presje, me përjashtim të rasteve të përsëritjes së tyre dhe përdorimit me nuanca të veçanta kuptimore, (p.sh.: ajo qëndronte më këmbë, dhe pse kjo që tejet e mundimshme), ndërsa para lidhëzave kundërshtuese dhe përmbyllëse zakonisht vendoset gjithmonë presje.

3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. Punë e pavarur, ushtrime.

- **Ushtrimi 1.** Veçuese, përmbyllëse, shtuese, kundërshtuese.
- **Ushtrimi 2.** Fjalja e 2, 3, 6 me bashkërenditje shtuese, 1, 7 dhe e fundit kundërshtuese.
- **Ushtrimi 3.** Kujdes fjalitë bashkërenditëse kundërshtuese, përmbyllëse dhe ato shtuese e veçuese të përsëritura ndahen me presje.
- **Ushtrimi 5, 6, 7** sipas kërkesës.

Vlerësimi: Më mirë bëhet në orën e dytë të ushtrimeve duke pasur parasysh ecurinë dhe pjesëmarrjen në të dy orët,

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për fjalitë bashkërenditëse e nënrenditëse. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç: fjali, pjesë bashkërenditëse, pjesë nënrenditëse, marrëdhënie barazie, varësie, marrëdhënie varësie, mjete lidhëse.	
<ul style="list-style-type: none"> • identifikon fjalitë e përbëra nga fjalitë e thjeshta në një tekst të dhënë; • dallon fjalitë bashkërenditëse nga ato nënrenditëse • përcakton mjetin lidhëz dhe llojin e tij; • diskuton marrëdhëniet ndërmjet pjesëve në fjalitë e përbëra; • ndërton fjali të përbëra sipas kërkesave të dhëna. 			
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë e pavarur, diskutim, stuhi mendimi.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve;

Kontrollohet dhe diskutohet detyra e shtëpisë. Rikujtohen shpejt me nxënësit njohuritë e fjalisë së përbërë sipas këtyre çështjeve:

- Ç’quajmë fjali të përbërë?
- Llojet e fjalive të përbëra.
- Mjetet lidhëse.
- Marrëdhëniet ndërmjet pjesëve në fjalinë e përbërë.

Ushtrime. Këto ushtrime mund të punohen edhe në trajtë minitestit.

Ushtrimi 1. Lidhëza **bashkërenditëse**; dhe, por, ndaj, veçse. **Nënrenditëse**; megjithëse, se, kur.

Ushtrimi 2, 3, 4, 5. sipas kërkesës.

Ushtrimi 6. Lidhëza: se, dhe, prandaj, sikur, që (në fjalinë e fundit) **Mjete lidhëse**; e cila, që (fjalja 3), ku (fjalja 6).

Ushtrimi 7. Përveç lidhjes së fjalive mes tyre, u kërkohet nxënësve të punojnë dhe me kthimin e gjymtyrëve, sidomos përcaktorë e rrethanorë, në pjesë fjalie.

P.sh., veç shembullit të librit, mund të zhvillohet dhe kështu: Shkrimtari që tashmë i kishte flokët e thinjur, po ecte aty ku ndodhej lishaja dhe i dukej se kishte pranë çunakun që kish njohur dikur.

Ushtrimi 8, 9, 10 sipas kërkesës. Për ushtrimin 9 përgjigja është se pjesët në fjalinë bashkërenditëse kanë rend të ngulitur.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit. Vendoset një standard nëse zhvillohet një minitest.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrim 11 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i presjes në fjali. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Drejtshkrim		Situata e të nxënët: Punë me tekstin.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • liston rregullat e përdorimit të presjes në gjymtyrët e veçuara, homogjene e fjalitë e përbëra me bashkërenditje; • gjen përdorimet e gabuara të presjes për rastet e mësipërme; • qorton përdorimet e gabuara të presjes sipas rregullave; • përdor drejt presjen në fjalitë e përbëra me bashkërenditje, gjymtyrët e veçuara dhe ato homogjene. 		presje, gjymtyrë të veçuara, homogjene, fjali të përbëra me bashkërenditje.	

Burimet: teksti i nxënësit, e-libri	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:						
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Di, dua të di, mësova, punë e pavarur, diskutim.</i>							
Organizimi i orës së mësimit							
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>diskutim</i> Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Në veçanti nxënësit shpjegojnë përdorimet e presjes në tekstin e tyre me fjali të përbëra me bashkërenditje.</p> <p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Di, dua të di, mësova.</i> U kërkohet nxënësve të lexojnë me kujdes materialin në tekst dhe të hedhin në tabelën e mëposhtme njohuritë që kanë rreth përdorimit të presjes.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>DI</td> <td>DUA TË DI</td> <td>MËSOVA</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table> <p>Përqendrohet puna të sqarohen paqartësitë e nxënësve dhe për t'i shpjeguar ato, kryesisht në lidhje me gjymtyrët e veçuara dhe ato homogjene. Rregullat që nxënësit mësojnë mund t'i ilustrojnë me tekstin në hyrje, duke shpjeguar në çdo rast që lidhet me mësimin dhe përdorimin e presjes.</p> <p>3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur. Ushtrime</i> Ushtrimi 1. i gëzuar nga rezultati (përcaktor), me zë të lartë (kundrinor me parafjalë), të emocionuar (përcaktor), nga kreu i dhomës (rrethanor vendi), në rininë e saj (rrethanor kohe), krahas ndërtimi të pallateve (kundrinor i zhdrejtë me parafjalë).</p> <p>Ushtrimi 2, 3, 4 sipas kërkesës. Së bashku me ushtrime të tjera ushtrimi 6 mund të punohet në trajtë diktimi ose të jepet detyrë shtëpie në vazhdim. Në realizimin e ushtrimit 6 nuk ka një zhvillim fiks. Në varësi të intonacionit që përzgjedhin nxënësit kur e lexojnë, bëhet dhe vendosja e shenjave të pikësimit.</p>		DI	DUA TË DI	MËSOVA			
DI	DUA TË DI	MËSOVA					
Vlerësimi: Për realizimin e rezultateve të të nxënit.							
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6.							

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mikael Ende “Historia pa mbarim” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Makina e kohës	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen e mjedisin. 			

<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të flasë me imagjinatë për aventurat e tij, nëse do të zotëronte makinën e kohës. • Lexon pjesë dhe u përgjigjet pyetjeve për të kuptuarit e përmbajtjes. • Parashikon ngjarjet nisur nga fragmenti paraardhës. • Ndan pjesën në paragrafë dhe ndërton oër secilin nga një fjali përmbledhëse. • Ritregon përmbajtjen e pjesës përmes fjalive përmbledhëse. • Rindërton ngjarjen duke u vënë në rolin e personazhit. 	<p>Fjalët kyç:</p> <p>histori pa mbarim, Basiani, libër, aventura</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, materiale për autorin, vepra “Historia pa mbarim”</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Vendimmarrja morale</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar, lexim zinxhir, diskutim, karrige e nxehtë, punë e drejtuar punë e pavarur</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit kanë lexuar librin “Makina e jetës” ose kanë parë të ekranizuar histori me humbjen e nocionit kohë dhe aventura fantastike. Ata tregojnë shkurtimisht historitë e tyre imagjinare, duke thënë përse ndonjëherë duan të arratisen nga realiteti, ku dhe si e parashikojnë botën fantastike ku duan të shkojnë. Nxënësve u kërkohet të flasin për jetën e Mikael Ende dhe ata që mund të kenë lexuar librin, të cilin në mënyrë të përmbledhur për të.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim zinxhir</i> Nxënësit lexojnë pjesën dhe pastaj punohen ushtrimet e rubrikës <i>Kuptimi dhe mesazhi</i>. Nxënës që e njohin historinë, por dhe të tjerë, përpiqen ta rindërtojnë atë duke u bazuar në çështjet e pikës 1. Dëgjohen disa variante dhe pranohet ai që shkon më afër së vërtetës.</p> <p>Bastian Baltazar Bux, pas vdekjes së nënës së tij, është lënë pas dore nga babai i tij. Një ditë ai merr një libër fshehurazi në bibliotekë dhe e lexuar në baxhon e saj. Ai hyn në botën fantastike që përshkruan libri, plot me aventura, futet në botën fantastike të librit dhe humb lidhjen me realitetin. Ndërkohë babai i tij ishte shqetësuar nga mungesa e të birit. Kur kthehet në shtëpi ai vendos një marrëdhënie të re dashurie me të atin.</p> <p>Nxënësit ndajnë pjesën në paragrafë dhe ndërtojnë fjali përmbledhëse për secilin paragraf duke dhënë informacionin kryesor të çdo paragrafi dhe dhënë përmbledhjen e pjesës. Pika 2 mund të realizohet nga një ose dy nxënës për të dhënë variante të ndryshme, që e vënë veten në rolin e Basianit dhe tregojnë historinë e tyre.</p> <p>2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>pyetje-përgjigje, diskutim, punë e pavarur, karrige e nxehtë.</i></p> <p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. Ushtrimi 3. F. 137.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Mikael Ende “Historia pa mbarim” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Ritregon historinë sipas mënyrës së tij. • Gjykon veprime e mendime të Bastianit duke argumentuar mendimin e tij. • Interpreton mesazhin dhe idetë e pjesës. • Komenton thënie që lidhen me filozofinë e jetës në tekst. 		Fjalët kyç: histori pa mbarim, Bastiani, Uji i jetës, babai	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, vepra “Historia pa mbarim”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Vendimmarrja morale	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, pyetje-përgjigje, ditarët e të nxënit, analizë teksti.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: diskutim

Nxënësit lexojnë detyrat dhe vlerësojnë historitë e ndërtuara më mirë për: origjinalitetin, fantazinë, logjikën, koherencën etj.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetje-përgjigje, Ditarët e të nxënit, Harta e personazhit

- Cila ishte tema e kësaj pjese?
- Sa prej jush e kanë lexuar veprën “Historia pa mbarim”?

Ushtrimi 4. Bastianit iu duk se kishte kaluar javë, muaj, vite larg.

Por në të vërtetë ai ishte larguar vetëm 24 orë. Kjo tregon që koha në jetën joreale shkonte shumë më shpejt, sepse ishte fantazia ajo që e përshpejtonte çdo gjë.

Ushtrimi 5. Uji i jetës i duhej Bastianit për të atin, t’i zgjaste atij jetën, jo thjesht se e donte atë, por pas humbjes së nënës, ai qe i vetmi njeri i afërt e i dashur për të, që mund ta donte pa kushte dhe që kohët e fundit po i mungonte.

Ushtrimi 6. Babai u përlot, sepse jo vetëm e kishte ndier mungesën të birit, por e kuptoi që ishte treguar i ftohtë me të dhe nuk i kishte dhënë vëmendjen e duhur. Ai kuptoi se i biri ishte një djalë i denjë për të, duke pasur parasysh se si ai ishte përpjekur mes peripecive e rreziqeve në fantazi, të sillte Ujin e Jetës për të atin.

Ushtrimi 7. Mund të punohet me ditarët e të nxënit.

Me këtë i ati donte të thoshte se në jetën e tyre vërtet mungonte nëna e Bastianit, por ai do t’i jepte gjithçka mundte për ta zbutur dhembjen e të birit, por dhe për ta zëvendësuar disi. Ata do të ishin shumë më të lidhur se më parë dhe më të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit.

Shprehja	Figura letrare	Interpretimi im

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Harta e personazhit, Analizë teksti*

Jepni tiparet e Bastianit përmes hartës së personazhit.

Gjuha dhe stili;

a. Fjalitë janë të gjata, kryesisht të përbëra me shumë pjesë. Kjo e ndihmon autorin ta japë botën plot fantazi e të pasur të Bastianit, duke sjellë shumë në detaje. dhe të japë detaje.

b. Fjalët e autorit gërshetohen me të personazhit dhe thuhet nuk i dallon nga njëri-tjetri dhe kjo të jep përshtypjen se autori ndjek në çdo hap personazhin e tij gjatë aventurave, bisedave dhe fantazisë së tij.

c. Baxhë-pjesa e sipërme në trajtë dhome në çati.

Avit - afrua

I ra në sy - pa me çudi,

la nguli sytë - e pa me mall me dashuri, me vërejtje

Zemrën e kishte të tejmbushur - ndiente dashuri, mallëngjim, frikë,

Nuk nxirrte zë nga goja - nuk fliste, por shijonte momentet e paqes dhe dashurisë me të atin.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Nëse pika e fundit nuk përfundohet, vazhdohet në shtëpi.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ligjëratat e drejtë dhe e zhdrejtë. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon ligjëratën e drejtë nga e zhdrejta; përcakton elementet përbërëse të ligjëratës së drejtë; ndërton vetë ligjëratat e drejta sipas kërkesave të dhëna. 		Fjalët kyç: ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë, pjesë lajmëruese, pjesë përmendëse.	
Burimet: teksti i nxënësit, përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, punë e drejtuar punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*

Bëhet kontrolli, diskutimi i detyrave të shtëpisë dhe një vlerësim i përgjithshëm i tyre

Bëhet një rifreskim të njohurive të nxënësve rreth ligjëratës së drejtë duke pasur parasysh mënyrën e veçantë të ndërtimit, mënyrës se si shprehen fjalët e autorit dhe të personazhit, shenjat e pikësimit që përdoren etj.

2. Ndërtimin e njohurive të reja: *analizë rasti, punë e pavarur*

- U kërkohet nxënësve të punojnë me dialogun në tekst duke nxjerrë këto konkluzione nga analiza e saj:
– Cilat janë fjalët e autorit, - fjalët e personazhit, - në ç’kohë e vetë janë foljet në secilin rast, - çfarë shenjash pikësimit janë përdorur.
- Të njëjtën gjë bëjnë dhe për fragmentin e dytë të përrallës duke bërë kështu emërtimin dhe dallimin mes dy ligjëratave.
- Për të plotësuar informacionin u kërkohet nxënësve të shohin materialin në tekst dhe të emërtojnë si duhet fjalët e autorit dhe të personazhit.

3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. *punë e drejtuar punë e pavarur* . Ushtrime Ushtrimi 1, 2, 3, 5 sipas kërkesës. Në zhvillimin e ushtrimit 1 u kërkohet nxënësve të thonë karakteristikat e secilës ligjëratë.

Ushtrimi 4. U kërkohet nxënësve të japin dhe kuptimin e shprehjeve frazeologjike.

- *Nxori në shesh* - e tregoi
- *E ndau mendjen* - e vendosi
- *I ndajmë gëzimet bashkë* - festojmë bashkë
- *I dha zemër* - e inkurajoi

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit por mund të shihet performanca dhe në të tria orët e ligjëratës së drejtë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 sipas kërkesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Rendi i pjesëve në ligjëratën e drejtë dhe shenjat e pikësimit. Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënët: Diktim	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • dallon pjesët e ligjëratës së drejtë; • ndryshon vendin e pjesëve në ligjëratën e drejtë pa e prishur kuptimin; • respekton shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë; • ndërton ligjërata të drejta sipas kërkesave. 		ligjëratë, e drejtë, e zhdrejtë, pjesë lajmëruese, përmendëse, shenja pikësimit, dialog.	

Burimet: teksti i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:						
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, diktim, punë e drejtuar, analizë rastesh, Di, Dua të Di, Mësova, punë e pavarur.</i>							
Organizimi i orës së mësimit, që mund të përmbajë:							
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë duke kujtuar përmes tyre karakteristikat e ligjëratës së drejtë e të zhdrejtë.</p> <p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>Diktim, analizë rasti, punë e drejtuar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • U diktohet nxënësve fragmenti në hyrje të mësimit dhe ata e vendosin vetë si duhet shenjat e pikësimit. • Nxënësit punojnë me tekstin e diktuar duke përcaktuar pjesën lajmësuese dhe atë përmendëse dhe vendin që ato kanë në raport me njëra tjetrën. • Hapen librat dhe shihet vendosja e shenjave të pikësimit. Këtu nxënësit mund të bëjnë një vetëvlerësim duke këmbyer fletoret dhe duke korigjuar njëri-tjetrin. • Ky vlerësim shihet dhe kihet parasysh nëse është bërë drejt kur duhet të vlerësohet ndonjë nxënës. • Vazhdohet në tekst nga nxënësit me materialin e librit duke përfunduar në fletore me teknikën, <i>Di, Dua të Di, Mësova</i>, dhe diskutimin për njohuritë që morën. <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td style="text-align: center;">DI</td> <td style="text-align: center;">DUA TË DI</td> <td style="text-align: center;">MËSOVA</td> </tr> <tr> <td style="height: 20px;"></td> <td style="height: 20px;"></td> <td style="height: 20px;"></td> </tr> </table> <p>3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur. Ushtrime</i> Ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 sipas kërkesës. Nëse premtion koha ushtrimet mund të zhvillohen në trajtë minitesti në libër dhe vlerësohen nxënësit rreth tyre.</p>		DI	DUA TË DI	MËSOVA			
DI	DUA TË DI	MËSOVA					
Vlerësimi: Vlerësimi mund të bëhet për aspekte të ndryshme, për të dyja orët e zhvilluara, në veçanti shihet dhe vetëvlerësimi në diktim dhe ushtrimet. Mund t'i bashkëngjitet vlerësimi dhe orës së ushtrimeve.							
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 8 sipas kërkesës.							

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë		Situata e të nxënët: ushtrime	
Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • dallon ligjëratat e drejta e të zhdrejtë në një tekst; • bën krahasimin mes ligjëratës së drejtë e të zhdrejtë; • dallon pjesët e ligjëratës së drejtë; • zhvendos pjesën lajmëruese në pozicione të ndryshme me pjesën përmendëse; • përdor saktë shenjat e pikësimit të ligjëratës së drejtë. 		ligjëratë, e drejtë, e zhdrejtë, pjesë, lajmëruese, përmendëse, shenjë pikësimi.	

Burimet: teksti i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve punë e pavarur: diktim, Diagram Veni, punë e pavarur, diskutim	
Organizimi i orës së mësimit	
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Diagram Veni</i> Nxënësit krahasojnë përmes diagramit të Venit ligjëratën e drejtë meligjëratën e zhdrejtë duke dhënë dhe karakteristikat e secilës, në veçanti të ligjëratës së drejtë.</p> <div style="text-align: center;"> </div>	
<p>2. Ndërtimi dhe prezantimi i njohurive: <i>punë e pavarur, diskutim</i> Ushtrime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushtrimet punohen sipas kërkesës dhe mund të korrighohen për të vlerësuar me notë. • Për të parë më mirë saktësinë e përdorimit të shenjave të pikësimit mund të diktohen tekstet e ushtrimit 1 dhe 3. • Për këto dy tekste mund t’u kërkohen nxënësve t’i kthejnë në ligjëratë të zhdrejtë. 	
Vlerësimi: Në bazë të realizimit të rezultateve të të nxënit në të tria orët e ligjëratës së drejtë.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 10	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i shumëpikëshit në fjali Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • liston raste të përdorimit të shumëpikëshit në fjali; • shpjegon vetë raste të përdorimit të shumëpikëshit në fjali; • përdor në shembuj të ndryshëm shumëpikëshin në fjali. 		shumëpikësh, pushim, fjalë, ngarkesë, vazhdim.	

Burimet: teksti i nxënësit, e-libri	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, analizë rasti, punë e pavarur, lojë në çift punë e drejtuar,</i>	
Organizimi i orës së mësimit	
<p>1. Lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Bëhet kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Pyeten nxënësit se cilat janë shenjat kryesore të pikësimit në fund të fjalisë dhe si përdoren ato. Të arrihet që nxënësit të kujtojnë dhe trepikëshin, si një shenjë që tregon se mendimi vazhdon, njohuri që ata e kanë marrë. <p>2. Ndërtimin e njohurive të reja: <i>analizë rasti, lojë në çift, punë e drejtuar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Fillimisht u kërkohet nxënësve të punojnë me evidentimin e rasteve kur është përdorur shumëpikëshi në fjali duke i shpjeguar përmes rasteve që janë dhënë në tekst. Duke i vendosur secilit rast nga një numër pranë çdo shumëpikëshi shënohet numri 1 - 6 në varësi të përdorimit. U kërkohet nxënësve të ndërtojnë shembuj për përdorimin e shumëpikëshit për çdo rast dhe i thonë ato jo sipas radhës por në mënyrë të çrregullt dhe shoku thotë rastin sipas të cilit është përdorur. <p>3. Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur. Ushtrime.</i> Ushtrimi 1 - 5 sipas kërkesës.</p>	
Vlerësimi: Sipas realizimit të rezultateve të të nxënët dhe gjykimit të mësuesit në çdo etapë.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit gjejnë pjesët e leximit dhe kopjojnë raste të përdorimit të shumëpikëshit dhe i shpjegojnë ato sipas çdo rasti që është dhënë në tekst.	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Anton dhe Sen Ekzyperi “Princi i vogël” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënët: Punë me feksin, novela “Princi i vogël”	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; Kompetenca e të menduarit; Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; Kompetenca personale; 			

<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lexon pjesën për t’u përgjigjur pyetjeve në tekst. • Ndan pjesën në paragrafë për ta përmbledhur atë. • Gjen shprehje e fjalë të reja të cilat i shpjegon përmes shembujve. • Interpreton fragmente nga pjesa duke vënë në kontrast personazhet dhe gjendjet e tyre. 	<p>Fjalët kyç: Princi i vogël, autori, lule, dele, shqetësim</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, novela “Princi i vogël”</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bashkëbisedim, lexim i drejtuar, punë e drejtuar, punë e pavarur,</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Bashkëbisedim,</i> Bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Me nxënësit zhvillohet një <i>bashkëbisedim</i> mbi marrëdhëniet që ata kanë me prindërit, a ndihen ndonjëherë larg botës së tyre dhe cilat janë interesat që i ndajnë. Si veprojnë kur interesat e tyre janë të ndryshme dhe nuk marrin vëmendjen e duhur prej tyre? Si sillen prindërit dhe ç’përgjigje japin kur nuk u kushtojnë atyre vëmendjen e duhur? A mendoni që kjo është normale mes brezash?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim zinxhir</i> Pas leximit, punohen ushtrimet e rubrikës <i>Kuptimi dhe mesazhi</i></p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Pyetje-përgjigje, punë e drejtuar, punë e pavarur</i> Ushtrimi 1. Princit të vogël i kishte bërë përshtypje që delet hanë shkurret, por edhe lulet, dhe që lulet kanë gjemba e këto janë të panevojshme. Me këtë autori do të rrëfejë se në botë ka njerëz të mirë e të këqij dhe te çdo njeri gjen dhe zbulon të dy anët e tij në raste të veçanta. Ushtrimi 2. Princi i tregoi për Kerrmëzën, një qenie pa shpirt, që s’i ka marrë kurrë erë një luleje, nuk ka soditur kurrë një yll dhe nuk ka dashur kurrë askënd. Për të ky lloj njeriu është kërpudhë. Ushtrimi 3. Princi quante serioze atë që lidhej me mbrojtjen qoftë edhe të një jete, të një luleje. Nxënësit ndajnë pjesën në paragrafë, ndërtojnë fjali përmbledhëse për secilin prej tyre dhe bëjnë përmbledhjen e pjesës. Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë. Detyrat dhe puna e pavarur. Ushtrimi 4 Këtu nxënësit vënë në kontrast botën e fëmijëve, botë e pafajshme kryesisht me gjëra të bukura që duan t’i njohin e shijojnë dhe botën e të rriturve, aviatori, që gjithmonë janë në lëvizje, të zënë me punë dhe nuk shijojnë ato që jeta ofron. Pra, shqetësimet e tyre janë të ndryshme; aviatori për atë që lidhet me jetën e tij në këtë moment, ndërsa Princi për problemet që ka në botë se si gjërat e bukura po humbasin.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII			
Tema mësimore: Anton dhe Sen Ekzyperi “Princi i vogël” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 						
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Gjykon dhe vlerëson sjelljen e personazheve mbështetur në argumente. • Shpjegon shprehje e përdorime të figurshme të fjalës për të dhënë të plotë figurën e personazheve. • Veçon elemente reale nga ato fantastike në tekst. 		Fjalët kyç: Princi i vogël, aviatori, gjuha, stili, lule, gjemba, trëndafila.				
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, novela “Princi i vogël”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkenca dhe shoqëria				
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, diskutim, ditarët e të nxënit, pyetje-përgjigje, harta e personazhit</i>						
Organizimi i orës së mësimt						
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Stuhi mendimi, diskutim</i> Kontrolli, diskutimi dhe vlerësimi i detyrave. Nxënësit plotësojnë njëri-tjetrin në lidhje me pasqyrimin e botës së personazheve. Nxënësit thonë përmbajtjen e pjesës me fjalët e tyre dhe mesazhin, që autori përcjell.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Pyetje-përgjigje, diskutim, tabela e koncepteve të personazhit.</i> Punohen ushtrimet e rubrikave <i>Interpretimi dhe vlerësimi, Gjuha dhe stili.</i></p> <p>Ushtrimi 5. Princi i vogël shqetësohet për jetën e gjallesave dhe fatin e tyre, për natyrën dhe gjërat që e dëmtojnë atë, por dhe për natyrën njerëzore, që nuk i shijon gjërat e bukura e të vogla që i ofron jeta. Miku i tij i rritur shqetësohet për avionin, faktin që ka mbetur në shkretëtirë etj..</p> <p>Nxënësit kalojnë në analizën e personazheve përmes tabelës së koncepteve:</p>						
Personazhet	Cilësi fizike	Cilësi morale	Ku duken	Mendime	Veprime	Mendimi yt për to
Princi i vogël	Flokëartë, me kaçurrela, i vogël, i bukur etj.	I dashur, i ndjeshëm ndaj natyrës dhe çdo gjëje të saj, i dhënë pas gjërave të bukura të saj,	Kur flet me keqardhje për lulet, gjembat etj.	Mendonte se jeta duhet shijuar dhe njohur në të gjitha detajet etj.	Revoltohet kur të rriturit nuk i shohin gjërat që i japin gëzim e hijeshi jetës etj.	

Aviatori	I rritur, i fuqishëm, pak hijerëndë.	Fjalëpak, punëtor, i shqetësuar i dashur me Princin, i ndjeshëm etj.			riparon defektin e avionit;	
----------	--	--	--	--	-----------------------------	--

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, diskutim, ditarët e të nxënit.*

Ushtrimi 6. Me anë të shumëpikëshave, autori do të tregojë se; Autori dëshiron që bota të ketë lule e të jetë e bukur dhe ia premtun këtë Princit, por nuk ndihet i sigurtë. Ajo gjithmonë do të ketë probleme të mëdha. Autori gjithashtu i jep të drejtën lexuesit që të mendojë si të dojë.

Ushtrimi 7. Me këtë pjesëz përforcuese autori do të japë indinjatën e princit dhe se vërtet nëse ka diçka serioze; është të ekzistuarit një botë me probleme e me gjemba.

Ushtrimi 8. Njeriu spec i kuq ishte; i ftohtë, egoist, pa pasione, i sakrificës, shpirtzbrazur.

Ushtrimi 9. Pyetjet retorike e kanë në vetvete dhe përgjigjen dhe ai kupton në njëfarë mënyre se nuk ka përgjigje pozitive për to, veç konstatimi i tij për botën me gjemba është i vërtetë dhe kjo është e dhimbshme.

Elementet reale si aviatori dhe problemet e tij gërshetohen me elemente fantastike si Princi i Vogël, lulet në Sahara, biseda për to dhe bota e tij.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë e me notë.

Detyrat dhe puna e pavarur. Ushtrimi 10, f. 140.

Rekomandohet të përdoret fjalori.

Në gaz e sipër..., në lodhje e sipër..., në punë e sipër..., në lodhje e sipër...,etj

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Diktim		Situata e të nxënit: Diktimi i përgatitur nga mësuesi	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • shkruan pa gabime pjesën e diktuar nga mësuesi; • zgjidh si duhet ushtrimet që lidhen me drejtshkrimin si: <ul style="list-style-type: none"> - vendosjen e shenjave të pikësimit në fjali dhe në fund të saj; - vendosjen e shenjave të pikësimit në ligjëratën e drejtë. 		diktim, ushtrime, shenja pikësimi.	
Burimet: materiale të përgatitura nga mësuesi		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diktim, diktim me plotësim.			

Organizimi i orës së mësimit:

Diktimin e një fragmenti që përfshin:

- a. përdorimin e shenjave të pikësimit në fjali dhe në fund të saj,
- b. ligjëratën e drejtë me pjesën lajmëruese e përmendëse.

Përralla e cironkës së artë

Na ishte njëherë një plak i varfër. Ai jetonte në breg të lumit bashkë me plakën e tij shpirtkeqe. Plaku zinte ndonjë cironkë në lumë dhe plaka e gatuante. Një ditë dimri plaku ndenji aty me orë të tëra, por nuk zuri gjë. Ai donte të kthehej në shtëpi, por kur kujtonte plakën rrinte aty me shpresë se mund të kapte diçka. Dhe më në fund fija e vjetër e fildispanjës u lëkund, ndërsa plaku nxitoi ta tërhiqte. Kur ç'të shihte? Një cironkë e vogël. Cironka kishte ca vezullime të arta. Plaku hapi torbën e tij të vjetër dhe...

– Të lutem, më hidh përsëri në lumë!

Plaku u habit.

– Të lutem më hidh në lumë, – tha cironka, – dhe unë do të realizoj çdo dëshirë që të kesh.

Plaku i shkretë ishte zemërmirë. Ai e kuptoi se as ai e as plaka e tij s'ngopeshin dot me një cironkë aq të vogël dhe e hodhi në lumë. Në çast, cironka doli nga uji dhe i tha:

– Më thuaj një dëshirë!

–Të kisha një torbë me cironj...

Pa mbaruar plaku fjalën, torba me cironj i erdhi pranë. Plaku ia tregoi gjithë historinë plakës, por si lakmitare ajo i tha:

– Shko merre cironkën tënde të qelbur dhe sille këtu!

Plaku i shkretë u nis e shkoi në anë të lumit dhe i thirri cironkës.

Ajo doli në çast mbi ujë.

– Më thuaj një dëshirë! – i tha ajo plakut si gjithmonë.

– Plaka më tha... - Plaku u gëlltit. – se ti duhet të vish me mua tani.

Pra...plaka do që ti ta lesh lumin dhe të vish me mua...

Cironka e vogël pa folur fare u krodh në ujërat e turbullta të lumit për të mos dalë më kurrë.

Plaku u kthye në shtëpi, por shtëpia s'ishte më. Në vend të saj gjeti kasollen, plakën e tij të keqe, të njëjtën varfëri dhe të ftohtit. Ndoshta kishte kërkuar shumë...

Ushtrim

Gr. A. Shkruani në ligjëratë të drejtë fjalinë duke e vendosur pjesën lajmëruese në të tria pozicionet.

Mësuesja e pyeti nxënësin se për çfarë dege dëshironte të vazhdonte në të ardhmen.

Gr. B. Shkruani në ligjëratë të drejtë fjalinë duke e vendosur pjesën lajmëruese në të tria pozicionet.

Skënderbeu u tha ushtarëve se lirinë nuk e kishte sjellë ai, por e kish gjetur mes tyre.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit. Një mundësi meqë pjesa është relativisht e plotë dhe i përfshin të gjitha konceptet mund të vlerësohet me tre notë dhe ushtrimi i dhënë me tre nota me një notë për çdo formë të saktë të ligjëratës së drejtë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjojmë poezi Kompetenca: Të dëgjuarit		Situata e të nxënit: Poezi të poetëve tanë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon poezitë për të bërë dallimin mes tyre. • Dallon gjatë dëgjimit të poezisë elementet metrike: rima, tinguj, përsëritjet, etj. • Përgjigjet për pyetje të tjera që lidhen me të dëgjuarin e poezive. • Komenton vargje nga njëra poezi sipas preferencës së tij. 		Fjalët kyç: poezi, rimë, ritëm, përsëritje	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, DVD me poezi, tekste me poezi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, dëgjim i materialeve të DVD, diskutim për motivet e poezive dhe veçoritë e secilës, recitim vargjesh, koment me ditarët e të nxënit</i>			
Organizimi i orës së mësimit			
<p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>stuhi mendimi</i> Nxënësit japin përkufizimin për poezinë, përmendin disa nga poezitë që i kanë në kujtesë, si dhe poetët më të njohur, duke dhënë mendimin e tyre në lidhje me atë që e dallon secilin prej tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Dëgjim i materialeve në DVD, punë e drejtuar, diskutim</i> Vendosen për t’u dëgjuar poezitë në DVD dhe u kërkohet nxënësve të përqendrojnë vëmendjen në motivet, por dhe strukturën e poezive, si dhe në ndjesitë që përcillen përmes tyre. Pas dëgjimit u kërkohet të kujtojnë titujt, motivet e secilës dhe atë që u mbeti në mendje rreth tyre.</p> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Diskutim</i> Nxënësve u kërkohet të kujtojnë pas dëgjimit; <ul style="list-style-type: none"> • Cila poezi e kishte rimën më të dukshme? “Lejleku” dhe “Mejtimi” • Ku konstatooni se ka strofa dyvargëshe? “Lejleku” • Dukuritë e natyrës shpirtëzohen te poezia? “Shiu në pishnajë” dhe “Guaska” • Cila poezi ka shumë tinguj e aroma? “Mejtimi” • Te cila poezi ka përsëritje? “Lejleku” • Te cila poezi ka mall për të shkuarën? “Guaska” </p> <p>Nxënësit mund të japin duke diskutuar e recituar parapëlqimin e tyre rreth njëres poezi duke argumentuar pse.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. Komentoni vargje nga njëra prej poezive dhe mësojeni përmendësh.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për sintaksën Kompetenca: Njohuri për gjuhën - Sintaksë		Situata e të nxënit: punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> dallon grupet përbërëse në fjalinë e thjeshtë; zgjeron dhe zvogëlon grupet emërore e foljore në fjali; përcakton funksionin e fjalëve në fjali; tregon klasën e fjalëve me të cilën shprehen funksione të ndryshme të fjalëve në fjali; dallon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra në një tekst; përcakton llojin e fjalive të përbëra dhe nënlojin e tyre; ndërton fjali të përbëra sipas kërkesës; dallon ligjëratat e drejta e të zhdrejta në fjali; përcakton karakteristikat e ligjëratës së drejtë në fjali; përdor si duhet shenjat e pikësimit në fjali dhe në ligjëratën e drejtë. 		Fjalët kyç: grup emëror, foljore, kallëzues, kryefjalë, kundrinor, rrethor, përcaktor, funksion, klasë fjalësh, shenjë pikësimi, ligjëratë e drejtë, e zhdrejtë, pjesë, fjali, e thjeshtë, e përbërë, bashkërenditëse, nënrenditës, lloj.	
Burimet: teksti i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>punë e drejtuar, punë e pavarur, ushtrime</i>			

Organizimi i orës së mësimit, që mund të përmbajë

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Ushtrime

Ushtrimi 1: Kujtohen nxënësit që në grupin e kryefjalës bëjnë pjesë vetëm kryefjala dhe përcaktorët e saj ndërsa në grupin foljor bën pjesë kallëzuesi dhe gjymtyrët e tjera të dyta, kundrinorë e rrethorë. Për kryefjalët të thuhet dhe me se shprehen.

Grupi emëror i kryefjalës	Kryefjala	Grupi foljor	Kallëzuesi
Dy dallëndyshet më të forta	<i>dy dallëndyshet</i>	U vërtitën nëpër ishull për ushqim	<i>u vërtitën</i>
Kjo jetë	<i>kjo jetë</i>	Ja afroi shpirtin dhe trupin natyrës	<i>ja afroi</i>
Një grup i madh alpinistësh	<i>një grup alpinistësh</i>	Do t'i ngjitet malit më të lartë të krahinës sonë	<i>do t'i ngjitet</i>
Djali	<i>djali</i>	U lëshua në një divan me kokën mes duarve	<i>u lëshua</i>
Kjo gjë	<i>kjo gjë</i>	U imitua më pas dhe prej tyre	<i>u imitua</i>
Ajo	<i>ajo</i>	Mbeti me vështrimin fiksuar mbi tavolinë	<i>mbeti</i>
Ai druvari i ri	<i>ai druvari</i>	Ishte përpjekur të fiksonte zanatin	<i>ishte përpjekur</i>
Një re e rumbullakët	<i>një re</i>	Kishte zënë diellin	<i>kishte zënë</i>
Kjo shtëpia e fundit	<i>kjo shtëpia</i>	Kishte dhe oborr me portë të madhe	<i>kishte</i>

Nëse ka mundësi, u kërkohet nxënësve të thonë dhe funksionin e gjymtyrëve të tjera përbërëse në grupin foljor.

Ushtrimi 3 sipas kërkesës dhe të thuhet edhe me se shprehen.

Kundrinor i drejtë	Kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë	Kundrinor i drejtë me parafjalë
<i>Vashën e bukur, e</i> (GE, tr. e shkurtër)	<i>Një melodie shumë të dhembshme</i> (i) GE, tr. shk.	<i>Me xhaketat e tyre</i> (GE)
<i>Fjalën, e</i> (emër dhe tr. e shkurtër)	<i>Të gjithëve u</i> (për. i pac. dhe tr. shk.)	<i>Për muzikë</i> (emër)
<i>Krahët, tymin, udhët, ajrin, vargjet</i> (emër)	<i>Banorëve u, korbit</i> (i) (emër dhe tr. shk.)	<i>Me erë të ëmbël</i> (GE)
<i>Ua</i> (vetëm e është kund. i drejtë me tr. të shkurtër, fj. 8)		<i>Për shokët, nga i ati</i> (emër me paraf.)

Ushtrimi 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 sipas kërkesës.

Ushtrimi 5. Fjali të thjeshta 1, 3, 4,7, 10,11. Fjali të përbëra bashkërenditëse; 5, 8. Të tjerat janë të nënrenditura. Në fjalitë e përbëra me nënrenditje bëjnë pjesë dhe ato që kanë kombinim të pjesëve të bashkërenditura e të nënrenditura.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 14

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Vepra dhe autori Kompetenca: Të folurit		Situata e të nxënit: Autorët më të famshëm për fëmijë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; Kompetenca e të menduarit; Kompetenca e të mësuarit për të nxënë; Kompetenca digjitale; 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> Sjell materiale për jetën dhe veprën e Ekzyperisë. Diskuton për fakte të jetës së Ekzyperisë dhe lidhjen e tyre me veprën “Princi i vogël”. Argumenton mendimin se çdo vepër letrare ka fakte nga jeta reale. 		vepra, autori, jeta	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, lexim i materialit në tekst, punë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *diskutim*

Nxënësit sjellim informacion për jetën dhe veprën e Ekzkyperisë dhe flasin për veprat dhe autorët për fëmijë të pëlqyera prej tyre duke argumentuar pse.

U kërkohet nxënësve, (porositen më parë të gjejnë informacion) se për cilat vepra kanë dijeni se bazohen në fakte të vërteta në përgjithësi, por edhe në fakte nga jeta e autorëve të një vepre në veçanti.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: lexim i materialit,

Nxënësit lexojnë materialin me fakte nga jeta e San Ekzkyperit, që lidhen me veprën e tij “Princi i vogël” ose me leximet e tij frymëzuese.

Diskutojnë rreth lidhjeve që ekzistojnë, duke përgjithësuar me fakte të tjera për ndikimin e jetës reale në realizimin e një vepre, mes shkrimtarit dhe veprës “Princi i vogël”.

Udhëtimet e tij, leximi i përrallës “Sirena e vogël”.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *diskutim*

Diskutohen të tjerë shembuj që lidhen me këtë fakt si; “Kronikë në gur”, “Shpella e piratëve”, Nxënësit flasin për ndikimin e jetës së këtyre shkrimtarëve në veprat e tyre.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Artur Klark “Ishuj në qiell” (ora e parë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Jep karakteristikat e romanit fantastiko-shkencor nisur nga veprat dhe pjesët e lexuara më parë. Lexon pjesën për t’u përgjigjur pyetjeve rreth të kuptuarit të përmbajtjes. Shpjegon kuptimin e fjalëve duke i përdorur ato në fjali. Ndan pjesën për të bërë përmbledhjen e saj. 		Fjalët kyç: Ishuj në qiell, rëndesa e tokës, fluturim.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve .		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkenca dhe shoqëria	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>stuhi mendimi, lexim i drejtuar, punë e drejtuar me fjalorin, punë e pavarur, diskutim, pyetje-përgjigje</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *stuhi mendimi*

Nxënësve u kërkohet të flasin për librat fantastiko-shkencorë, marrëdhëniet që kanë me to dhe çfarë karakteristikash i bën të dallueshme nga vepra të tjera.

Në romanet fantastiko-shkencore gërshetohen elementet realiste me ato fantastike e shkencore, personazhet, ngjarjet, vendet reale me ato të trilluara nga fantazia e autorit. Në këtë lloj letrar autorët na sjellin pranë dhe na e bëjnë të besueshme një kohë të ardhme, që është shumë e largët. Shkrimi i këtyre romaneve është mjaft i pasur në fjalë nga fjalori i shkencës e i teknologjisë moderne.

2. Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i drejtuar DRTA, punë e drejtuar me fjalorin*

Pasi lexohet pjesa punohen ushtrimet e rubrikës *Kuptimi dhe mesazhi* për të zbërthyer përmbajtjen. Nxënësit ndajnë në paragrafë pjesën duke nxjerrë fjalët kyç në çdo paragraf e rindërtuar informacionin kryesor për të dhënë përmbledhjen e pjesës.

3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur, pyetje-përgjigje*

Vazhdohet me përgjigjet rreth të kuptuarit të pjesës
Pyetja 1 dhe 2 në dy paragrafët e parë të pjesës

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur; Ushtrimi 6, f..144

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Artur Klark “Ishuj në qiell” (ora e parë) – tekst letrar		Situata e të nxënit:	
Kompetenca: Të lexuarit		Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Ritregon ngjarjen me fjalët e tij duke e shoqëruar me vizatim. • Ilustron me shembuj karakteristikat e një veprë fantastiko-shkencore. • Komenton mendimet dhe veprimet e personazheve duke i ilustruar ato. • Bën një shkrim gazetaresk (ose tregim fantastiko-shkencor) lidhur me një fakt shkencor zbuluar kohët e fundit. 			

Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, vepra “Ishuj në qiell”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkenca dhe shoqëria. Tik dhe teknologji
---	--

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, shkrim i lirë, pyetje përgjigje, punë e pavarur.

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: pyetje-përgjigje,

Kontrolli i detyrave të shtëpisë

Mësuesi aktivizon nga 2 nxënës nga secili grup për të lexuar skicat e zhvilluara. Më pas pyet nxënës të tjerë për të plotësuar detyrat, nëse është e nevojshme.

2. Ndërtimi i njohurive të reja; punë e pavarur, diskutim,

Pasi lexohet teksti, punohet me ushtrimet.

Ushtrimi 3. Roit, marsianët i dukeshin magjepsës në veshje, në të folur dhe në mënyrën e komunikimit.

Ushtrimi 4. Ata e ndienin veten jo mirë kur i quanin “kolon”, sepse kjo i bënte të ndiheshin të huaj dhe aspak miqësorë.

Ushtrimi 5. Ritregohet pjesa nga disa nxënës, duke u ndalur në elementet kryesore të dialogut.

Nxënësit punojnë me tekstin për të gjetur të gjitha elementet, që i japin karakterin fantastiko- shkecor pjesës, pra ndajnë veç elementet shkencore dhe ato fantastike.

Elemente fantastike			Fakte shkencore	Fakte reale		
Personazhe	Veprime	Objekte		Personazhe	Objekte	Veprime
Marsianët, njerëz nga katër planetët	Bisedë me marsianët	Shkolla në Mars	Cilindra, marsi si planet që mund të ketë jetë, rëndesa e tokës	Roi	Stacion hapësinor, koloni	Fluturim


3. Demonstrim i rezultateve të arritura: Diskutim

Nxënësit diskutojnë në lidhje me njohuritë që ata kanë për kozmosin, planetët, planetin Mars e jashtëtokësorët.

Vlerësimi: Sipas gjykimit të mësuesit me gojë dhe me notë

Detyrat dhe puna e pavarur. shkrim i lirë. Nxënësit mund të shkruajnë një tregim fantastiko-shkencor.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Uilliam Shekspir “Nata e dymbëdhjetë” (ora e parë) – tekst letrar		Situata e të nxënit: Komedia e Shekspir “Nata e dymbëdhjetë” nga Teatri Kombëtar	
Kompetenca: Të lexuarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca personale. 5. Kompetenca digjitale. 			

<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sjell përshtypjet e tij rreth fragmenteve të komedisë luajtur nga aktorët e teatrit Kombëtar. • Lexon fragmentin me role duke respektuar intonacionin. • Ndërton pyetje për t’u përgjigjur rreth të kuptuarit. • Shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja përmes shembujve në fjali. • Jep tiparet e tekstit dramatik. 	<p>Fjalët kyç: komedi, Shekspir, pyetje, personazhe, teatër</p>
<p>Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve(fragment nga komedia vënë në skenë nga Teatri Kombëtar). https://www.youtube.com/watch?v=qU2kaX_JucA</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte, Teatër</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Vëzhgim i materialeve në video-projektor, bashkëbisedim, <i>lexim me role, punë e drejtuar, punë e pavarur, pyetje-përgjigje, lojë në role,</i></p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>vëzhgim i materialeve në video-projektor dhe bashkëbisedim</i> Nxënësit sjellin nga materiale të gatshme, që lidhen me fragmente nga komedia “Nata e dymbëdhjetë”, vënë në skenë nga Teatri Kombëtar. Vëzhgojnë materialin dhe diskutojnë rreth tij dhe rreth komedive të tjetra të Shekspirit duke dhënë një informacion të shkurtër rreth jetës dhe veprave të tij.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>lexim me role</i> Bëhet leximi i pjesës nga nxënësit me role duke u kërkuar respektimin e intonacionit në përshtatje me personazhin.</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p>3. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Pyetje –përgjigje, diskutim</i> Nxënësit ndërtojnë pyetje rreth fragmentit, por dhe fragmenteve që panë në video-projektor, duke pasur parasysh dhe ato që kanë lexuar rreth saj. Ushtrimet 1, 2, 3, 4 Diskutohen çështje të ndryshme nga kuptimi dhe interpretimi i pjesës që lidhen me humorin, kuptimin, veset, personazhet etj. Në 10 minutat e fundit nxënësit ndahen në grupe për të interpretuar fragmente nga komedia. Përzgjedhim nëse sigurojmë tekstin dhe fragmente të ndryshme nga komedia për çdo grup nxënësish. U sugjerojmë të punojnë brenda grupit me skenën, veshjet dhe muzikën e fragmentit që do të luajnë.</p> <p>Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë.</p> <p>Detyrat dhe puna e pavarur. Lojë në role. Nxënësit ndahen në grupe dhe pasi përzgjedhin një drejtues (regjisor) dhe përcaktojnë brenda grupit skenografin, kostumografin dhe kompozitorin.</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Uilliam Shekspir “Nata e dymbëdhjetë” (ora e dytë) – tekst letrar Kompetenca: Të lexuarit		Situata e të nxënit: Lojë në role	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. 2. Kompetenca e të menduarit. 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare. 7. Kompetenca digjitale. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në punën në grup për të luajtur në role fragmente nga komedia. • Luan në role fragmente nga komedia “Nata e dymbëdhjetë”. • Diskuton, vlerëson lojën e shokëve në role. • Bën analizën e personazheve për të dhënë gjykimin rreth tyre përmes lojës në role. • Shpreh bukur mesazhet dhe idetë e pjesës. 		Fjalët kyç: komedi, lojë në role, personazhe, mesazh.	
Burimet: Libri “Gjuha shqipe 7”, libri digjital; përvoja të nxënësve, komedia “Nata e dymbëdhjetë” https://www.youtube.com/watch?v=qU2kaX_JucA		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Lojë në role, punë e pavarur, diskutim</i>			

Organizimi i orës së mësimit

1. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Lojë në role*

Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e pavarur*

Nxënësit prezantojnë lojën e tyre në role.

2. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *diskutim*

Nxënësit bëjnë analizën e personazheve nisur nga pjesa, por dhe nga informacione shtesë.

Mund të punohet me tabelën e koncepteve të personazheve:

Personazhet	Cilësitë	Ku duken	Mendime	Veprime	Mendimi yt për ta
Viola					
Sebastiani					
Duka					

Vlerësimi: Sipas gjyqimit të mësuesit me gojë dhe me notë dhe vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin.

TEST SEMESTRI III

EMRI _____

KI-VII

GRUPI A

I. Njohuri letrare

Pasi të lexoni tekstin, shkëputur nga romani *Viti 1793* i Viktor Hygosë, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Goveni arriti në këmbët e skelës. Oficeri e shoqëroi. Goveni zgjidhi shpatën dhe ia dorëzoi oficerit; hoqi kravatën dhe ia dorëzoi xhelatit. Kurrë nuk ishte dukur kaq i bukur. Flokët e tij të zinj valëviteshin në erë; asokohe nuk i prisnin flokët. Qafa e tij e bardhë të sillte ndërmend një grua, dhe syri i tij heroik dhe sovran të sillte në mend një kryeengjell. Ai qëndronte mbi skelën e gijotinës, ëndërrues. Goveni ishte më këmbë, i madhërishëm dhe i qetë. Dielli, duke e mbështjellë, e nxirrte në pah si ndonjë dritë lavdie. Xhelati erdhi me një litar në dorë. Në atë çast, kur panë kapitenin e tyre të ri tek shkante me aq guxim në thikë, ushtarët nuk duruan më. Zemra e këtyre burrave të regjur në luftëra shpërtheu. U dëgjua ajo gjë e stërmadhe, dënosa e një ushtrie. Një britmë çau ajrin:

– Falje! Falje!

Disa ranë në gjunjë, disa të tjerë flaknin pushkët dhe ngrinin krahët drejt platformës, ku ishte Simurdeni. Një granatier bërtiti duke treguar gijotinën:

– A pranohen zëvendës në këtë punë? Ja ku më keni mua.

Të gjithë përsërisnin me zjarr: “Falje! Falje!”

Edhe luanët sikur ta kishin dëgjuar këtë, do të ishin tronditur ose frikësuar, sepse lotët e ushtarëve janë të tmerrshëm. Xhelati qëndroi, pa ditur se ç’të bënte. Atëherë një zë i prerë dhe i ulët, por që të gjithë e dëgjuan, kaq fort ishte e përzishëm, bërtiti nga maja e kullës:

– Të zbatohet ligji!

Ata e njohën theksin e papërkulshëm. Simurdeni kishte folur. Ushtria u rrëqeth.

Xhelati nuk e bëri fjalën dysh. U afrua duke mbajtur litarin.

– Prisni, – tha Goveni.

Ai u kthye nga Simurdeni, i bëri me dorën e djathtë që i kishte mbetur ende e lirë, një shenjë lamtumire; pastaj qëndroi ta lidhnin. Kur ishte lidhur, i tha xhelatit:

– Më falni. Edhe një çast.

Dhe thirri:

– Rroftë Republika!

E shtrinë mbi dërrasën si shilarës, ajo kokë e hirshme dhe krenare u kapllos e mallkuar; xhelati ia ngriti flokët butë-butë, pastaj shkeli sustën; trekëndëshi u zgjidh dhe rrëshqiti, në krye ngadalë, pastaj me shpejtësi; u dëgjua një goditje e llahtarshme. Në të njëjtin çast u dëgjua edhe një krismë tjetër. Goditjes së sëpatës iu përgjigj një krismë kobureje. Simurdeni kishte kapur njërën nga koburet që mbante në brez, dhe në çastin kur koka e Govenit po rrëkëllehej në shportë, Simurdeni e shpoi tejet zemrën me një plumb. Një valë gjaku i doli nga goja, ai ra i vdekur. Dhe këta dy shpirtra, vëllezër tragjikë, fluturuan bashkë, hija e njërit përzier me dritën e tjetrit.

1. **Zgjidhni alternativën e saktë.** 1 pikë

Ngjarja që rrëfëhet është një:

- a. Ekzekutimi në fushën e betejës të një luftëtari të Revolucionit Francez
- b. Dyluftim mes dy miqve gjatë Revolucionit Francez
- c. Ekzekutim me varje i një heroi, luftëtar i Revolucionit Francez
- d. Momenti i fitores së republikanëve gjatë Revolucionit Francez

2. **Tema e pjesës është:** 1 pikë

- a. solidariteti deri në vdekje mes shokëve
- b. trimëria dhe guximi i luftëtarëve
- c. tirania e regjimit të kohës
- d. momente heroike gjatë Revolucionit Francez

3. **Radhit veprimet që bën xhelati për të ekzekutuar të dënuarin.** 1 pikë

1 _____ 2 _____ 3 _____

4. **Vëri pjesës një titull tjetër shprehur në mënyrë të figurshme** 1 pikë

5. **Përkruani figurën e Govenit në moentin e ekzekutimit. Ilustroni me shembuj nga teksti.** 3 pikë

6. **Cila nga idetë e mëposhtme NUK del në tekst?** 1 pikë

- a. Dashuria për shokun shkon deri në vetësakrifikim.
- b. Kauza për të cilën luftoi Goveni nuk e tremb para vdekjes.
- c. Bukuria e moshës dhe solidariteti mposhtin zemrën e çdo xhelati.
- d. Dhuna dhe tirania nuk mund ta mposhtë një popull.

7. **Në cilin rast mbiemri është në kuptim të figurshëm?** 1 pikë

- a. flokë të zinj
- b. lotë të tmerrshëm
- c. qafë e bardhë
- d. djali i lidhur.

8. **Gjeni dhe emërtoni një figurë letrare në fjalinë:** 1 pikë

Dhe këta dy shpirtra, vëllezër tragjikë, fluturuan bashkë, hija e njërit përzier me dritën e tjetrit.

9. **Shkruani një fund tjetër për pjesën duke ndjekur rrjedhën logjike të ngjarjes.** 2 pikë

10. **Bëni një shkrim argumentuese me 10 fjali me temë “Liria është një kauzë që e mposht vdekjen”.** 4 pikë

I. NJOHURI GJUHËSORE

11. Ktheni foljen nga veprorë në joveprorë duke ruajtur kohën, vetën dhe numrin e saj. **1 pikë**
 Xhelati shkeli sustën.

12. Gjeni kallëzuesin dhe thoni llojin. **2 pikë**
 Goveni ishte i qetë, duke pritur vdekjen pa asnjë shenjë frike dhe dhimbjeje në fytyrë.

13. Thoni funksionin e fjalëve të nënvizuara. **4 pikë**
Goditjes së sëpatës iu përgjigj një krismë tjetër.
 Ne pamë një sëpatë që binte mbi kokën e tij.

14. Formoni fjali sipas kërkesës **2 pikë**
 a. Kundrinori i drejtë të shprehet me përemër vetor
 b. Kryefjala të shprehet me grup emëror

15. Plotësoni fjalitë me gjymtyrën e kërkuar **3 pikë**
 a. Atë e panë (rrethanor mënyre) _____

 b. (Rrethanor kohe) _____ u dëgjua një krismë arme.

 c. Zërat thërrisnin (rrethanor qëllimi) _____

16. Qarkoni alternativën ku ndodhet fjalia e përbërë me bashkërenditje **1 pikë**
 A. E shtrinë mbi dërrasën si lisharse kur ajo kokë e hirshme dhe krenare u kapllos e mallkuar.
 B. Në të njëjtin çast u dëgjua edhe një krismë tjetër
 C. Goditjes së sëpatës iu përgjigj një krismë kobureje.
 Ç. Një valë gjaku i doli nga goja, ai ra i vdekur.

17. Ndërtoni një fjali bashkërenditëse veçuese. **1 pikë**

18. Në fjalinë e përbërë qarkoni mjetin lidhës dhe nënvizoni pjesën e nënrenditur . **2 pikë**
 Oficeri, që komandonte granatierët, e shoqëroi gjer aty.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-10	11-13	14-19	20-25	26-28	29-31

ÇELËSI I TESTIT TË PËRGJIGJEVE TË GRUPIT A

1. C
2. A
3. E shtrinë mbi dërrasën si shilarës
xhelati ia ngriti flokët butë-butë
pastaj shkeli sustën
4. Pranohet çdo lloj alternative që përkon me pjesën.
5. 2 pikë përshkrimi i plotë 1 pikë lustrimi
Përshkrim i pjesshëm, hiqet një pikë
Mungesa e ilustrimit hiqet një pjesë
6. C
7. B
8. Ka epitete (vëllezër tragjikë)
Metaforë (këta dy shpirtra **fluturuan** bashkë)
antitezë në fund (**hija** e njërit përzier me **dritën** e tjetrit.)
9. Sipas përgjigjes
10. Sipas përgjigjes 2 pikë për idenë
1 pikë struktura
1 pikë drejtshkrimi
11. Susta u shkel nga xhelati
12. **Ishte i qetë** kallëzues emëror
13. Goditjes së sëpatës - kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
Një krismë tjetër - kryefjalë
14. Një sëpatë – kundrinor i drejtë
Mbi kokën e tij rrethor vendi
15. Sipas përgjigjes
16. D
17. Që - përemër lidhor
Pjesa e nënrenditur - që komandonte granatierët

TEST SEMESTRI III

EMRI _____

KI-VII

GRUPI B

I. Njohuri letrare

Pasi të lexoni tekstin përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Zemërimi i nana Zemkës

Aty nga ora pesë e pasdites, sapo kishte mbaruar kursi, pashë Bardhin në rrugë nga dritarja e korridorit. U çudita. Ai po vinte drejt shtëpisë sime. Po ç'kishte ashtu? Pas pak arriti te pragu i portës, shtyu kanatën dhe hyri në oborr. U zgjata të shihja mirë. Edhe pse i kishte sytë me lot, kthente kokën prapa çast më çast dhe shtrëngonte buzët për të mbajtur të qeshurat. Ishte si një ditë me shi e me diell. Harrova që nuk flisnim.

– Eja brenda! – i thashë. Nuk m'u përgjigj. Ndërkaq u duk gjyshja e tij, nana Zemka, me ca degëza të gjata në dorë, që vinte duke tërhequr shapkat e zeza: vëzh-vëzh. Ishte tetëdhjetë e më tepër vjeç, po me kockë të fortë, me veshët pipëz e me sytë qelq. Sa e pashë, u trondita. I druhesha shumë, se s'kishte llafe me të.

“Edhe kur të jeni me mustaqe gjer te veshi, - na thoshte neve çunave, – të mos ma bëni fjalën dy. Vritja mendjen shpesh të gjeja se ku qëndronte e fshehta e fuqisë së nana Zemkës dhe e lidhja këtë me fytyrën e vrenjtur, me sytë, me zërin, me flokët si bora, me trupin eshtak e fjalët e ashpra. Më vonë kuptova që fuqia e nanasë buronte nga vetë qenia, nga shpirti i madh e mendja e kthjellët.

– Mos lëviz, or pulishti i qerratait! – i thirri Bardhit.

Ky nuk lëvizi. Nanaja iu afrua duke marrë frymë me zor. “Obobo, ç'u fik! – thashë me vete. – Ç'do të ketë bërë?” Isha mbledhur si iriq dhe pothuaj nuk merrja frymë fare. E kuptova në çast dhe e ndjeva veten vërtet si zog nën grackë. Nga nxitimi i paskësja harruar hapur kanatat e musëndrës! “Mora fund!” – thashë me mend.

– Ku u fsheh firauni, ku u fsheh?

– Nga ta di unë e shkreta! Te musëndra më ngjan të jetë futur, –tha e pasigurt nëna.

Po kujt po ia hidhte nëna!? Ajo me siguri, po ia tregonte nanasë musëndrën me gisht.

– Dil, o miu i arave! Dil, se e di që je aty! Dil në fushë të burrave, në ta mban! – Ishte zëri i nana Zemkës. I prerë. Nuk linte shteg për të bërë xhap. A thua se qe ndonjë luftëtar i lashtë me ushtë e në majë të kalit, që më ftonte në duel!

Dola. Ngadalë-ngadalë. Iu vura përballë. Kokulur. Pa gëk-mëk.

– Afrohu edhe ti këtu! – i tha Bardhit. Pastaj na foli të dyve:

–Tani do t'ju zhvesh siç ju kanë pjellë nënat e do t'ju përvëloj mirë e mirë me hithra, sa t'ju bëhet mishi flluga-flluga. Hë,ç'pritni? Zhvishuni! Sa nisëm të zbërthehemi, vuri buzën në gaz, flaku nga dritarja hithrat dhe u ul mbi minder. I tha nënës:

– Bëmë tani një kafe të rëndë, ti nuse! E aty për aty, shtoi e kthyer nga ne: – Sa te bëhet kafeja, dua t'ju shoh të pushtoheni me sho-shoqnë! Dhe po mbajtët mëri, di vetë se ç'ju bëj.

1. Zgjidhni alternativën e saktë. 1 pikë

Ngjarja e këtij tregimi zhvillohet në:

- a. shtëpinë e Bardhit
- b. shtëpinë e rrëfimtarit
- c. oborrin e shkollës
- d. rrugicën para shtëpisë?

2. Bardhi hyri në shtëpinë e shokut: 1pikë

- a. për t’u pajtuar me shokun
- b. për t’i shpëtuar zemërimit të nana Zemkës
- c. për të pyetur për qenin e tij
- d. për të kërkuar ndihmë për mësimet?

3. Shkruani si i kuptoni fjalët e nana Zemkës: 1 pikë

“Edhe kur te jeni me mustaqe gjer te veshi, të mos ma bëni fjalën dysh.

4. Pse ishte nxehur nana Zemka? 1 pikë

5. Ku duket kjo? 2 pikë

6. Fuqia e nana Zemkës buronte nga: 1 pikë

- a. përvoja e saj jetësore
- b. forca e saj trupore
- c. qenia, shpirti i madh, mendja e kthjellët
- d. dashuria e respekti që gëzonte?

7. Nxirrni nga teksti një krahasim dhe një epitete. 2 pikë

Epitete _____

Krahasim _____

8. Bëj portretizimin fizik e shpirtëror të mama Zemkës. 3 pikë

Ilustro me shembuj nga teksti.

9. Bëni një shkrim argumentues me temë 4 pikë

“Këshillat e të moshuarve nuk blihen me para”

I. Njohuri Gjuhësore

10. Ktheni foljen në trajtën joveprore.

1 pikë

Gjyshja paska harruar hapur kanatat e dritares.

11. Gjeni kallëzuesin e përbërë të fjalitë e mëposhtme.

1 pikë

- a. Kishte mbaruar kursi dhe pashë nga dritarja e korridorit Bardhin në rrugë.
- b. Pas pak arriti te pragu i portës, shtyu kanatën dhe hyri në oborr.
- c. U zgjata që të mund të shihja mirë.
- d. Harrova që nuk flisnim.

12. Shkruani funksionin e fjalëve të nënvizuara.

4 pikë

E ndjeva veten vërtetë si zog nën grackë, _____ a thua se qe ndonjë luftëtar _____ i lashtë me ushtë. _____
 Nga nxitimi _____ i paskështa harruar hapur kanatat. _____

13. Formoni fjali ku:

2 pikë

- a. Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë të shprehet me përemër.

- b. Rrethanori i mënyrës të shprehet me ndajfolje

14. Plotësoni fjalitë me gjymtyrën e kërkuar.

3 pikë

- a. Ai u fsheh (rrethanor shkaku) _____
- b. (Rrethanor vendi) _____ u fut shoku im, Bardhi
- c. Gjyshja kishte në dorë (rrethanor sasi) _____

15. Qarkoni fjalinë e përbërë me nënrenditje.

1 pikë

- a. Mamaja mu afrua duke marrë frymë me zor.
- b. Më vonë kuptova që fuqia e mamasë buronte nga vetë pema.
- c. Nuk linte shteg për të bërë xhap.
- d. Vuri buzën në gaz, flaku nga dritarja hithrat dhe u ul mbi minder.

16. Formoni një fjali bashkërenditëse kundërshtuese.

1 pikë

17. Qarkoni mjetin lidhës, nënvizoni pjesën e nënrenditur.

2 pikë

Nuk e nuhata dot se gjithë ai rrebesh që u çua aty, do të shkactohej edhe mbi mua.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-10	11-13	14-19	20-25	26-28	29-31

ÇELËSI I TESTIT TË PËRGJIGJEVE TË GRUPIT B

1. B
2. B
3. Në varësi të përgjigjes
4. Për shkak të miqësisë së vjetër mes dy familjeve, ajo nuk pranonte asnjë lloj mërie mes fëmijëve të këtyre familjeve.
5. C
6. 1 pikë për përgjigjen dhe 1 pikë ilustrimi
7. si iriq, si zog, si bora, - krahasime
e vrenjtur, eshtak, e ashpra. shpirti i madh e mendja e kthjellët. (epitete)
8. 2 pikë për portretin e plotë, 1 për portretizimin e paplotë dhe 1 pikë ilustrimi
9. Sipas përgjigjes
2 pikë për idenë
1 pikë struktura
1 pikë drejtshkrimi

Njohuri Gjuhësore

10 Kanatat e dritares qenkan harruar hapur nga gjyshja.

11 C U zgjata që të mund të shihja mirë.

12 qe ndonjë luftëtar - kallëzues emëror
me ushtë - kundrior i zhdrejtë me parafjalë Nga nxitimi - rrethor shkak
kanatat. – kundrinor i drejtë

13 sipas përgjigjes

14 sipas përgjigjes

15 B. Më vonë kuptova që fuqia e mamasë buronte nga vetë pema.

16. Sipas përgjigjes

17 (që përemër lidhor) që u çua aty

PROJEKT

TITULLI I PROJEKTIT: Vendimmarrja në grup – Organizojmë një festë

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe

Shkalla: III

Klasa: VII

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e vet për një temë me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth temës, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar që lidhet me temën;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të temës
- shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore dhe sipas temës;
- përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në largësi nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

2. Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- shpreh mendimin e vet për një punim letrar ose shkencor duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e temës, duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive.

3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi/ja:

- përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë për temën;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në

komunitet dhe e realizon atë me sukses;

- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrim (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve);
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
- merr pjesë si anëtar i një jurie, (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi artistik, duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.

5. Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

- merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., si dhe raporton (me gojë, me shkrim) për përvojat personale të fituara.

6. Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., si dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë;
- shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të ndryshme interesi;
- merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

7. Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në largësi për zhvillimin e njohurive;
- analizon, vlerëson dhe menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik);
- zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe nëse burimi është parësor apo dytësor).

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- merr pjesë në projekt me një shkrim a veprimtari praktike;
- shkruan për organizimin e veprimtarisë, si: plani i veprimtarisë, anketë, intervistë, kronikë, njoftim, rregullore, udhëzues etj.;
- bashkëpunon në grup për realizimin e projektit;
- krijon në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit një dokumentar për zhvillimin e veprimtarisë me materiale gazetareske e muzikore që përcjellin emocionet e përftuara;

Temat e njohurive kryesore që rimerren në projekt:

- Media e shkruar dhe elektronike; lajmi, kronika, reportazhi, njoftimi, intervista, rregullorja.
- Shkrimi i esesë, letrës.
- Fotografia dhe piktura.
- Teksti letrar, si poezia, tregimi etj.

Lidhja me fushat e tjera dhe temat ndërkurrikulare:

Lidhet me shkencat shoqërore, artet, TIK-un dhe teknologjinë.

Temat ndërkurrikulare: Vendimmarrja morale, mjedisi.

Partnerët: Komuniteti, mësues sipas fushave të studimit.

Numri i orëve që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit:

- 1 orë të lexuarit
- 1 orë të shkruarit
- 1 orë të dëgjuarit

Numri i nxënësve në projekt: Të gjithë nxënësit e klasave të shtata.

Përshkrim i projektit dhe veprimtarive që do të zhvillohen në të:

Për orën e parë do të bëhet prezantimi i temës së projektit dhe rezultatet që priten prej tij, si dhe do të bëhet ndarja e grupeve të punës.

Në orën e dytë do të bëhet vëzhgimi i materialeve bruto dhe përzgjedhja e tyre.

Në orën e tertë do të bëhet prezantimi përfundimtar i projekteve sipas grupeve.

Ora I. Të shkruarit

- Në orën e parë mësuesja u kërkon nxënësve të kujtojnë tema mësimore që lidhen me mjedisin. Nxënësit mund të rikujtojnë temën “Vdekja e lisanjës”, por dhe tema të tjera ndihmëse.
- Prezantojmë temën dhe rezultatet që kërkohen nga projekti, të cilat mbahen shënim.
- U sugjerojmë nxënësve se çfarë mund të përfshijnë në projekt, por pas ndarjes në grupe lihen të lirë për të punuar sipas fantazisë së tyre.
- Mund të sugjerohen punime, si: dokumentarë, reportazhe, njoftime, rregullore, udhëzues të ndryshëm, makete, letra, intervista, anketa etj.
- Për t’u ardhur në ndihmë nxënësve, mund t’u shfaqim një fragment dokumentari për mjedisin, (nxënësit gjatë punës me projektin mund të vëzhgojnë vetë materiale që lidhen me temën), mund t’i njohim me reportazhe që lidhen me mjedisin ose shkrime të tjera të llojeve të ndryshme që lidhen me pastërtinë dhe gjelbërimin e tij.
- Klasa ndahet në tri grupe të mëdha ose katër, meqenëse materialet që mund të përfshihen janë shumë të larmishme. Në pjesën e dytë secili grup punon për ndarjen e detyrave.

Ora II. Të lexuarit

- Gjatë orës së dytë nxënësit prezantojnë materialet bruto që kanë mbledhur, lexojnë disa prej tyre për të bërë vërejtjet e nevojshme dhe plotësojnë me ide të reja vazhdimin e projektit.
- Në vazhdim secili grup redakton, sipas sugjerimeve, materialet që ka dhe riformulon detyrat për realizimin e punëve përfundimtare.

Ora III. Të dëgjuarit

- Nxënësit prezantojnë sipas grupeve dhe në kohën e caktuar materialet e tyre të projektit.
- Ata përzgjedhin vetë mënyrën e prezantimit dhe realizimin e secilit material.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Projekti ka për qëllim që, përmes rezultateve të të nxënësve, t'i pajisë nxënësit me të gjitha kompetencat e mundshme. Gjithashtu, përmes projektit, synohet sensibilizimi i nxënësve, por dhe i komunitetit në lidhje me problemet aq të ndejshme të mjedisit.

Mënyra e prezantimit:

- Çdo grup, përveç prezantimit të revistës vizualisht dhe në mënyrë materiale, do të bëjë një prezantim në videoprojektor dhe ta dorëzojë materialin në disk.
- Kështu mblidhen fakte, dokumentarë të shkurtër dhe vëzhgime dhe bëhen prezantime të veprimtarive në trajtë kronikash të shkurtra.
- Çdo nxënës e fut materialin personal në dosjen e tij.

Vlerësimi:

Vlerësim me gojë, vetëvlerësim dhe vlerësim me notë.

Nxënësit mund të vlerësohen me notë për pjesë të veçanta të projektit, por do të marrin një vlerësim personal për dosjen.

MODEL PROJEKTI

TITULLI I PROJEKTI: Dramatizimi i pjesës “Epoka para gjyqit”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Projekt Kompetenca: Të shkruarit, të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit		Situata e të nxënësve: dramatizim	

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç:**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**

Nxënësi/ja:

- prezanton punën e tij për dramatizimin e pjesës;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët;
- përdor intonacionin e duhur;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë lojës në role;
- shpreh mendimin e vet në lidhje me lojën në role të shokëve ose detaje të tjera në dramatizim;
- përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në largësi nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit.

2. Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati në lidhje me lojën në role;

- shpreh mendimin për një prezantim në varësi të detyrës që ka.
- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;
- përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi duke paraqitur rezultat të njëjtë;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

3. **Kompetenca e të nxënit**

Nxënësi/ja:

- përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi etj.), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë për temën;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e marra nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes;
- parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur; menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo diku tjetër).

1. **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen mjedisin**

Nxënësi/ja:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrimeve, ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
- merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi artistik, duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.

2. **Kompetenca personale**

Nxënësi/ja:

- merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit për përvojat personale të fituara.

3. **Kompetenca qytetare**

Nxënësi/ja:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., si dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë;
- merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

4. **Kompetenca digjitale**

Nxënësi/ja:

- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në largësi për zhvillimin e njohurive;
- analizon, vlerëson dhe menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik);
- zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe nëse burimi është parësor apo dytësor).

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- diskuton fragmente nga drama “Epoka para gjyqit” shfaqur nga Teatri Kombëtar;
- bashkëpunon në grup për dramatizimin e fragmentit “Epoka para gjyqit”;
- merr përgjegjësitë e tij për punën në grup;
- prezanton punën e tij në projekt duke bërë argumentimet e duhura;
- gjykon punën e shokëve të tij në dramatizim;
- shfaq pjesën e dramatizuar para bashkëmoshatarëve, mësuesve dhe komunitetit.

Temat e njohurive kryesore që rimerren në projekt:

Teksti dramatik

Lidhja me fushat e tjera:

Lidhet me artet, identitetin kombëtar dhe njohjen e kulturave.

Numri i orëve që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit:

- 1 orë të lexuarit
- 1 orë të folurit
- 1 orë të dëgjuarit

Numri i nxënësve në projekt: Të gjithë nxënësit e klasave të shtata.

Përshkrim i projektit dhe veprimtarive që do të zhvillohen në të:

Ora I. Të lexuarit

Gjatë orës së parë nxënësit kujtojnë ngjarjet në pjesën “Epoka para gjyqit”, personazhet dhe karakteristikat e secilit prej tyre.

Vendosim për të parë një fragment nga drama e vënë në skenë nga Teatri Kombëtar. Nxënësit mund të diskutojnë për veshjet, skenën dhe karakteristikat e personazheve që vijnë nga loja në role.

Klasa ndahet në tri ose katër grupe.

U kërkojmë nxënësve që të gjejnë dramën e plotë dhe të përzgjedhin fragmente të ndryshme ku marrin pjesë sa më shumë aktorë. Brenda çdo grupi ndahen detyrat për kostumet, skenën, muzikën dhe mënyrën e realizimit të tyre.

Ora II. Të folurit

Gjatë kësaj ore nxënësit, pasi kanë bërë prova të pavarura, bëjnë një provë të përbashkët për të përcaktuar se si do të realizojnë skenën, veshjet dhe muzikën.

Ora III. Të dëgjuarit

Nxënësit shfaqin pjesët e dramatizuara dhe secili nxënës mund të diskutojë rreth paraqitjes së shokëve.

Në këtë orë bëhet votimi i nxënësve për dramatizimet më të mira.

Përshkrim i produktit të projektit:

Projekti ka për qëllim ta pajisë nxënësin me kompetencat e mësipërme dhe të përforcojë disa rezultate të të nxënit sipas kompetencave të fushës: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, njohurive gjuhësore.

Në përfundim të tij, nxënësi/ja:

prezanton një material të realizuar prej tij;

e interpreton atë duke argumentuar tematikën, por dhe llojin e tekstit të përdorur;

bashkëpunon me persona të ndryshëm për të arritur qëllimin përfundimtar, realizimin e dramës.

Mënyra e prezantimit:

Çdo grup prezanton lojën e tij në role.

Vlerësimi:

Vlerësim me gojë, me notë dhe vetëvlerësim.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kalemi, Natasha

Gjuha shqipe 7 : libër mësuesi për tekstin shkollor /

Natasha Kalemi, Luljeta Noka; red. Natasha Pepivani, Dorina Basha. –

Tiranë, etj. : Albas, 2016.

304 f. ; 20.5x27.5 cm.

ISBN 978-9928-02-787-0

I. Noka, Luljeta

1. Gjuha shqipe 2. Tekste për mësuesit

3. Tekste për shkollat 9-vjeçare

811.18 (072) (075.2)